

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814.09
Ø 5c

Dilaver
Dilaveri

Nëpër
faqet
e prozës
sonë

884.08
/ 850

DILAVER DILAVERI

NEPER FAQET E PROZES SONE

(Artikuj kritikë)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

**PROBLEME
TË PROZËS SONË
TË GJATË**

ZHVILLIMI REVOLUCIONAR I REALITETIT DHE PASQYRIMI I KONTRADIKTAVE TË TIJ NË PROZËN TONË

Pasqyrimi i jetësores në art e në letërsi ka si kërkesë ndër më kryesoret paraqitjen me vërtetësi të kontradiktave në konfliktet letrare të veprave, në çdo gjini apo lloj letrar.

Plenumi i 4-t i KQ të PPSH ndër të tjera theksoi edhe një herë me forcë mësimin e Partisë për konfrontimin e përhershëm të krijimeve letrare me realitetin e gjerë jetësor, me mendimin revolucionar të masave, si mënyrën e vetme të pagabueshme për vlerësimin e sukseseve apo të dobësive në krijime të letërsisë dhe të artit tonë. E theksojmë këtë pohim të njojur për të vënë në dukje se arti dhe letërsia janë në vlerat e tyre pozitive i kanë qëndruar përherë pranë dhe e kanë pasqyruar besnikërisht zhvillimin revolucionar të realitetit. Tri dekadat e ndërtimit të socializmit të jetuara tashmë, janë dhe përbëjnë epokë të madhërrishme në historinë shumëshekullore të popullit tonë dhe një bazament për të ardhmen. Ato u kaluan hap pas hapi, vit pas viti, në luftë të ashpër për jetë a vdekje në shumë fronte, me armiq të shumtë e të shumëllojtë, prandaj janë të lavdishme dhe të pavdekshme.

Shkrimtarët tanë duke qenë dëshmitarë të këtij zhvillimi, të vrullshëm revolucionar, nëpërmjet luftës së të kundërtave, nëpërmjet kontradiktash të fuqishme anta-

goniste dhe joantagoniste, e reflektuan aktivisht këtë proces të zhvillimit ekonomiko-shoqëror që në kriji met e para, kur nisi rrugën e zhvillimit të vet letërsia jonë e realizmit socialist. Është fakt se qysh në vitet e para reformat e mëdha të pushtetit popullor, qofshin ato me karakter demokratik apo socialist, u realizuan në luftë të mprehtë pér jetë a vdekje me reaksionin e brendshëm e të jashtëm. Vrasjet e militantëve komunistë, diversionet e bandave të armikut, sabotimet në veprat e para të socializmit: në hekurudha, tharje kënetash etj. nga armiq të hapur dhe të fshehur, si dhe frikësimet e shantazhet që synonin të mbillnin përçarje, panik e mosbesim te pushteti i ri popullor, qenë shprehje të rezistencës së klasave të përmbysurës në dëm të triumfit të së resë socialiste. Është e kuptueshme se triumfi mbi krejt këtë botë të errësirës dhe mbi gjithë përpjekjet e makinacionet e saj, që sa heroik edhe emocional e frysmezues.

Reflektimi më i parë i zhvillimit të realitetit në-përmjet kontradiktash të mprehta e të fuqishme u duk te një numër i konsiderueshëm tregimesh të atyre vitezave, të cilat shpejt u ndoqën nga novelat e para e më pas, nga ndonjë dramë, që e përqëndronte vështrimin jo vetëm në pasqyrimin e thjeshtë të realitetit ekonomiko-shoqëror të kohës, por madje tentonte ta zbërtethente atë me një vështrim të thelluar. Janë të njoitura e mbeten suksese pér kohën ku u krijuan nove-la të tilla si «Bereqeti» e Zihni Sakos dhe «Ujët fle, hasmi s'fle» e Fatmir Gjatës. Në këto krijime, e në shumë të tjera, vërehet dhe është kryesor synimi përtë zbuluar emocionalist idenë që asnjëherë s'duhet humbur vigjilencia, se rezistenca e klasave të përmbysurës, pavarësisht formave që mund të marrë në situata e rrethana të ndryshme, në esencë mbetet pérherë e egër dhe armiqësore pér idealet tona të ndërtimit të botës së re.

Një ide edhe më të mprehtë përftojmë po në këtë plan të pasqyrimit letrar të realitetit, në dramën e sukseshme «Toka jonë» të Kolë Jakovës. Mendimi i madh

e i vërtetë i kohës që zberthehet nga kjo dramë, se rruga e fitoreve tona ka qenë dhe mbetet rruga e luftës, e sakrificave dhe e heroizmave, na komunikohet me forcë dramatike. Fati i heronjve, i masës së gjerë të fshatarësisë në ato vite të realizimit të ëndërrës së saj shekullore për tokë, si dhe fati i heroinës së dramës, Lokes, janë gërshtuar e thurur në funksion të kontradiktës së madhe me armikun e brendshëm, i cili, në një luftë për jetë a vdekje, iu kundërvu zbatimit të Reformës Agrare që po kryente populli ynë i udhëhequr nga Parta.

Vitet më pas thelluan dhe konsoliduan gjithmonë e më shumë fitoret e arritura. Pesëvjeçarët e parë, veprat e para të industrisë sonë të re, uzinat, kombinatet e hidrocentralet, bënë që jo vetëm atdheu të marrë një faqe të rë, por njëkohësisht ndikuan në çrrënjosjen e asaj pjese të kalbur të botës shpirtërore, të mentalitetit feudo-patriarkal apo mikroborgjez, për t'i hapur rrugë asaj që do të përbënte njërin prej qëllimeve kryesore të Partisë në këtë revolucion, triumfit të ndërgjegjes së re, të njeriut me botëkuptim revolucionar e me moral proletar. Ky proces transformues, njëri prej më të vështirëve që sjell dhe synon të realizojë revolucioni, kërkon luftë të pandërprerë e për një kohë të gjatë me një armik shpeshherë të padukshëm, por të egër, me mentalitetin e mykur të shoqërisë, që si mentalitet i formuar ndër shekuj, mbart në vete gjurmë të thella të koncepteve nga më të ndryshmet për njerëzit, marrëdhëni midis tyre, për fenomenet e natyrës apo të shoqërisë, për etikën dhe filozofinë në etapa të ndryshme të zhvillimit historik të kësaj shoqërie. Lindjes dhe fitores së ndërgjegjes së re të shoqërisë sonë socialiste iu desh dhe i duhet ende sot të ndeshet me botëkuptimin e trashëguar apo më saktë, me një përzierje botëkuptimesh ku s'është e vështirë të dallohen ndikime të huaja që nga ai feudal-patriarkal, ku janë të dukshme roli negativ i fesë, i kanunit, i mënyrës anadollake të të menduarit, e deri në pseudoetikën dhe pseudomo-

ralin modern, ku gjithashtu s'është e vështirë të njihen ndikimet çoroditëse të moralit dhe të ideologjisë borgjezo-revizoniste si dhe të botëkuptimit mikroborgjez, si forma nga më të rrezikshmet e më të parat me të cilat është përleshur e po përleshet shoqëria jonë, morali i saj.

Shfaqja e rëndësishme e përpjekjeve dhe e realizimeve të mëdha që janë arritur dhe po arrihen, shenjë e pjekurisë së letërsisë dhe e krijuesve të saj, është trajtimi dhe pasqyrimi me partishmëri e pjekuri letrare i ndeshjes, i kontradiktave qofshin ato me natyrë antagoniste ose joantagoniste. «Isha unë Çobo Rrapushi» novelë e Shevqet Musarajt, pa dyshim është një ndër realizimet më të mira të kohës kur u botua.

Ndonëse kontradikta mbetet në terrenin moral dhe me një kundërshtar të pakonkretizuar, novela nën-vizon me forcë artistike idenë e flakjes së vetëkëna-qësisë, idenë e largimit nga dëshira për rehati personale. Për njeriun tonë duhet të jetë i huaj mendimi apo pretendimi që të tërhiqet nga lufta, nga përpjekjet, nën pretekst se e ka kryer detyrën që i takon. Njerëzit tanë më të mirë, që i dhanë gjakun lirisë, s'duhet të mënjanohen prej rrugës së luftës së mëtejshme. Rruga e Çobos, tipizuese dhe përgjithësuëse për një kategori të paktë njerëzish, është shprehje e kontradiktës joantagoniste të jetës sonë. Duke ironizuar me vvetven, me mënyrën e të menduarit e me konceptet e tij të mëparshme, personazhi kryesor i novelës kundërve në një kontradikcion joantagonist dy qëndrimet e tij. Kështu shkrimitari realizon në novelë qëndrimin tendencioz të partishëm kundër elementeve regressive në ndërgjegjen dhe botëkuptimin e njerëzve tanë, pa mohuar mbartësit e atij morali, të asaj ndërgjegjeje, por duke synuar kryesisht në pastrimin, në riformimin e tyre botëkuptimor revolucionar.

Teoria shkencore e revolucionit dhe e triumfit të socializmit, e ka bërë më se të qartë se kontradiktat

jetësore të çdo lloj natyre qofshin, nuk shfaqen as nuk ekzistojnë veçmas. Ato janë të ndërthura e të gërshtuara, ato ndikojnë te njera-tjetra dhe s'është aspak e pamundshme që nga kontradiktat joantagoniste të kalohet në ato antagoniste. Rreziku i një kapërcimi të tillë është edhe më i mundshëm kur harrohet lufta kundër tyre, kur u bëhen lëshime të paparimta mbartësve dhe përfaqësuesve të tyre, që lehtësisht mund të bien në darën e ndikimit të armikut. Indiferentizmi ndaj tyre është i pafalshëm sepse është vdekje-prurës për socializmin.

Në vitet pesëdhjetë kur proza jonë lëvroi me sukses romanet e saj të parë, ashtu si në të gjitha gjinitë letrare të njoitura e të lëvruara më parë, edhe në roman zuri vend konflikti i madh i realitetit jetësor, i fenomeneve të zhvillimit të tij, si pasqyrim i kontradiktave që vlonin në gjirin e shoqërisë shqiptare të atyre viteve. Romane të tilla si «Kënetë» dhe «Afërdita përsëri në fshat» janë ndër të parat vepra të kësaj gjinie të gjatë, që me forcë e realizëm na kanë transmetuar epokën plot kontradikta të kohës, kur gërshtetoheshin e bashkëvepronin kundër së resë socialiste armiku i jashtëm dhe i brendshëm po ashtu edhe forcat e errësirës, të zakonit e të moralit të mykur konservator.

Pa vështruar se si u shtrua dhe u zgjidh ky aspekt jetësor në romanet me temë Luftën tonë Antifashiste Nacionalçlirimtare, në të dy romanet e sipërpërmendura ai u shtri më gjëresisht. Kështu te «Kënetë», roman i F.Gjatës, shumë harmonikisht, në përputhje me vetë realitetin jetësor, lufta për realizimin e një vepre të parë të ndërtimit të socializmit bëhet arenë e kontradiktave nga më të ndryshmet. Në një plan, romani i lë vend tentativave të egra të armikut të klasës që, i dirizhuar, i frysmezuar dhe i paguar nga imperializmi amerikan, bën ç'është e mundur jo vetëm të sabotojë një vepër bonifikuese, por edhe të dëmtojë themelin e fitoreve tona, unitetin Parti-popull, duke ngjallur mosbesim dhe dy-

shim në mundësinë e realizimit të ndërmarrjeve të atilla, kurse në planin kryesor diapazoni i gjerë i veprës ka bërë që në pasqyrimin artistik të jetës të gjejnë vend një masë e gjerë problemesh të tjera që nga lufta kundër ngurimit për të përqafuar jetën e re e deri të konfliktet që lindin mbi bazën e kontradiktave joantagoniste, ngushtësisht të lidhura me konceptet për familjen e re, për marrëdhëni midis burrit e gruas e kështu me radhë.

Periudhat e thellimit të mëtejshëm të revolucionit socialist u karakterizuan nga një intensifikim i luftës së armikut të klasës që, e kamufluar me mënyra të ndryshme përherë e më të stërholluara, synoi e synon të njëjtin rezultat, të dobësojë e mundësisht të përbysë fitoret e revolucionit tonë. Duke shpresuar në arrijen e këtij qëllimi, reaksiioni i brendshëm apo i jashtëm gjeti mbështetje në mbeturinat e botëkuptimit fetaro-konservator apo në ndikimet e drejtpërdrejta të ideologjisë borgjezo-revisioniste. Partia kurdoherë ka orientuar drejt një thelli të mëtejshëm të revolucionarizmit të ndërgjegjes së njerëzve të shoqërisë sonë në-përmjet luftës në të dy krahët: si kundër ideologjisë borgjezo-revisioniste ashtu edhe kundër mbeturinave e shfaqjeve të botëkuptimit patriarkalo-konservator. Ky orientim çoi peshë masën e gjerë të popullit e sidomos të rinisë, rriti fryshten revolucionare, mprehu vigjilencën në shumë drejtime e aspekte të kohës kundër formave e metodave frenuese dhe të dëmshme që përdorte armiku.

Proza e gjatë e kësaj etape të zhvillimit tonë letrar u ngjiz dhe u brumos tërësisht me brendi jetësore. Në veprat më të mira të romancierëve, me përvojë të gjatë apo fillestare në këtë zhanër, zuri vend qendror larmia e kontradiktave të kohës. Është fakt që një vend të dukshëm në raport me të tjerat, zuri tema e fshatit dhe e fatit të gruas (kryesisht fshatarë) në këtë periudhë të revolucionarizmit të ndërgjegjes. Në romane të tillë si «Kullat» i Gj.Zhejit, «Një lindje e vështirë» i E.Kadaresë. «Juga e bardhë» i

J.Xoxës, «Zjarre» i S.Spasses dhe «Tokë e ashpër» i T.Laços zotëron kontradikta e luftës midis së resë revolucionare, që po fitonte terren në jetën e fshatit të ri, ashtu sikurse në gjithë jetën tonë, me të vjetërën që përpëlitez por s'hiqte dorë apo që me vështirësi i lëshonte pozitat e saj.

Kështu zhvillimi shoqëror, raportet etiko-morale të lindura mbi bazën e re ekonomike, u hapën horizont krijuesve, sidomos romancierëve, që ta pasqyronin vërtetësisht fizionominë tonë sociale në këtë etapë zhvillimi. Romane të tilla si ata që përmendëm më sipër synon dhe me sukses realizuan, në elementët e tyre kryesorë, rikrijimin emocional artistik të tablove jetësore, duke përcuar me tendenciozitet idetë e fuqishme transformuese të Partisë. Megjithëse me tematikë të përafërt, të gjitha këto vepra kanë tipare dhe vlera të individualizuara në atë masë saqë ato ruajnë mvehtësi të plotë nga njëra-tjetra. Nëse ne arrijmë në një konkluzion të tillë, kjo i dedikohet, përpos shumë të tjerave, edhe faktit që këta autorë kanë ditur ta kapin në mënyra të ndryshme e origjinale tëmën dhe kanë vendosur në themel të saj konflikte apo kontradikta tipike kryesore për jetën dhe zhvillimin tonë shoqëror. Së dyti, është pér të vënë në dukje se materiali i pasur jetësor që është derdhur në këto romane u ka dhënë dorë autorëve që të pasqyrojnë realitetin në përmjet një sërë konfliktesh të mëdha apo të dorës së dytë, të jetës shoqërore apo asaj familjare dhe intime. Dhe kështu duhet të ndodhë. S'ka se si shkrimtari ynë të mund të pasqyrojë realitetin pa e marrë atë në unitet, pa njojur mirë raportin e drejtë midis pjesës dhe së tërës, të veçantës dhe të përgjithshmes. Teodor Laçoja te «Tokë e ashpër» ka gërrhetuar përpjekjet e mëdha për zhvillimin e kooperativave të prapambetura, me luftën për fitoren e botëkuptimit të ri, luftë ku përplasen mentalitete nga më të kundërtat lidhur me ndërgjegjen ndaj punës, me mënyrën e re të konceptimit të marrëdhënieve familjare etj. Kurse te «Juga e bardhë» kontradikta jetësore ruan origjinali-

tëtën e saj se lidhet me shfaqje negative të rralla jetësore, të trupëzuar në figurën e një tirani të vogël si Kiu Koroziu. Dhe jo vetëm kaq. Pas këtij aspekti kryesor shumë funksional, në vepër shtrohen dhe marrin zgjidhje një sërë kontradiktash të tjera duke nisur me ato më kardinalet si dallimet fshat-qytet, punë mendore-punë fizike dhe duke arritur deri në përpjekjet përfundimtare e kooperativave të bashkuara, apo tek ato lidhur me një mori problemesh etiko-morale të rinisë, të familjes, të shoqërisë.

Romani i viteve të fundit, përvèç të tjerave, ka edhe meritën se bëri më shumë në pasurimin e gamës problelore të kësaj gjinie, dhe për pasojë, mundi të përfshijë më gjerësisht konfliktet si reflektim të kontradiktave jetësore. Përpos atij aspekti të sipërpermendur të realitetit tonë të sotëm, që ka gjetur vend me origjinalitet në shumë romane të tjera, romani i viteve të fundit ka pasqyruar nëpërmjet një realizimi të bukur artistik edhe në jetën e klasës punëtore, e në këtë drejtim ka bërë hapa të rëndësishëm përpara. Në veprat e «Përsëri në këmbë» e Dh.Xhuvanit kontradikta, ndonjëse duket sikur ka një natyrë thjeshtësisht personale, nuk mabetet në këtë sferë të ngushtë. Ajo, e vështruar në planin e madh shoqëror në kuadrin e heroizmit masiv për ndërtimin e socializmit në konditat e bllokadës së egër borgjezo-revizoniste, merr forcë përgjithësuese si një mishërim i qëndrimit revolucionar masiv. Din Hyka me luftën e tij duhet vështruar si simbol i pastërtisë e forcës shpirtërore të njeriut të ditëve tona, i njeriut të ushqyer e të frymëzuar me ideat e Partisë. Konflikti të fuqishëm e me shumë interes për të sotmen e realitetit tonë, si pasqyrimi të ditëve që po jetojmë, lidhur me formimin e kalitjen e moralit proletar në ndërgjegjen e masës së gjerë, ndeshim në romanet «Fan Smajli» i Dh.Xhuvanit, «Dasma» i I.Kadaresë etj. Kontradikta midis botëkuptimit patriarkal e mikroborgjez dhe botëkuptimit të klasës punëtore në fuqi, zhvihet mprehtë në jetën tonë. Morali ynë i ri lufton dhëmb për dhëmb me shfaqje të meskinitit, egoizmit mikro-

borgjez, patriarkalizmit dhe liberalizmit. Ai çdo ditë fiton terren, bën për vete elementë të rinj të shoqërisë sonë, duke i zhveshur ata nga mbeturinat që mbartin. Por kjo nuk kryhet lehtësisht as spontanisht. Në romanet e sipërpërmendura këto kontradikta është zgjidhjet e tyre janë pasqyruar të realizuara me luftë e përpjekje.

Sikurse theksuam më lart, në të gjithë shembujt e përmendur si dhe në shumë vepra të tjera dallohet si veçori e pasqyrimit të kontradiktave jetësore, gërshtimi i antagonisteve me joantagonistet. Edhe në romanet ku zotëron lufta e shoqërisë sonë me mbartësit e botëkuptimit të mykur apo të huaj (në të dy rastet armiqësor), që më shumë e përfshijnë kontradiktat joantagoniste, ndihet edhe aspekti ndonjëherë antagonist. Kjo spikat sidomos e kryesisht kur mbartës i tyre bëhet elementi armik. Kështu te «Tokë e ashpër», krahas kontradiktave të tjera, merr shtrirje e zgjidhje edhe kontradikta me armikun e klasës, ish-kulakun, Shabanin, që përfundon në duart e organeve të drejtësisë; te «Dasma» mbetet mbartës i antagonizmit klasor shkesi, njeriu me lungë, që shfrytëzon forcat e errëta të kënnunit për të përcarë e për të dëmtuar etj.

Në këtë aspekt të mpleksjes së kontradiktave, të pasqyrimit të tyre realist në vepra letrare me mjete specifike të letërsisë, proza jonë e gjatë, po ashtu si edhe krejt llojet e tjera të letërsisë, janë udhëhequr e kanë realizuar mësimin e madh të Partisë të konkretizuar esencialisht në thënien e shokut Enver që: «Në art, ashtu si në të gjitha fushat e ideologjisë, ka luftë klasash. Kjo, luftë është shprehje e luftës midis ideo-logjisë proletare dhe ideologjisë borgjeze, midis realizmit socialist dhe rrymave artistike reaksionare borgjeze, që në mënyra të ndryshme ushtrojnë presion mbi njerëzit tanë».¹⁾

Prandai kërkesa jonë për një konflikt real, të fuqishëm dhe tipizues, që të shprehë fenomenet dhe tendencat më pozitive të kohës, të nxjerrë në arenën

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», fq. 478.

e ndeshjes mbartësit e këtyre tendencave, njerëzit tanë, ndërtues të shoqërisë socialiste, buron nga tiparet e veçoritë e jetës sonë revolucionare dhe s'është aspak një kërkesë subjektive e diskutueshme. Prania e konflikteve të tilla, si shprehje e kontradiktave jetësore, në romanet tona, është kusht kryesor që përcakton vlerat e tjera të tyre. Edhe personazhet, edhe linjat e subjektit, edhe kompozicioni apo krejt stili i shkrimtarit, në një masë të konsiderueshme varen dhe lidhen drejtpërdrejt me konfliktin që vendos shkrimtari në qendër të romanit të vet. Një konflikt i rëndësishëm, i fuqishëm, kërkon edhe karaktere mbartës të fuqishëm, përfaqësues të denjë të klasës në fuqi, luftëtarë të paepur dhe fitimtarë në përlleshjet e mëdha klasore.

Por me gjithë karakterizimin pozitiv që mund t'i bëjmë në këtë vështrim romanit tonë, sikurse në tërësi letërsisë sonë, në ndonjë vepër të veçantë, në periudha të ndryshme të zhvillimit të letërsisë sonë e sidomos para Plenumit të 4-t të KQ të PPSH, si pasojë e teorive armiqësore dhe e teorizimeve të gabuara, në ndonjë roman, ndonëse më pak se në llojet e tjera letëra, pati mënjanim nga konfliktet e forta antagoniste. U ndie një farë zbutje e tyre dhe zotëroi, ku më qartësisht e ku më pak, tendencia për t'u marrë vetëm me kontradiktat, joantagoniste.

Shoku Enver në Plumin e 4-t të KQ të PPSH theksoi se: «*Zbulimi i kontradiktave e pasqyrimi i tyre në art, duke përfshirë këtu edhe kritikën e fenomeneve negative, duhet bërë drejt, nga pozitat e partishmërisë proletare, nga qëllimi që ato të kapërcehen dhe shoqëria të shkojë përpara dhe jo të mbetet në darën e kontradiktave».¹⁾*

Kjo kërkesë, që mund të themi se është realizuar denjësisht në shumë romane, sidomos me temë Luftë Antifashiste Nacionalçlirimtare, nuk është arritur përherë ashtu si duhet në romane me temë nga jeta jonë

1) Enver Hoxha. Raport në Plumin e 4-t të KQ të PPSH, fq. 34.

e sotme. Mosnjohja e thellë e kontradiktave jetësore, antagonistë dhe joantagoniste, ndonjëren nga veprat tona (romanet) e ka çuar në rrumbullakosje dhe zbulurim të trilluar e të panevojshëm në zgjidhjen e konfliktit letrar (kujtojmë romane si (Brezat» apo mbylljen, pjesën e fundit të ndonjë romani si «Vlaga e dheut»). Nga ana tjetër, edhe tendenca për ta mbingarkuar romanin me një mori kontradiktash joantagoniste, duke synuar që të zgjidhen të gjitha në treqind apo katërqind fakte, jo vetëm do ta shtynte autorin që të mos i motivonte dot ato zgjidhje, por do të krijonte, dhe ndonjëherë e ka krijuar, përshtypjen ireale që, në pak qindra metra katrore vend në të cilat shtrihet hapësira e një fshati, të jenë mbledhur krejt të zezat e gjynahet e mundshme, siç ndodh në romanin «Stuhia», që siç është e kuptueshme, e ka shtyrë autorin në zgjidhje ireale e artificiale.

Të tillë të meta, qofshin dhe shumë pak të ndjeshme në realizimet e prozës sonë të gjatë, duhen mënjanuar dhe ekzistojnë mundësítë e plota për t'i mënjanuar, për shkak të vetë natyrës vitale e pozitive të jetës sonë, ku zoteron ecja përparrë, fitorja mbi botën e vjetër dhe mbi botën e urryer borgjezo-revisioniste, mbi ideologjitetë e tyre të mykura e të helmatisura.

1974.

PËR TË MBAJTUR PËRHËRE TË PASTER BRENDINË SOCIALISTE TË LETËRSISE SONE

Brendia socialiste shprehet në përbajtjen jetësore të veprave tonë, në pasqyrimin e marrëdhënieve të reja socialiste në shoqëri e në prodhim, në theksimin dhe evidencimin e fenomeneve pozitive të forcave që lëvizin e çojnë përpara shoqërinë, në interpretimin e drejtë marksist-leninist të ngjarjeve e fakteve historiko-shoqërore, në paraqitjen e gjithçkaje të bukur dhe me vlerë që ka ruajtur në shekuj shqiptari në emër të dëshirës për çlirim kombëtar e shoqëror.


Në veprat më të mira të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë të pendës ka zënë vend zotëruesh paraqitja e realitetit të gjallë revolucionar, problemet e mëdha shoqërore të së djeshmes apo të sotmes, realiteti heroik i viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Sidomos një vend të rëndësishëm në veprat letrare ka zënë njeriu ynë i ri me tipare morale të reja, me ndërgjegje dhe botë shpirtërore të pasur, me interesa e shqetësimë sociale, i çliruar përfundimisht prej guaskës mikrobor-gjeze; jeta, puna dhe aktiviteti i të cilit u shkri e u harmonizua me jetën e madhe të të gjithë shoqërisë.

Në romane me temë nga Lufta heroike Antifashiste Nacionalçlirimtare (pa u ndalur në morinë e madhe të tregimeve), siç mund të përmendim ndër më kryesoret «Para agimit», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Komisari Memo», «Një vjeshtë me stuhi» etj., apo në romane ku është trajtuar si tema e së kaluarës

së mjerë të paraçlirimt ashtu edhe realiteti aktual në shumanshmérinë e vet si te «Kéneta», «Lumi i vdekur», «Kronikë në gur», «Pérséri në këmbë», «Kullat», «Fan Smajli», «Zbulimi» etj., ndihet fuqishëm brendia e re, brendia socialiste, kualitativisht e dallueshme qoftë edhe nga brendia e veprave më përparimtare të traditës letrare demokratike të së kaluarës. Ky dallim cilësor i brendisë në veprat e letërsisë sonë të realizmit socialist shprehet kryesisht në pasqyrimin realist e me vërtetësi të jetës në zhvillimin e saj progresiv dhe në interpretimin e drejtë të këtij realiteti nga pozitat e ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Në këtë kuptim shkrimitarët, duke pasur një njohje të plotë e të thelli të materialit jetësor, kanë seleksionuar dhe operuar mbi të ngaqë kanë pasur të qartë atë që kanë dashur të thonë. Ky qëndrim, ky këndvështrim i realitetit në transplatin artistik të jetës, u ka dhënë veprave tendenciozitetin e duhur klasor, frymën militante, partishmérinë e qartë proletare.

Tendencioziteti në letërsi dhe art ka ekzistuar në të gjitha periudhat historike. Por partishmëria e letërsisë dhe e arteve tona, e shkrimitarit dhe e artistit të shoqërisë sonë, është e një cilësie të re. E bazuar nga ana teorike mbi një sistem të thelli e konsekuent njo-hurish pér ligjet e zhvillimit të shoqërisë ajo përmban një vetëdije politike të shkrimitarit dhe të artistit në një shkallë shumë më të lartë, sepse ushqehet nga vija politike e Partisë sonë.

Në këtë tipar themelor të letërsisë sonë, duhet të kuptojmë qëndrimin e drejtë ideoemocional të shkrimitarit kur ai merr të na flasë pér të djeshmen, Luftën Antifashiste Nacionalçlirimitare apo të sotmen e jetës së popullit tonë. Kështu Jakov Xoxa te romani «Lumi i vdekur» ka në qendër të vëmendjes realitetin e djeshëm shqiptar, kur mbi fshatarin rëndonte zgjedha shumëfishe e sistemit shoqëror dhe e pushtetit shtetëror anti-popullor. Në këtë brendi jetësore shquhet simpatia e shkrimitarit tonë pér masën popullore dhe përbuzja e qëndrimi demaskues i tij ndaj sundimtarëve dhe for-



cave të errëta, që synonin të mashtronin popullin dhe të përjetësonin të drejtën e tyre për shfrytëzim. Paraqitja e rritjes së protestës popullore, e zemërimit dhe e revoltës së masave kundër shtypjes dhe shfrytëzimit në romane si «Ata nuk ishin vetëm» i S.Spasses, ku në masën zotëruese është dhënë jeta e vegjëlisë, shqetësimet e mëdha të saj që qenë dhe shqetësimet më kryesore të kohës apo fakti që në disa vepra të tjera si te «Kronikë në gur» e I.Kadaresë, shkrimtari përmes brendisë jetësore ka zbuluar lëvizjen e thellë sociale që kishte përfshirë shoqërinë shqiptare të asaj kohe flet për brendinë e re socialiste të romaneve tona me temë nga e kaluara historike, flet për faktin që vetë jeta e asaj periudhe historike që përfshihet në këto e të tjera vepra, e kishte elementin progresiv që autorët tanë e ngritën dhe e përgjithësan artistikisht.

Në një përfundim të tillë do të arrijmë edhe po të gjykojmë për romanin «Komisari Memo». Mënyra se si i zgjedh shkrimtari faktet jetësore që vendos në vepër e në episodet qendrore të subjektit të saj, nëpërmjet të cilave shpaloset ideja kryesore e veprës, simpatitë dhe antipatitë e autorit ndaj tipave dhe karaktereve, prioriteti i pozitives në raport me negativen në roman (si një domosdoshmëri që rrjedh nga realiteti ynë objektiv), janë shfaqje të brendisë socialiste të veprave tona ku spikat roli aktiv i shkrimtarit ndaj asaj që krijon. Po kështu, në një sërë veprash të tjera me temë aktuale që i përmendëm më sipër, në dhjetëra tregime ndër më të realizuarit, si edhe në shumë poezi e poema, apo në disa drama që janë vlerësuar nga kritika letrare dhe janë mirëpritur nga spektatori, kemi një qëndrim të përcaktuar të krijuesve, një tendenciozitet e partishmëri të shprehur me art nëpërmjet brendisë socialiste.

Le të marrim sa për ilustrim të mendimit të mësipërm romanin «Juga e bardhë». Te kjo vepër shkrimtari ka qëmtuar nga jeta ato fenomene, ato karaktere që përgjithësojnë dhe tipizojnë vetë kohën dhe njerëzit tanë në një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë

sonë. Problemi i luftës që duhet bërë kundër burokratizmit, i rrezikut që paraqet kjo mbeturinë në ndërgjegjen e njerëzve tanë, i dhënë në një mishërim të realizuar në figurën e Kiut, «tiranit të vogël» të fshatit dhe kundërvënia me dinjitet e komunistit Adnan me tërë bagazhin pozitiv të njeriut të lidhur dhe të afërt me masën, në mes të shumë ngjarjeve dhe personazheve të tjera, dëshmon për brendinë e re socialiste që ka sot romani ynë. Një brendi të tillë, me veçantitë dhe originalitetin e shkrimtarit, me vulën e individualitetit të tij, do ta gjejmë edhe te romane si «Tokë e ashpër», «Dasma», «Zbulimi», «Një lindje e vështirë» etj.

Në këtë vështrim, brendia e veprave tona letrare duhet të jetë e tillë që, siç e ka theksuar Partia, të përfshijë pasqyrimin më të gjerë e më të thellë të luftës, të jetës dhe të punës së popullit, të idealeve dhe aspiratave të tij. Ky të jetë problemi kryesor që duhet të térheqë vëmendjen e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë.

Por, sïkurse theksoi edhe Plenumi i 4-t i KQ të PPSH, për shkak të mosnjohjes së jetës, të subjektivizmit si edhe të ndikimeve të huaja borgjezo-revizoniste, u vunë re shkarje e devijime nga fryma e shëndoshë e letërsisë sonë, gjoja për hir të «novatorizmit», që tek autorë të ndryshëm në poezi, prozë apo dramë që kuptuar dhe pasqyruar së prapthi. Dhe kështu, në emër të këtij «novatorizmi», u manifestua në krijime letrare prirja e ndonjë shkrimtari për të vendosur në qendër të veprave anët negative të jetës apo fenomenet negative të shoqërisë, madje duke i përgjithësuar ato. Kjo mënyrë të paraqituri të realitetit, edhe pse shkrimtari niset nga pozita dhe qëllime të shëndosha ideore, për të edukuar nëpërmjet demaskimit të fenomenit negativ, krijon përshtypjen ireale sikur ky, fenomeni negativ, prediminon në jetë, duke shtrembëruar kështu pasqyrimin e realitetit.

Natyrisht vepra militon edhe kur shkrimtari niset të demaskojë shfaqjet negative me një pikësynim të shëndoshë ideor, duke kundërvënë forca dhe elementë

pozitivë, që i shesh realisht dhe i paraqet me forcë bindëse, me vërtetësi përballë negatives, sepse tipikja e jetës te ne, ajo që e karakterizon ecjen përpara të shoqërisë sonë socialiste është fenomeni pozitiv dhe lufta e vazhdueshme që bëjmë për t'i hapur rrugë atij. Shembulli pozitiv, qëndrimi optimist ndaj problemeve, detyrave e vështirësive që dalin përpara në rrugën e ecjes sonë drejt socializmit dhe komunizmit, është karakterizues për jetën tonë, prandaj duhet të jetë dhe është karakterizues dhe tipik edhe në veprat tona (le të sjeillim nëpër mend këtu morinë e veprave tona të të gjitha gjinive që e trajtojnë kështu realitetin jetësor).

Shkarje dhe shtrembërime të brendisë socialiste, që u vunë re në ndonjë nga veprat, lindën edhe për hir gjaja të thellimit të realizmit. T'i kundërvihesh skematismit, (që edhe ky më vetvete e shtrembëron realitetin jetësor dhe tregon që autori s'e njeh mirë jetën, s'i njeh forcat e saj lëvizëse dhe s'arrin të shohë perspektivën e zhvillimit shoqëror) s'do të thotë të mohosh çdo gjë të shëndetshme e pozitive që me luftë kundër së vjetrës lind çdo ditë në realitetin tonë. Të jesh realist s'do të thotë as të zbukurosh dhe as të nxish realitetin, por ta pasqyrosh me vërtetësi dhe në mënyrë bindëse atë, duke u mbështetur në njohjen e thellë të ligjeve të zhvillimit të tij dialektik. Tendenca e gabuar për ta dhënë jetën tonë me të meta edhe atje ku nuk ka, apo me karaktere të po kësaj natyre (negativë), mbart me vete gjithmonë mündësinë për ta shtrembëruar atë realitet, për ta deformuar brendinë e veprave tona.

Të tilla shtrembërime të brendisë së shëndoshë socialiste u manifestuan edhe në krijime të prozës sonë. Duke mos e kuptuar drejt luftën e Partisë kundër burokratizmit dhe elementeve të tjera negative, që shfaqen si mbeturina nga e kaluara, apo si ndikime të huaja në jetën tonë, disa autorë si Shevqet Tigani, Koço Kosta etj. në ndonjërin nga tregimet e veta i trashën tej së vërtetës këto rreziqe dhe pa dashur e shtrembëruan të vërtetën e jetës. Kjo tendencë e gabuar çoi deri në mpakjen e frysës optimiste për të ardhmen. Madje kjo

e metë zuri vend edhe në ndonjë tregim me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçirimitare, siç qe tregimi «Fushata» i S.Godos ku mungon heroizmi i madh i partizanëve tanë, romantika e luftës vigane që bëri populli ynë i prirë nga Partia dhe ku ndihet shumë lodhja, indiferentizmi dhe preokupimi pas gjërave të vogla i personazheve të tregimit, sikur ata t'i shqetësonë më shumë fati i dashurive të tyre sesa fati i luftës së madhe heroike që po bënин.

Letërsia s'ka pse t'u shmanget dhe t'i injorojë të metat. Detyrë e shkrimtarit është që t'i njoħe thellë dhe drejt ato, të vështrojë edhe përtej tyre, duke mos humbur mes tyre, por duke parë edhe forcat e vërteta zotëruese pozitive në jetën dhe realitetin tonë, që është thellësisht revolucionar, pér t'ia kundërvënë me vërtetësi dhe me forcë bindëse artistike të metave ekzistuese.

Brendinë e shëndoshë të letërsisë sonë në disa veprat e viteve të fundit, sidomos në krijimet poetike, e cenoj edhe dëshira e ndonjë autori pér «formë të re».

Rendja pas formës, importimi në mënyrë mekanike i saj vetëm pér snobizëm, dëshmojnë pér një të kuptuar të shtrembër, me kokë poshtë, të parimeve të estetikës sonë. Kjo, në mënyrë të pashmangshme e çon krijuesin në shtrembërimin e brendisë ideore të veprës.

Novatorizmi i artit tonë në radhë të parë lidhet e ka të bëjë me përbajtjen e veprave letrare. Realiteti ynë i ri, vrulli revolucionar që ka përfshirë katërprincipërisht jetën tonë, ka përcaktuar dhë përcakton edhe përbajtjen e re të letërsisë. Sigurisht kjo e vërtetë e madhe lidhur me brendinë ka bërë që shkrimtarët në përshtatje dhe harmonizim me të, të përpilen edhe pér një formë artistike më të ngritur.

Duke mos e kuptuar drejt novatorizmin, ndonjëherë, janë manifestuar shfaqje të gabuara pér të përdorur e futur forma artistike jo të diktuara nga brendia, nga nevoja pér të paraqitur realitetin jetësor në formë sa më të qartë e të goditur. Konkretisht në poezi, ten-

denca për figuracion të mbingarkuar dëmtoi brendinë e krijimit poetik. Kurse në prozën tregimtare u manifestua në maninë për stërhollime psikologjike dhe për mosidentifikim të qartë të personazhit sidomos gjatë dialogut. Pra ndonëse në raste të rralla, por ka ndodhur që të jetë zëvendësuar marrja e eksperiencës në mënyrë kritike nga arti përparimtar botëror me imitimin e thjeshtë të disa autorëve, rrymave e stileve pa njojur mirë natyrën letraro-shoqërore të tyre.

Tendencë tjetër e dëmshme dhe e dënueshme është edhe largimi nga problemet e mëdha shoqërore, nga temat e rëndësishme e me peshë në jetën tonë. Rendja pas temave intime, pas mikrotemave, duke harruar temën dhe problematikën e madhe qytetare, ku nuk mo-hohet, por merr një shtrirje dhe zgjidhje shumë më të drejtë edhe jeta intime, problemet e individit, të jetës së përditshme, është shprehja më e qartë e largimit, e shkarjes, në disa krijime letrare të viteve të fundit, nga brendia socialiste, nga tabani kombëtar, të cilat janë vlerat e saj kryesore.

Për t'iu kundërvënë tendencave dhe gabimeve të tillë letërsia jonë, e shëndoshë dhe pozitive në masën e saj dërrmuese, duhet të ruajë me fanatizëm karakteristikat e fituara në tridhjetë vjetët e ekzistencës së vet, si një letërsi e fuqishme dhe vitale e realizmit socialist. Shkrimtarët tanë duhet të ruajnë frymën e partishme, brendinë socialistë dhe tabanin kombëtar, nëpërmjet njojjes së jetës, përvetësimit aktiv të ideologjisë revolucionare marksiste-leniniste dhe mësimeve të Partisë e të shokut Enver Hoxha.

1973.

KOMBËTARJA NË KARAKTERET DHE AMBIENTET E DISA ROMANEVE TË VITEVE TË FUNDIT

Nëse sot ekziston një thesar kulturor i përbotshëm me vlera jo vetëm për kohën kur është krijuar secila pjesë e tij por edhe për kohën tonë, madje edhe për të ardhmen, kjo pa dyshim ka ndodhur ngaqë ai është krijuar me kontributin e veçantë të shumë popujve në të, gjatë të gjitha kohërave deri në ditët tona. Kur pohojmë këtë të vërtetë, ne patjetër kemi parasysh se vlerat e kontributit të secilit popull qëndrojnë para së gjithash dhe mbi të gjitha në atë të veçantën, kombëtaren që çdo komb ka derdhur në krijimtarinë e përbashkët, duke i dhënë kështu njerëzimit veçantitë e tij etiko-morale dhe konstitucionin shpirtëror që është individual dhe i papërsërishëm nga njëra kulturë te tjetra, nga njëri popull te tjetri. Pa këtë specifikë (veçoritë nacionale të kulturës së çdo populli), nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë asnjëherë asnjë vlerë të vërtetë artistike dhe kulturore.

Është kjo arsyjeja, pra kërkesa për një letërsi, art dhe kulturë me vlera, që i ka shtyrë mendimtarët e krijuesit e vërtetë, demokratët, revolucionarët të luftonin që në vlerat shpirtërore që krijoj epoka e tyre të ndihej vula e konstitucionit shpirtëror të popullit. Ky qëndrim parimisht i drejtë erdhi e u bë më i ndërgjegjshëm, më bindës dhe i domosdoshëm kur u motivua shkencërisht me mësimet e socializmit shkencor, të botëkuptimit më revolucionar të të gjitha kohërave.

Duke e parë si një armë të proletariatit në luftë

kundër kozmopolitizmit borgjez, Lenini e shpjegoi nga pozitat e teorisë revolucionare marksiste nevojën e mbrojtjes së karakterit kombëtar të letërsisë, të artit dhe të kulturës së çdo populli, i madh ose i vogël qoftë ai. Lenini në artikullin «Tolstoi si pasqyrë e revolucionit rus», e vlerëson realistin e fuqishëm të letërsisë ruse të shekullit të kaluar ngaqë gjen në veprën e tij Rusinë e kohës, me kontradiktat antagonistë që e brenin përbrenda, me kalbësirën e feudalizmit carist dhe me revoltën e masave të gjera popullore të fshatit dhe të qytetit.

Në përcaktimin teorik të këtij elementi thelbësor për letërsinë, për artin dhe për kulturën e popullit tonë, veçanërisht për letërsinë, për artin dhe për kulturën tonë socialiste, në qëndrimin që duhet të mbajnë krijuesit e letërsisë dhe të artit tonë të sotëm revolucionar, të gjithë ne studjuesit dhe krijuesit e letërsisë dhe të artit, duhet të udhëhiqemi nga mësimet e mëdha të Partisë e të shokut Enver që, të mbështetura në komunizmin shkencor, e kanë pasuruar me përvojën e revolucionit tonë, me përgjithësimin e praktikës së krijimtarisë në këto fusha, edhe këtë aspekt të teorisë marksiste — karakterin kombëtar të letërsisë, të artit dhe të kulturës.

Ruajtja e karakterit kombëtar në përmbajtjen dhe në formën e veprave ka qenë kurdoherë tipar dallues për letërsinë tonë përparimtare militante të së kaluarës. Naimi në veprat e tij më të mira, Migjeni në krijimet e tij në poezi e në prozë, Noli në gjithë gamën e gjerë poliedrike të krijimtarisë së tij letrare dhe publicistike, duke qenë përfaqësuesit më në zë të romantizmit përparimtar (Naimi) dhe të realizmit kritik (Noli, Migjeni) pasqyruan kohën e tyre, problemet e mëdha të saj, shqetësimet e fuqishme të bashkatdhatarëve për popullin, atdheun, lirinë politike e shoqërore. Edhe pa hyrë në hollësi rrëth kësaj vllere të veprës së tyre, dallohet lehtësisht se që të tre autorët e cituar, sikurse shumë të tjerë, që ndoqën rrugën e tyre në krijimtari si demokratë dhe patriotë, kanë jetuar me pulsin e kohës, me

shqetësimet e mëdha të popullit, kanë milituar për interesat e atdheut dhe të vegjëlisë, duke urryer pushtuesin e huaj, reaksionin feudal vendës dhe gjithë recidivët e tjerë të rrjedhur syresh. Tërë këto vlera ata na i kanë transmetuar artistikisht në veprat e tyre nëpërmjet një forme të goditur e të brumosur me tipare kombëtare.

Letërsia jonë socialiste gjatë këtyre më se tridhjetë vjetëve ka ecur drejt thellimit dhe pasurimit të veprave të krijuara me elemente që kanë rilevuar më mirë se kurrë shpirtin revolucionar krijues të popullit tonë, forcën e heroizmit masiv të tij, si dje në luftën për çlirim edhe sot në punë për ndërtimin e shoqërisë socialiste, në rrëthamat konkrete aktuale të blokadave, diversioneve e shantazheve, që kurdoherë janë kapërcyer e do të kapërcehen në saje të udhëheqjes së sigurt e largpamëse të Partisë. Është pikërisht kjo udhëheqje, kjo përkrahje dhe ky kujdes i vazhdueshëm i Partisë dhe i shokut Enver, që duke u qëndruar pranë njerëzve tanë të letërsisë e të artit, i ka armatosur ata për luftë kundër çdo shtrembërimi apo shmangjeje, kundër çdo ndikimi të huaj borgjez e revisionist, kundër kaosit e zhurmës së propagandës armiqësore, e cila kurdoherë ka synuar në mohimin e kulturës e të artit kombëtar në emër të «ecjes përpara», drejt vlerave letitore artistike «tejnacionale».

Njëri nga momentet më në shenjë të sulmit, shpifjeve e trillimeve të teorive false të mendimit të sotëm borgjez dhe revisionist është karakteri kombëtar i letërsisë dhe i artit, pra qëllimi për ta mohuar këtë vëçanti të letërsisë dhe të artit. Për t'i kundërvënë këtij tipari, borgjezia imperialiste ka ngritur e mundohet të mbajë lart flamurin e kozmopolitizmit, e nevojës për «difuzion kulturor» në emër të gjoja kërkesave të kohës që e kanë «superuar» kornizën e ngushtë kombëtare në letërsi, në art e në kulturë. Është e qartë që kjo paçavure teorike e ekspansionit botëror i shërbën asaj që synojnë superfuqitë jo vetëm përmes ekspansionit ekonomik, por edhe përmes ekspansionit ideologjik.

Për këtë problem shoku Enver na mëson se:

«Borgjezia imperialiste gjithnjë është përpjekur të denigrojë apo të zhdukë traditat kulturore të popujve të vegjël, frymën kombëtare të artit e të kulturës së tyre. Kjo është një nga rrugët për realizimin e agresionit të saj kulturor e të nënshtimit të popujve. Koncepti reaksionar borgjez mbi «ndërkombetarizimin» e kulturës e të artit, mendimet se «tanimë u kapërcye fazë e shkollave kombëtare», kanë për qëllim zhdukjen e kulturave të popujve të tjerë. Në këto kushte për ne bëhet edhe më imperitative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturore të popullit. »¹⁾

Në Plenumin e saj të 4-t Partia kritikoi ato tendencia qoftë dhe të rralla por të rrezikshme që, nën ndikimin e ideve e pikëpamjeve borgjeze e revizioniste, kishin nisur të dukeshin në forma të ndryshme edhe te ndonjë nga shkrimtarët dhe artistët tanë pas maskës së «novatorizmit», në emër gjoja të luftës kundër patriarkalizmit, arkaizmit, etnografizmit, konservatorizmit etj. Ky pseudonovatorizëm që nxitej e përkrahej me qëllime të caktuara nga armiqjtë e Partisë e të popullit F.Paçrami e T.Lubonja, kërkonte t'i hapte rrugë një letërsie e një arti «modern» pa ftyrrë kombëtare, pa tematikën e kohës, pa problemet e mëdha sociale, një letërsie dhe arti amorf që synonte të minimizonte, madje dhe të zhdukte po të qe e mundur, shpirtin e vërtetë të artit tonë, partishmérinë e tij. Prandaj shoku Enver në fjalën e tij mbajtur në plenum theksoi në mënyrë të veçantë se: «Këto prirje të shtrembëra janë në kundërshtim me partishmérinë e letërsisë e të artit, me rolin formues dhe edukues, me karakterin popullor e kombëtar të tyre».²⁾

E reja e letërsisë së Partisë është se ajo, duke u mbështetur mbi gjithçka pozitive të së kaluarës, eci dhe u pasuria në brendinë e vet me realitetin e madh socialist, me idetë e fuqishme të socializmit shkencor në zgjedhjen e këndit të pasqyrimit të jetës dhe në inter-

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», fq. 319.

2) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», fq. 312.

pretimin ideoemocional të saj. Në letërsinë tonë hyri tema e madhe shoqërore në mënyrë sunduese, hyri jetë heroike e viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e viteve të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Brendia e saj u pasurua në mënyrë të pakrahasueshme me problemet e mëdha të përditshme, me vrullin e pa-përbajtur revolucionar. Ajo ka fituar, siç thotë shoku Enver, vulën kombëtare në tërësinë e saj, në unitetin e pandashëm brendi-formë.

Mbi këto parime marksiste, letërsia jonë e re është mbështetur kurdoherë fuqimisht dhe ka mundur të realizojë vepra me dinjitet artistik, vepra me brendi të shëndoshë, me problematikë të pasur dhe me forma të larne e të shumëlojta, vepra thellësisht shqiptare.

Thelbësore në dallimin e vlerave tona kombëtare, kur është fjala për krijimin e një personazhi, ca më tepër të një hero, nuk është mënyra se si flet ai, as mënyra se si vishet, ha, fle, ecën etj., që sigurisht kanë rolin e tyre në ravigjëzimin e një karakteri letrar. Thelbësore, në radhë të parë, është natyra e karakterit të tij, mënyra si mendon dhe si vepron ai në jetë, ç'qëndrim mban ndaj ngjarjeve të mëdha, se sa ai niset nga interesat e popullit të vet, të kombit të vet, sa ai, më së fundi, përfaqëson konstitucionin shpirtëror të shqiptarit.

Dihet se konstitucioni shpirtëror i popullit tonë është krijuar në shekuj dhe mbart mbi vete tipare që lindën dhe u formuan në luftën e gjatë për çlirim nga okupatorët e huaj, në luftën tjeter të madhe kundër shtypjes dhe shfrytëzimit shumëshekullor, në luftën për tokë, për liri dhe për drejtësi. I ndikuar është ai edhe nga sfera etiko-morale që përfshin doket dhe zakonet e vetë popullit, ato që ka krijuar e ka vënë ai si norma morale dhe jo ato që ia kishte imponuar i huaji dhe sundimtari për shekuj me radhë. Besa, mikpritja, bujaria, trimëria, nderi e të tjera cilësi morale, që shqiptari i ka ruajtur si njësi të matjes së virtyteve të tij, kanë formuar mentalitetin popullor për këtë problem, që përbën njëkohësisht edhe tiparet e karakterit

kombëtar shqiptar. Ky karakter nuk i është shhangur dhe s'mund t'i shhangj, në atë masë minimale të pranueshme, as vetë natyrës madhështore të truallit tonë: madhështisë dhe ashpërsisë malore të maleve, të ndërthurur me butësinë dhe ngrohtësinë e bregdetit që si të thuash, kanë gërshetuar te fizionomia morale e shqiptarëve krenarinë, shpirtin liridashës, ashpërsinë e urrejtjes ndaj armikut dhe sundimtarëve tok me dëshurinë e zjarrtë, mallin e pasuar, miqësinë e ndershme, e të përjetshme.

Spassja: në krijimin e karaktereve mban kurdoherë parasysh vlerat më të mira morale të popullit. Mjaf-ton të kujtojmë këtu linjën e Gjok shqiptarit që vdiq heroikisht duke shpërndarë abetaren e gjuhës shqipe apo dhjetëra episode të tjera deri te veprimtaria e Xole Qiraxhiut, që bën sa mundet po për këtë çështje, me librat e gazetat që bie fshehurazi nga kurbeti. Interesante në këtë plan mendoj se janë dhe figura të tjera të shumta e me elemente të theksuara kombëtare në karakteret e tyre. Le të kujtojmë p.sh. atë plakun e urtë Hamit Efendiun, pra atë plakun e mirë kovaç, që gjykon aq drejtë përherë për çdo gjë që ndodh, që është gati të bashkëpunojë me luftëtarët e çështjes së çlirimt të atdheut dhe që, së fundi, bie viktimi e egërsisë së feudalëve filoturq dhe antishqiptarë vetëm e vetëm se s'do të lejojë gjakderdhjen në mes të myslimanëve e të krishterëve.

Shkrimtari ka mundur të realizojë e të skalitë një masë të tërë personazhesh me tipare të dukshme të karakterit kombëtar duke u kapur, për realizimin e kësaj ane tek ata, kryesisht në veprimet e qëndrimet e tyre, në mënyrën si gjykojnë për ngjarjet, ç'pozicion zenë, pra në përbajtjen e ndërtimit të tyre si figura. Pikërisht në këtë vështrim kryesor i gjejmë të realizuar, sigurisht në mënyra të ndryshme e në masë të shkallëzuar, karaktere të tillë si Rexhoja, Fadili, Estrefi, Esmaaja etj. Megjithatë romani ka edhe personazhe që janë të zbehtë dhe jo aq të goditur në pikëpamje të përfqësimit sa duhet të ngjyrave kombëtare të kohës. Dobët

janë realizuar, gjithmonë në këtë pikëpamje, disa figura siç janë Orhan Pojani, Bajo Topulli, Vaska dhe disa nga fshatarët që dalin në më se një nga ngjarjet që zhvillohen në kapitujt e romanit.

Për realizim dhe vulë kombëtare në personazhet tipa që ka krijuar mund të përmendet edhe romani «Nëntori i një kryeqyteti» i I.Kadares. Karaktere të tillë si Sherifi, Javeri, Dino Sinojmeri, meqithëse janë karaktere të individualizuar, njerëz me botën e tyre shpirtërore e morale, me qëndrimin e tyre të përcaktuar e të veçantë ndaj jetës dhe ngjarjeve të mëdha të kohës, prapë mbartin në këtë individuale edhe të përbashkëtën e të përgjithshmen që lidhet me qëndrimin antagonist ndaj armikut dhe bashkëpunëtorëve të tij. Në konceptimin e tyre të përgjithshëm si personazhe letrare, shkrimitari ka arritur t'u japë ngjyrat e kohës duke i bërë mbartës të ngjarjes më të madhe të historisë së popullit tonë, Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pasqyrimi i asaj lufte, qëndrimi revolucionar antifashist, dhemburia për popullin, për çdo gjë të tij, shpirti prej fshatari të dashruar pas punës, kafshëve të punës, tokës, fshatit që gjejmë te Sherif Gorenin, i cili arrin deri aty sa të djegë shtëpinë e vet për të mos u menduar asgjë e keqe për të, janë tipare të karakterit shqiptar, që në këtë vepër shkrimitari i ka pasuruar me vlera të kohës së revolucionit tonë popullor. Të tillë janë edhe Javeri, Dino Sinojmeri, Mete Aliu. Ky i fundit mbetet i paharruar për intransigjencën e tij ndaj armikut pushtues apo të klasës, që autori na e ka komunikuar përmes mjaft detajeve në vetë natyrën e personazhit si tip i kohës, i transplatuar artistikisht në vepër. Origjinaliteti i Kadaresë në dhënen e ngjyrave kombëtare personazheve që skalit, qëndron në ato elemente shumë të goditura që ai hulumton te njerëzit e popullit për t'i nxjerrë më pas si tipare të personazheve të tij.

Në këtë drejtim autorit i ka dhënë dorë konciziteti, forca e rrallë e mjeteve artistike, të cilat ai i përdor për të gjallëruar personazhet, për t'u dhënë atyre

vulën e kohës, karakterin kombëtar. Këtë forcë përgjithësuese e përcaktuese autor i ka ruajtur edhe te personazhe që qëndruan jashtë kampit të luftës së popullit siç qenë një pjesë e intelektualëve shqiptarë që s'gjetën rrugën e vërtetë në jetë, por u mjaftuan vetëm me njëfarë mospajtimi me kohën, pa arritur deri në kundërvënie, pa mundur të lidhen me krahun e revolucionit tonë popullor, siç është në vepër Adrian Guma e ndonjë tjetër. Ky personazh me shumë elemente dhe detaje që e përcaktojnë në kohë dhe hapësirë, të bind që është i individualizuar dhe jo një përfaqësues i papërcaktuar i një kohe dhe shoqërie të çfarëdoshme. Në realitetin shqiptar të atyre viteve që fenomen i njohur ndonëse i rrallë çoroditja e ndonjë përfaqësuesi të inteligjencies së kohës. Themi kështu se dihet që ajo pak inteligjencie e kohës e kishte përcaktuar që në krye të Lëvizjes rrugën e vet: O me pushtuesin dhe klasat e larta, këtë gjë bëri shumica e intelektualëve për shkak të origjinës së tyre, o me popullin, me Luftën Nacionaletirimtare, me të cilën u bashkua krahu me progresiv i inteligjencies, ata intelektualë që kishin dalë nga gjiri i popullit. Adrian Guma duke mos përfaqësuar asnjerin nga këto dy qëndrime, është i destinuar të dështojë ashtu sikurse ndodh edhe në roman. Ajo turbullirë ideore, ajo kalamendje e pafund dhe e kotë së cilës ai ia ndjen kotësinë, por shumë vonë, që reale për një pakicë intelektualësh. Po kaq të identifikuara në negativitetin e vet janë edhe forcat e errësirës, mbeturinat e klasave të përbysura nga revolucioni që vërtiten nëpër faqet e romanit si fantazma të egërsuara por të pafuqishme. Ato mbeten të realizuara në vijat që i përcaktojnë si pjella të klasave të tyre me ato veçanti historiko-sociale që ishin karakteristike për klasat shfrytëzuese shqiptare të asaj kohe.

Në këtë vështrim të arritjeve të shumta në vepër, disi më zbehtë dhe jo aq e realizuar si përfaqësuese e partizanes shqiptare të kohës mbetet figura e Teutës, që s'ka ato elemente thelbësore, të cilat kanë ka-

rakterizuar këtë tip të vajzës, që Lufta e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare e pasuroi shpirtërisht e moralisht duke e ngritur në një plan me vëllain dhe burrin, konsideratë të cilën ajo e meritoi me heroizmat që kreu e me gjakun që derdhi. Teuta qëndron si një tingull thellësisht lirik në vepër, e dashur dhe e këndshme për lexuesin, po përveç këtij emocioni, ajo nuk të përfton asgjë më shumë.

Për forcën dhe karakterin thellësisht shqiptar, si tip i fshatarit patriot, të ndershëm e të drejtë, që dashuron dhe urren me pasion, që është sa mirënlohës aq dhe hakmarrës ndaj të tjerëve, dallon dhe vihet menjëherë në radhën e karaktereve me ngjyra kombëtare shumë të theksuara Mato Gruda, heroi i romanit «Njeriu me top» të Dritëro Agollit. Ky personazh të bën për vete që në faqet e para të veprës. Zemërimi i thellë shpirtëror i Matos për atë ndodhi tragjike të dikurshme e ka bërë atë të heshtur, por kjo heshtje e tij flet shumë, se Matua mendon shumë. Ai jeton i shkëputur nga familjet e tjera të fshatit sepse shqetësimi i tij i përhershëm është vetëm i tij, ose së paku kështu mendon ai. Matua ngjyrën kombëtare si personazh nuk e ka te ndjenja e hakmarrjes, siç mund të mendohet, se dihet sa e huaj dhe e imponuar për qëllime të caktuara nga armiqëtë e popullit tonë, nga okupatorët, nga kleri dhe nga sundimtarët qe ajo ndjenjë për shqiptarët. Përkundrazi, mendoj se pikërisht aspektet e tjera të karakterit të tij, dashuria për njerëzit që Matoja i çmon si të mirë, për tokën, për kafshët, (le të kujtojmë këtu faqet e bukura e të ngrrohta ku spikat dashuria e Matos për lopën e kafshët e tjera) janë tipike për bujkun shqiptar që kurdoherë e ka pranuar vetëm nga e keqja, me përdhunë, për hir të kanuneve, që të ngrinte dorën hakmarrëse kundër vëllait të tij, kundër bashkatdhatarëve të tij.

Këtij tipi shoqëror të kohës shkrimitari i ka veshur shumë elemente që flasin për natyrën e tij thellësisht shqiptare. Në raportin e marrëdhënieve të Matos me Auguston ka spikatur në mënyrë originale e vërteta e madhështisë shpirtërore të popullit, që i mbajti dhe i

mbrojti ushtarët e gënjer të agresorëve fashistë në Shqipëri, edhe pse deri dje i kishte kundërshtarë. Elemente të karakterit të shqiptarit të viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare e kanë pasuruar dhe aktualizuar Maton si tip. Dihet se në ato vite bota shpirtërore dhe mendore e vegjelisë, deri atëherë e shtypur, u pasurua si asnjëherë tjetër me qartësinë e qëllimit të luftës së madhe, me besimin në fitoren e popullit në saje të punës sqaruese e bindëse të Partisë. Duke marrë këto vlera, Matoja rritet si përfaqësues i fshatarësisë patriote të kohës, të cilën revolucioni ynë popullor e bindi që të hakmerrej kundër atyre që ishin burimi i të gjitha të këqijave të jetës, dhe të kuptione se në ç'verbëri kishte jetuar deri atëherë. Matoja me topin, mbi të cilin kishte ngritur tërë planin e hakmarrjes, bëri atë që bënë shumë të tjerë në ata vite, luftoi kundër një hasmi shumë më të madh e më të rrezikshëm, kundër okupatorëve nazistë. Imazhi i asaj skene që mylli romanin të mbetet në përfytyrim jo vetëm për epizmin e lirizmin e tij të rrallë, por më shumë për atë që Matoja në atë skenë fiton edhe më tepër vlera përgjithësuese si përfaqësues i fshatarësisë sonë patriote në vitet e Luftës Nacionalçirimitare.

Më pak kujdes në këtë vështrim, autori, u ka kushtuar disa personazheve që janë me peshë ideore në vepër, siç mund të përmendim figurat e partizanëve e sidomos të komunistëve. Kam mendimin se veç Murat Shtagës, të tjerët, komisari i njësitet partizan dhe të dërguarit e Partisë në atë krahinë, që lidhen me ngjarjet që shtjellohen në roman, kanë mbetur të paplazmuar sa duhet në pikëpamje të përfaqësimit të kombëtares si personazhe që janë pjellë e një kohe dhe e një populli të caktuar.

Edhe në ndonjë roman të kohëve të fundit që trajton temën e raporteve të reja etiko-morale në gjirin e shoqërisë sonë socialistë, si romani «Ruga Budi 723» i Ruzhdi Pulahës, është ruajtur fryma kombëtare në vizatimin e karaktereve. Atmosfera e diskutimit të gjallë, të mprehtë e të pasur, ku kanë gjetur mundësi manifes-

timi vlera shoqërore aq të larne të përfaqësuesve të ndryshëm të ditëve tona, i ka dhënë dorë shkrimtarit jo vetëm të individualizojë personazhet e ndryshëm, por tu japë edhe fuqi përgjithësuese për kategori e shtresa të ndryshme të shoqërisë sonë.

Tipa si Vangjeli e Ema të kujtojnë shpesh njerëz të shumtë që njohim në jetën e përditshme. Kjo ndodh se secili prej personazheve ka vulën e kohës d.m.th. ka shqetësimet dhe gjëzimet e ditëve tona, të epokës sonë. Vangjeli është tipik për moshën e tij dhe brezin e tij. Si prind ai i do fëmijët, por si kryetar i familjes ai gabon në konceptet e tij për nderin, dashurinë, raportet në mes të fëmijëve etj. Kjo shfaqje e karakterit të tij është shpesh dukuri e ditëve tona, e kësaj periudhe transitorë të kalimit për në shoqërinë socialiste. Po më tipik është për kohën tonë fakti që Vangjeli, ndonëse është i tillë ndaj fëmijëve, qëndrim që evoluon pozitivisht në roman, është krejt i ndryshëm në marrëdhënie me kërkessat e kohës, frymën e mobilizimit masiv, qëndrimin e ri revolucionar të zhveshur nga egoizmi, karrierizmi e shpirti mikroborgjez. Në këtë dyanshmëri të figurës nuk ka kondërsens, personazhi në të dy rastet është i besueshëm dhe i singertë, por është i tillë sepse në karakterin e tij gjithmonë e më shumë ndihet vula e kohës, e jetës sonë që fiton terren te personazhi duke sprapsur çdo ditë e më me sukses gjurmët e së kaluarës, elementet e asaj bote shpirtërore që ka perënduar përgjithmonë nga jeta jonë.

Ndërsa Ema misheron në karakterin e vet figurën e vajzës shqiptare të kohës, figurën e së resë të emancipuar. Dëshirat, interesat, qëndrimi i saj, flasin për një botë shpirtërore të pasur, të lirë e të bukur që u bë realitet te ne vetëm sot në epokën e Partisë. As gjë s'është false, e shtirë apo e sajtar nga shkrimtari lidhur me portretin moral të kësaj vajze. Çdo veprim e qëndrim i saj besohet jo vetëm se shkrimtari ka ditur t'i motivojë ato, por kryesisht se realiteti ynë shoqëror është i tillë, që stimulon të renë, revolucionaren, stimulon formimin dhe rritjen e personalitetit të nje-

riut, ca më shumë të femrës, ndaj themi se ndër personazhet e tjera Ema është figurë përfaqësuese e vajzës shqiptare. Por s'mund të pohojmë të njëjtin mendim edhe për personazhe të tilla të paarrira në këtë vështrim si Tefta, Vera, Fisniku e ndonjë tjetër, të cilët mund të jetojnë po kaq lehtësisht në çdo vepër të çdo periudhe qoftë.

Letërsia e ruan dhë e manifeston karakterin e saj kombëtar edhe në ambientet që vizatojnë autorët në vepër, në ato ambiente ku lëviz veprimi i veprës dhë shfaq karakteristikat e veta dalluese personazhi. Kjo veçori në letërsinë tonë të sotme ka fituar vlera lidhur me transformimin e pashembullt ekonomiko-social që ka realizuar dhe po realizon zhvillimi i vendit dhe i shoqërisë në rrugën e socializmit.

Kërkesa jonë e drejtë për ambiente ku të ndihet vula kombëtare s'duhet ngatërruar me tendencën për etnografizëm, për paraqitje enumerative e jo funksionale të ambienteve të fshatit e të qytetit tonë. Por nga ana tjetër, është po aq e rrezikshme që duke u ruajtur nga gjoja etnografizmi, shkrimtari të mos i kushtojë kujdesin dhe vëmendjen e domosdoshme përshkrimit të ambientit, të një ambienti të përcaktuar shqiptar, sigurisht përherë në funksion të qëllimeve të tjera më kryesore në vepër.

Paraqitja e një ambienti me ngjyrë kombëtare nuk është dhe s'duhet marrë si një kërkesë formale, konformatiste. Ajo lidhet me nevojën për të përcaktuar shumë elemente të tjera të rëndësishme duke nisur që me konfliktet e një vepre e deri tek episodet më rastësore, qofshin edhe të dorës së tretë në të.

Një ambient i vizatuar bukur, me individualitet, ku të spikasë e jona, shqiptarja, që nga veçoritë e natyrës e deri te mënyra e jetesës, te paraqitja e ambienteve familjare ose shoqërore, te zakonet ose normat e moralit, sendet që përdor, mënyrën si vishet shqiptari, etj., i jep shumë gjallëri veprës, e individualizon atë, zbulon vlerat e aftësitë krijuese, madje shkallën e talentit të tij.

Në të gjitha veprat e mësipërme të bien në sy si realizimet me dinjitet të ambienteve tona shqiptare ashtu edhe veçantitë dalluese në këtë drejtim të secilit prej shkrimtarëve. Kështu nëse S. Spassja në romanin «Zgjimi», ka derdhur epokën plot trazira të luftës për Shqipëri të lirë, në fillimet e shekullit tonë, këtë ai na e ka komunikuar edhe nëpërmjet imazheve të gjalla plot detaje e kolorit për vendet ku zhvillohen ngjarjet, për Korçën, për fshatrat apo për Manastirin. S. Spassja si në të gjithë krijimtarinë e tij, edhe te ky roman është i ngadalshëm në përshkrime, mundohet të japë sa më shumë detaje në vizatimin e tablove, i kushton shumë vëmendje studimit të elementeve të kohës, të jetës së popullit për t'i përdorur ato si mjete konkretizimi e individualizimi.

Te «Nëntori i një kryeqyteti» I. Kadare sado i kur-syer e lakonik në stil, ka dhënë elemente të shumtë që krijojnë ambiente të kohës, të luftës së Tiranës. Përfytyrimi i gjallë që krijon shkrimtari për vendet ku zhvillohen betejat, detajet e kohës që gjejmë në përshkrimet e romanit etj., e gjallërojnë shumë imazhin duke i dhënë shumë kolorit kombëtar veprës. Në shumë episode, detajet në funksion të përcaktimit të ambienteve janë shumë të sinqerta dhe bindëse, ato dallohen për originalitetin e tyre, për thjeshtësinë e koncizitetin e përmendur. Nëna që u ndan kafe partizanëve në rrugë është një episod-detaj shumë i gjetur. Mënyra si ndërtohen barrikadat, në ç'ambiente jetojnë klasat armike të popullit, si dhe ku veprojnë njësitet partizane, janë të gjitha të krijuara si nga një dorë mjeshtëri të penelit, që e ka ngjyer atë në dritëhijen e atyre ditëve të zjarrta e të pavdekshme, legjendare të luftës për çlirimin e Tiranës.

Të bie në sy menjëherë se me sa vëmendje dhe me sa kolorit kombëtar i ndërton ambientet D. Agolli edhe te romani i tij i ri «Njeriu me top». Fshati Arun me pozicionin e tij gjeografik, me raportet e mprehta klasore e zakonore, është mjeshtërisht i krijuar nga autorë. Megjithëse shkrimtarin e ka tërhequr më tepër për-

shkrimi i ngjarjeve dhe i karaktereve, ai s'ka lënë pas dore edhe evidentimin e ambienteve që janë me theks të ndjeshëm kombëtar. Shtëpia e Matos, hauri, ku mban lopën, mushkën e kaun, plevica ku mban topin, ambienti i familjes së Fisëve e deri rrugicat, pylli, mali ku lëvizin ngjarjet, janë të gjitha të mbushura me elemente që theksojnë e dallojnë pér frymën dhe vulën tonë kombëtare mes së cilës idetë e autorit dhe episodet e romanit shtjellohen më lirisht.

Po pér këtë karakteristikë shquhet edhe romani «Ruga Budi 723» i R. Pulahës. Ambienti i ri i qyteteve tona socialistë, si edhe ambienti i ri në kuqtimin më të gjerë të kësaj fjale; ambienti shoqëror dhe familjar, është i mbushur me detaje që pasqyrojnë epokën tonë plot përpjekje dhe heroizëm, moralin tonë në fazën e revolucionarizimit të tij, kur e vjetra ndeshet me të re në dhe çdo ditë triumfon mbi të. Në shtëpinë e Vangjelit dhe jo vetëm në aspektin material të atij ambienti por kryesisht në frymën e shëndoshë zotëruese, në frymën revolucionare të ambientit shoqëror të asaj familjeje, brenda dhe jashtë mureve të saj, ndihet kurdoherë vula e fortë e mënyrës sonë të jetesës, ku tradita e shëndoshë po fiton çdo ditë tiparet revolucionare të jetës së ditëve tona të mbushura me hovin e frymën e iniciativave, ak-sioneve dhe të heroizmit masiv.

Duke analizuar romanet që përmendëm më sipër në këtë shkrim, gjemjë sikurse në shumë vepra të tjera me vlerë të letërsisë sonë të sotme, të realizohet përherë dhe më mirë porosia e shokut Enver që na mëson se: «*Brendia socialiste është tipari dallues e më esencial i letërsisë dhe i artit tonë. Kjo brendi ka një karakter të qartë klasor proletar. Si e tillë ajo duhet të realizohet në unitet me formën kombëtare, gjë që e shohim edhe në praktikën e krijimtarisë sonë letraro-artistike.*»¹⁾

1976.

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», fq. 320.

MBI PROBLEMIN E TIPIKES NË ROMANIN TONË

Problemi i tipikes në letërsi dhe në art është një nga problemet më kryesore në procesin krijues të shkrimtarit dhe të artistit përparimtar të të gjitha kohërave. Qëndrimi ndaj këtij tipari të letërsisë dhe të artit, që lidhet drejtpërsëdrejti me përbajtjen e veprave e të krijuar artistike po aq sa edhe me anën strukturore të tyre, ka qenë kurdoherë përcaktues i vijës ndarëse ndërmerjet artit zyrtar reaksionar dhe artit përparimtar realist. Në kohën tonë qëndrimi ndaj tipikes, ndaj të gjitha shfaqjeve tipike të fenomeneve në jetën e shoqërisë dhe ndaj mënyrës se si duhen reflektuar ato në letërsi dhe art është bërë më i mprehtë, më i ashpër.

Eshtë për këtë arsy që lëshimet në këtë aspekt, sado të parëndësishme të duken, janë gjithmonë të dëmshme e të papranueshme për krijuesit tanë, se ato lëshime kanë të bëjnë kryesisht me ideologjinë, me botëkuptimin tonë marksist-leninist ku s'ka patur dhe anjëherë s'do të ketë kompromis.

Qysh kur Engelsi më 1888 në letrën drejtuar Margarita Harknësit shkruante se: «Realizmi presupozon paraqitjen me vërtetësi të karaktereve tipike në rrethana tipike» — u formulaua në mënyrë klasike ky tipar thelbësor i realizmit si metodë letrare progresive. Letërsia dhe arti i realizmit socialist e vuri në themel të vet përcaktimin e mësipërm marksist të Engelsit, duke e vë-

shtruar tipiken si shprehje të tendenciozitetit të krijuesit, si karakteristikë ndër më kryesoret që shpreh dhe është në lidhje të ngushtë me partishmërinë proletare.

Realizimet më të suksesshme në fushat e letërsisë dhe të arteve tona kanë pohuar katërcipërisht vlerën e madhe të tipizimit, të forcës përgjithësuese të karaktereve dhe të fenomeneve shoqërore më të rëndësishme, duke hedhur poshtë pretendimet e estetëve e të teoricinëve borgjezë dhe revizionistë mbi gjoja rrezikun e monotonisë që mund të sjellë me vete karakteri tipizues i krijimeve letrare dhe artistike, apo duke hedhur poshtë edhe mendimin estetik reaksionar të tyre që nxit në mënyrë të qëllimshme për t'i shërbyer sa më mirë padronëve të rendit në fuqi një letërsi që të ketë në qendër të saj tipa tej caqeve «të ngushta», tipa të përgjithshëm tërënjerezorë që i kapërcejnë kufijtë e kohës. Pikërisht kjo tendencë e shpjegon rendjen e shumë letërsive drejt mitit, larg problemeve dhe fenomeneve të mëdha shqetësuese të kohës.

Fakti që tipikja, kur është fjala për karaktere tipike apo fenomene e ngjarje tipike, realizohet nëpërmjet individualizimit, nëpërmjet tipareve dhe cilësive të veçanta të karakterit apo të fenomenit, e shmang plotësisht rrezikun e uniformitetit në letërsi e në art. Sigurisht kjo lidhet edhe me aftësinë dhe pregatitjen e artistit si dhe me shkallën e njohjes që zotëron ai kundrejt karakterit apo fenomenit që do të na paraqesë në epiqendër të veprës.

Kërkesa për të vendosur në qendër të krijimeve tona karaktere dhe fenomene tipike, rrjedh së brendshmi, nga vetë qëllimi që ndjek letërsia dhe arti ynë, si armë e fuqishme në duart e klasës udhëheqëse të shoqërisë sonë, në duart e klasës punëtore, për të krijuar njeriun me ndërgjegje të re revolucionare. Pa u shtrirë gjërësisht në krejt llojet e artit, por edhe duke u përqëndruar në një gjini të vetme të rëndësishme të letërsisë sikurse është proza, mund të dallojmë qartë si vlerat dhe sukseset e letërsisë sonë lidhur me këtë tipar, ashtu edhe dobësitë: cektësitë, shkarjet dhe ndikimet borgjezo-libe-

rale që u vërejtën, te ndonjë autor e në disa nga veprat tona.

Letërsia jonë e realizmit socialist është prirë përherë në masën e saj dërrmuese drejt temës së madhe duke vënë kështu në qendër të krijimtarisë së vet, si shfaqjen më tipike të realitetit të sotëm e të djeshëm, problemet e mëdha shoqërore, ato që lidhen më ngushtësisht me fatet e atdheut, me luftën për liri dhe socializëm. Në këtë tematikë letërsia, e në mënyrë të veçantë proza e gjatë, romani, ka milituar me dinjitet. E tillë ka qenë dhe mbetet tema e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në dhjetëra romane që kanë trajtuar këtë temë, shkrimtarët tanë kanë pohuar betejën vigane që populli ynë, i udhëhequr nga Partia, kreu në emër të lirisë kombëtare dhe të çlirimt shoqëror. Me mënyra gjithmonë të reja, në realizime të tillë të prözës sonë të gjatë si te «Para agimit», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Komisari Memo» etj., në sajë të elementeve të shumtë individualizues në trajtimin e kësaj teme, autorët kanë mundur me art të fuqishëm të tipizojnë e të përgjithësojnë heroizmin madhështor të popullit në luftën partizane. Po aq tipike dhe përgjithësuese, në madhështinë e vet epike, është tema e realitetit tonë të sotëm revolucionar. Tri dekadat e luftës dhe të përpjekjeve për ndërtimin e konsolidimin e socializmit në atdheun tonë janë faqe të ndritura të realitetit të sotëm. Ato u shkruan me djersën dhe gjakun e një populli të tërë, ato u bënë realitet në rrëthanat e rënda të rrëthimit të dyfishtë borgjez dhe revisionist, ndaj fitorja jonë, e njerëzve tanë, ka ato ngjyra epike që të bëjnë të krenohesh se je bir i këtij populli në epokën e ndritur të Partisë. Proza jonë, duke vendosur në qendër të saj këtë temë, këtë realitet, ka mundur të ndjekë, edhe pse jo gjithmonë në masën e duhur, jetën, aspektin më tipik të saj. Në vepra të tillë të suksesshme si «Kënetë», «Përsëri në këmbë», «Isha unë Çobo Rrapushi», «Juga e bardhë», «Tokë e ashpër» e shumë të tjera, pavarësisht nga ndonjë mungesë apo vërejtje e pjesshme artistike, ndihet tendenca pozitive e autorëve për të kapur shqetësimet e mëdha të kohës,

aspektet më madhështore të realitetit, anët më tipike e më pozitive të jetës, që e karakterizojnë atë, duke bërë që vepra e tyre të militojë me pulsin e ditëve tonë. Po këtë vlerë njeh edhe krijimtaria më e suksesshme e autorëve të prozës së gjatë apo të shkurtër, që kanë ngritur e janë marrë me tema e probleme të mëdha shoqërore në periudhat e së kaluarës së largët apo të afërt historike. Duke u marrë me më tipiken, me paraqitjen e jetës së rëndë të masës së gjerë të fshatit apo të vegjelisë së qytetit si dhe me pasqyrimin e protestës dhe të revoltës që sa vinte po rrитеj e po shpërthente, nga njëra anë, si dhe nga ana tjetër me demaskimin e gjith-anshëm të feudo-borgjezisë së kohës, si klasa të dënuara të shuheshin e të zhdukeshin me gjithë tërbimin e tyre, me gjithë egërsinë e sundimit të tyre, prozatorët tanë në vepra si «Ata nuk ishin vetëm», «Lumi i vdekur», «Të munduarit» etj., kanë bërë që kjo gjini e letërsisë, sikurse krejt arti dhe letërsia jonë, të militojë me sukses, të luajë një rol të rëndësishëm njohës dhe edukativ sidomos te rinia, për formimin në mënyrë të veçantë të ndërgjegjes së saj klasore. Në këtë tragë vlerash ideore renditen edhe vepra me temë e me problematikë thellësisht shoqërore që hedhin vështrimin e tyre më tej, në thellësinë e shekujve, për të rilevuar tiparet më të shkëlqyera të të parëve tanë në luftërat e tyre legjendare për liri e pavarësi. Te krijime të tillë si «Kështjella», «Gjorgj Golemi», «Muret e Krujës», «Fyelli i Tanës» etj., marrin jetë e zënë vend ato vlera morale e virtute karakteri të rrallë të shqiptarëve, që i dhanë, i japid e do t'i japid përjetësisht vitalitetin e madh popullit e kombit tonë. Në shekuj shqiptarët me fanatizëm ruajtën si gjënë më të shtrenjtë gjuhën, zakonet, emrin shqiptar. Populli ynë manifestoi atë forcë rezistence, që s'u imposht dot as nga fuqi të tillë të mëdha asimiluese siç qenë ronjakët, sllavët dhe turqit. Këtë të vërtetë të madhe historike, ndonëse ende jo në krejt madhështinë e saj, letërsia jonë e re, veprat që cituan më sipër, e kanë pasqyruar duke synuar t'u transmetojnë bashkëkohësve tanë dhe brezave të ardhshëm vlerat e mëdha morale të të

parëve dhe problemet më shqetësuese të atyre epokave të hershme.

Ajo që e ka karakterizuar prozën, sikurse krejt letërsinë e artin tonë në masën dërrmuese të krijimeve, gjatë të tri dekadave të ekzistencës dhe të lulëzimit është se, krahas synimit për një tematikë të rëndësishme e shoqërore, është luftuar edhe që kjo tematikë të marrë jetë në vepër nëpërmjet një problematike po aq të rëndësishme dhe po aq tipike për kohën. Prozatorë të ndryshëm në romanet, tregimet apo novelat e tyre me temë nga e kaluara historike e popullit tonë, nga Lufta Antifashiste 'Nacionalçlirimtare apo nga e sotmja, e kanë përqëndruar vështrimin e tyre në radhë të parë në problemet e mëdha, që lidhen me krejt gamën e gjerë të themave të rrahura, megjithëse ende shumë probleme s'janë kapur në thellësinë që meritojnë e rrjedhimisht, letërsisë, pra në radhë të parë prozës, si gjinia më e zhvilluar dhe më e gjerë e saj, i mbetet ende shumë për të bërë në mënyrë që në plan të parë të mund të ndjekë me sukses, jetën, realitetin e madh shoqëror e hisforik në problematikën e vet më të rëndësishme e më tipike. Mjafton të kujtojmë vetëm morinë e problemeve të realitetit tonë të sotëm shoqëror, për t'u bindur për këtë. Pas Letrës së Hapur të KQ të PPSH hovi revolucionar i masave tona punonjëse shpërtheu me një vrull të parë. Sulmi frontal për thellimin e revolucionarizimin e ndërgjegjes sonë nxori në fushën e luftës ideologjike aspekte të tillë të trashëgura e mbeturina nga e kaluara si patriarchalizmin zakonor e moral, botëkuptimin fetar, përbuzjen dhe përcëmimin ndaj femrës në sferën etiko-morale, në fushën social-ekonomike dhe fenomene të tjera si: burokratizmin, shfaqjet e indisiplinimit e të liberalizmit, që për pasojë të indiferentizmit e të nënveftësimit të palejueshëm janë po aq të rrezikshme sa dhe konservarizmi me të gjithë recidivët e tij. Proza, siç është e qartë për të gjithë, ka bërë sigurisht një punë me vlerë në rrahjen e shtjellimin e kësaj problematike më tipike, më të përgjithshme, ashtu sikurse krejt letërsia dhe arti ynë i ri, por ndonjëherë për disa arsyen, e në radhë

të parë për mosnjohje të realitetit, të fenomenit apo problemit dhe për mungesa të formimit ideopolitik të shkrimtarit, kanë ndodhur te ndonjë autor dhe në ndonjë vepër edhe gabime e shtrembërimë të tilla që flasin, ndër të tjera, edhe për faktin se ende nuk njihet ashtu si duhet se ç'është fenomeni tipik jetësor dhe cili është vendi që duhet të zërë ai në krijimet tona, se cila shfaqje jetësore mund të jetë tipike, se në ç'masë e në ç'raport mund dhe duhet të jetë tipikja me fenomenet e shfaqjet më të dyta etj., etj.

Në disa tregime u zëvendësua tipikja me të rastësishmen, dhe kjo e fundit u zmadhua dhe u ekzagjerua në atë masë saqë padrejtësisht tingëlloi si tipike, si zotëruese në jetën dhe realitetin tonë. Kështu për shembull pati ndonjë rast kur burokratizmi si një e metë u shtri aq shumë, saqë të krijohej përshtypja se ishte e pamundur të mposhtej kjo e keqe. Është e kuptueshme se duke mos njojur tipiken jetësore të këtij fenomeni siç është burokracia, autori e shtrembëron atë, deformon realitetin e si pasojë, shket nga qëndrimi i partishëm, nga tendencioziteti klasor. Krijuesit i duhet doemos të ketë të quartë se tipikja nuk është ajo që ndesh ai në një apo disa raste të veçanta në jetë, tipikja nuk përcaktohet aspak as edhe nga mesatarja numerike e fenomenit apo tipit jetësor në realitet, por është ajo që ka të ardhmen, që përfaqëson apo nxit fitoren e së resë, novatores mbi të vjetrën. Shkrimtari, së pari, duhet të niset nga e vërtetë që burokratizmi është fenomen i trashëguar nga mëh-murët e administratës së vjetër feudo-anadollake të së kaluarës, pra ai në administratën tonë u suall nga punonjës të administratës së vjetër, që vazduan të punojnë edhe në administratën tonë; së dyti, që burokratizmi në jetën tonë lind dhe favorizohet nga disnivelet në mënyrën e jetesës, nga dallimet punë mendore-punë fizike të cilat vijnë që nga koha e shoqërisë me klasa antagoniste dhe jetojnë përkohësisht në gjirin e shoqërisë sonë; së terti, që ai s'ka të ardhme si fenomen shoqëror në sistemin tonë. Kjo duhet të zotërojë dhe jo fakti rastësor që

edhe një komunist nëpunës paska shfaqje burokratizmi në jetën familjare, në zyrë e gjetkë.

Të meta të kësaj natyre lidhur me të vërtetën jetësore tipike, zotëruese te ne, ka parasysh shoku Enver kur, duke dënuar subjektivizmin e autorëve, thekson: «*Në krijimet letrare ne shpesh gjejmë më shumë refleksin e botës së brendshme të autorit dhe më pak jetën e gjallë, luftarake, revolucionare të masave punonjëse, atyre që luftojnë e veprojnë*.¹⁾ Për t'i shmangur kësaj, shkrimtari duhet të njohë mirë e thellë realitetin, jo në mënyrë intuitive e të përciptë por rrënjosht, që të mundë të dallojë se cila është shfaqja më tipike e fenomenit, ajo që në rrethanat tona të sotme tipike ka të ardhmen, sepse dihet që jo çdo fenomen dhe jo çdo shfaqje e tij është tipike. Që të jetë e tillë ajo duhet të jetë simptomatike, përgjithësuese, përfaqësuese.

Me sa thamë më sipër nuk duam të mohojmë të drejtën e shkrimtarit që të vendosë në krijimet e veta edhe fenomene apo tipa negativë, për t'i dënuar ata, për të edukuar te lexuesi ndjenjën e pështiroshes dhe të urrejtjes për ato fenomene e ata tipa të shëmtuar e të ulët, veprimet e të cilëve nuk pajtohen me idealet tona social-estetike. Por duam të nënvisojojmë që edhe në këto raste s'duhet dalë nga e vërteta e tipikes jetësore, s'duhan ekzagjeruar e fryrë ato. Shkrimtari i armatosur me ideo-logjinë tonë, ka për detyrë t'i pasqyrojë aspektet apo tipat negativë duke na i dhënë ato në planin konkret si dhe në lidhje të pashkëputur, në ballafaqim të vazhdueshëm me planin e përgjithshëm të realitetit tonë pozitiv.

Kur theksojmë domosdoshmërinë e trajtimit të tematikës së madhe shoqërore si më tipikja e realitetit tonë të sotëm, nuk duam asnjëherë të mohojmë të drejtën e ligjshme që ka e duhet të ketë edhe tematika e problematika e sferës së jetës intime, përfshi edhe erotikën këtu. Realiteti ynë revolucionar nuk e mohon por përkundrazi, e presupozon këtë sferë jetësore të ndërtuar e të kultivuar mbi parime e baza sociale kryekëput të reja nga

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», faqe 482.

ato të shoqërisë me klasa. Revolucioni ynë popullor bashkë me sistemin e vjetër theu dhe shkatërrroi edhe superstrukturën e tij, moralin dhe etikën e tij. Kjo thyerje gjigante bëri të mundur dhe i hapi rrugën triumfit të moralit të ri, triumfit të dashurisë së re. Proza jonë na ka dhënë shembuj të shumtë të trajtimit të drejtë të këtij fenomeni shoqëror. Ajo që është e re dhe e rëndësishme në shtjellimin e kësaj teme është se ajo u vështrua lidhur ngushtë me jetën shoqërore, me problemet që shqetësonin masat për fatin dhe të ardhmen e socializmit. Ne kemi shumë tregime ku dashuria e të rinjve vizatohet, përpos të tjerave, dhe si një forcë shtytëse në një hulli me idealet e mëdha shoqërore për triumfin e revolucionit tonë popullor dhe për fitoren e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për ndërtimin e shoqërisë sociale, për mbrojtjen e fitoreve të mëdha nga armiku i klasës dhe nga bandat e diversantëve etj. Por shqetësues ka qenë fakti që trajtimi i temës erotike, intime, është parë ndonjëherë si një ndjenjë e vogël, egoiste e meskine.

Në sferën e tipikes përfshihen edhe elemente të tjera të rëndësishme sikurse janë rrëthanat tipike dhe karakteret tipike. Partia gjithmonë në mësimet e saj e ka vlerësuar drejt situatën duke përcaktuar në etapa të ndryshme rrëthanat më tipike e me këtë ajo u ka dhënë një ndihmë të madhe shkrimtarëve e artistëve. Të njoftësh rrëthanat tipike do të thotë të orientohesh drejt në to, për të zbuluar thelbin tipik të fenomenit shoqëror që vendos në oendër të veprës. Realistët e shekullit të kaluar i vlerësuan drejt ato. Balzaku është një shembull i shkëlqyer në këtë drejtim. Kuqtohet se letërsia jonë e realizmit socialist e ka çuar e duhet ta çojë më tej zbulimin e saktë shkencor të këtij elementi të rëndësishëm krijues. Shkrimtarit tonë i duhet të njoftë mirë rrëthanat që ndikojnë në kultivimin e zhvillimin e moralit tonë të ri revolucionar, që të mund të shpjegojë edhe ngjarjet apo tifat nërcues të atii morali. Dhe në këto tridhjetë viet clirim, këto rrëthana kanë ndryshuar, kanë fituar cilësi të reja në vartësi nga transformimet e mëdha ekonomike-shoqë-

rore e politike. Konkretisht, në ditët tona, ato «... janë rrrethanat në të cilat vendi ynë po ndërton socializmin i rrrethuar ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht nga armiku i klasës, nga imperializmi dhe revisionizmi». ¹⁾ Këtë duhet ta ketë mirë parasysh shkrimtari ynë që të mundë të vendosë drejt ngjarjet, fenomenet dhe karakteret tipike në krijimin e vet. Por disa herë ka ndodhur që rrrethanat nuk janë njohur dhe ato janë shtrembëruar duke u shtrembëruar kështu edhe vetë tingulli ideor i veprës. Në disa krijime ka ndodhur për shembull që është harruar nga shkrimtari rrrethimi i dyfishtë armiqësor imperialisto-revisionist, është spostuar lufta e klasave për t'ia lënë vendin luftës në terrenin ideologjik, jo me armikun e klasës, por me njeriun tonë që, për një sérë arsyesh, mbart koncepte e pikëpamje të gabuara. Kjo tonitje vigjilence përbën një ndër të metat më kryesore. Mosnjohja e realitetit jetësor bëri që, në ndonjë rast, edhe kthesa shpirtërore e heroit të veprës të dalë jo aq e përligjur me gjithë zhbirimin shpirtëror që autori është përpjekur të vëré në themel të motivimit të kthesave që zgjidhin konfliktin bazal në vepër. Kështu, krahas romaneve të tilla si «Fan Smajli» ku rrrethanat tipike të jetës së klasës punëtore ndikojnë në formimin e botëkuptimit proletar te protagonisti, ndeshim edhe romane si «Vdekja e një nate» e ndonjë tjetër ku këto rrrethana janë disi të sfumuara dhe jo aq në funksion të zgjidhjes përfundimtare, ku klasa punëtore e ditëve tona dhe ambienti i saj revolucionar jepen më terër në sfond. Më e ndieshme akoma është kio mungesë në ato raste, sidomos të tregimit tonë, kur edhe pse subjekti preston për një trajtim e mbarështrim të konfliktit në plan shoqëror, brenda një ambienti dhe rrrethash po të atilla, harrohet kjo rrugë nismëtare, degradohet problemi deri në një konflikt dashurie që, edhe pse s'ka arsyë të jetë në qendër, bëhet qendror e do-

1) Mehmet Shehu, «Fjala në aktivin e Partisë të Tiranës», rev. «Nëntori», nr. 2, fq. 6, 1974.

minues. Kjo shhangje vjen edhe për shkak të mos-njohjes së rrethanave tipike. Për të mënjanuar të meta e dobësi të tilla duhet të kemi parasysh gjithmonë orientimet e Partisë që në analizën e realitetit të nisemi nga botëkuptimi materialist dialektik e jo nga pozitat metafizike, për të mos rënë në tendencat e gabuara të lustrit me skematik të realitetit apo në zmadhimin e përgjithësimin e së keqes, negatives, të cilën në ndonjë vepër e gjejmë të ngritur deri si shfaqje tipike në emër të gjoja thellimit të realizmit në krijimet tona. Dhe dashur pa dashur e nxjmë, e shtrembërojmë atë realitet të cilin kujtojmë se e kemi dhënë me vërtetësi. Në shfaqje të tilla duhet dënuar sidomos ndikimi i pikëpamjeve dhe i praktikës së shtrembër armiqësore të letërsisë revizioniste.

Tipizimi në një vepër letrare kërkon, veç sa u tha më sipër, edhe një moment tjetër të rëndësishëm, që ndikon shumë në procesin krijues të shkrimtarit për realizimin e tipikes në vepër, dhe ky moment lidhet drejt-përsëdrejti me karakterin, tipin shoqëror, që shkrimtari, e në mënyrë të veçantë prozatori, vendos në qendër të veprës së vet. Krijimi i karakterit tipik nuk është çështje dhe problem që zgjidhet lehtë. Si një nga momentet kryesore në ndërtimin tërësor të veprës, personazhi apo karakteri tipik i një vepre letrare është përfaqësuesi i një shtrese të caktuar shoqërore me shumë tipare që e dallojnë dhe e karakterizojnë atë si përfaqësues. Në vlerësim të kësaj ka lindur dhe mendimi që vepra letrare në një kuptim është historia e karaktereve. Vështirësinë e madhe dhe punën që i duhet të bëjë shkrimtarit në këtë drejtim, e ka nënvizuar në mënyrë kuptimplotë Gor-ki, shkrimtari i madh i realizmit socialist, kur thotë: «...Pikërisht nga këta njerëz të vegjël ashtu si ndërtohen prej tullash kullat dhe këmbanoret, artistët e fjalës kanë përfytyruar «imagjinuar» «tipa» përgjithësues njerëzish, tipa më të përgjithshëm». Letërsia jonë e re njeh një sërë tipash apo karakteresh tipike të realizuara mirë që dëshmojnë për punën e gjatë hulumtuese në jetë të shkrimtarëve tanë të ndryshëm. Pa hyrë në listën e

gjatë të këtyre tipave karaktere, ne mund të përmendim disa ndër më të realizuarit si: Gjikë Shpati, Stavri Lara, Qemal Orhanaj, Pilo Shpiragu, Rrapo Tabani, Adnani etj. Me Rrapo Tabanin, personazh i romanit «Komisari Mem» të D. Agollit, shkrimtari ka mundur të realizojë një tip shoqëror përgjithësues për kohën. Ky fshatar, i brumosur me dashurinë e thellë për liri sa edhe me urrejtjen kundër sundimtarëve dhe pushtuesve, ruan në faqet e romanit tiparet që e karakterizojnë. Këtë autori ka mundur ta realizojë jo vetëm nëpërmjet njojjes së thellë e të plotë të tipit që do të mishërohej me Rrapon, po edhe nëpërmjet detajeve të gjetura që flasin për temperamentin, burrërinë, dashurinë e tij të pastër për shokët apo edhe për urrejtjen ndaj armikut. Rrapua është individualizuar me forcë e vërtetësi. Rezerva e tij ndaj komisarit apo vajzave në batalion, si dhe ftohtësia karakteristike që ndihet tek ai ndaj shkollës dhe njerëzve të shkolluar, ashpërsia pa të keq e tij ndaj shokëve dhe partizanëve të batalionit e deri edhe dara që mban ai për t'u shkulur dhëmballët e prishura atyre që vuajnë, janë po aq tipike për personazhin sa edhe tërbimi i tij kundër armikut në betejë, apo dhembja e thellë kur mëson lajmin e vdekjes së komisarit. Në krejt këto veçori individualizuese është arritur me forcë ideoartistike tipizimi i personazhit si figurë që përgjithëson.

Për tipizim të mirë nëpërmjet individualizimit dhe forcës përgjithësuese shquhen në romanin «Dimri i madh» të I. Kadaresë edhe një sërë personazhesh. Le të kujtojmë fotografin Xan me shqetësimin e tij të madh. Sa i vërtetë dhe i pranueshmë është ai kur shpreh atë lidhje të fuqishme midis udhëheqësit të dashur dhe njeriut të thjeshtë të popullit. Po kështu tipike është edhe figura e garderobistikë plak të Kremplinit, si figurë e revolucionarit të vërtetë, e leninistikë të vendosur dhe e bolshevikut që i dhimbset uniteti revolucionar i komunizmit botëror kur sheh dhe kupton kursin tradhtar të revisionistëve hrushovianë.

Përgjithësuese dhe tipike për idenë që mbart është në këtë vepër plaka Nurihan që në vetminë e saj

ngjethëse, me helmin dhe vrerin e mendimeve të veta, me frikën, shpresat e kota, trishtimin e pashërueshëm si dhe me vdekjen e saj, na krijon imazhin e saktë për ato mbeturina e plehra klasash të përblysura që në situata të atilla dramatike për fatet e socializmit, ringjallinëndrrat e tyre të përbindshme por edhe të pafuqishme e qesharake përparrë forcës së revolucionit tonë.

Ajo që e dallon prozën tonë është pikërisht tipizimi nëpërmjet individualizimit të thellë. Kemi tashmë një galeri tipash dhe karakteresh të individualizuar bukur e në mënyrë të qëlluar. Kjo traditë e shëndoшë pune serioze e ka karakterizuar në përgjithësi letërsinë tonë. Por ka pasur edhe shmanjje nga kjo traditë pozitive. Kështu në romanin satirik «Kur qesh tërë qyteti» të Q.Buxhelit u ekzagjerua dhe u ngrit në përgjithësim e tipizim negacioni, injoranca, burokratizmi i tipave të krijuar nga shkrimtari në atë masë saqë ata s'i përgjigjeshin të vërtetës së realitetit jetësor, qoftë dhe në një sektor të vetëm sikurse është administrata e kulturës, në rrethet e vogla të vendit tonë. Po kështu në figurën e Hanës te romani «Traseja» i R.Likës, me gjithë synimin pozitiv të autorit për të dhënë tipin e malësoreve në luftën e saj në emër të të drejtave të ligjshme që i përkasin, nuk i është arritur qëllimit. Mbingarkesa me moralizime, që autori ka vënë në gojë të personazhit, e ka zbehur atë dhe nuk i ka dhënë vërtetësinë e tipit. Sidomos mënyra skematike e konceptimit të figurës në aktivitetin e saj në hekurudhë lë shumë për të dëshëruar.

Trajtimi dhe kërkesa e drejtë e mendimit tonë teorik për nevojën e evidentimit të tipikës në letërsi, s'duhet parë shkëputurazi por nië lidhje të ngushtë me vetë karakterin dhe fryshtën kombëtare që duhet ta përshkojë tejembanë prozën tonë, sikurse gjithë letërsinë dhe artistin. Cilido krijim i yni, s'mund të ketë asnjë vlerë po s'që i brumosur me ato tipare që do ta dallonin atë si vepër shqiptare, për jetën shqiptare dhe për njeriun e ri të Shqipërisë socialiste. Me të drejtë ne kemi

dënuar ato manierizma që në fund të fundit i bëjnë jehonë teorive reaksionare për ekspansionin ideologjik e shpirtërор të popujve të vegjël nga «superkulturat» e imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik.

Për t'iu shmangur shtrembërimeve dhe gabimeve në çështjen e tipikes dhe të tipizimit në letërsinë dhe artin tonë, si dhe për t'u kundëryënë me sukses si rrezikut të ndikimeve brogjezo-revisioniste ashtu edhe konservatorizmit, me qëllim që të ruajnë të pastër e të çojnë më tej atë çka krijoi tradita më përparimtare e letërsisë së kaluar dhe tradita shumë pozitive e letërsisë sonë të realizmit socialist, krijuesit tanë, artistët dhe shkrimitarët tanë të talentuar e të partishëm, duhet të realizojnë me këmbëngulje atë që thotë Partia lindhur me këtë çështje se, për të tipizuar duhet akumular e për këtë duhet studjuar gjendja nëpërmjet njohjes së jetës sa më thellë, nëpërmjet studimit të letërsisë marksiste-leniniste, mësimeve të Partisë, vijës së saj në përgjithësi dhe në sferën e arteve e letërsisë në veçanti.

Problemi i tipikes, në radhë të parë si problem brendie e natyrisht edhe i arritjeve artistike, lidhet me shumë anë të krijimtarisë letrare. Domosdo ai nuk kufizohet vetëm me ato që u thanë më sipër. Ky problem kërkon ende një trajtim të shumanshëm, të thelluar e më konkret nga kritika jonë.

QENDRIMI IDEOEMOCIONAL I AUTORIT DHE VENDI QË ZË AI NË DISA ROMANE

Paraqitja artistike e realitetit kërkon në vetvete jo vetëm njojjen empirike dhe intuitive të jetës e shoqërisë nga shkrimtari, por edhe njojjen e ligjshmërisë sociale, ku vendin kryesor e zë njojja ideologjike, me anë të së cilës ai, shkrimtari, e interpreton jetën, fenomenin shoqëror që vendos si objekt kryesor në krijimin e tij letrar. Në këtë funksion, për përmasat dhe shtrirjen e vet, ze një vend të veçantë romani.

Realiteti jetësor është burimi i parë dhe më kryesor i romancierit të letërsisë sonë të realizmit socialist. Por realiteti jetësor, gjatë procesit të krijimit letrar, nën ndikimin dhe në vartësi të forcës njohëse e interpretuese të autorit si dhe të talentit të tij, shndërrohet në një realitet artistik, i cili përpos shumë pluseve të tjera, fiton edhe forcën përgjithësuesë. Pa këtë pasurim ideoemocional të domosdoshëm, vepra letrare e në mënyrë të veçantë romani, nuk mund të dalë tej caqeve të një fotografimi të realitetit. Është ligj i pashmangshëm dhe nevojë e dorës së parë e të gjitha letërsive progressive që realiteti të hyjë në veprën letrare jo «ter a ter» por nëpërmjet një reliivi të thyer, plot maya e honte emocionale. Vetëm kështu bëhet i mundshëm transmetimi ndjesor i atij realiteti, që synon të na japë autori jo në mënyrë të ftohtë por duke evokuar edhe të ne atë qëndrim ideoemocional që ai ka provuar në kontaktin e drejtpërdrejtë me jetën.

Kur flasim për qëndrim të autorit, për këndvështri-

mín nga niset njëri apo tjetri shkrimtar, që në veprën e vet paraqet jetën, realitetin shoqëror, duhet të kemi parasysh se kjo veçori s'është tipar dallues vetëm i letërsisë sonë të re. Në letërsitë e të gjitha kohërave dhe rendeve shoqërore, ka pasur dhe ka qëndrim të përcaktuar të shkrimtarit në paraqitjen artistike që i bën ai realitetit. E re në letërsinë tonë, pra edhe në romanin tonë, është jo prania e qëndrimit të përcaktuar ideo-emocional të autorit, por pozita e re ideoestetike e tij e brumosur dhe e armatosur me teorinë marksiste-le-niniste të socializmit shkencor dhe më mësimet e Partisë sonë. Ky formim i dallon krijimet e autorëve tanë të sotëm nga çdo krimj i mëparshëm, qoftë edhe i autorëve më të njohur si Naimi, De Rada, Çajupi, Migjeni, Noli etj., që me veprat e tyre shënuan maja në letërsinë tonë të paraçlirimit.

Qëndrimi ideoemocional i shkrimtarëve tanë, në këtë drejtim, diferencohet dukshëm edhe nga ai i autorëve përparimtarë botërorë te të cilët, ndonëse mund të ndeshim tendenca përparimtare, madje revolucionare, s'gjejmë atë impostim të qartë ideoemocional përkrah forcave më progresive për t'iu kundërvënë regresit, shtypjes dhe demagogjisë së borgjezisë.

Letërsia e sotme borgjeze, shprehëse e interesave të oligarkive industriale apo financiare, ndjek besnikërisht atë mision që i është ngarkuar: të narkotizojë apo të helmojë ndërgjegjen e mašave shumëmillionëshe për t'i hapur rrugë sundimit e shfrytëzimit të paskru-pull. Autorët më të lançuar të asaj bote, që nga etërit dhe themeluesit e dekadentizmit të sotëm si Xhojsi, Kafka e Prusti e deri te më të zëshmit e ditëve tona si Sartri, Saroti, Kamy, Beketi e shumë të tjerë, predikojnë kotësinë filozofike të kuptimit të jetës, i vështrojnë të këqijat e sistemit kapitalist si të këqija të vetë natyrës njerëzore, nxisin egoizmin, instiktet dhe imoralitetin dhe i përfundojnë veprat e veta me mohimin e jetës. Me një paraqitje të tillë të fenomeneve shoqërore dhe me një interpretim kësisoj të realitetit shoqë-

ror, është e vetëkuptueshme se ç'interesa mbrohen dhe ç'qëllime synohen të arrihen.

Konform kësaj letërsie të degjeneruar, letërsia e sotme revizioniste, sikurse ideologjia mbi të cilën mbështetet, ruan si veçanti dalluese të saj demagogjinë. Në paraqitjen dhe interpretimin e realitetit të sotëm shoqëror, shkrimtarët revizionistë fshihen pas frazave të majta dhe në emër të «superrealizmit», kalojnë në mohim të gjithçkaje të bukur, heroike e njerëzore, në deheroizim e në nxirje të realitetit. Qëndrimi ideoemocional i autorëve të tillë priret drejt injorimit të kontradiktave apo drejt spostimit të ndërgjegjshëm nga kontradiktat ekzistuese. Truke të tilla sigurisht synojnë në spostimin e qëllimshëm të ndërgjegjjes së masave nga ngjarjet korrente, që kanë të bëjnë me të sotmen e të nesërmen e shoqërisë dhe të revolucionit.

Sikurse përmendëm më sipër, letërsia jonë e tri dekadave të pasçlirimit, dhe kryesisht romani ynë, manifestoi qëndrimin e ri ideoemocinal të shkrimtarëve në paraqitjen artistike të realitetit. Burimi i këtij qëndrimi të ri, i këtij këndi të kundrimit të realitetit, duhet kërkuar në një sërë faktorësh që e kondicionojnë. Së pari e mbi të gjitha ai qëndron në botëkuptimin marksist, thellësisht të partishëm. që përqafuan dhe me të cilin u armatosën romancierët tanë. Kjo nuk ndodhi rastësisht, as nëvërmiet ndonië diktati. Realiteti jetësor, Lufta heroike Antifashiste Nacionalçlirimtare, pjesëmarrës të së cilës qenë edhe shumë nga shkrimtarët. që hodhën themelët e kësaj letërsie, qe një shtytje e fuqishme drejt qëndrimit të ri ideoestetik. Më pas, në luftën për të ndërtuar një Shqipëri të re, nisi të zotëroië më fort triumfi i botëkuptimit marksist, si botëkuvtimi më revolucionar, më pranë interesave të vegjilisë, më pranë ëndrrave shumëshekulllore të popullit. Së dvti. tendencat më progresive. realiste. që pat arritur letërsia e paraclirimit, e kryesisht poezia. ku dënohei dhe fshikullohei ashpër shtypia. shfrytëzimi dhe mierimi i namasë i popullit si dhe tentativat e norsadukura te disa nga ata autorë, për të thirrur popullin në luftë

të armatosur, apo për të zbuluar dhe demaskuar shkaktarët e atij mjerimi, nuk lejonin një mohim të asaj çka qe arritur por përkundrazi, kërkonin një thellim gjithmonë e më të madh në atë drejtim ideor, një thellim të tillë ku dashamirësia dhe predispozita shpirtërore përkrah popullit dhe haleve të tij, të armatosej dhe të merrte një shpjegim shkencor për të dalë nga karakteri spontan intuitiv i deriatëhershëm.

Qëndrimi i autorit, pozicioni që mban ai ndaj asaj që na përshkruan në vepër, është i lidhur ngushtësisht me formimin e tij por s'duhet injoruar në këtë mes edhe forca e talentit, me fjalë të tjera, aftësia e shkrimitarit për ta komunikuar këtë qëndrim duke e dhënë atë në mënyrë sa më artistike.

Kështu në disa romane me vlerë të letërsisë sonë si «Zjarret», «Kullat», «Një lindje e vështirë», «Juga e bardhë», «Vlaga e dheut», «Tokë e ashpër» me subjekt nga jeta e fshatit tonë të sotëm apo te të tjera, me subjekt nga jeta e klasës sonë punëtore e gërshetuar kjo me luftën për formimin ideoologjik të njeriut tonë në gjirin e kësaj klase si te «Dasma», «Përsëri në këmbë», «Dhjetor i shqetësuar», «Fan Smajli», si dhe në romane që trajtojnë të kaluarën historike të popullit apo vitet e okupacionit e të Luftës Antifashiste Nacionalclirimtare, siç janë «Kështjella», «Kronikë në gur», «Komisari Memo», «Tri ngiyra të kohës» etj., giejmë realizime të diferencuara të qëndrimit të autorit. Te «Vlaga e dheut», në pjesën e parë personazhi kryesor Lulash Preka, ndonëse në të është tepruar pak përsa u përket shoqegjimeve të hollësishme të autorit, është dhënë mirë e në mënyrë mjaft funksionale. Shpjegimet për të kaluarën e personazhit hedhin dritë e motivoinë veprimet e qëndrimet e tij të mëpasme ndonëse edhe këtu mund t'i vihej fre në një farë mase zërit të hapur të shkrimitarit në dobi të veprimit apo zbërrthimit shpirtëror të heroit. Por kur autori nis të flasë për të renë në fshat, kur ai skicon tipat që në vepër do ta mbartin këtë të re, këtu atij i ka shkarë situata nga dora. Duke mos e njojur si duhet të renë e jetës

në fshatin tonë, si edhe nga që s'ka arritur të zbërthejë si duhet arsyet dhe shkaqet sociologjike që e vunë në lëvizje jetën e fshatit në drejtim të rinovimit të shumë normave, dokeve apo zakoneve, autori ka rënë në deklaratzém të hapur, në krijim tipash aspak bindës dhe shumë më të zbehtë se përfaqësuesit e së vjetrës.

«Një lindje e vështirë», roman i Elena Kadaresë, dëshmon për një realizim të suksesshëm në këtë aspekt. Autorja, njohëse e mirë e botës shpirtërore të gruas së përbuzur e të ndrydhur nga zakonet, e ka shprehur qëndrimin e vet duke i ndenjur sa më pranë heroinës, Bardhës, nëpërmjet zberthimit psikologjik të së cilës ka mundur të japë, me shumë natyrshmëri, qëndrimin e saj ideoemocional, pa e ndierë të nevojshme të shprehet me fjalën e vet si autore. Ne e kemi plotësisht të kuptueshme se ku anon simpatia e autores, se cilën mbron ajo me zjarr dhe c'gjë urren nga bota e vjetër, dhe këtu, lexuesi, koha, është plotësisht. me të.

Në veprimet e heroinës, në luftën e saj të vazdueshme kundër të ungjit, mishërim i patriarkalizmit më konservator të kohës, në përpjekjet e Bardhës për t'u shpjeguar me Fadilin për çka ndodhi ndërmjet tyre, ndiejmë qëndrimin ideoemocional të drejtë e progresiv të autores. Dhe jo vetëm këtu. Duke na dhënë mefshtësinë e organizatës-bazë të Partisë të fshatit, qëndrimin inert të byrosë së rinisë, madje edhe lëkundjet e pasivitetin e pajustifikueshëm të Fadilit, të shoqit të Bardhës, autorja, nëpërmjet aksionit, episodeve dhe skenave jetësore që krijon në vepër, e ka shprehur në mënyrë të tertiortë e me mjeshtëri qëndrimin e saj ideoemocional.

Mendoj se duhet theksuar në mënyrë të veçantë që në romane ku prioriteti i takon veprimit, ngjarjes, episodit për vetë natyrën e veprës, sikurse janë romanet me temë ngajeta e heronjve të heshtur ngaqë shkrimitarin e tërheq disi më tepër ana e jashtme, ajo e veprimtarisë së personazheve, ka rëndësi të dorës së parë kujdesi për të mos rënë në tregim të thatë, por idetë, mendimet dhe qëllimet e tij ai t'i realizojë në-

përmjet vetë personazheve dhe veprimeve të tyre jetë-sore.

Një konstatim interesant përbën edhe rasti i romanit «Kullat» vepër e Gjergj Zhejit. Te ky roman vërehet një dyllojshmëri përsa i përket paraqitjes apo mënyrës si autor i na e ka dhënë qëndrimin e vet ideo-emocional. Kur është fjala për linjën e Majës, duke përfshirë këtu edhe krejt degëzimet e kësaj linje, që kanë të bëjnë me dramën e Xhizez apo me historinë e gjaksisë së dy fiseve, autor i ka manovruar mjeshtërisht dhe, pa ndërhyrë vetë, na e ka komunikuar qëndrimin e tij, simpatinë dhe antipatinë e tij. Por në episodet e luftës për triumfin e normave të reja morale në kooperativat tonë malore, të bie në sy menjëherë mungesa e asaj force komunikuese ndërmjet autorit dhe lexuesit, për shkak se idetë dhe mendimet e tij nuk arrijnë të jenë aq të mveshura me ndjenjë dhe forcë krijimi artistik sa në linjën e sipërpërmendur, por kanë mbetur disi të zhveshura, agitative dhe propagandistike.

Vepra që dëshmojnë për qëndrim të drejtë dhe të realizuar ideoartistik të autorit ndërmjet të tjerave mund të përmendim edhe romanin «Juga e bardhë» të Jakov Xoxës si dhe «Tokë e ashpër», roman i Teodor Laços.

Tablo më të ndryshme dhe disi më të realizuar paraqet ky problem krijimi kur është fjala për të biseduar për vepra me temë nga jeta e klasës punëtore apo në përgjithësi, nga jeta e qytetit tonë. Ndonëse pak e trajtuar mund të thuhet se kjo temë është kapur nga romancierët më gjerësisht dhe më thellë se në gjinitë e tjera. Natyrisht ky mendim nuk pohon ezaurimin e plotë të problemit, por së paku një arritje disi më të suksesshme të këtyre veprave me natyrë të tillë përbajtjeje. Kështu janë origjinale gjetjet e Ismail Kadaresë te romani «Dasma» për të na zbërthyer qëndrimin e tij kur është fjala lidhur me qëndrimin e shkrimittarit daj karaktereve dhe linjave që ata ndjekin në vepër, nëpërmjet tregimit në vetë të parë të

personazhit. Në këtë formë autor i ka bërë të mundur realizimin artistik të ideve dhe të qëndrimit të vet. Edhe kur shumë mendime të veta autor i jep nëpërmjet shkrimtarit S.K., personazh në roman, nuk të bie aspak në sy deklarativi, as ndonjë thyerje apo zbehje e forcës krijuese, dhe kjo ka ndodhur për pasojë të forcës krijuese të tij. Nder romane të tjera si: «Përsëri në këmbë» dhe «Fan Smajli» të Dhimitër Xhuvanit, «Vdekja e një nate», i Kiço Blushit «Dinjtor i shqetësuar» i Fatos Arapit, «Rusha» i Gjergj Zhejrit etj., mund të konstatojmë arritje të ndryshme të romancierëve lidhur me problemin që po diskutojmë. Kështu ndërsa te Dhimitër Xhuvani (te të dy romanet e tij) e gjejmë më të realizuar artistikisht qëndrimin ideoemocional të autorit, ndonëse edhe në këto vepra hasim pasazhe të paarrira në shprehjen e pozicionit që ze autorit, te romanet «Vdekja e një nate» dhe «Dinjtor i shqetësuar» vepra të Kiço Blushit e Fatos Arapit, ndihet se autorët më pak janë kujdesur për këtë aspekt të punës së tyre krijuese e, si rrjedhim, këto vepra aty-këtu kanë marrë karakter të thatë agitativ. Ndërsa romani «Rusha» i Gjergj Zhejrit, dëshmon për rritje të autorit në këtë plan. Aty të bie në sy finesa e hollë për ta derdhur në mënyrë sa më të natyrshme qëndrimin ideoemocional nëpërmjet mënyrës se si autorit dënon forcat konservatore-patriarkale dhe liberalo-moderniste në përkrahje të së resë progresive të moralit tonë socialist.

Në barabitje me romanet e mëparshme që trajtonin temën e së kaluarës apo të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, romanet e këtyre viteve të fundit me këto tema si «Kështjella», «Kronikë në gur» të Ismail Kadaresë si dhe «Komisari Memo» i Dritëro Agollit flasin për një ngritje cilësore në mjeshtërinë e dhënieve së qëndrimit ideoemocional të shkrimtarëve. Ata u janë shmangur në një masë të dukshme formave naivë e arkaike në dobi të dhënieve mjeshtërore e të tërthortë të qëndrimit të tyre të drejtë ideoemocional ndaj fenomeneve shoqërore, që zënë vend në romanet e tyre.

Realizmi ynë socialist i ka dhënë vend i jep mun-

dësi të mëdha shkrimtarit për të krijuar. Ai synon ta orientojë letërsinë tonë, në radhë të parë romanin, drejt temash të mëdha shoqërore, drejt problemesh të mëdha që preokupojnë mbarë shoqërinë tonë, pa më-njanuar e pa nënvleftësuar aspak jetën intime, botën e pasur të ndjenjave, përkundrazi gjithmonë duke e presupozuar këtë element të rëndësishëm jetësor.

Qëndrimi i partishëm i autorit lidhet dhe ka të bëjë kryesisht me interpretimin e fenomenit shoqëror që trajton vepra apo romani nga pozitat e ideologjisë sonë, duke e vështruar e vlerësuar realitetin nën prizmin e qëndrimit të prerë klasor. Realizimi i kësaj kërkese lidhet me formimin e shkrimtarit, me origjinën e tij klasore dhe me forcën e tij njohëse e zhbiruese ndaj realitetit.

Por për mungesë të ndonjë elementi të mësipërm ndikues në qëndrimin e partishëm të autorit, ndodh që ndonjëherë, nga krijues të ndryshëm të keqinterpretohet partishmëria duke u ngatëruar me qëndrimin thjeshtë agjativ. Në këto raste, autorët, duke mos mundur të krijojnë skena dhe episode që do ta ngrinin më fort realitetin jetësor në realitet artistik, apo ngaqë nuk arrijnë të krijojnë karaktere të fuqishme përgjithësuese, nëpërmjet zhbirimt të thellë në botën e tyre shpirtërore, mundohen ta plotësojnë boshillëkun me ndërhyrjet e vazhdueshme, shpjeguese dhe informuese, që e zbehin së tepërmi forcën ndikuese të romanit. Ky të kuptuar i shtrembër i raportit ndërmjet vendit që duhet të zërë fjala e autorit me episodet ku lëvrijinë personazhet dhe fati i tyre, apo me monologët e hesh-tur të heronjve, ka qenë më i dukshëm në fillimet e lëvrimit të romanit. Vitet më pas, rruga e zhvillimit dhe e pjakurisë ideoartistike të romanit, sollën me vete, nga njëra vepër te tjetra, shkarkimin e tyre nga ndërhyrjet e tepërtë shpjeguese dhe informuese të autorëve, pasurimin artistik të krijimeve të romancierëve tanë. Heronjtë apo personazhet në romanet e këtyre viteve të fundit e ndiejnë veten disi më të lirshëm. Ato veprojnë dhe linjat e tyre procedojnë shumë më

natyrshëm në përputhje me logjikën jetësore dhe artistike e jo sipas diktatit e dëshirës së autorit. Sigurisht edhe nga sa analizuam, del se ka ende mjaft dobësi në këtë aspekt të krijimit. Ende manifestohen raste mungesash serioze te ndonjë autor lidhur me qëndrimin e tij në vepër, lidhur me këndin ideoemocional të vështrimit të tij mbi jetën dhe njerëzit, por kjo nuk na shqetëson gjithaq se i pranojmë si dobësi të përkohshme rritjeje.

1973.

KLASA PUNËTORE DHE BOTËKUPTIMI I SAJ NË DISA ROMANE

Njëra nga detyrat më kryesore të letërsisë sonë të re është pasqyrimi i klasës punëtore dhe i botëkuptimit të saj në mënyrë sa më të plotë dhe sa më dinjitoze në veprat tona të çdo gjinie e sidomos në romanin tonë, ku kjo kërkesë mund të gjejë shtrirjen dhe reflektimin e saj më të gjerë.

Pohimi i mësipërm s'është rrjedhim apo pasojë e një dëshire të zakonshme e të rastit, që mund të na lindë për arsyen e thjeshtë se na pëlqen të shohim klasën punëtore, jetën e saj, botëkuptimin e saj në veprat tona letraro-artistike, por ka të bëjë dhe lidhet në mënyrë organike me tiparet më esenciale të shoqërisë sonë ku klasa punëtore, ideologjia dhe botëkuptimi i saj, janë në udhëheqje të të gjitha shtresave të tjera të shoqërisë. Pikërisht këtë nevojë, këtë domosdoshmëri, që këtë veçori të jetës sonë të sotme ta ndiejmë në përmasat që meriton në letërsi e sidomos në romanet tona, ripohon edhe një herë Partia në përshëndetjen e saj drejtuar njerëzve të artit e të letërsisë me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, ku thuhet: «Bartëse e ideve revolucionare, farkëtuese e filizave të rinj të komunizmit, është në radhë të parë klasa jonë punëtore. Ajo është rinia e përjetshme e artit revolucionar të realizmit socialist. Duke qenë kështu, figura, vepra dhe botëkuptimi i kla-

sës punëtore në krijimtari duhet të bëhen akoma më zotëruese.»¹⁾

Të vështrosh se në q'masë është realizuar kjo kërkesë në veprat tona e sidomos në romanet tona, nuk do të thotë vetëm të numërosh se sa heronj apo personazhe veprash janë punëtorë, se në sa romane janë përshkruar ambiente punëtore si bie fjala fabrika, uzina apo kombinate, se kjo do të ishte një thjeshtësim i problemit, dhe se nuk është kjo që do t'i jepte zgjidhje e përgjigje kërkesës së mësipërme. Për t'u bindur për këtë të vërtetë mendoj se do të mjaftonte që të kujtonim se edhe në shumë vepra të letërsisë së huaj realiste, apo të realizmit kritik, ndeshen personazhe punëtorë, ambiente pune, ku edhe demaskohet shtypja e shfrytëzimi, por megjithatë ato s'mund t'i quajmë vepra që përshkohen apo pasqyrojnë botëpuktimin e klasës punëtore, sepse të zberthyerit e konflikteve e të kontradiktave jetësore nuk realizohet nga pozitat botëkuptimore të kësaj klase. Në ato vepra, shpjegimi i raporteve të caktuara shoqërore nga shkrimtari nuk i kalon caqet e botëkuptimit liberalo-borgjez apo shumë - shumë demokrat.

Pikërisht këtu, në shpjegimin dhe interpretimin e realitetit, qëndron ndryshimi thelbësor i letërsisë sonë të realizmit socialist nga letërsia parasocialiste. Shkrimtari ynë nuk e merr pünëtorin dhe ambientin punëtor si sfond për të realizuar qëllime dhe ide të cilat s'kanë gjë të përbashkët me klasën punëtore dhe botëkuptimin punëtor, sikurse bën letërsia e sotme dekadente borgjezo-rezisioniste, që mundohet si e si ta largojë nga letërsia njeriun e thjeshtë të punës me hallët e problemet e tij. Përkundrazi, shkrimtari ynë vendos në tabanin e vet krijues vetë klasën punëtore dhe botëkuptimin e saj.

Në këtë vështrim ne mund të themi se krejt rruga e përshkuar nga letërsia jonë dëshmon për përpjekjet e ndërgjegjshme të shkrimtarëve në këtë drejtim, për-

1) Revista «Nëntori», nr. 12, 1970, f. 6.

pjekje që herë-herë janë kurorëzuar me sukses, me gjithëse ka mbetur akoma shumë punë përpara për t'u kryer, në mënyrë që klasa punëtore të zërë në letërsi po atë vend kryesor e të rëndësishëm që zë në jetën tonë.

Romanet që janë shkruar vitet e fundit, shënuan një hop të mëtejshëm në trajtimin e gjerë e serioz të jetës së klasës punëtore. Tani mund të diskutohet për vepra që në qendër të tyre apo si qëllim kryesor të autorit kanë pikërisht paraqitjen e vetë punëtorit e të problemeve, sukseseve dhe karakteristikave të jetës së klasës punëtore.

Kjo dukuri pozitive në romanin tonë lidhet edhe me rritjen e vetë ndikimit përherë e më të madh që ushtron klasa punëtore në jetën e shoqërisë sonë socialistë. Nëse dy dekada më parë ne e shtronim këtë kërkuesë, sot kemi shumë më tepër arsy që të dëshërojmë të shohim në romane punëtorin e ditëve tona.

Punëtorin e mirëfilltë në një dramë të fortë shpirterore dhe fizike na e dha Dhimitër Xhuvani me romanin e tij «Përsëri në këmbë». Është meritë e autorit që arriti së fundi t'i japë letërsisë shqipe, në një roman, në plan të parë klasën punëtore, punëtorin që hyri në radhët e klasës së vet fill pas Çlirimt, kur edhe për familjen e tij të varfér qytetare aguan shpresat e mëdha. Megjithëse linja jetësore e heroit në reflektimin e saj letrar në vepër është disi e veçantë për vetë fatkeqësinë që i ndodhi atij, heroit, prapë lidhur ngushtë me fatin e tij autori ka gërshtuar mjaft momente që i jepin shtrirje të gjerë dhe forcë përgjithësuese veprés.

Din Hyka, heroi i romanit, mishëron një sërë tiparesh karakteristike të punëtorëve tanë që, edhe pse s'manifestohen në atë mënyrë dhe aq mprehtë sa te ky përfaqësues i klasës, prapë ato i ndeshim shpesh dhe rëndom në jetë, në gjirin e masës së punëtorëve.

Këtë klasë, fizikisht të pranishme në vepër në përmjet heronjve të saj përfaqësues, e ndeshim edhe te romani «Fan Smajli» vepër tjetër edhe kjo e Dhimitër

Xhuvanit. Romani ka në qendër të vet një hero që mishëron idenë ë transformimit të ndërgjegjes së njeriut të ditëve tonë ndën ndikimin e fuqishëm të ideo-logjisë e të botëkuptimit revolucionar të klasës. Këtë tip e plotësojnë figurat e tjera të personazheve të mirëfilltë punëtorë që trupëzojnë ndjenja të larta njerëzore të humanizmit tonë revolucionar dhe që ndikojnë të-thorazi në formimin e karakterit të heroit.

Si te ky roman, skenat që përshkruajnë heroizmin e masës, punën vetëmohuese të njerëzve, ashtu edhe te «Përsëri në këmbë», pasazhet ku ravijëzohet jeta dhe puna në oficinë, lufta për realizimin e detyrës, pa vështruar vështirësitë që solli bllokada revisioniste, përpjekja revolucionare e klasës punëtore etj., ndonëse janë dhënë shkurt dhe si në sfond të veprave prapë bëjnë të ndiejmë dhe të njohim tiparet e klasës, fizionominë e saj, forcën e saj.

Tentativa për ta trajtuar në këtë plan dhe me këtë diapazon temën e klasës punëtore ka patur edhe në vepra apo autorë të tjerë. Kjo dëshirë e mirë ka shtyrë mjaft krijues të tjerë dhe në këtë drejtim kontributi s'është i paktë. Por mendojmë se në ndonjë vepër të kësaj temë, për shkak të mosnjohjes së thellë të realitetit ose për shkak të trajtimit të sipërfaqshëm të problemit, vërehen cungime, cektësi, madje dhe shtrembërimi lidhur me pasqyrimin në letërsi të kësaj sfère të rëndësishme të realitetit jetësor. Kështu romanet «Brigada e shtatë» dhe «Nëntë ballë» të G. Miçinotit dëshmojnë përmoshellim në pasqyrimin e jetës së njerëzve të klasës punëtore. Traktoristë, buldozeristë apo edhe shoferë qofshin ata, heronjtë e veprave, pavarësisht nga profesioni, kanë si element të përbashkët dhe kryesor ndërgjegjen e klasës. Por nëse autori, sikurse vepron në këto dy romane, do të tërhoqi më tepër mbas pasqyrimit natyralist të karaktereve dhe do të mundohet që me këtë rrugë t'i realizojë ata dhe klasën që përfaqësojnë, pa dyshim dashur pa dashur do ta deformojë të vërtetën jetësore. Në krijime të tillë asnjëherë

s'duhet të mbështetemi në njojjen intuitive dhe empirike të realitetit se vetëm kjo njojje është e pamjafueshme.

Mendojmë se në realizimin ideoartistik të romaneve me temë klasën punëtore ka rëndësi të dorës së parë saktësimi dhe realizimi i karaktereve që krijon shkrimtari në vepër dhe i ideve që përgon në të dhe jo «gjetjet origjinale» e të kërkua sikurse ndodh te «Dhjetori i shqetësuar» ku dëshira për të dhënë një vepër me formë të re, e ka shtyrë autorin në paraqitje gati reportazhistë të realitetit, dhe në mungesa të rëndësishme artistike. Fakti që për nga ana e ndërtimit vepra s'i ka elementët e domosdoshëm kompozicionale për të qenë një roman, e ka dëmtuar shumë atë.

Ndonëse synon të trajtojë këtë temë dhe këto probleme, romani «Vdekja e një nate», i K. Blushit nuk ia ka arritur qëllimit për dobësi në skalitjen e tipave përgjithësues punëtorë të ditëve tona, si dhe për mosrealizim në krijimin e ambienteve tipike punëtore ku, si në kudhër, rrighet e kalitet ndërgjegjja jo vetëm e klasës punëtore por edhe e shtresave të tjera të shoqërisë. Kjo ka ardhur ngaqë ky autor i ri në gjininë e romanit, s'ka mundur t'i përmbahet e të pasqyrojë, ndoshta për mungesë materiali jetësor, forcën e vërtetë morale, botën e vërtetë shpirtërore të klasës më progressive në gjirin e shoqërisë sonë socialistë.

Kur bisedojmë për botëkuptimin e klasës punëtore dhe për pasqyrimin e tij në letërsi, duhet të kemi parasysh së pari se ky është botëkuptimi i repartit pararojë të klasës punëtore, i partisë komuniste, dhe së dyti, se ideologjia e klasës punëtore, e partisë së saj, është ideologjia marksiste-leniniste.

Në të gjitha proceset kryesore të jetës sonë, në luftën e madhe që po bën sot mbarë populli dhe Partia për revolucionarizimin e ndërgjegjes së njerëzve tanë, ndihet e pranishme dhe e domosdoshme fryma e klasës punëtore, botëkuptimi i saj, prandaj ne e gjejëmë atë kudo në letërsinë tonë qoftë edhe në ato vepra që s'e kanë në epiqendër vetë klasën punëtore. Por

sigurisht më i dukshëm ky botëkuptim punëtor manifestohet aty ku edhe vlon jeta punëtore, problemet e klasës punëtore.

Te «Dasma» një nga konfliktet kryesore është ai i luftës për emancipimin e femrës, për shkëputjen e saj, nga kthetrat e kanunit, për të drejtën që ajo të vetëvendosë për fatin e vet. Katrina, heroina e romanit, bëhet mbartëse e frysës së re. Në luftë me botëkuptimin e vjetër patriarchal, ajo vendos të lidhë jetën e saj me një punëtor që e njoihu dhe e deshi vetë. Përveç ky veprim i vajzës, kjo mënyrë e zgjidhjes së konfliktit në roman, është kryer nën ndikimin e drejt-përdrejtë të botëkuptimit revolucionar të klasës punëtore, e cila vendos normat dhe ligjet e reja në marrëdhëniet shoqërore në emër të jetës e të humanizmit socialist.

Edhe shumë fenomene të tjera, që vazhduan të ekzistojnë në gjirin e shoqërisë sonë pas Çlirimt, si mbeturina të shëmtuara të së kaluarës, në këtë roman zgjidhen në mënyrë revolucionare nën prizmin e botëkuptimit punëtor. Kantieri i ri që po ngrihet po zhduk jo vetëm ferrat e drizat e fushës së djerrë, por edhe teqetë e botëkuptimit klerikal, bashkë me plagë të tjera të mbjella e të konservuara ndër shekuj, nga të huajt dhe nga shtypësit.

Ndikimin e botëkuptimit progresiv të klasës te romani «Përsëri në këmbë» e vërejmë lehtësisht në radhë të parë në triumfin shpirtëror të Dinit. Për ta rilevar këtë ide, autori jo rastësisht ka vëndosur në vepër një përfaqësues të cinizmit të shëmtuar të botës kapitaliste. Duke ballafaquar të dyja botët, duke ballafaquar rastin e Dinit me raste analoge në botën me klasa antagonistë, ne ndiejmë thellë forcën pozitive të humanizmit tonë socialist. Është botëkuptimi revolucionar i klasës sonë punëtore, nga radhët e së cilës ka dalë edhe Din Hyka që e frysëzon atë me besim për të ardhmen. Dini fare mirë mund të jetonte me pensionin që iu lidh si invalid, por kjo se kënaq, sepse ai është edukuar që të mos qëndrojë indiferent në jetë, të mos jetë parazit, ndaj në krejt

romanin ne gjejmë luftën e tij, me fatkeqësinë, me vetveten dhe njerëzit që mundohen t'i mbjellin farën e disfatizmit. Dini i mposht vështirësitë dhe ambienti shoqërор, botëkuptimi zotëruesh, e përkrah atë deri në fitoren përfundimtare. Përkisht janë këto leva, këto forca që i jasin mundësi heroit të mposhtë plogësh-tinë, të thyejë cdo rezistencë që ia krijon gjymtimi fizik dhe të bëhet i dobishëm për shoqërinë.

Shpirtin dhe frymën e klasës punëtore, mënyrën revolucionare të perceptimit e të qëndrimit ndaj fenomeneve shoqërore të rëndësishme në jetën e një populli, e gjejmë të manifestohet edhe te romani «Fan Smajli». Nuk shpjegohet ndryshe, veç me ndjenjën e solidaritetit të madh, me shpirtin e sakrificës, ajo që ndodhi në jetën e personazheve (dhe që ka zënë një vend kryesor në roman) në episodin e vërvshimit të lumit që i rrëmbeu jetën njërit prej shokëve më të mirë të brigadës së montatorëve. Edhe në shumë episode që mbartin konflikte nga më të ndryshmet, qoftë edhe të atillë që myllen brenda guaskës familjare, kudo zgjidhja varet dhe realizohet nën ndikimin e drejtpërdrejtë të botëkuptimit të klasës. Të gjitha këto dëshmojnë se në këtë plan fenomenet e konflik-tet janë parë e zgjidhur në funksion të botëkuptimit tonë të ri revolucionar. Kjo është fryma e vetme zotëruese që ndeshim në krejt romanet tona më të mira të realizuara nga shkrimitarë të ndryshëm, pavarësisht nga tema që trajtojnë. Por me gjithë sukseset e arri-tura, romani ynë, si edhe krejt letërsia jonë, ka shumë për të bërë për realizimin e plotë të kësaj detyre, ashtu si e kërkon populli dhe Partia. Mbetet ende një punë e madhe për t'u kryer. Punëtori ynë po bëhet nga dita në ditë më i ndërgjegjshëm për rolin që i ka caktuar historia në shoqërinë tonë të re, për detyrën e madhe që ka klasa punëtore si klasa më revolucionare dhe udhëheqëse e shoqërisë.

Prandaj qëndron gjithmonë e ngutëshme kërkesa që letërsia, e sidomos romani, të pasqyrojë këtë kla-

së në tiparet e saj kryesore, duke u thelluar në drejtinterpretimin e fenomeneve dhe të shfaqjeve të ndryshme të jetës, pa rënë as në idealizim as në skematizëm. Vetëm kështu letërsia jonë do të fitojë freski, gjallëri, dinamizëm dhe gjerësi ideoproblemore.

1974.

PROBLEMI I HEROIT POZITIV NË DISA ROMANE ME TEMË LUFTËN ANTIFASHISTE NACIONAL- ÇLIRIMTARE

Historia e letërsisë është historia e karaktereve. Në këtë përcaktim merr shpjegim përpjekja e gjithë-hershme e letërsisë përparimtare të të gjitha kohërave për skalitjen e heronjve, personazheve si karaktere të fuqishme, si mishërim tiparesh më të qenësishme të bashkëkohësve të epokës së tyre historike, apo dhe si trupëzim idealesh të shkrimitarëve, krijues të atyre karaktereve. Është një e vërtetë e provuar se ata, heronjtë apo karakteret, kanë mundur të jenë më të plotë, më të besueshëm, në ato raste kur është arriut shkrirja e plotë e të dyja anëve të mësipërme, domethënë kur heroi i veprës ka mishëruar edhe tiparet e bashkëkohësve, edhe idealet pozitive të shkrimitarit për atë epokë.

Me shtrirje të plotë, në funksionin e militantit shoqëror që kryen heroizma në emër të idealeve të popullit dhe të së ardhmes komuniste, heroi pozitiv u konkretizua vetëm në letërsinë më përparimtare botërore, në letërsinë e realizmit socialist. Si e tillë edhe letërsia jonë e re, heroin pozitiv, e vuri në themel të saj. Njohja dhe zotërimi përherë e në një shkallë më të lartë i filozofisë dhe i botëkuptimit materialist nga kriju-sit tanë, pasurimi dhe thellimi i asaj filozofie në terrenin tonë kombëtar, nëpërmjet mësimeve të Partisë dhe të

shokut Enver, zotërimi i estetikës dhe i parimeve të saj thelbësore, i dhanë dorë dhe e zhvilluan duke e përkryer gjithmonë e më shumë punën e romancierëve për skalitjen e heroit pozitiv, si figura qendore dhe më e fuqishme ideoartistike në vepër.

Sikurse është e natyrshme dhe rrjedhim i faktit se në fillimet e saj letërsia jonë rrahu më tepër temën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, edhe heroï i saj pozitiv duhet kërkuar dhe e gjejmë pikërisht si të tillë, si një hero luftëtar për çështjet e mëdhatë kohës; për çështjen e çlirimit kombëtar e shoqëror. Ky aspekt mbeti karakteristik edhe për romanin tonë të ri, ndonëse ky lindi e u zhvillua vite më vonë se gjinitë e tjera letrare.

Sot proza jonë e gjatë, romani, në tërësinë tematike të trajtuar, numëron një galeri të tërë heronjsh pozitivë të realizuar; sukseset e ardhme në këtë drejtim do të janë përherë e më të mëdha; por sado të shkojë ky proces, fillnisja e mbarë, themeli i shëndo-shë ideor i krijimit të kësaj tendencë të lidhur me karakterin e heroit pozitiv në letërsinë tonë, do të mbetet një fitore me vlera të pallogaritshme dhe garanci e përhershme suksesesh.

Përpjekjet e gjithanshme të autorëve tanë, për skalitjen dhe krijimin e heroit pozitiv; u vunë re, që në romanet e para dhe konkretisht që te «Çlirimtarët», roman i parë edhe për temën e luftës. Ajo (përpjekja) u konkretizua me krijimin e figurave të Hajdar Reçanit dhe të Gani Gurit. Në këtë realizim të parë si edhe në një varg heronjsh të tjere pozitivë, krijime të shkrimtarëve të ndryshëm, që nisen të lë-vrojnë në këtë gjini dhe tematikë, siç mund të përmendim: Luftar Bregu në romanin «Përbysja», Petrit Guraj në romanin «Një vjeshtë me stuhi», etj., vihet re në mënyrë të dukshme imprenjimi i autorëve për një realizim përherë e më të përsosur të heroit letrar në mënyrë që ai të materializonte sa më vërtetësisht heroin real; luftëtarin partizan, birin e popullit të thjeshtë, punëtorin apo fshatarin që ngjeshi armët.

dhe u bë jo vetëm luftëtar i paepur kundër armikut për çlirimin e atdheut, por njëherazi mori mbi vete edhe misionin, fisnik të propagandistit, të përhapësit dhe të agitatorit të flaktë të ideve të Partisë.

Por edhe pse sukses për kohën kur dolën, te këto romane, siguriشت në mënyrë të shkallëzuar, kanë bëre dukë dobësi lidhur me plazmimin e heroit pozitiv. Ai në një farë mase mbeti ende disi skematik. Jo një herë heronjtë pozitivë janë vendosur në situata dhe ambiente që u kanë dhënë dorë, si të thuash, natyrës së tyre agitativo-deklarative. Në mbledhje komunistësh apo ilegalësh, në takime me masën, në biseda me njerëz të veçantë, që zhvillojnë këta heronj të rinj ku më shumë dhe ku më pak ndihet kjo dobësi, pasojë sigurisht e mungesës së përvojës krijuese të shkrimtarëve dhe e njohjes së cekët të tipit shoqëror përgjithësues dhe tipit në ato vite heroizmash dhe sakrificash.

Megjithëse ky qëllim është i përbashkët për të gjithë ata prozatorë që lëvruan këtë temë në romanet e tyre të para, dallohet qartë se materiali jetësor, njoha e realitetit historik të kohës si dhe preqatitja e diferencuar ideoprofesionale e secilit prej tyre, ka përcaktuar shkallën e realizimit të personazhit kryesor, protagonistit apo heroit pozitiv në çdonjëren nga veprat me këtë temë. Nga mënyra e të konceptuarit të heronjeve pozitivë në romanet e sipërpërmendura, kuptohet se impenjimi ideoprofesional i autorëve, ka synuar gjithsesi drejt paraqitjes realiste dhe sa më të individualizuar të tyre. Me gjithë parimet e njëjtë, në krijimin e këtij karakteri si edhe me gjithë faktin që tematika, në mënyrë të përgjithshme, është e njëjtë, ka individualizim të secilit karakter në çdo njëren vepër. Hajdar Reçani, Luftar Bregu, Petrit Guraj etj., ruajnë secili fizionominë e vet, individualitetin e vet, janë tipa të dallueshëm, përherë njerëzore, me mish e me koska. Në shumicën e tyre ata rriten e formohen në faqet e romanit e përparrë syve të lexuesve, duke fituar kështu vlera gjithmonë e më realiste në

tabanin e funksionit të tyre kryesor si heronj pozitivë. Tentativa e shkrimtarëve për individualizim nëpërmjet vështrimit edhe në jetën intime të karaktereve heronj pozitivë, shpesh është kurorëzuar me sukses dhe e ka zgjeruar gamën individualizuese të tyre, por kjo është arritur veçanërisht në ato raste kur me natyrshmëri është bërë pasurimi i karakterit. Ndërsa kur kjo s'ka rrjedhur në mënyrë të vjetvishme, kur kjo ka ardhur më tepër si dëshirë subjektive e autorit dhe si me përdhunë është futur në vepër, e ka dobësuar, e ka zbehur personazhin.

Në këtë periudhë të parë qenë të natyrshme si të meta rritjeje edhe dobësitë në skalitjen e heronjve pozitivë me temë nga lufta. Ndërsa dobësitë kryesore ndihet në mënyrë të veçantë karakteri i theksuar i tyre. Në ndonjë pasazh ata shndërrohen në zëdhënës të zbehtë të ideve të autorit.

Por me gjithë sa thamë më lart, kjo periudhë e parë e trajtimit të temës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e përpjekjeve për krijimin sa më të arritur të heroit pozitiv, edhe pse me të meta në realizimet e saj, shërbeu shumë pozitivisht si mbësh-tetje për zhvillimin e mëpasëm, deri të sotëm, të këtij tipari, ndërsa më kryesorët e letërsisë sonë.

Vitet e pesëvjeçarëve, sidomos periudha e blokadës së egër imperialisto-rezisioniste, e ngritën në një shkallë të paparë ndonjëherë shpirtin dhe frymën revolucionare të masave të gjera të popullit, kalitën edhe më shumë tiparet më pozitive të karakterit heroik të këtij populli dhe bënë më të nevojshme ruajtjen e atyre traditave të shkëlqyera që ia rilevoi, si asnjëherë më parë, popullit tonë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Autorët që në këtë periudhë trajtuan temën e luftës e të heroizmit partizan, e ngritën cilësisht më lart krijimtarinë e tyre në romanet me këtë temë. Ndikoi në këtë rezultat tradita e krijuar me veprat e para, përvaja krijuese e romancierëve e sidomos formimi i tyre më i plotë ideor në interpretimin dhe

pasqyrimin e asaj epoke, tashmë nga lartësia e dy dekadave të jetuara, në ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Për thellim, pasurim dhe një arritje më të mirë në skalitjen e heroit pozitiv në romanet e kësaj etappe të zhvillimit tonë ekonomiko-shoqëror me temë Luftën Antifashiste Nacionalçirimitare, duhen përmendur në mënyrë të veçantë romanet «Para agimit» dhe «Komisari Memo», vepër që me të vërtetë shënojnë ngritje edhe pse kritika mund të ketë vërejtjet dhe kërkesat e saj dashamirëse. Në analizën e krijimit të heroit pozitiv, si në të gjitha tematikat e tjera, ashtu edhe në atë të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, duhet të nisemi kurdoherë nga orientimi që i dha letërsisë për këtë problem shoku Enver Hoxha në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH: «Duke kritikuar kuptimin skematik të një heroi të idealizuar në mënyrë libreske pa u mbështetur në realitetin tonë, në të njëjtën kohë ne nuk mund të pranojmë në asnje mënyrë skemën e re për një hero të lëkundur, e cila në fakt është një ndikim i hapët borgjezo-revizionist». ¹⁾

Lufta Antifashiste Nacionalçirimitare që me triumfin e saj përbëysi përfundimisht e përfjetësish rendin e padrejtë të shoqërisë me klasa, shënoi fillimin e një kthesë të paparë në historinë e popullit tonë. Ky realitet madhështor historik, sikurse është e kuptueshme, i dha mundësi zhvillimi të lirë gjenisë krijuese të masës së udhëhequr e të orientuar nga Partia. Si moment i tillë kthesë në jetën shoqërore të vendit, ai ndihmoi në krijimin e personalitetit të njeriut të thjeshtë të punës, rriti respektin ndaj tij, vuri në dukje tiparet më të pastra të karakterit duke u dhënë shkëlqim të ri atyre. Në këto kushte e rrëthana, të cilat erdhën duke u pasuruar me vlera përherë e më të mëdha, proza e gjatë gjeti material të begatë jetësor dhe, në zhvillimin e saj gjatë më se dy dekadave, që nga lindja e deri në ditët to-

1) Enver Hoxha. «Raport i mbajtur në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të PPSH», f. 34.

na, ajo e pasuroi me elemente të reja heroin pozitiv, e bëri atë gjithmonë e më real, më të fuqishëm e më ndikues, shënoi pra suksese në kristalizimin estetik të këtij elementi të dorës së parë për letërsinë tonë.

Duke qëndruar përherë në veprat me tematikë Luftët Nacionalçlirimtare, në romanet e viteve të fundit, mendojmë, sikurse e kemi përmendur edhe më sipër, se sukses ka arritur D. Agolli me figurën e komisarit Memo, në romanin me të njëjtin titull. Puna e shkrimtarit për të realizuar me dinjitet heroin pozitiv është kurorëzuar me sukses duke krijuar mirë figurën e heroit kryesor, figurën e komunistit, komisarit, aktivistit dhe agitatorit të pasionuar të Partisë. Memua i Agollit është një figurë e gjallë mjart reale, që ka një botë intime, e mbi të gjitha, që ka një dashuri e vendosmëri të pashembullt për idealet e Partisë së tij. Te kjo figurë nuk kemi të bëjmë me një mishërim idesh e konceptesh, sikurse është shprehur në mënyrë të pasaktë në ndonjë rast kritikë jonë, po me një tip të nxjerrë nga jeta e gjallë e kohës, me një figurë të realizuar komunisti. Natyrisht duke diskutuar për problemin e krijimit të heroit pozitiv, nuk duam të themi se me Memon D. Agolli ka arritur përsosmërinë, ne kemi gjithmonë kërkesa në këtë drejtim, por mendojmë se me këtë hero, shkrimtari ka bërë një hap të ndijshëm përrpara drejt largimit nga skematizmi në këtë fushë. Edhe fakti tjetër që Memua, si hero pozitiv, nuk është pasqyruar në evoluimin e tij, në rritjen e tij, por është pëershkuar dhe konceptuar si figurë e formuar, e cila na zbërthehet e na shfaqet në episode e situata të ndryshme, duke na vënë në pah me realizëm tipin shoqëror që përgjithëson, s'përbën aspak mangësi, por është në vetvete një formë e pasqyrimit artistik të personazhit dhe veçanërisht e heroit pozitiv, sepse s'është e thënë që të na jepet në çdo wepër doemos rruga e rritjes së heroit. Edhe kjo formë e pëlqyer nga D. Agolli është plotësisht e mundshme për të qenë e suksesshme.

Në ndryshim nga sa më sipër, rruga kërkimore për këtë problem thelbësor e Sh. Musarait te romani «Para

agimit» është konkretizuar në skalitjen e heroit pozitiv të romanit, Qemal Orhanajt, në vështrimin transformues të tij si një figurë që rritet bashkë me ngjarjet e mëdha shoqërore, bashkë me luftën tonë. Periuadha historike që ka marrë në vështrim Musaraj te kjo vepër është e ndryshme, detyra që i ka vënë vetes ai me këtë roman është e ndryshme, pra edhe mënyra e zgjidhjes së problemit të heroit pozitiv, e realizimit konkret të tij, doemos do të qe e ndryshme. Në këtë lëmë s'duhen kërkuar receta dhe as që mund të ketë receta.

Gjerësia e proporcioneve që u jep autori ngjarjeve të lidhura me Qemal Orhanajn, misioni i shumëfishtë i këtij personazhi në raport me realitetin dhe detyrat që shtonte ai realitet, poliedriciteti funksional i tij në vitet e luftës, siç ka dashur dhe ka arritur ta krijojë shkrimitari, janë arsyet e suksesit në krijimin e kësaj figure. Por s'duhet të injorojmë ndonjë të metë të personazhit, veçanërisht në pjesën e dytë të romanit, kur shkrimitarit në një farë mënyre i ka shkarë filli kompozicional nga dora, e për pasojë, disi i është dobësuar edhe heroi pozitiv i krijuar e i përquar aq me sukses në pjesën e parë të veprës.

Në zgjidhjen e këtij problemi, thelbësor për letërsinë tonë të realizmit socialist, në romanet e viteve të fundit vërejmë ecuri kualitative përsa u përket përpjekjeve të shkrimitarëve për të dhënë heronj pozitivë me vërtetësi jetësore. Interes paraqesin në këtë drejtim romane të tillë si «Zgjimi i Nebi Surelit» i Dh. Xhuvanit dhe «Shtigje të zëna» i M. Kallamatës. Te romani i Dh. Xhuvanit ndonëse në shtrirje hapsirë kohore të vogla, heroi pozitiv, Gaoja, ruan individualitet dhe është përfaqësues për atë aspekt të përpjekjeve të kohës, siç ka qenë lufta për shtypin ilegal të Partisë, në ato vite heroike të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare. Ai ka botë shpirtërore të mëvetshme, mendon dhe vepron në përputhje me natyrën e tij, por duket relativisht pak në faqet e veprës. Po të riparohej kjo e mëtë, heroi do të fitonte shumë. Kurse romani i ri i M. Kallamatës, i vështruar në këtë plan që i intereson

studimit tonë, ka meritën se ka krijuar një grup heronjsh pozitivë, éshtë munduar t'i individualizojë ata dhe u ka kushtuar vemendjen kryesore atyre, duke lënë në plan të fundit tipat negativë dhe shfaqjet negative jetësore të kohës.

Romani tjetër i kohëve të fundit «Nëntori i një kryeqyteti» éshtë një rillevim i ri, origjinal dhe i freskët i temës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Me densitetin karakteristik të mendimit, Ismail Kadareja u ka dhënë botë të pasur dhe individualizim heronjve të veprës, përfaqësuesve dhe mbartësve të së resë, që po vinte përmes tymit të krismave, heroizmit dhe besimit të patundur në triumfin e saj.

Skalitja e personazheve pozitivë, që autori e ka realizuar nëpërmjet zërthimit të botës së tyre të pasur shpirtërore, i ka dhënë gjerësi dhe gjallëri veprës. Në figurat jetësore dhe reale të komisarit, komandantit, partizanëve të thjeshtë të skuadrës sulmuese apo të udhëheqësve të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, janë derdhur me art veti dhe tipare morale të njeriut tonë të ri, që kishte lindur e po rritej bashkë me luf-tën e madhe, bashkë me revolucionin popullor.

Krahas këtyre realizimeve më dinjitoze lidhur me figurën e heroit pozitiv, lidhur me rrugët e ndjekura dhe sukseset e arritura në terrenin e romanit tonë të viteve të fundit me temë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, janë përpjekur, dhe jo pa fryt edhe autorë të tjerë. Kështu në romanin «Tri ngjyra të kohës» të Ali Abdihoxhës hasim edhe vlera edhe mungesa në plaz-mimin e heroit pozitiv. Skënder Shpata që në disa aspekte éshtë i arrirë dhe në lartësinë e misionit shoqëror që i kishte ngarkuar koha, në më se një rast tjetër, në pasazhe të ndryshme të romanit, éshtë dhënë nën këtë nivel, si në konceptimin ideor ashtu edhe në realizimin artistik të tij. Te ky roman, mendojmë se e ka dëmtuar realizimin e heroit pozitiv së pari: dëshira disi e tepëruar e autorit për të dhënë në dilemë çdo njerin nga personazhet, pra edhe heroin. Kjo sigurisht éshtë bërë me qëllimin e mirë që heroit të dalë sa më real

e jashtë skemës, por, pa u vënë re, ka sjellë me vete një skemë të re në roman. (Kujtojmë linjën e dashurisë me Blertën dhe lëkundjet e vazhdueshme të Skëndërit. Po e njëjta gjë ndodh edhe në raportin e marrëdhënieve të tij me të jatin). Së dyti, përqëndrimi i pavend dhe i tepëruar i interesit të shkrimtarit te heronjtë e mesëm, gjë që e ka zbehur linjën e luftës e të heroit pozitiv të veprës. Së treti, procedimi artistik jo shumë i saktë i shkrimtarit në reflektimin e jetësores në letërsi lidhur me heroin pozitiv. Kjo të bie në sy në mënyrë të dukshme, kur autori, ndërsa zhvillohen ngjarjet më të rëndësishme të luftës, e izolon heroin nga ato ngjarje, e fut atë në burg e hetuesi, ndalet në heroizmin e rezistencës së tij, gjë që është më e dorës së dytë se sa po të ishte dhënë heroi në aktivitet revolucionar. Për më tepër kujtojmë se, si vlerë estetike emocionale, kjo mënyrë paraqitjeje e heroit pozitiv është ezauruar prej shkrimtarit që në romanin e parë të tij «Një vjeshtë me stuhi». Këto dobësi e ngushtësimë të kësaj figure, edhe pse shkrimtari në vëllimin e fundit të veprës e vendos Skënderin në veprimitari partizane, nuk kundërbalancohen dhe nuk arrijnë t'i riparojnë mungesat e romanit në krijimin e heroit pozitiv.

Impenjimi i autorëve në këtë drejtim të punës së tyre krijuese, mendojmë se është i pamjافتë edhe te ndonjë roman tjetër. Tablotë e jetës së kohës, skenat e betejave, episodet e rritjes e të lindjes së ndjenjës atdhe-dashëse në masën e gjerë të popullit, fillimet e organizimit luftarak të popullit nën udhëheqjen e Partisë si dhe shumë aspekte të tjera të domosdoshme edhe këto në skicimin sa më realist të epokës, mendojmë se s'duhet të pengojnë përkujdesjet e veçanta të shkrimtarit për ta paraqitur heroin pozitiv dhe as ta zëvendësojnë atë. Çdo njëri nga komponentët përbërës të romanit në metodën tonë letrare ka vendin dhe vlerën e vet, që varet nga shumë rrethana të lidhura me qëllimin konkret të shkrimtarit në veprën që krijon, por mendojmë se asnjëherë s'ka arsy që në veprat tona heroi pozitiv në një farë mase e mënyre të zëvendësohet me personazhin

pozitiv, që e mbart më pasivisht të renë sesa heroi, i cili e përhap dhe e përçon ndërgjegjësisht atë në masat e gjera duke i tërhequr ato në rrugën e luftës për të ardhmen, për triumfin e së resë.

Degradimi i heroit pozitiv është bërë tipar i letërsisë së sotme revizioniste, e cila duke ndjekur qëllimet e saj si armë në duart e borgjezisë së re të vendeve revizioniste, jo rastësisht, por me synime të përcaktuara, është sulur drejt imitimit të çdo shfaqjeje të shëm-tuar të letërsisë borgjeze. Në këtë tendencë të saj ajo ka sulmuar me tèrbim, në mënyrë të veçantë, këtë vlerë të dorës së parë të letërsisë sonë, heroin pozitiv. Duke eliminuar nevojën për hero pozitiv, në fakt letërsia revizioniste është lëshuar pas deheroizmit, që e propagandon me të madhe në emër gjoja të thellimit në natyrën realiste të letërsisë.

Tendenca e letërsisë së sotme revizioniste që mohon rolin pozitiv, është një arsy me shumë që shtron përpara letërsisë sonë të realizmit socialist, nevojën e luf-tës për mbrojtjen e pastërtisë së saj ideore, nevojën e impenjimit të shkrimtarëve tanë në skalitjen dhe përsosjen sa më dinjitoze të heroit pozitiv, përquesit të së resë revolucionare në jetën tonë socialiste. Për t'i arri-tur kësaj duhet mbajtur parasysh mësimi i Partisë që: «*Po u errësua roli i heroit pozitiv, atëherë është mohuar shembulli i mirë, procesi dialektik i zhvillimit, është mohuar tipikja në fenomenin tonë shoqëror, është errësuar e mohuar perspektiva*.»¹⁾ Që këtej del i qartë kuj-desi dhe puna që imbetet të bëjnë shkrimtarët në ska-litjen gjithmonë e më të përkryer, në kuptimin më jetësor, më të përgjithësuar e më të individualizuar të heroit pozitiv, që i takon të sotmes e të nesërmes së shoqërisë sonë socialiste.

Duke pasur parasysh sa thamë më sipër, ashtu si-kurse e dëshmojnë edhe romanet tonë të shumta, prapë si rruga më kryesore dhe më e efektshme për pasqyri-

1) Mehmet Shehu, (Fjalim i mbajtur në aktivin e Partisë të Tiranës), rev. «Nëntori» nr. 2, 1974, fq. 9.

min revolucionar të realitetit tonë jetësor, mbetet rruga e pasqyrimit artistik të këtij realiteti nëpërmjet heroit pozitiv, nëpërmjet shembullit pozitiv, që është tipik e zotérues edhe në vetë jetën tonë.

Pra, si konkluzion, romani ynë me temë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare ka synuar dhe realizuar drejt e me dinjitet artistik heroin pozitiv, komandantin apo partizanin legjendar të asaj epoke heroizmash të pashembullta në historinë e popullit tonë. Ky hero nga romanet e para e deri në të sotmet ka fituar shumë vlera si në pikëpamje të gamës ideore ashtu edhe në individualizmin artistik.

Por me gjithë arritjet pozitive të deritanishme, ende mbetet shumë për të bërë në mënyrë që romani ynë me këtë temë t'u japë brezave të ardhshëm sa më të plotë figurën e luftëtarit revolucionar, të partizanit të frymëzuar më idealet e mëdha të Partisë. Mbetet ende, ndër kërkessat më të para për romancierët tanë, që në veprat e tyre të ardhshme të realizojnë sa më me vërtetësi heroin e gjallë, të besueshëm dhe të pastër, i cili me luftët dhe vetëmohimin e tij, u bë pishtar i së ardhmes socialiste dhe komuniste për popullin tonë. Ç'është bërë deri më sot për këtë problem është mjaft shpresëdhënëse për sukseset e pritme.

1975

MENDIME MBI DISA NGA FORMAT MË TË NJOHURA TË ROMANIT TONE

Romani, si një nga llojet letrare, njeh një periudhë relativisht të shkurtër lulëzimi te ne. Në kuptimin e mirëfilltë romani lindi dhe po zhvillohet si i tillë vetëm pas viteve pesëdhjetë të shekullit tonë. Gjithçka është krijuar më parë, e kemi fjalën për periudhën e paraçlirimit, pra në traditën tonë, është vetëm një përpjekje individuale, e vëtmuar e ndonjë autori, që arri ti sukses. Por sidoqoftë, romani si lloj i epikës, po zhvillohet e po lulëzon në mënyrë të theksuar në epokën e realizmit socialist.

Zhvillimi i vrullshëm i romanit, lulëzimi i shumë lloj stileve e formave në këtë lloj letrar, suksesi i tij i bujshëm te lexuesi ynë, na tërheq vëmendjen dhe na shtyn të thellohem i përgjigje në një farë mënyre, shkaqeve që sollën këtë sukses, për të zbuluar veçantitë e secilit lloj që përdoret nga autorët tanë të ndryshëm si edhe për të hedhur ndonjë mendim, krejtësisht tonin, për shtigjet e mundshme të së ardhmes së romanit.

Sigurisht inovacioni kryesor, themeli i suksesit të romanit tonë qëndron në brendinë e re jetësore, në identë e mëdha që derdhin në të autorët tanë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të realitetit jetësor dhe të ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Por lidhur ngushtësisht me këtë element të parë, si dhe në funksion të tij, pa u shkë-

putur për asnjet çast prej tij, duhet marrë në konsideratë edhe mënyra se si romancieri e organizon materialin jetësor që fut në vepër, pra q'formë përdor ai në përshtatje me brendinë e veprës, sa efikase dhe të komunikueshme e bën veprën, forma e përdorur etj. Se vetëm në këtë mënyrë, duke i njojur të gërshtuara të dyja këto elemente, mund të kemi mendim të saktë për vlerat e romanit dhe të llojit ku bën pjesë njëri apo tjetri roman.

Me formë të romanit nënkuuptojmë një numër elementesh, që i shërbejnë shkrimitarit për të derdhur sa më mirë e sa më me art brendinë jetësore dhe idetë në vepër, duke përfshirë këtu që nga arkitektura apo kompozicioni i përdorur e me radhë veçoritë e gjuhës, të figurës së fjalës e deri te dialogu në vepër etj. Për këto funksione të gjera e të shumta të formës, është lehtësisht e kuptueshme se sa e domosdoshme është njojja deri në imtësi e veçorive të saj te një shkrimitar, kur marrim të zbérthejmë një vepër për ta vlerësuar. Po kështu, nënkuptoher edhe kujdesi që duhet të tregojë autorit për të arritur që materiali jetësor të mund t'i japë atë veshje me të cilën do të mund ta bënte më të komunikueshëm romanin e tij.

Qoftë edhe nga ajo traditë e paktë e lëvrimit të prozës, e veçanërisht e lëvrimit të prozës së gjatë te ne, është e kuptueshme pse romani ynë fillimi shi ndoqi, e në një masë të konsiderueshme edhe sot ndjek, formën me narracion të shtruar, me rrjedhje të qetë faktesh, ngjarjesh, episodesh, me kulminacione e zgjidhje apo mbyllje që, të marra së bashku, përbëjnë një arkitekturë të përcaktuar klasike dhe shumë mirë të njojur.

Por duhet shënuar se edhe pse arkitektura është e njojur prej kohësh, romani ynë i realizmit socialist e pasuroi atë, i dha ftyrën shqiptare nëpërmjet brendisë së re që futi te ajo lloj arkitekturë. Nga ana tjetër, është pikërisht kjo brendi që diktoi pasurimin e romanit klasik në formë. Kështu lindi dhe po zhvillohet në romanin tonë heroi pozitiv, i cili s'duhet konside-

ruar si novacion. vetëm në brendi por edhe në formë. Kjo duket qartë tek ato romane ku heroi pozitiv duke qenë në qendër të ngjarjeve dhe të linjave të ndryshme që shtjellohen në vepër, shërben edhe si element i fuqishëm organizativ i materialit të derdhur nga shkrimtari në të. P.sh. te romani «Këneta» një funksion të tillë kryen Stavri Lara, te romani «Komisari Memo» epikendër organizative nga pikëpamja kompozicionale është Memo Kovaçi, vetë komisari etj.

Cilat janë tiparet e këtij zhanri të romanit të letërsisë sonë të re? Romane të tilla të sukseshme te ne qenë dhe janë «Ata nuk ishin vetëm» i S.Spasses, «Këneta» i F. Gjatës, «Një vjeshtë me stuhi» i A. Abdi-hoxhës etj. Në tërësi te këto romane ndërtimi i përmbahet pak a shumë kësaj linje: në krye është vendosur ekspozicioni që në ndonjë rast realizohet edhe me prologum, pas kësaj nis morja e episodeve që autorët i vendosin dhe i radhisin sipas qëllimit që ata duan të realizojnë në vepër. Në rrjedhën e ngjarjeve ka thyerje të shkaktuara nga retrospektiva që hedhin dritë e sqarojnë ndodhi apo skalisin karaktere. Romanet shtjellohen në bazë të një komflikti kryesor, të cilit herë-herë i shtohen koflikte më sekondarë. Autorët nën vizojnë dallueshëm tiparet e palëve të kundërtat ndërmjet të cilave shtjellohet subjekti dhe zgjidhet konflikti. Kështu romani procedon deri në pikën kulmore pas së cilës vepra ecën drejt zgjidhjes e, në ndonjë rast mbylljet edhe me epilogun sqarues i cili shuan plotësisht kureshtjen e lexuesit.

Kjo formë është përdorur me sukses në më se një rast. Ajo kërkon përgjithësisht një material jetësor të hollësishëm. Në krijimin e romaneve të tilla autori observon shumë dhe gjatë në jetë, në realitet. Por në këtë zhanër romani ndonjëherë ka ndodhur që rrëfimi të jetë i flashkët, t'i mungojnë impulset, ndonjëherë të tingëllojë shumë monoton, madje të sqarojë aq shumë saqë bëhet i mërzitshëm dhe kalon në një informacion të zbehtë e të painteres për lexuesin. Sigurisht të meta të tilla i hasim te romane të dobët të këtij

zhanri si: «Stuhia» i R.Likës, «Nëntë ballë» i G.Miqi-notit etj.

Jeta e popullit në vitet e shtypjes, të shfrytëzimit dhe të robërisë, epopeja e madhe e Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare si edhe realiteti i mrekullueshëm i ditëve tona janë burim i madh subjektesh për romanin tonë të asaj forme ku shkrimtari realitetin mundohet ta pasqyrojë sa më gjatë, në mënyrë sa më të shtrirë, me sa më shumë fenomene jetësore, me qëllim që të japë një tablo të plotë deri në hollësi të jetës, të forcave të saj lëvizëse, të shtresave përbërëse të shqërisë, të rolit të tyre në zhvillimin tonë shoqëror etj. Kjo formë e romanit shumëvellimsh nisi të lëvrohet tek ne që me lindjen e këtij lloji. Romani «Çlirimtarët» i Dh.Shuteriqit synoi drejt kësaj forme. Më vonë romani «Lumi i vdekur» i J.Xoxës, «Para agimit» i Sh. Musarajt, «Tri ngjyra të kohës» i A.Abdihoxhës dhe «Juga e bardhë» i J.Xoxës e pasuruan këtë zhanër romani në tiparet dhe fizionominë e tij.

Është karakteristikë për këtë formë romani, praprër romanin e gjatë, shumëvellimsh dhe shumëplansh, vështrimi i gjerë i autorit mbi realitetin frysëzues, moria e detajeve, linjat e shumta dhe procedimi kompozicional nëpërmjet shumë kapitujve që vijnë e renditen njëri pas tjetrit në funksion të zbërtimit të brendisë dhe të ideve të veprës. E re te kjo formë është pasurimi i madh i brendisë së veprës në shërbim të sqarimit të ideve të romancierit.

Më pranë romanit epope, ndër romanet tona shumëvellimshe, mendojmë se qëndron romani «Lumi i vdekur». Themi kështu se te kjo vepër ka përpjekje serioze nga autori për të folur e medituar për epokën që kamarrë në observim: Te «Lumi i vdekur» J.Xoxa e ka dhënë të plotë tablonë e jetës së fshatarësise myzeqare në kohën e sundimit të feudo-borgjezisë. Romani përfshin e pasqyron në shumanshmëri mjerimin e bujkut shqiptar, jetën dhe zakonet e tij, protestën apo revoltën e tij.

Dhe jo vetëm kaq. Te «Lumi i vdekur» tabloja e

jetës përfshin shumë shtresa të shoqërisë shqiptare të kohës; feudalët zënë vend aty me tërë egërisinë, injorancën dhe imoralitetin e tyre të shfrenuar. Borgjezia tregtare manifeston tiparet e saj në mënyrë fare të lakuriqtë. Vellezërit Gjanica janë shfrytëzues të atillë, që nuk shtangen e nuk ndalen në realizimin e qëllimit të tyre edhe kur gjenden përpara katastrofës së njerezve të varfër. Nuk mungon të zërë vend në roman administrata e shthurur dhe e korruptuar zogolliane, forcat ushtarake të «ruajtjes së rendit publik» etj.

Veprat e tjera të prozës sonë të gjatë shumëvëllimshe, kryesisht janë romane ku autorët, duke pasur në zotërim një mori faktesh jetësore të njoitura ose të jetuara, kanë mundur të derdhin në vepër material shumë të madh. Te këto romane ndeshen herë-hërë të meta e dobësi lidhur me tepërinë e materialit, që ka ardhur nga mosseleksionimi i morisë së fakteve të derdhura në vepër, nga proliksiteti etj.

Periudha e thellimit të revolucionit tonë ideologjik e kulturor, solli lindjen dhe zhvillimin e një zhanri të ri të romanit tonë. Duke pohuar si sukses trajtimin dhe pasurimin e formës së romanit shumëvëllimsh që përmendëm më sipër, themi se sukses për prozën tonë të gjatë qe edhe lëvrimi i romanit të ri me një natyrë të theksuar meditativo-filosofike dhe të ngjeshur me probleme të mëdha shoqërore.

Një ndër autorët me merita në këtë drejtim zhvillimi dhe lulëzimi të këtij romani pa dyshim është Ismail Kadareja me veprat e tij si «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Kështjella» dhe «Kronikë në gur». Te secili prej këtyre romaneve vërejmë përpjekjet e sukses-shme të autorit për të gjetur e përdorur forma të reja sa më në përshtatje me idetë e shkrimtarit për kohët e njerëzit.

Te ky zhanër i ri romani janë karakteristikë kon-densimi i materialit, lakonizmi i theksuar, përgjithësimet filozofike për njerëzit, ngjarjet dhe kohët. I.Kadareja duke qenë edhe poet i një poezie të fuqishme e të

figurshme, ka ruajtur në prözë një stil të bukur plot figuracion e me ritëm të brendshëm. Romanet e I. Kadaresë kanë thurje të larme dhe proçedojnë vrullshëm nëpërmjet kapitujsh të shkurtër e të ngjeshur. Vëmentdjën kryesore autori e ka përqëndruar në paraqitjen e fenomenit shoqëror tipik për atë etapë historike së cilës i drejtohet vepra dhe vetëm në shërbim të saj, autori zbulon karakteret dhe përshkruan ngjarjet. Karakteret njerëzore, elemente të dorës së parë në krijimin letrar, te romanet e Kadaresë, vizatohen me pak penelata, ndryshe nga romani tradicional apo shumëvëllimsh, ku autorët i jepin faqe e kapituj të tërë ndërtimit të karaktereve. Në romanin e vet I.Kadareja operon shumë më efekt nëpërmjet simbolesh. Simbolet te ai janë në funksion të ideve që ngre vepra, ato asnjëherë s'janë dhënë si qëllim në vetvete, prandaj, ato përherë janë të kapshme dhe të kuptueshme për lexuesin. Drejt e mjeshtërisht shkrimtari ka arritur të na jep qëndrimin e vet, këndin e tij të vështrimit për ngjarjet dhe njerëzit. Këtu ka spikatur edhe aftësia e tij për të mos na e komunikuar drejtpërsëdrejti qëndrimin si autor me ndërhyrjet e vëta direkte, por duke na e dhënë atë tërthorazi, nëpërmjet personazhesh që veprojnë dhe jetojnë midis të tjerëve, në epokën dhe ngjarjet që përfshihen në materialin jetësor të veprës. Këto sigrisht janë vetëm tiparet më kryesore të romaneve, të Kadaresë pa u futur në hollësi dhe karakteristika të tjera të shumta.

Një formë të ndryshme, interesante dhe funksionale për brendinë e derdhur në të përbën edhe ai zhanër që karakterizohet nga një brendi e pasur me probleme shoqërore të kohës, së cilës i është veshur forma e zbërthimit psikologjik të personazheve. Në romanë të tillë si «Përsëri në këmbë» dhe «Fan Smajli» të Dh.Xhuvanit, «Një lindje e vështirë» i E.Kadaresë etj., mjeti kryesor i autorëve është analiza e botës shpirtërore të personazhit nëpërmjet monologëve të heshtur për të motivuar veprimet dhe qëndrimet e tyre. Kjo formë romani ka vlerën e vet, përsa i përket the-

llimit të meditimit të autorëve mbi jetën, mbi ngjarjet dhe mbi njerëzit. Ka vlerë edhe për faktin se pa rënë në maniera të një psikologjizmi formal, edukon te lexuesi dëshirën shumë pozitive për t'i njojur në thellësi fenomenet e jetës e të shoqërisë. Kjo sigurisht në mwartësi të forcës njoħe塞 dhe analizuese të autorëve. Pra 1ëvrimi i një forme të tillë në përputhje me materialin jetësor, qëllimin dhe aftësitë e talentit krijuies të njerit apo të tjetrit shkrimtar, eshtë një plus i konsiderueshëm për romanin tonë të sotëm.

Me interes për format e tyre pak a shumë origjinalë apo së paku, që kanë elemente origjinaliteti krijuies lidhur ngushtë me stilin e shkrimtarit, në letërsinë tonë janë edhe romane të tillë si «Komisari Memo», «Kullat», «Tokë e ashpër», «Zbulimi» etj. Sigurisht kjo përpjekje e mirë e autorëve në veprat e mësipërme që do t'ë vijë duke u rritur e kristalizuar, do të sjellë diçka me vlerë në formën e romanit tonë.

Pra rruga e imbarë e punës së shkrimtarëve për krijimin e romanit tonë të ri eshtë e dëshmiuar plotësisht edhe nga shumëlojshmëria e formave që hasim sot te disa nga romanet tona. Ato, në shumicën e tyre, e kanë justifikuar vetveten dhe dashurinë e respektit e lexuesve.

1974.

**ANALIZA
VEPRASH TË VEÇANTA
NË PROZË**

ДЕЛАНИЯ
АТМАДЕН ВЪ ПОСЛАНИИ
СВѢТОГО ПАИ

VITET E RILINDJES NË FAQET E NJË ROMANI

Rilindasit tanë me luftën dhe jetën, me veprat dhe me sakrificat e tyre, u bënë pishtarë të lirisë. Ata duruan vuajtjet dhe varfërinë, ndjekjet e egra të sundimtarëve turq e të agjentëve të borgjezisë si dhe të vetë kishës së huaj, ata ranë dëshmorë në altarin e shenjtë të lirisë së atdheut, të bindur se me veprimtarinë dhe me heroizmat e tyre po i shërbenin zbardhëllimit të çlirimt kombëtar, që për shekuj me radhë e kishin dëshëruar për Shqipërinë e tyre të vogël. Ajo epokë ndriçoi gjatë në historinë tonë kombëtare, nxiti pasuesit, ata që i thelluan dhe i tejkaluan ëndrrat më të guximshme të rilindasve, luftëtarët heroikë të Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pa mbyllur sytë përpara kufizimeve ideore dhe botëkuptimit idealist të tyre, duke vlerësuar atë që qe dhe mbetet më pozitivja në jetën e veprimtarinë patriotiko-letrare të rilindasve, Partia dhe shoku Enver e kanë ngritur dhe çmuar së tepërm shembullin prej revolucionarësh demokratë të patriotëve të Rilindjes. *Epoka e Rilindjes*, — ka thënë shoku Enver, — është një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë, është një epokë e ndritur, e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur *Rilindja e kombit, dalja nga errësira mesjetare-feudale*,

imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarezi, demokraci, për dritë dhe arsim».¹⁾

Letërsia jonë e realizmit socialist, në të gjitha gjinitë dhe llojet e saj, shpesh i është drejtuar epokës së Rilindjes, është frysmezuar nga patosi patriotik masiv i saj, nga lufta dhe veprimtaria letraro-arsimore e pionierëve të saj. Populli e ruan të pavdekshme në poezinë, në këngën e vet, kujtimin e heroikës dhe të patriotizmit të atyre viteve. Por në mënyrë të vëçantë, me mundësi shumë më të mëdha pasqyrimi, për vetë natyrën epike, këtë detyrë sa të vështirë aq edhe fisnike për edukimin me traditat atdherdashëse të brezit të ri të sotëm e të ardhshëm, mund ta kryejë romani.

Romani ynë edhe më parë e ka trajtuar këtë periudhë: Jehona e kohës, heroizmi i viteve kur luftohej për mëmëdhenë, ndihet në shumë romane, sidomos te ata që kanë për objektion pasqyrimi artistik luftën e madhe; revolucionin tonë popullor. Ky kalim, kjo lidhje epokash, kur në historinë tonë janë kryer ndeshje vigane, që qenë vendimtare për të ardhmen, mbetet më se e natyrshme dhe madje është e domosdoshme të zerë vend në vepra të tillë. Fakti që qysh te «Ata nuk ishin vetëm», te njeri nga romanet e para të letërsisë sonë të re, Sterjo Spassja krijoi, ndër personazhet më simpatikë e më të realizuar, xha Koroveshin, atë ish-bashkëluftëtarin e Themistokli Gërmjenit e të çetave të Rilindjes, i cili mbart deri në vitet 30-të të këtij shekulli frysni luftarake dhe urrejtjen e pashuar për pasardhësit e halldupëve, për feudalët dhe bejlerët e periudhës së urryer të sundimit zogolian, tregon dhe na bind se romancieri ynë i njobur e ka pasur gjithmonë për zemër trajtimin e kësaj teme.

Fundi i shekullit të 19-të shënoi një kulm në vijën e ngritjes që po ndiqte lëvizja patriotike e Rilindjes. Ato përpjekje të nisura me aq guxim nga patriotë të flaktë si Naum Veqilharxhi, Kristoforidhi, Grigor Ar-gjirokastriti, për lëvrim të shkrimit të shqipes, po jepnin

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», fq. 368.

frytet e veta në atë fund shëkulli me alfabetaret, që ishin shtypur jashtë, me aktivitetin e patriotëve të emigruar në dobi të lëvizjes në Shqipëri dhe sidomos me besëlidhjen e parë të krahinave të ndryshme të atdheut në Lidhjen shqiptare të Prizrenit. Brenda në Shqipëri, lëvizja liridashëse mori fytyrën e luftërave kryengritëse në Veri e në Jugë, kundër sundimit turk; ajo u shpreh me luftën për ndërgjegjësim patriotik të masës së popullit.

Në këto vite dhe lidhur ngushtësisht me këto rrëthana të kohës, nisin ngjarjet që përfshihen në subjektin e romanit «Zgjimi».

Helmi dhe vreri i grumbulluar në zemrat dhe shpirtin e njerëzve të thjeshtë për shkak të shtypjes, varfërisë dhe intrigave të kohës, e kishin mbushur ikupën e durimit popullor. Dhe në këtë drejtim romani dëshmon se autori zotëron një njojje të mirë dhe një material të pasur për kohën. Emocionalisht vepra të fut në thelbësoren, tipiken e realitetit që në kapitujt e parë. Shqetësimi dhe pasiguria e qytetarëve, frika nga sulmet e befta plaçkitëse prej ushtrisë turke, shqetësim ky që rri ngritur përherë mbi kokën e vegjëlisë qytetare, duke u përsëritur herëpashere në kapitujt e romanit, e ka krijuar atë atmosferë pasigurie dhe tronditjeje të vazhdueshme. Në shërbim të pasqyrimit emocional dhe realist të kohës, si dhe për të plotësuar sa më denjësishë tablonë e jetës shqiptare, shkrimitari ka hedhur dritë mbi shumë fenomene. Ardhja e turmës së redifëve, që Turqia kishte grumbulluar me ngut për të përballuar presionin shkatërrues të luftërave e të kryengritjeve, të cilat po e shpinin drejt vdekjes së pashmangshme «të sëmurin e Bosforit», si dhe gjendja e vajtueshme e këtyre trupave për shkak të kalbësisë e të dekompozimit të ekonomisë së Perandorisë Otomane, flasin në mënyrë të pakundërshtueshme dhe bindëse se kishëte ardhur koha të shporrej ai pushtues. Dhembja dhe vuajtja e zgjatur me vite e Hamit efendiut, atij kovacit të varfër, për të birin ushtar prej vitesh që s'di se ku e ka apo dhe e Ali Zboqit, fshatarit nga Gora,

për të nippin redif, janë raste që përgjithësojnë një të vërtetë të lidhur, por të madhe të kohës.

Gjithmonë në këtë tragë realiste, romani na�renda mureve të qytetit. Këtu ai zbirthen dhe analizon, duke zbuluar me forcë artistike, raportet e shumta e të shumëlojta shoqërore si edhe kontradiktat e ashpra antagoniste, që vlonin në gjirin e kohës. Në subjektit e romanit ne njohim lojën e egër dhe të ndyrë të klerit ortodoks, që për të zbatuar urdhrat e dëshirat e borgjezisë së huaj shoviniste, përpinqet me të gjitha forcat, duke mos u ndalur as përpara kërcënimeve dhe krimave më çnjerëzore, të fusë ndjenjat antishqiptare, përqarëse në popullsinë shqiptare. Për këtë qëllim ai vepron prej kohësh me një rrjet të gjerë klerikësh, agjentësh, dhe institucionesh që i mbante në këmbë dhe i financonte. Romani ka një seri episodesh nëpër linja të ndryshme të subjektit, që zbulojnë pikërisht këtë të vërtetë. Ndonëse jo aq e pikëzuar në zbulimin e punës shkombëtarizues që kryente nëpërmjet fesë kleri mysliman, vepra hedh drithë mbi një fakt tjetër të rëndësishëm real të kohës, mbi bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet ortodoksisë dhe myslimanizmit në emër të shkombëtarizimit.

Në aleancë kundër popullit të shtypur dhe ndjenjës së shqiptarizmës, janë lidhur jo vetëm kërët e fesë, por edhe administrata qeveritare turke. Të gjithë që nga pashai e deri te oficerët më të rëndomtë, në mënyrë të padeklaruar, janë lidhur me pasanikët ortodoksë dhe me klerikët e kësaj feje nëpërmjet shumë interesash të përbashkëta e të pashkëputura. Ata janë kompromentuar plotësisht në sytë e njëri-tjetrit dhe, ndonëse e urrejnë njëri-tjetrin, kanë bërë kauzë të përbashkët. Episodet jetësore, që pohojnë këtë të vërtetë, janë të shumtë në vepër.

Në miqësinë e tyre s'ka veçse rushfete, borxhe, imoralitet e fëlliqësi. Njëra palë i jep tjetrës atë që i mungon dhe kjo i lidh të dyja palët në një miqësi të fëlliqur aq sa edhe të kalbëzuar.

Mendojmë se një element jo fort bindës e jo fort

i motivuar për vetë natyrën ideore të veprës dhe qëllimin që ka ndjekur autori është qëndrimi disi i lë-kundur e dashamirës i pashait ndaj patriotëve shqiptarë, qëndrim që gjoja justifikohet me origjinën shqiptare të tij.

Në zhbirimin e raporteve klasore të kohës, në njohjen e forcave regresive, që u vunë në shërbim të interesave të borgjezisë së huaj shovene, për lidhjen e ngushëtë të veprimtarisë së tyre me interesat vetjake, shkrimtari ka demaskuar me forcë dhe vërtetësi borgjezinë shqiptare të kohës nëpërmjet dy prej përfaqësuesve të saj tipikë, nëpërmjet tregtarit grosist të Kondurit dhe përfaqësuesit të borgjezisë financiare, Mangalecit. Kjo e vërtetë e madhe historike e kohës, në romanin «Zgjimi» ka marrë një pohim të ri nëpërmjet krijimit origjinal dhe me vlera individualizuese për fenomenin.

Por nëse jemi të bindur dhe e çmojmë këtë krimj të ri të S.Spasses për vlerat njohëse, këtë e themi jo aq se vepra ka zbuluar forcat dhe burimet e shtypjes dhe të armiqësisë ndaj popullit tonë dhe pavarësisë së tij kombëtare, por kryesisht dhe në radhë të parë, për forcën zhbiruese realiste me të cilën shkrimtari vështron dhe zbërthen jetën e popullit ku, nën shtypjen dhe varfërinë, po ndizej flakë ndjenja e revoltës dhe e luftës për të drejtat kombëtare, si edhe për pasqyrimin artistik emocional të këtij aspekti jetësor, të cilit shkrimtari i jep vendin zotërues dhe në interpretimin e të cilit qëndron simpatia dhe përkrahja e dukshme e tij.

Realiteti historiko – shoqëror shqiptar i viteve të fundit të shekullit të kaluar, i kohës kur btoheshin veprat e fuqishme e të frymëzuara poetike të Naimit, kur së pari shpalaje hapur si thirrje për bashkim dhe si sfidë për armiqëtë e pavarësisë krenaria për emrin shqiptar, ishte i rëndë dhe i ngarkuar me shtypje dhe mjerim. Romani «Zgjimi» e ka rilevuar mirë artistikisht këtë të vërtetë. Janë të shumta skenat e goditura në vepër, që zbulojnë gjendjen realisht duke

e vështruar si në masën e fshatarësisë ashtu edhe në shtresat e gjera të vegjilisë së qyteteve. Shtypja shumëfishe në kurriz të fshatarësisë, sundimi çnjerëzor anadollak i agallarëve dhe i oficerëve turq, taksat e shumta etj., e kishin shndërruar fshatin në një arenë ku më imprehët se kudo shprehej egërsia e sundimtarit të huaj dhe padrejtësia shoqërore e sistemit feudal. Romani i pohon këto anë të jetës në disa episode. Kujtojmë episodin e taksave që mbledh Sefedin agai nëpër fshatrat e Mokrës, aty ku përshkruhet gjendja dhe varfëria e familjes së Gjokës, apo mjerimi dhe fatkeqësia e Ali Zboqit dhe e dhjetëra e dhjetëra familjeve të tjera fshatare. Po në këtë plan, realiste: dhe demaskuese janë dhe dhjetëra episode që vizatojnë përpara nesh tablonë e jetës qytetare. Familje të skamura që mezi e ngrysin ditën dhe jetën, punëtorë të papunë që vërtiten pa shpresë në pazarin e krahut të punës, ku shitet dhe forca e njeriut si çdo mall tjetër; si forca e çdo kafshe pune, kurbetlinj që shtegtojnë për bukën e gojës, familje që i ka molepsur e po i bren veremi etj, etj. Por pas kësaj pamjeje të përgjithshme, shkrimtari ka ditur: dhe ka mundur të zbulojë atë të vërtetë që, ndonëse e padukshme, ishte e pranishme për kohën kur rritej lufta për pavarsësi kombëtare; e cila edhe pse heshturazi, kishte nisur të lëvrinte e të dukej përherë e më hapur. Çetët e komitëve që kërcënolin shfrytëzimin e qetë e pa telashe të pushtuesve apo të feudo-borgjezisë vendëse dhe që herë pas here e përshkojnë veprën si ankthe të pamposhtshme dhe tronditëse për sundimtarët, përpjekja e ndërgjegjshme për shkollën dhe gjuhën shqipe, lufta përmotivë shoqërore apo patriotike e Gjokë Mokrarin, (ndonëse individuale), lufta e përditshme, përherë e më e ndërgjegjshme e Mistos, Thimi Markos, Xha Vanit, Orhan Pojanit etj., për gjuhën shqipe, përtë drejtën e mësimit të saj në shkolla të huaja apo shqipe, kërkesa për gjuhë e shkollë shqipe e firmuar nga dyqind familje korçare, flasin për atë urrejtje, që vlonë dhe që së afërmi do të shpërthente dhe do

të ndizte flakë zemrat e patriotëve e të rinisë shqiptare. Duke qenë i inkuadruar në fundin e viteve 80-të të shekullit të kaluar, romani i përçon ngjarjet jo më tej se kjo precatitje për luftë, se këto fillime proteste e revolte, sepse ende zgjimi kombëtar s'ishte arritur në atë shkallë saqë të kuptohej nevoja për shkollë e pavarësi në mënyrë masive, se ende forcat e errëta të klerit, të okupatorit, të sundimtarëve dhe të borgjezisë vendëse kishin influencën e tyre dhe mundoheshin ta mbanin në verbëri ndërgjegjen kombëtare shqiptare, në të mirë të tyre synimeve të tyre aneksioniste.

Krejt këtë brendi jetësore dhe realiste autori e ka përquar në vepër nëpërmjet të shtjellimit të shumë linjave, gjë që ka zbuluar raportet antagonistë të kohës. Edhe te ky roman i ri i S.Spasses shkojmë atë karakteristikë të përgjithshme e dalluese të krijuarrisë së tij, që shprehet në punën e kujdeshshme dhe arritjen e suksesshme, në skalitjen e karaktereve. Krejt brendia e veprës, shumica e episodeve në të, linjat më të rëndësishme që shpalosin para nesh subjektit e veprës, janë në funksion të karaktereve jetësore, tipike e përgjithësuese, që do të krijojë autori dhe mbarten e realizohen vetëm prej tipash të atillë letrarë sic na i ka plazmuar shkrimitari.

Planet që e mbartin antagonizmin e konfliktit të kohës kanë lindur në roman edhe tipa që e përfaqësojnë këtë antagonizëm. Rrjedhimisht në vepër kemi, të skalitur një sërë luftëtarësh e patriotësh, ku përfshihen figura të njohura historike si Themistokli Gërmjenji, apo edhe figura të krijuara me vërtetësi e forcë përgjithësuese nga shkrimitari. Me Miston (Themistokliun, në roman janë dhënë vetëm vitet e rinisë së patriotit të madh të Rilindjes sonë Kombëtare), Spassja ka krijuar figurën e djaloshit atdhetar që e do popullin, e do lirinë e Shqipërisë, e ndien padrejtësinë e sundimit të huaj, por që vetëm tanë, nën shtytjen e përpjekjeve patriotiko-gjuhësore të kurbetlinjve si edhe të patriotëve brenda në Shqipëri, filloj ta konkretizojë në ndërgjegjen e vet nevojën e ngutshme për tu hedhur në aksion,

në veprime konkrete siç e kërkonte koha. Mistoja rritet në roman, atë e rrisin ngjarjet e mëdha, tronditëse, që të shërbën si prelud i ngjarjeve të mëdha të së ardhmes. Nga një djalosh pothuaj i brishtë, i qetë, me tipare të buta, ai arrin deri te akuzuesi i guximshëm, që në hartimin e tij flet hapur për nevojën për çlirim, për dashuri ndaj atdheut, për dashuri ndaj gjuhës. Këtë transformim rrënjosor, këtë rritje, shkrimitari e ka motivuar etapë pas etape, nëpërmjet elementesh bindëse. Shtresa e varfër nga e cila rrjedh, (i jati kurbetli e patriot, vëllai shërbëtor në han) ambientet shoqërore që e tërheqin, (kovaçhana e Hamit efendiu, miqësia me Rexhon, kovaçin kosovar), ndikimi i patriottëve brenda në Korçë si Xha Vani, Orhan Pojani dhe sidomos Marga etj., e së fundi, kontakti i përhershëm me varfërinë, mjerimin dhe urrejtjen e masave, e formojnë djaloshin, e gdhendin si karakter, e pjekin si luftëtar, si bir besnik e të paepur në realizimin e qëllimeve të mëdha për dituri dhe liri kombëtare. Por edhe pse me këto vlera mjaft pozitive, Mistoja ka ndonjë çast zbehtësie, sidomos në aspektin e marrëdhënieve familjare.

Eshtë tjetër punë hutimi në aksionin e vrasjes së mitropolitit Fillothe. Ne e pranojmë si plotësisht të motivuar këtë skenë, se ajo qe prova e parë e aksionit me armë për Miston. Por hutimi e dyshimi për Gjokën, kur edhe i jati, që më parë e ka lajmëruar se do t'i dërgojë një abetare të shqipes, eshtë i panatyrshëm dhe sikur e cenon në një farë mënyre figurën, forcën bindëse të saj. Këtu edhe pse kemi të bëjmë me një figurë reale, historike, e cila mund t'i ketë të vërteta momente të tilla jetësore, ne gjykojmë si për një krijim letrar.

Shumë pranë Mistos dhe në të njëjtin plan ideor të romanit qëndron Marga si karakter, që, për mendimin tonë, eshtë ndër më të realizuarat në vepër. Marga eshtë vajza shqiptare e atyre viteve, e asaj periudhe të zjarrtë për pavarësi, që përbuzi prangat zakonore, sfidoi moralin ekzistues dhe u ngrit në nivelin e grave luf-

tëtare, e motrave, që, krahas burrave dhe vëllezërve të tyre, luftuan për çlirimin kombëtar.

Marga është e realizuar plotësisht si personazh, është dhënë artistikisht në nivelin më të mirë, ajo të bind dhe komunikon si figurë reale në çdo veprim të sajin. Në dashurinë e saj për gjuhën shqipe, në letrat që u shkruan shqip plakave të lagjes për bijtë e tyre në kurbet, në miqësinë e ngushtë me Miston, me të cilin e aftron ideali i përbashkët, në urrejtjen e saj për klerin e klerikët, ajo zbulon fizionominë e vet të pastër morale. Edhe në momentet delikate për ecurinë unike të personazhit, për koherencën ideore të tij, autori e ka motivuar drejt. Është kemi fjalën konkretisht këtu përmartesën e Margës me Petraq Kondurin, tregtarin e pasur të Korçës dhe antishqiptarin e tërbuar. Mendojmë se autori ka vepruar drejt në lidhjen martesore të të dy të rinjve. Për kohën, për nivelin e zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore, për mentalitetin zotëruesh, do të qe një thyerje e pajustifikueshme e kohërencës së karakterit të personazhit nga ana e autorit që Marga ta refuzonte atë martesë. Në motivim të këtij veprimi shërbën edhe synimi i Margës për të lëkundur Petraqin nga rruga e tij antipatriotike pavarësisht se objektivisht kjo do të qe e pamundur, por vajza kështu mendon). Nga ana tjetër, kur ajo e njeh mirë të shoqin, bindet përmë të kundërtën e iluzioneve të saj të dikurshme, njeh edhe fëlliqësinë morale të tij, është prapë plotësisht e motivuar në veprimin e saj të guximshëm, kur braktis Petraqin, përbuz pasurinë e tij, jetën e rehatit përmë të mos tradhuar idealet e saj përmë çlirim kombëtar nga zgjedha e dyfishtë e pushtuesve turq dhe e propagandës greke. Figura e Margës arrin një kulm të rritjes së saj, kur ajo, duke mos përfillur asgjë, deri edhe mallkimin e kishës, merr pjesë, e vetme si grua dhe ndërmë të paktët burra, në varrimin e Pandeliut, djalit të Kristo Oparakut.

Por ndërsa me Margën kemi këtë realizim dinjitoz ideoartistik, me vajzën tjetër, që njëherazi shpreh edhe tragjizmin e fatit të femrës shqiptare të kohës, me Durrutinën, autori s'ka pasur aq dorë të mbarë. Edhe si

Vlinjë ajo e Doruntinës me Marko Gjatollin, ndonëse shërbën për të zbuluar fëlliqësinë morale dhe krimet e shëmtuara të klerit të huaj në Shqipëri, mbetet disi e zhbehtë. Edhe si episod në roman, ajo jo vetëm është mjaft e shfrytëzuar (bukuroshja e varfër, që lako mohet dhe rrëmbhet nga turqit sundimtarë apo klerikët e pamorëshëm dhe që arrin në çmenduri apo vetëvrasje), por është e mbuluar me një vëllo romantike të panevojshme dhe përshikohet nga një frymë e pajustifikueshme sentimentale, e pajustifikueshme për tabanin thallisht realist të romanit në tërësi. Për mendimin tonë, Doruntina dhe fati i saj përfaqëson një ide të drejtë të shkrimtarit, që ai e ka përfthuar nga realiteti kohor i asaj periudhe historike, por një ide që mbetet e parealizuar artistikisht.

Një galeri e tërë personazhesh të tjera të dorës së parë apo të dytë në vepër mishërojnë realitetin shoqëror dhe përfaqësojnë aspekte të rëndësishme pozitive të atij realiteti. Në funksion të luftës për zhvillimin e gjuhës shqipe si armë që do të ruante unitetin tonë komibëtar dhe luftën për pavarësi, në vështrim të përgjithshëm për kohën, radhitën një sërë individualitetesh shoqërore më pak apo më shumë të individualizuara nga puna e shkrimtarit. Të tilla na mbeten në përfytyrimin tonë Xha Vani, Orhan Pojani e Thimi Markoja, me përpjekjet e tyre disi tepër të matura por këmbëngulëse për të drejtën e mësimit të gjuhës shqipe, apo Hamit Efendi, kovaçi Rexhë, Ali Zboqi, me mjerimin, me varfërinë dhe me urrejtjen e tyre të fuqishme. Me ngarkesë të plotë emocionale dhe mjaft komunikuese në roman mbeten figura të tjera si Kristo Oparaku apo Paçistani dhe Gjokë Mokrari. I pari, me urrejtjen e tij të hapur ndaj klerit të huaj hipokrit të asaj kohë ngritet mbi dhembjen e tij prej babai që ka humbur djalin e vetëm dhe fshikullon me tèrbim deri dhe mitropolitin «e shenjtë» Fillotheun. Kurse i dyti, Gjoka, me luftën dhe përpjekjet e tij heroike për përhapjen e shkrimtit të shqipes dhe me dhembjen për dramën e së bijës, bëhet aq konkret dhe i konceptueshëm, veçanërisht në

fundin e tij prej martiri për çështjen e shqiptarizmës, ku ai ngrihet në një simbol, në një përgjithësim të krejt atyre që ranë dhe u martirizuan nga dora e egër e armikut të huaj.

Në këtë ansambël figurash e tipash të larmë e në përgjithësi mjaft mirë të realizuar, na vjen keq kur konstatojmë ndonjë notë të pasigurt, qoftë kjo shumë pák e ndjeshme. Mendojmë se autori do të kishte bërë mirë ta konceptonte po në këtë plan pra, në planin realist, edhe figurën e komitit, Markos, që e njoihëm në linjën e marrëdhënieve me Doruntinën. Themi kështu se mendojmë që Markoja ka mbetur shpesh një figurë e mje-gulluar qoftë në raport me çetën e komitetëve, qoftë në planin e hakmarrjes së tij kundër Filliotheut dhe Sefedin agait.

Me fundin tragjik dhe të pasuksesshëm të Markos vërtet autori i ka shprehur qëndrimin e tij dizaproves për këtë rrugëdalje të gabuar, por s'na duket e drejtë që në këtë aventurë të pashpresë implikohen dhe Mistoja, madje deri-diku edhe Marga, që gjatë gjithë romanit, me përjashtim të këtij episodi, mbajnë një qëndrim në férësi realist e të drejtë në luftë kundër armikut të huaj.

Plani tjetër në roman, ai që shpreh qëndrimin e të huajve okupatorë apo shovinistë si dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë nga shtresat e pasura të qytetit, është dhënë nëpërmjet karakteresh të realizuara dhe të livërteta. Autori i ka stigmatizuar duke zbuluar anët më të egra e më të zvethnuara të moralit të tyre të shëmtuar. Ndër ta mendojmë se përsosmërisht është zgjidhur figura e mitropolitit Filliothe dhe e arqimandritit. Ky i fundit është si një plotësim i elementeve më të egra e më shtazore, që mitropoli i fsheh. Kuptimplotë është fakti që arqimandriti është edhe evzon i tërbuar që, për nevojat e propagandës shovene, ka veshur petkun e klerikut.

«Shenjtëria» Filliothe, injeri me kulturë e me autoritet në patrikanën e Stambollit, në vepër i ka të gjitha premisat e një kleriku të aftë në zanatin e tij. Ai është

dinak, demagog dhe i pashpirt. Ndonëse rrallë e ndeshim në kapitujt e romanit, në çdo takim me të, shkrimtari i zbulon fytyrën e vërtetë. Duke qenë një klerik e kryetar feje i këtij kalibri, është e qartë sesa e vështirë qe lufta për ta mposhtur atë. Në episodin me Doruntinën e sidomos në mbytjen e fëmijës së saj të porsalindur me urdhër të Fillotheut, zbulohet natyra kriminale e «shenjtërisë» së tij. Në raport me Margën, zbulohet demagogjia dhe loja dinake e klerit të huaj të kohës në dëm të pavarësisë sonë kombëtare, kurse, në përplasje me Kristo Oparakun është dhënë demaskimi përfundimtar i hipokrizisë fetare të mishëruar te ai personalitet kishtar. Ky qëndrim demaskues e përshkon tejetej veprën edhe kur është fjala për klerin mysliman, që, në mënyrë kuptimplotë, e gjejmë të përqafuar me priftërinjtë vetëm e vetëm që të mos u shpëtojnë nga zinxhirët e injorancës dhe robërisë «turmat e shqiptarëve».

Me realizëm janë zbërthyer e tipizuar edhe figurat e kolaboracionistëve të paskrupuj nga shtresat e pa-sura të borgjezisë shqiptare. Te qir Mangaleci e sidomos te familja Konduri, me përfaqësues Petraqin, të shoqin e Margës, janë përgjithësuar vëtitë e asaj shtrese të pasur që u lidh dhe i shërbeu propagandës antishqiptare, sepse gjithë interesat e saj i kishte të lidhura ngshtësisht me të huajin. Petraq Konduri, sikurse krejt familja e tij, konkretizon rënien e plotë morale, mungesën e çdo shfaqjeje ënderi e dinjiteti, lakminë e pafund për pasuri. Egoizmi është forca që e shtyn Petraqin në çdo dëshirë e veprim. Për të kënaqur atë egoizëm, ai, pa përfillur opinionin e klasës së vet, që e dënonët një martesë të tillë, merr Margën grua, dhe do ta kthejë atë në një objekt thjesht të kënaqësisë fizike. Për egoizëm ai i shërben mitropolitit dhe dëshirave e ndjenjave shovene të borgjezisë së huaj të asaj periudhe. Në orgjitetë e tij, në histerizmin e tij, në lakminë e gjetkë autorit ka gjetur ato vese morale dhe fizike që plotësojnë portretin e borgjezisë shqiptare të kohës.

Shkrimtari ynë, i udhëhequr nga dëshira për të

evokuar epokën e ndritur të luftës së rilindasve, në romanin e tij «Zgjimi» na ka zbuluar fillimet e asaj lëvizjeje, që vite më pas shpërtheu në luftën e armatosur dhe u kurorëzua me fitoren e pavarësisë më 1912. Në pasqyrimin e ngjarjeve, në vlerësimin e situatave, në gdhendjen e tipave, ai ka mbajtur atë pozicion të shëndoshë ideor dhe na e ka krijuar epokën në atë interpretim të drejtë të fenomeneve social-ekonomike që është karakteristike për shkrimitarët tanë të armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me mësimet e Partisë e të shokut Enver në trajtimin letrar të tematikës e të problemeve të mëdha historike të së kaluarës sonë të lavdishme. Kjo, pa dyshim, përbën vlerën më kryesore të romanit «Zgjimi».

1974.

VËRTETËSIA JETËSORE DHE ORIGJINALITETI NË ROMANIN «SHEMBJA E IDHUVJE»

Romani «Shembja e idhujve» e Skënder Drinit është një ndër ato vepra të letërsisë sonë të realizmit socialist, që pas romanit «Ata nuk ishin vetëm» të S. Spasses, «Lumi i vdekur» të J. Xoxës, e ndonjë tjetri pasqyron gjendjen e fshatarësisë sonë në vitet e regjimit antipopullor të Zogut.

Janë vitet kur pregatitej pushtimi italian i vendit, kur reaksionarët e çdo kallëpi manovronin në të gjitha mënyrat për të përbajtur zemërimin e popullit. Këtë situatë të ndërlikuar të kohës, acarimin e marrëdhënieve midis klasave shfrytëzuese dhe popullit, autori ka mundur të na e japë me mjeshtëri. Ai ka ndërtuar, nëpërmjet tipikes e zbërthimit me realizëm të karaktereve, një tablo të gjallë jete me të gjitha skutat e qoshet e saj. Nga ana tjetër, S. Drini i ka kushtuar vëmendje të vëçantë edhe demaskimit të veprimtarisë së klerit katolik në ato vise ku janë vendosur ngjarjet që ngërthen romani.

Kleri katolik qe rrënjosur thellë në malësi duke spekuluar mbi injorancën e varférinë. Ai, si vegël e sundimtarëve bajraktarë, gjeti përkrahjen e tyre, madje u shndërrua në një forcë pothuaj të barabartë, aleate, përpos të tjerave, duke shfrytëzuar, ashtu si i vinte përmbarë kanunin, ligjin e pashkruar të maleve.

Me demaskimin e fesë si armë në duart e sundim-

tarëve dhe të okupatorëve të çdo kallëpi, letërsia jonë, dhe si pjesë e saj edhe romani ynë, është marrë më se një herë. Në mund të numërojmë një varg romanesh ku në linja kryesore apo në linja të dyta të subjektit, ka zënë vend kleriku, përfaqësues i veprimtarisë së maskuar antipatriotike.

Ky konstatim nuk është thjesht shprehje e dëshirës subjektive të bashkëkohësve tanë. Ai lidhet me faktin real, me aktivitetin e gjatë armiqësor të klerit shqiptar që para ekzistencës së shtetit tonë, pas krijimit të tij dhe arrin deri në ditët tona. Nga ana tjetër, ai lidhet me të sotmen, me luftën që masat e gjera të udhëhequra nga Parta dhe mësimet e shokut Enver po i bëjnë fesë, si mbeturinë e së kaluarës, e cila, nuk është e njaf-tueshme të luftohet si institucion, por duhet rrënjosur edhe si ideologji, si botëkuptim që i ka rrënjet të thella në ndërgjegjen e një pakice njerëzish sidomos të moshuar.

Në krejt shtjellimin e ngjarjeve në vepër, shkrimitari nxjerr në pah se kleri, ky institucion i shoqërisë me klasa, i ndërgjegjshëm përmisionin e vet antipullor e reaksionar, është munduar dhe ka nxitur mes njerëzish uato veti morale që u vinin përshtat qëllimeve të tij. Hakmarrja, vëllavrasja në emër gjoja të nderit, u nxit përmekësuar me radhë prej priftërinjeve, të cilët në mënyrë hipokrite, nga pupitrat dhe altarët e shenjtë predikonih paqen, dashurinë, faljen e fajeve e të mëkateve. Duke i hyrë thelli kësaj të vërtete, romani zbulon se jo vetëm në këtë aspekt, por edhe në krejt shfaqjet e aktivitetit të tij të fëlliçur, kleri katolik sidomos në krahanat e thella të malësive, dirizhojë nga koka e reaksionit kishtar botëror, Vatikani. Në këtë plan romani merr vlera se jetërsori dhe mbush me material faktik të vërtetat e njohura dhe të jetuara nga masat e gjera të popullit në të kaluarën. Çdo aktivitet i klerit, gjithë të hu i synimeve që u shërbente interesave dhe pango-pësë së tij, në shekuj ka qenë i drejtuar në dëm të vegjilisë. Romani hedh dritë mbi të vërtetën e pamohueshme që përherë kleri është përpjekur dhe i ka shë-

byer të huajit, armikut të lirisë. Duke luftuar idealet pozitive të popullit, duke penguar dëshirën pér arsim dhe kulturë dhe, nga ana tjetër, duke nxitur dhe duke mbjellë interesat e qarqeve shoviniste fqinje, kleri shqiptar ka përdorur pa skrupuj çdo mjet sado të egër e gjakësor në dëm deri edhe të ekzistencës sonë si popull shqiptar.

Nëpërmjet linjave kryesore, nëpërmjet episodeve të shumta që ngërthehen brenda këtyre linjave, romani zbulon edhe të vërtetën tjetër të rëndësishme se hipokrizia fetare, sado e rafinuar dhe e kamufluar, prapë kishte nisur të demaskohej në sytë e malësorëve. Ata kishin nisur të kuptionin diçka nga falsiteti i predikimeve kishtare dhe kjo po ndodhje jo rastësish. Valët e historisë sado dobët, me ngjarjet e tyre të mëdha, kishin lënë jehonën e vet edhe thellë në malësitë e Veriut. Lufta e patriotëve të mëdhenj: e Bajram Currit, Isa Boletinit, Fan Nolit, pra revolucioni i 1924-ës, s'kishte kaluar pa lënë gjurmët e veta, përkundrazi, ai kishte ndezur flakët e luftës pér liri në shpirrat e malësorëve. Këto ndjenja e dëshira revolte, në fillim spontane, gjatë viteve po mbruheshin dhe po shndërrroheshin në të vetëdijshme. Ato po përshkoheshin nëpër malësi nën ndikimin e vetë jetës dhe jo vetëm të saj. Demokratët popullorë nga radhët e inteligjencës, të ushqyer me ndjenjat e urrejtjes ndaj regjimit të egër të tipit anadollak të Zogut, mësuesit e fshatrave, djem me zemra të zjarrta që kishin rënë në kontakt me idetë e reja madje edhe me literaturën ilegale marksiste, u bënë nxitës së urrejtjes qoftë kundër regjimit, qoftë kundër forcave të tjera të errësirës e në radhë të parë, kundër falsitetit dhe propagandës hipokrite armiqësore klerikale.

Romani «Shembja e idhujve» i ka realizuar artistikisht këto aspekte jetësore dhe sidomos në planin e demaskimit të klerikut hipokrit nëpërmjet krejt linjës së dom Engjellit. Edhe pse kjo është meritë e romanit do të na dukej po kaq me vlerë, në mos më shumë, që shkrimtari t'i kushtonte vëmendje edhe demaskimit të vetë fesë si botëkuptim i gënjeshtërt, që synon të tutlatë forcat progresive të shoqërisë, t'i vërë në gjumë

ato pér tē lehtesuar sundimin e sundimtarëve. Mendoj-
më se me aq vend sa i është dhënë në vepér kësaj
ideje, ajo mbetet disi e mangët. Episodet e pakta lidhur
me muret e shkollës që rrëzohen natën nga «zemërimi i
fantazmave», se në themel tē tyre s'është bërë kurba-
ni, përpjekjet e mësuesit si te episodi i prerjes së dru-
rit tē pyllit, që askush s'e prekte pér tē mos ngjallur
zemërimin e zanave e tē shtojzavalleve, apo beteja që
do tē bëjë vetë Martini me këto krijesa fantastike, që
sillnin prapësira në Kalcë, veprime ku ai bindet pér
foshnjërinë e mentalitetit tē tij, janë tē pakta jo vetëm
pér tē ezauruar qëllimin që në mënyrë tē domosdoshme
i përket kësaj teme, por edhe pér ta trajtuar atë me
djinjitet.

Pér stadin e sotëm tē luftës sonë kundër fesë dhe
botëkuptimit fetar, kur ne i kemi zhdukur klerikët dhe
institucionet e tyre, mbetet detyrë ende lufta kundër botë-
kuptimit reaksionar klerikal që nuk shrrënjoset aq leh-
tësist nga ndërgjegjja e një pjesë tē shoqërisë, ashtu
sikurse u përbysën institucionet e këtij botëkupti-
mi. Romani që po analizojmë do tē kishte fituar një dia-
pazon më tē gjerë ideor, do tē kishte një tingull më tē
fuqishëm aktual, nëse demaskimi i vetë botëkuptimit
klerikal do tē qe vënë më në objektion tē synimeve tē
shkrimtarit në mënyrë që tē mos kalojej kaq shkarazi
ky aspekt.

Edhe pse romani krahas tē tjerave ka në qendër
tē vet problemin e demaskimit tē rolit reaksionar tē
kishës dhe tē klerit, ai nuk mbetet ngushtësisht i mby-
llur në trevën e kësaj ideje. Në brendinë e tij ai është
pasuruar me vështrimin e gjerë ndaj këtij fenomeni
negativ që, kurdoherë ishte zhvilluar i ndërlikuar edhe
me forcat e tjera tē errësirës, shtypjes dhe reaksionit.
Dom Engjëlli gjatë gjithë aktivitetit tē tij shumëvjeçar
në Kalcë pérherë dikujt i ka shërbyer dhe prej dikujt
është ndihmuar. Ai ka gjetur gjuhë tē përbashkët, madje
dhe shumë miqësore qoftë me pushtuesit austriakë në

kohën e tyre, qoftë me kryeféudalin, Zogun, qoftë edhe me imperializmin italian që po prégatiste pushtimin e ri të Shqipërisë.

Dom Engjelli pér qëllimet e tij ka bërë kauzë të përbashkët me kapter Selimin, me kryeplakun e fshatit, me kapidan Gjonin, bajraktarin e urryer, megjithëse ai thellë në vetvete i përbuz këta njerëz makutë, injorantë, të pashpirt dhe xhahilë. Dom Engjelli pér hir të interesave të veta, ngrihet mbi konsideratat personale, sepse e kuption që janë pikërisht këta njerëz, sado të pështirë qofshin, që i duhen, që u shërbejnë synimeve të tij. Ai nuk heziton të marrë në shërbim deri edhe kriminelë si Mur Perkeqi. Në realizimin e kësaj ideje romani ka episode të ndërtuara bukur dhe me forcë komunikuese. Të tilla janë skenat e takimeve që bëhen në qelë me emisarë të klerit të Vatikanit, të cilët viniñ në Shqipëri pér të parapregatitur pushtimin fashist të vendit tonë; takimet me kryeplakun, kapidanin apo kapterin deri edhe takimet me Mur Perkeqin, që këtu në qelë merrte urdhra pér të vrarë njerëz të padëshëruar të saj. Autori në këtë funksion ka mundur që edhe artistikisht qelën, kur e përshkruan, ta paraqesë si fole krimesh dhe kriminelësh, e cilâ simbolikisht me të tre katet e saj zotëron plotësisht mbi godinën e ulët të zbrazët e të ftolitë të kishës së lënë pas dore. «*Shtëpia le Dom Engjellit*, — 'thotë në roman shkrimtari, — ia kishte kâluar shtëpisë së zotit.»

Makiavelizmin dhe jezuitizmin e mesjetës të impostaar në shekullin XX në Shqipërinë e prapambetur të kohës së Zogut, shkrimtari ynë e demaskon nga pozitat revolucionare të ideologjisë sonë. Në këtë kuptim romani tërësisht qëndron në pozita të shëndosha. Realiteti jetësor në të është pasqyruar dhe interpretuar artistikisht në mënyrë të re, duke u nisur nga një këndvështrim i drejtë. Pikërisht pér këto merita ne e gjejmë veprën të freskët e me interes edhe pse trajtimi i kësaj temë ka qenë objekt krijimi pér shumë pena të fuqishme botërore.

Vihet re në vepër tendenca jo vetëm pér të goditur

hipokrizinë, dhe jezuitizmin katolik, por edher për t'i vënë atij përballë forcat e reja progresive, ato që do ta shkatërronin atë, duke dhënë kështu embrionin e asaj së cilës i përket e ardhmja. Konkretisht, Skënder Drini këtë element, të së nesë, e realizon përvç me anë të paraqitjes së pakënaqësisë, dhe të revoltës së heshtur të fshatarëve, ku bën majë qëndrimi i fisit të Camajve, që brez pas brezi kanë pas luftuar kundër sundimtarëve, të huajve dje pushtuesve e ku sidomos spikat protesta dhe kryengritja e hapur, ndonëse e vetmuar e Kalosh. Camit dhe e të birit, edhe me paraqitjen e figurës së mësuesit që vjen në Kalcë, me përpjekjet e tij për të ngritur shkollën, me luftën që ndërmerr ai për të demaskuar priftin dhe fenë në sytë e në ndërgjegjen e fshatarëve etj.. Kemi mendimin se në roman është realizuar në mënyrë më të denjë përpjekja e mësuesit për t'u kundërvënë personalisht, me bagazhin dhe me mprehtësinë e tij dinakërisë dhe hipokrizisë së priftit. Kurse luftha për shkollën, për arsimimin e malësorëve, pra përtë krijuar ndërgjegjen e re te masat e popullit, si e vëmja rrugë e suksesshme që do ta lëkundte seriozisht ngrehinë kishtare në ndërgjegjen e malësorit, është lënë në plan të dytë, madje herë-herë është lënë po-thuajse në harresë.

Historikisht dihet se sado me vështirësi, sado që ka kërkuar sakrifica të mëdha, qysh vite më parë, dje jo më në prag të okupacionit fashist, shkolla shqipe në Jug e në Veri, luajti rolin e saj të madh për zgjerimin e ndërgjegjes kombëtare. Në këtë mision fisnik të saj ajo u ndeshashpër edhe me armikun e saj të përjetë, shëm, klerin. Mësuesit tanë patriotë synuan dhe i vunë forcat e tyre në këtë drejtim (në drejtim të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare të masave) se e kuptuan drejt që vëtëm kështu mund të mposhtej hidra fetare. Me mprehtësinë, me nivelin e vet kulturor, mësuesi i vëtmuar, sado i pregetitur dhe i vendosur të qe, s'do të mundej kurrrë të lëkundte pozitën dhe autoritetin e kishës, ca më pakt do të kishte shans t'i shembte idhujt që, me një mijë mënyra e rrugë kleri gjatë shekujve

kishte mundur të nguliste në mendjet e njerëzve të thjestë. Në këtë kuptim mendojmë se romani do të kishte fituar shumë vlera ideore sikur ky aspekt i punës së mësuesit në shkollë të që qe ndriçuar ca më shumë.

Figura më e angazhuar në veprën, ajo që pëson dhe mbart forcën fshikulluese të idesë qendrore të romanit është dom Engjelli. Në plazmimin e këtij tipi themi se romani ka shënuar njérën nga meritat kryesore, duke na dhënë një karakter që mbetet në galerinë e personazheve më të arritura të romanit tonë të sotëm. Mënyra si e ka konceptuar këtë personazh autorit; forca individualizuese ku spikat tentativa për të gjetur elemente të reja të pashfrytëzuara në shumë figura klerikësh të tjerë, te vepra dhe autorë të ndryshëm të prozës sonë, flet për punën e ndërgjegjshme e të kujdesshme të shkrimitarit. Dom Engjelli i Skënder Drinit është prifti dinak, i egër, agjent i të huajit, prifti pa skrupuj në ndërgjegje, që është gati të ndërmarrë e të kryejë çdo poshtërsi, por që di të fshehë me zgjuarësi dhe në mënyrë hipokrite të gjitha veprimet e veta, duke i veshur ato me petkun e pafajsisë, të shenjtërisë, me petkun e «*bariut të përvuajtur të grigjës njerezore*».

Ky prift është një figurë komplekse. Te ai bashkëjetojnë pasioni i shkencëtarit egoist, i shkencëtarit pa gjak me sadizmin e kriminelit të pashpirt. Ai ka pasion për një shkencë tèresisht të shkëputur ngajeta, për një shkencë mirfilltazi pa qëllim, pa ideal madje më tepër se kaq, për një shkencë në shërbim të së keqes, të armikut. Falsiteti i bindjeve të tij zbulohet në çdo veprim dhe arrin kulmin kur mësojmë se edhe për ato që predikon në kishë ai s'ka bindje, përkundrazi. Përvite me radhë duke ndjekur me këmbëngulje një plan të vetin shumë të studjuar dhe të mbështetur mbi hipokrizinë, ai ka mundur t'u imponohet malësorëve të varfër e injorantë. Pikërisht këtu, te varfëria dhe injoranca e malësorëve, janë dhe themelët e pushtetit të tij. Dom Engjelli i rrjep malësorët, ai u jep me kamatë çdo kile bereqeti, ai është majmur mbi kafshatën e fëmijëve të

uritur, por këtë shfrytëzim ai ka ditur ta bëjë pa rënë në sy, madje në emër të shenjtërisë së kishës. Kur vjen rasti, ai prapë di të manovrojë duke u hequr si shpëtimtari i fshatarëve nga uria. Ai shfrytëzon mjeshtërisht situatën e rëndë që kishte krijuar regjimi shfrytëzon koniunkturat e kohës për t'u shitur si zemërgjerë e i dhimbsur me misrin e mykur që u ka grabitur po këtyre fshatarëve. Dom Engjëlli është një zbatues i përpiktë i urdhreve dhe i dëshirave të Vatikanit dhe të fashizmit.

Antipod i dom Engjëllit, mbartës i vlerave morale pozitive në roman është mësuesi. Qëndrimi i tij antizogist, pasioni që ka ai për të ngritur shkollën në këtë krahinë të largët mes maleve të Veriut, urrejtja e pašuar që ushqen për feudalët dhe agjentët e regjimit, mos-pajtimi i tij me dogmën, fetare në mënyrë kategorike si dhe me predikimet e priftit, e bëjnë atë figurë me vlerë, tip shoqëror të kohës, përfaqësues të atij grupei intelektualësh të varfër popullorë, të cilët qëndrimi thellësisht demokratik i bëri të vihen në rrugën e protestës kundër regjimit zogolian e më pas, kjo predispozitë përparimtare i coi deri në rrugën e luftës për çlirim, në rrugën e revolucionit tonë popullor. Mësuesit i dhimb-set populli i tij, por kjo ndjenjë s'mbetet një trishtim pasiv shpirtëror tek ai. Ajo bëhet nxitje për veprim. Mësuesi e ka njojur dom Engjëllin nëpërmjet artikujve që ky klerik erudit botonte në shtypin kombëtar e ndërkombëtar të kohës. Por këtu, në Kalcë, mësuesi njeh fytyrën e vërtetë të dom Engjëllit si prift hipokrit e i pashpirt, që e shtrydh dhe e urren malësorin për interesat e veta dhe të kishës. I zhveshur nga mentaliteti patriarkal i malësorit, me atë nivel kulturor që zotëron, mësuesi i kuption mirë tërë lodrat dinake të priftit qoftë në raport me malësorët goftë në raport me shkollën, me atë vetë, mësuesin. Romani ka një varg skenash të mbushura me një dialog të mprehtë, plot zgjuarsi dhe replika të mprehta që këmben mësuesi me priftin, ndonjëherë edhe mes gjindjes së fshatarëve për ta demas-kuar priftin publikisht. Ky qëndrim e bashkon që në

krye mësuesin me derën e fshatarit të varfër por plot autoritet dhe tepër fisnikë të Camajve, e cila gjëzon emër të mirë pér trimëri, ndershmëri. Është meritë e shkrimtarit që figura i është mësuesit, ndër më pozitivet në roman, është dhënë e gjallë dhe jashtë skematizmit. Por në ndonjë rast kemi përshtypjen se në qëndrimin, fjalët dhe veprimet që kryen, ai sikur e kalon kohën e vet dhe mundësitet historike që i ka dhënë shkrimtari. Në roman bëhet e qartë prejardhja e mësuesit. Ai është dërguar në Kalcë si njeri i padëshirueshëm, gati si i internuar, pér shikak të qëndrimit të tij demokratik. Ai është tuberkuloz dhe kjo është një arsy e dytë që e nxit të vijë në malësi, të vijë mes njerëzve të thjeshtë e të shtypur, mes bashkatdhetarëve të vet që s'i kishte njojur deri atëherë. Më pas mësojmë që ky mësues ende s'është njojur më asgjë nga literatura marksiste, s'është njohur me bolshevizmin, dhe të kemi parasysh që jemi në vitin e fundit të sundimit zogollian, pra aty nga viti 1938, kur mendimi marksist kishte nisur të hynte në mes intelligencës përparimtare të kohës nga punare lavdërueshme e grupeve komuniste. Pra mendojmë se ka një mospërputhje ndërmjet të vërtetës jetësore dhe asaj artistike. Kemi përshtypjen se është e paktë prédispozita vetjake demokratike e një mësuesi të atyre viteve pér të shpjecuar atë qëndrim tepër përpárimtar pér kohën dhe atë mprehtësi pér të mundur me forcën e argumentave e të logjikës një prift katolik dhe pér më tepër shkencëtar, sikurse është dom Engjelli. Lidhja e mësuesit në një farë mënyre me idetë përpárimtare, revolucionare, marksiste do ta bënte më bindës e më real krejt qëndrimin e ndërgjegjshëm e demaskues të tij, do të shpjegonte superioritetin e tij në ndeshjen e vazdueshme me bótëkuptimin klerikal e me përfaqësuesin e tij të denjë, dom Engjellin. Kjo rrëthanë do ta motivonte të vërtetën e madhe që idhujt filluan të tronditeshin qysh atëherë në ndërgjegjien e malësorëve, dhe u shembën plotësisht vetëm në ditët tona, në epokën e Partisë.

Do të donim të shtonim diçka rrëth vlerave të veprës lidhur me realizimin e figurave të mësuesorëve, e veçat

nërisht të Kalosh Camit, Martinit, Suta Sokolit, Dash Cungelit apo të përfaqësuesve të botës feudale të kohës si kapter Selimi, kapidan Gjoni, Mur Merkeqi etj. Ata janë të gjithë tipa të individualizuar mirë, me karakteristika të veçanta, tipa të gjallë veprues, me veti të ndryshme e njëkohësisht përfaqësues të shtresës e klasës shoqërore të cilës i përkasin. Kalosh Cami është një nga personazhet më të realizuar të romanit, që mbart në vete tiparet e përgjithshme të malësorit tonë, por në të njëjtën 'kohë' ai ka edhe një individualitet të theksuar.

Në thurjen e romanit, autori ka ndjekur linjën e kompoziconit klasik, ku tonet epike të ngjarjes janë thyer nga pasazhe të tëra të mbushura me një lirizëm të hollë e të këndshëm. Janë të bukura dhe të qëlluara tërë ato skena në të cilat autori e ndërpert rrjedhën e ngjarjeve për të shpërthyer në meditime poetike. Këto shkëputje jo vetëm që e çlodhin lexuesin, por hedhin dritë edhe mbi elemente që do të shërbejnë në evidentimin e ngjarjeve. Gërshtimi i ngjarjeve, i linjave, shpalosja e tyre etj., janë bërë me natyrshmëri. Romani ka pasuri të rrallë figurative e gjuhësore.

Ndoshëta do t'ia kishte shtuar vlerat veprës shmangia aty-këtu e një farë frysme romantike që ndjehet sidomos në pëershkrimet e natyrës.

Përfundimisht mendojmë se kjo vepër e re e S. Drinat është një hap i rëndësishëm i autorit në gjininë e vështirë të romanit dhe një sukses i prozës sonë në përgjithësi.

1975.

ROMAN PËR RRITJEN E NDËRGJEGJES KLASORE

Romani «Zgjimi i Nebi Surrelit» i Dh. Xhuvanit është i pari ndër krijimet e gjata të këtij prozatori që trajton temën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Te kjo vepër e re përsëri dallojmë individualitetin krijues të autorit. Në roman ai na ka dhënë me forcë përgjithësuese një aspekt të realitetit heroik të asaj epoke, një copëz nga tabloja e madhe e atyre viteve të revolucionit tonë popullor.

Duke i qëndruar besnik mënyrës së tij krijuese, shkrimtari ka krijuar një vepër sa të thejshtë po aq dhe të bukur, një vepër ku rrëfimi rrjedh natyrshëm, realist, pa u ngarkuar me linja të shumta. Ideja qendrore i ka shërbyer autorit edhe si element kryesor organizues, pavarësisht se në shtratin e kësaj ideje kryesore bashkohen edhe një sërë idesh të tjera, të dyta e të treta, që e pasurojnë dhe e nxjerrin më mirë në pah idenë qendrore.

Procesi i zhvillimit social-ekonomik të vendit tonë qe mbërthyer në darën e fortë të krizës së përbotshme, e cila solli si pasojë shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria feudal e kohës së Zogut me amullinë e plotë ekonomike, pas pushtimit, më tepër nga qëllimet propagandistike fashiste, u duk sikur mori njëfarë gjallërimi ekonomik, për të cilin propaganda fashiste bëri zhurmë të madhe. Në të vërtetë ekonomia e vendit nisi të shkatërrrohej më tepër për shkak

të luftës ekspansioniste fashiste. Mjerimi dhe varfëria, uria dhe papunësia u shtuan në vratat e familjeve të vegjëlisë së fshatit dhe të qytetit. Pikërisht këtë të vërtetë të kohës përftojmë në romanin «Zgjimi i Nebi Surelit», të cilën shkrimtari na e jep i nisur nga një këndvështrimi i drejtë ideoemocional pér kohën dhe pér njerëzit, duke rilevuar njëkohësisht edhe faktin historik të asaj kohe, polarizimin e pashembullt ekonomik, nëpërmjet pasurimit të vrullshëm, të një grupei feudalësh e borgjezësh kolaboracionistë që në roman përfaqësohen me tipa si Ali Maliqi, Gani Herraj etj., ndërsa nga ana tjetër, shumica dérrmuese e popullit shqiptar po zhytej çdo ditë e më tepër në mjerim të plotë. Tablo të gjalla, ku përshkruhen këto faktë, autori i ka dhënë bukur që në kapitujt e parë të romanit. Errësira, heshtja, zymtësia, dhe mbi të gjitha uria e Nebiut dhe e s'ëmës, të krijojnë përfytyrime emocionale. Mjerimi e varfëria kanë hyrë kaq thellë në jetën e kësaj familjeje saqë Nebiu dhe nëna rrallë e tek shkëmbejnë ndonjë frazë me njëri-tjetrin. Madje ata komunikojnë më tepër me mendimet se sa me fjalët që u mbeten në grykë e s'arrijnë t'u dalin. Një varg tablosh të tjera vijnë më tej dhe janë po kaq të errëta, po kaq të zymta. Pushtimi dhe varfëria, shtetrrethimi dhe turma e të papunëve, njerëzit që s'kanë me se të mbajnë frymën gjallë, hamejtë që sillen rrötull me duar «të varura» dhe kafeneja e Jorgos, ku orë e çast të papunët janë të gatshëm të përfyten e të bëjnë zënka me pronarin e kafenesë, me xhandarin, spiunin, apo këdo që do të guxojë t'i cysë sadopak, pohojnë atë epokë nëpërmjet shumë detajesh reale.

Shtjellimi i subjektit, mbushur me rrjedhën e ngjarjeve të shumta në ato vite, i ka dhënë material të pasur autorit që në kapitujt e mëpasëm të pasqyrojë me vërtetësi sesi në gjirin e popullit, në kushtet e rënda të sundimit të dyfishtë, me lindjen e Partisë Komuniste Shqiptare u mbrujt pak nga pak revolta e ndërgjegjshme e masave popullore, e cila e çoi atë në udhën e gjerë të revolucionit populor. Demostrata në sheshin e bashkisë, aktiviteti ilegal i komunistëve, që në çdo vep-

rim ndihmohen nga njeréz të thjeshë të popullit, dashuria dhe dëshira e flaktë e masave pér të lexuar dhe pérhapur traktet e Partisë e deri aksioni final i romanit, në mbrojtje të shtypit ilegal të revolucionit, dëshmojnë pér këtë brendi jetësore, të realizuar artistikisht, që ka mundur të derdhë shkrimtari në vepër.

Gjithë ky material jetësor realizohet në vepër në-përmjet linjës së heroit kryesor Nebi Surelit. Ideja që zotëron në roman, ajo rrneth së cilës dhe në shërbim të së cilës autori ka krijuar tablo e aspekte të realitetit jetësor të kohës, ëshë ideja e madhe, e trajtuar edhe nga ndonjë autor tjeter i romanit tonë, që shpreh forcën e drejtësinë e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, e cilat bëri pér vete dhe ndërgjegjësoi edhe njerëz të tillë si Nebi Sureli, që koha me egërsinë dhe varfërinë e saj i kishë flakur në mes të katër rrugëve. Ajo u ngjalli shpresa pér jetën njerëzve si Nebiu, i dha kuptim asaj, i armatosi ata me idealin e madh të luftës pér liri, pér ditë më të bukura.

Nebiu si karakter vjen duke u rritur. Në roman informohet dhe brumoset si revolucionar në sytë e lexuesit. Duke qenë një i papunë, Nebiu zien nga urrejtja pér të pasurit. Vuajtja dhe uria, s'kanë mundur ta vrasin shpirtërisht, s'kanë mundur ta degjenerojnë karakterin e tij. Por si mijëra të tjerë, ai s'diku të kapet, s'di kundër kujt të luftojë. Ai urren edhe Ali Maliqin, tregtarin cinik të vjetërsirave, edhe kapitalistin e ri Gani Herraj, por sesi mund t'i përbysë ata dhe sistemin e tyre, sesi mund të hakmerret, këtë Nebiu s'e di. Ai është krenar dhe nuk lejon pér asnje gast që personaliteti i tij të mirret nëpër këmbë. Ai merr pjesë në demonstratë dhe tërheq një të plagosur rëndë. Kur e fyejnë dy fashistë, e qëllon me grusht njërin prej tyre. Më se një herë ai bëhet gati ta vrasë Ganiun nga urrejtja pér shfrytëzimin e egër që provonte duke shërbyer tek ai. Në të tilla momente Nebiu ndeshet me Gaqon, punëtorin komunist ilegal dhe vihet në kontakt me luftëtarët e çështjes së lirisë së atdheut dhe të qirimit të vegjelisë. Ka disa skena që hedhin dritë në rrugën dhe luftën e

Nebiut për transformimin e ndërgjegjes së tij. Ai mëson nga Gaqoja se cilët duhet të urrejë por edhe si duhet të përdorë këtë urrejtje në emër të një hakmarrjeje më të madhe, në emër të hakmarrjes popullore. Pika kulmore e formimit të Nebiut nis aty, kur pasi ka gjetur punë rastësish te Ganiu, (rastësi plotësisht e pranueshme dhe e motivuar), vihet në aktivitet nga grupi illegal i Gaqos dhe kryen një nga punët më të rrezikshme: pën transferimin dhe ruajtjen e teknikës së shtypit. Odiseja e rëndë dhe heroike që përshkon Nebiu brenda një dite për të realizuar detyrën e lartë që i kanë besuar, e fut atë përfundimisht në rrugën e ndritur të luftës për popullin, për çlirimin e vegjëlisë, për çlirimin e atdheut. Është me interes të vihet re se krejt kjo linjë e madhe, kjo kthesë dhe rrugë e heroit, sikurse edhe në romanet e mëparshme të Dh. Xhuvanit, është realizuan hap pas hapi nëpërmjet zbërthimit të qëlluar psikologjik të tij. Kur lexojmë veprën ne jetojmë ndjenjanë nga më të ndryshmet. Ndiejmë hidhërimin, tronditjen, dhembjen, dhe urinë e tij, provojmë revoltën, llavën e zemërimit, ndiejmë rrahjet e zemrës së tij, kur zhgënjet apo entuziazmohet, tronditet nga pengesat, kur përmban zemërimin, dhe dufin e vet, apo kur heroi ndien atë lumturi të qetë, ngadhnjyese në fund të aksionit heroik që kryen. Në këtë aspekt, pa dyshim romani shënon një meritë dhe vlerë reale në tërësinë e krijimeve të Dh. Xhuvanit.

Por edhe pse e pranueshme për veprën, kjo linjë e parë dhe kryesore, në raport me aspektet e tjera jetësore të kohës dhe me masën që zënë ato në roman, menjmë se duhet të qe dhënë disi më ndryshe. Dihet se lufta e popullit tonë, puna e Partisë Komuniste Shqiptare, si udhëheqëse dhe organizatore e luftës, umbështetë popull; te punëtorët, te njerëzit si Gaqoja, Hasani, Semi, Xani etj. Këta si tipa, si karaktere shoqërore, qenë ata që mbushën radhët e luftëtarëve të lirisë, prandaj, kur shkrimitari flet për atë epokë, duhet, për të qenë më pranë së vërtetës së jetës, t'u kishte dhënë një raport më të drejtë linjave të tyre dhe vëganërisht, kur merr

përsipër të tregojë sesi me luftëtarët e vërtetë dhe me proletariatin u bashkuan edhe shtresat e tjera të shoqërisë. Këtu s'duam të mohojmë të drejtën e shkrimtarit për një linjë të vetme qendrore, por kërkojmë që ajo të jetë në përpjesëtim më të drejtë me linjat e tjera për hir të realitetit kohor dhe të interpretimit më të saktë ideologjik të realitetit. Kështu si është dhënë, plani i aktivitetit të punëtorëve ilegalë, i veprimtarisë së tyre organizative dhe drejtuese ka mbetur më tepër në sfond dhe disi në periferi të vëmendjes së shkrimtarit.

Te romani «Zgjimi i Nebi Surelit» janë ringjallur bukur dhe na mbeten në përfytyrim të pashlyeshme ato aspekte heroike të punës ilegale të Partisë që kryheshin për të ndezur dhe mbajtur gjallë flakën e urejtjes ndaj armikut dhe të dashurisë pér liri në zemrat e masave të popullit. Jo vetëm në linjën e heroit, por tërësisht, në krejt episodet dhe detajet e përdorura nga shkrimtari, spikat dashuria e popullit pér bijtë e vet komunistë, ndjenja e gatishmërisë pér heroizma. Kujtojmë episodin e hamejve që ngarkojnë kamionçinën me armë pér lëvizjen dhe s'pranojnë të paguhen, apo familjet që ndihmojnë Gaqon t'u shpëtojë fashistëve natën para aksionit dhe, mbi të gjitha, demonstratën, ku njerëz të popullit ndihmojnë demonstruesit qoftë në përlleshje qoftë pér të tërhequr të plagosurit nga fusha e përlleshjes. Kurse në faqet ku përshkruhet aksioni i shpërnguljes së pedalinës, ku spikat dhe rritet figura e Nebiut, uniteti i popullit me Partinë gjen shprehje në shumë momente, në shumë episode. Kudo, ndër njerëz të ndryshëm mbisundon përbuzja pér të huajin, simpatia dhe gatishmëria pér luftën, pér revoltën. Vështrimi realist i autorit në këtë aspekt ka zbuluar në mënyrë të diferencuar edhe qëndrimin e lëkundur e të shtrembër të një pakice individësh, që hezitonin të hynin në vorbullën e luftës antifashiste, mbi të cilët ndikoi heroika e kohës. Kujtojmë këtu episodin më zotin Gazmend, si ndër më tipikët, dhe në sens të kundërt me të, qëndrimin e Jovanit, gatishmërinë e tij pér t'i shërbyer lëvizjes, luftës së Partisë dhe në rrëthana tepër të vështira familjare. Pikërisht pér këto vlera

të mëdha njohëse dhe ideore, mendojmë se do të qe në dobi të romanit që të zgjerohej ky plan ku, jo vetëm lufta e njerëzve të shtypur ilegalë të Partisë, por edhe vetë figura e heroit të romanit, Nebiut, do të mund të fitonte më shumë vërtetësi dhe frymëmarrje.

Në linjën e Nebiut, një degëzim i veçantë, që herë-herë duket dhe shqetëson rrjedhën e jetës së tij, janë marrëdhëni e tij me Magdën. Ky fill, ashtu si është trajtuar dhe vendosur në roman, shërben për të theksuar mendimin se jeta qe kaq e padrejtë dhe e egër për njerëzit e varfér si Nebiu, saqë ajo thau çdo gjëzim të tyre. Kjo ndjenjë e parë dashurie, që ka mbetur më tepër si një ëndërr e pastër e viteve të rinisë së parë të heroit, u gris, u shkel e u vra nga dora e ftohtë e skamjes, e varfërisë. Pra për Nebiun ajo plotëson kuadrin e së vërtetës së kohës që i mohon çdo gjëzim, sado të vogël e të domosdoshëm, njeriut të mjerë e të papunë. Si e tillë ndodhia me Magdën është e pranueshme, por mënyra e trajtimit të saj, ndonjë detaj në të (kur Magda i puth dorën Nebiut në kinema) i kanë dhënë një tingëllim disi të zbehtë dhe sentimental që stonon me frymën tërësore realiste të romanit.

I thjeshtë në ndërtimin kompozicional, i pasur në zbërthimet psikologjike, i larmishëm në episode e me vlera njohëse të ndijshme, — «Zgjimi i Nëbi Surelit» është një vepër e realizuar dhe dinjitoze e Dhimitër Xhuvanit, që renditet ndër sukseset e romanit tonë të viteve të fundit.

1975.

ROMAN ME VLERË PËR DITËT E ZJARRTA TË HISTORISË SONE

'Pas romanit «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» I. Kadareja iu rikthye temës së Luftës sone Antifashiste Nacionalçlirimitare me romanin e tij të ri «Nëntori i një kryeqyteti». Por edhe pse këto vepra janë dy krijime të të njëjtët autor me të njëjtën temë, ato dallojnë shumë nga njëra-tjetra për një varg vlerash dhe arritjesh që dëshmojnë forcën krijuese të autorit, mënyrën origjinale të trajtimit të temës, këndvështrimin e shëndoshë ideor nga niset ai në interpretimin artistik të realitetit dhe mbi të gjitha, për atë fakt objektiv e madhështor, që flet për përmasat gjigante të heroizmit partizan, i cili është e do të mbetet burim i pashtershëm fryshtimi për shkrimtarët tanë.

Ndërsa te «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» autori na ka dhënë një sintezë të epopesë së paharuar të partizanëve, ku lakonikisht u përvijua vitaliteti dhe madhështia morale e popullit, natyra epike e karakterit shqiptar e pasuruar me tërë cilësitë e tjera shpirtërore të tij, e gjitha kjo e vendosur krejtësisht në antitezë me negacionin ideomoral të okupatorëve fashistë, te ky roman i ri si situatat jetësore që kanë fryshtuar shkrimtarin ashtu dhe qëllimi krijues i tij, na kanë dhënë një vepër me një ngarkesë problemore dhe artistike krejtësisht të ndryshme.

Te «Nëntori i një kryeqyteti» tema e madhe e ka

nxitur autorin të shpalosë origjinalisht një moment të shkurtër të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të ndriçojë njërin nga qindra dhe mijëra aksionet e guximshme partizane që e shpunë popullin në çlirim, por një ngarmomentet vendimtare, siç qe lufta për çlirimin e Tiranës. Ky qëllim që ka ndjekur shkrimtari, sigurisht i ka diktuar atij edhe gjithçka tjetër që lidhet si me materialin lëndor të grumbulluar në roman ashtu dhe me derdhjen e tij, në formën artistike të veprës. Por edhe pse vlerësojmë si merita të të dy romaneve dallimet e ndryshme midis tyre, theksojmë se mbetet po kaq meritë dhe vlerë e shkrimtarit që edhe te ky roman i ri, sado me shtrirje më të vogël vendi dhe kohe, buçet po ajo forcë epike, zberthehen po ato vlera etiko-morale që nxjerrin në pah e lartësojnë, siç e meriton, popullin tonë trim e liridashës.

Në brendinë e vet romani është mbërthyer në përshkrimin e sulmit pakditor të një njësiti të vogël partisan për çlirim e radiostacionit të kryeqytetit, në një kohë kur Shtabi i Përgjithshëm dhe shoku Enver kishin dhënë urdhrin për çlirim e kryeqytetit. I inkuadruar në këtë ngjarje të madhe historike, mund të duket sikur aksioni me të cilin merret romani është një copëz tepër e vogël e asaj që po ndodhë ato ditë, por kur lexojmë veprën bindemi që s'është kështu. Gjerësia e vështrimit të autorit, fuqia përgjithësuese, mënyra si janë vendosur në roman forcat kundërshtare, dendësia e situatave jetësore që përshkruhen, shumëlojshmëria e karaktereve tepër të individualizuar, thellësia e zhbirimit filozofik të ngjarjeve si dhe së fundi, pasuria e madhe dhe e përhershme e Kadarsë në planin artistik të krijimit, kanë bërë që edhe ky roman të ketë forcë përgjithësuese, jetësore dhe artistike e të vihet në nië radhë me veprat tona më të mira që kanë trajtuar këtë temë.

Romani dallohet për përbajtjen e vet të mbushur me mendime të mëdha e të fuqishme, për mendime që përçojnë drejt e me partishmëri të thellë tek lexuesi të vërtetën e luftës heroike që kreuz populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Në kapitujt e veprës suksesivisht

vijnë e shtjellohen njëra pas tjetrës situata të ndërtuara me epizëm dhe forcë dramatike përmes një mënyre krejt të natyrshme, zbërthehet qëndrimi ideoemocional i shkrimtarit dhe komunikohet heroizmi i bijve dhe bijave të popullit. Për shkrimtarin, siç na e sugjeron vepra, ajo luftë qe gjigante për forcën e pashtershme shpirtërore të popullit, për karakterin heroik të saj. Dhe heroizmi, madhështia shpirtërore nuk mund të manifestohen asgjékundi tjetër më mirë se në luftë kundër një armiku të egër i cili nuk qe e lehtë të thyhej. Një armik i tillë qe Gjermania naziste, qenë hitlerianët që qenë egërsuar ca më tepër në ato ditë të agonisë së tyre. Duke mbajtur parasysh këtë të vërtetë, Kadareja ka ndërtuar në vepër disa situata dhe episode që nënvisojnë superioritetin moral të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare ndaj shtazërisë së nazistëve. Çdo metër tokë, çdo shtëpi, çdo rrugicë apo kryqëzim rrugësh fitohej me gjak, me sakrifica. Pikërisht këto sakrifica i gjejmë të trupëzuara artistikisht në vepër në vdekjen heroike të sa e sa luftëtarëve tanë. Ato qenë aq pranë kosës së vdekjes dhe s'i trembeshin asaj se e donin jetën e lirë. Rënia heroike e tyre në roman është dhënë fare pa bujë, pa pompozitet, pa poza. Kështu vdes në barrikadë komisari i njësimit të vogël partizan të ngarkuar me detyrën për çlirimin e radiostacionit, po kështu i këputet krahu Mete Aliut apo bie heroikisht te dera e radiostacionit komandanti i njësimit Dino Sinojmeri. Janë me dhjetëra personazhet episodike që u flijuan në ato ditë, në atë luftë fisnike që po kurorëzonte ëndrrën e një populli të tërë, e brezave të shumtë për çlirimin politik e shoqëror prej çdo lloj shtypjeje e padrejtësie. Për të na dhënë emocionalisht këtë të vërtetë autori ka vizatuar skena me dramacitet të rrallë dhe shumë komunikuese vetëm se në ndonjë rast kjo ka qenë jo aq e domosdoshme dhe do të qe më mirë që ai t'i qe shmangur detajimit të ndonjë episodi jo aq funksional për idenë.

Superioritetin dhe besimin e patundur në fitoren e afërt që i karakterizonte partizanët, e ushqente lidhja e tyre e ngushtë me popullin. Ai njësit i vogël prej pak

partizanësh, që kishte marrë detyrën për të çliruar radiostacionin, nuk qe i vëtmuar. Ai në çdo çast qe mes përkrahjes dhe ngrohtësisë së popullit. Kur u ngrit barrikada, kur po sulmohej ndërtesa e radiostacionit, kur duheshin mbledhur ish-nëpunësit e radios e në çdo veprim tjetër, partizanët e njësitet kurdoherë gjunjë përkrahjen aktive të qytetarëve të thjeshtë, të guerilierëve, që pa hezitim u flijuan në emër të të njëjtit ideal me partizanët. Në mënyrë të qëlluar dhe origjinale, pa rënë në prozaizëm dhe informacion të thatë, romani na kriJon përfytyrim të saktë për tërësinë e veprimeve ushtarake që u zhvilluan ato ditë në godinat, rrugët dhe shehet e Tiranës. Përmes pasazhesh të kursyera, autori na bën të njojur situatën e luftimeve dhe të vendosjes së grupimeve ushtarake, si dhe dorën e sigurt të komandës partizane që udhëhiqte e drejtonte luftën për çlirimin e kryeqytetit. Këtu krahas me strategjinë dhe taktilën që u ndoq, ne ndiejmë deri në konkretësi praninë e Partisë dhe të udhëheqësit tonë shokut Enver. Qëndrimi i komisarit të njësitet dhe bisedat e tij për memecëllëkun shekullor të Shqipërisë, ardhja e sekretarit të qarkorit në vijën e parë të luftimeve etj., si edhe skenat ku flitet për këshillat dhe ndërhyrjet e udhëheqësit edhe për problemet e veçanta e të përditshme, apo episodet ku njohim së afërmi komandantin e brigadave partizane, që drejtonte luftimet për çlirimin e Tiranës, shokun Mehmet Shehu, të skicuar mjeshtërisht në dy-tri momente në vepër, flasin për atë karakteristikë kryesore të Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare që në çdo veprim dhe ndërmarrje luftarake, e shkëputur apo me proporcione të mëdha të qe, në mënyrë të domosdoshme ishte dora dhe mendja e Partisë, e udhëheqjes së saj mark-siste-leniniste.

Vepra në tërë elementet përbërëse të saj në ngjarjet, në linjat, në karakteret që realizon, pohon superioritetin moral partizan, të lindur e të kalitur në zjarrin e luftës. Ky superioritet manifestohet në shumë aspekte të romanit dhe kryesisht në përbuzjen e vetvetishme që ndiejnë heronjtë e veprës ndaj llumit dhe përdhosjes morale të

klasave të larta. Partizanët e njësitet i karakterizon humanizmi i ri klasor dhe revolucionar, thjeshtësia dhe sinqueriteti mes shokëve, përbuzja ndaj rrezikut të vdekjes, pështirosja pér degjenerimin borgjez që ata e ndiejnë së afërmi gjatë ditëve që qëndruan në kryeqytet dhe pas çlirimit të tij. Këta trima që të habisin me aktet e tyre, janë aq të ngathët e të turpshëm kur ndeshen me shfaqje imoraliteti nga më të zakonshmet e borgjezisë. Sherifi e provon disa herë këtë tronditje emocionale sipas mënyrës së tij, edhe Dino Sinojmeri ka reagimin e vet të drejtë kundër asaj që lexon në shënimet pér ragonin që do të çlirojë. Teuta aq e pastër në ndjenja dhe e çiltër në shpirt nervozohet me provokimet sado të tërthorta që vë re te ai ish-tekniku vagabond i radiostacionit. Kjo fizionomi e re morale, e pastër që s'pronon asgjë nga morali i kalbur borgjez, që e urren armikun, dhe propagandën e tij të ndyrë, e çon Mete Aliut deri në atë veprim, sipas tij shumë të drejtë, që të shkallmojë aparatin e vogël radiomarrës, veprim që pér mendimin tonë, duke u vështruar brenda natyrës së Mete Aliut dhe urrejtjes së tij shumë të drejtë, është i motivuar dhe i pranueshëm, pér më tepër që pas këtij veprimi të çastit, Mete Aliu njeh reagimin e kundërt të komisarit dhe të shokëve të tij.

Nëse në ndonjë moment episodik në roman, krahas pasqyrimit të vërtetë dhe emocional të ngjarjeve dhe të heroizmit të bijve dhe të bijave të popullit ka zënë vend edhe ndonjë tip arrivist dhe karrierist si Stefan Papa, kjo jo vetëm s'e zbeh, por i jep edhe më shumë vërtetësi pastërtisë së moralit partizan. Lufta jonë me ashpërsinë e saj flaku tej shumë aventurierë, njerëz të dobët, bashkudhëtarë të përkohshëm të revolucionit që mbeten të zhgënjer kur u njohën me synimet dhe programin e saj. Partia i luftoi ata që në lindjen e saj. Por në qoftë se në roman ne gjemjë që edhe në ditët e para të çlirimit të kryeqytetit pati njerëz që nisen të endërronin pér poste, kjo i ka dhënë veprës jo vetëm forcë realiste, por edhe tingull aktual, se qenë pikërisht këta tipa të huaj, të paformuar që penetruan në radhët e

luftës dhe u fshehën aty nën maskën e interesave të përbashkëta pér të pritur rastin që në momente të përshtatshme të përfitonin thjesht pér veten e tyre. Madje lufta pér pastërtinë e radhëve, lufta kundër shfaqjeve të huaja që aq vrullshëm po zhvillohet sot te ne, në kuadrin e luftës së klasave, pati fillnisjen e vet në elemente të shkëputur, që në ditët e para të Çlirimit, te tipa si Stefan Papa me shokë.

Tingull aktual vepra ka fituar dhe në momente të tjera itë saj, p.sh. aty ku shtjellohen ngjarjet që pasqyrojnë kampin e kundërt, armiqtë e posashpronësuar. Plot funksion në vepër është grupi i plakave të veshura me itë zeza, që si një grumbull i vogël korbash sillet nëpër rrugët e qytetit pér të parë ato vetë se në ç'shkalë kanë rënë, se kush ka mbetur pér rigrupimet e ardhshme. Kështu mendon plaka Mukades. Te ky personazh është konkretizuar jo vetëm fizikisht por edhe shpirtërisht, pra me tërë filozofinë e saj bota e përmbysur. Mendoj se nuk përbën ndonjë irealitet fakti që mentalitetin dhe botëkuptimin e asaj shoqërie e përfaqëson një plakë, madje ca më me efekt nga ana artistike dhe më përbuzëse është që një plakë dhe jo ndokush tjetër ka marrë në dorë flamurin e antiradiostacionit. (Ngjetur shumë bukur ky emërtim pér të dhënë simboli-
kisht idenë e rezistencës së ardhshme të armikut të përmbysur, por përherë të egër e të vendosur në qëllimet e tij.) Jo rastësisht ky grumbull i vogël plakash disa herë ndeshet me patrullën partizane që ka dalë pér itë mbledhur ish-nëpunësit e radiostacionit derisa më në fund i shmanget kësaj ndeshjeje nga frika. Në gojën e plakës Mukades autori më se një herë ka vënë fraza që parathonë riardhjen e klasave të përmbysurë, jo si një profeci, por si përvojë reale e të gjithë revolucioneve parasocialiste në të cilat parullat dhe frymë revolucionare hidheshin poshtë, revolucionari tradhitoj porsa udhëheqësit e klasave drejtuese zinin postet e komandimit. Mbi këtë mundësi e mbështet shpresën e vet bota e Mukadesëve. Fakti që te ne, në saje të udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë iu

pre dhe gjithmonë do t'i pritet hovi një degjenerimi të mundshëm të fitoreve të revolucionit, e nënvizon ca më tepër fryshtë aktuale të veprës dhe ia rrit forcën përgjithësuese asaj duke gjetur pikëlidhjet embriionale midis borgjezisë dhe pjellës së saj, revizionizmit modern.

Vend të konsiderueshëm zë në roman edhe problemi i fatit të intelektualëve vanitozë, i artistëve të kullës së fildishtë që jetonin larg realitetit, larg ngjarjeve të mëdha të kohës pa u interesuar përfatim e popullit të tyre, por duke u mbyllur në atë botën e vet plot ego-centrizëm. Ata nuk arritën deri në kampin armik, por nuk u afroan as me popullin se s'patën fuqi të dilnin nga «dilema e madhe». Ata vegjetuan pa qëllim në jetë ndaj dhe u vyshkën e u flakën nga jeta. Vetëvrasja e Adrian Gumiës kur ai ndeshet me luftën e popullit qoftë edhe përfnjë moment është fundi logjik i kësaj rruge pa krye. Romani pohon me forcë artistike se në situata të mprehta historike nuk ka rrugë të mesme. O do të jesh me popullin, o do të jesh me armikun. Të gjithë ata që kanë iluzione përfundimës së artë», vjen një çast në jetë që i zhgënjen në shpresat e tyre.

Jo pak vend zënë në roman skena ngjarjesh retrospektive që flasin përfshirë zhganin e kolaboracionistëve. Përmes tyre shkrimitari me vërtetësi njohtëse dhe forcë artistike ka evidentuar llumin e tradhtisë së klasave të larta, të cilat pa pasur asnjë ideal të vetin, u vunë në shërbim të çdo klike dhe pushtuesi kurdoherë në dëm të popullit. Ky llum tradhtie që është vizatuar «en bloc» por edhe i personifikuar te fytyra të urryéra të së kaluarës sonë si patër Anton Harapi etj., rilevohet ca më tepër kur ndodhet para veprimeve të madhërishme të njerëzve të thjeshtë, bijve të popullit si Vasil Laçi që me guxim të pashoq atentoi kundër perandorit. Këtë galeri mumjesh politike vjen dhe e plotëson më mirë demaskimi që i bën romani inteligjencës shërbëtore, sahanlëpirëse dhe antishqiptare të përfaqësuar me Gjergj Fishtën, Ernest Koliqin etj. Me shumë funksion ideorështë derdhur në vepër edhe paraqitja e fëlliqësisë mo-

rale ku qe zhytur ajo shoqëri fund e majë, shenjë kjo e kalbësirës së plotë të atij sistemi e rendi. Aventurat dashurore të pafundta të Mirjam Morinës, Hamide Hanëmes, Kristin Dakles dhe të një vargu prostitutash të tjera nga aristokracia e kohës, kotësia e jetës së mbytur në luks e pasuri e një radhë tregtarësh, mini-strash, fajdexhinjsh, bankierësh, galeria e kalemxhinjve pa skrupuj si Nebi Kaçaj me shokë dhe sidomos fundi i botës së tyre, kur nguten të arratisen me makinat e veta nga e vetmja rrugë që ishte ende e lirë, «Rruga mbretnore», që Adrian Guma e krahason me zorrën e trashë të qytetit, të gjitha këto të dhëna me një mori skenash shumë të realizuara, e kurorëzojnë dhe e japidnë të qartë idenë e shkrimtarit që në mënyrë tendenecioze përbuz atë botë që perëndoi përgjithmonë nga faqet e historisë së Shqipërisë.

Sikurse brendia ideore e veprës ashtu edhe karakteret e selitur në të dëshmojnë për një ndarje intran-sigjente mes kampesh kundërshtarësh krejtësisht antagonistë. Në këto karaktere, dhe ky është sukses i romanit, kanë marrë më shumë ndriçim ato që përfaqësojnë popullin dhe luftën e tij. Grupi i vogël i partizanëve është i përbërë prej individualitetesh mjafft mirë të dallueshmë nga njëri-tjetri. Secili prej tyre të mbetet i gjallë në kujtesë ngaqë shkrimtari ka gjetur për secilin detaje individualizuese. Le të sjellim ndër mend sa e gjallë dhe poliedrike është figura e Sherifit po të mbajmë parasysh raportin e marrëdhënieve të tij me të tjerët: me Javerin, me Teutën, me ish-nëpunësit e radio-stacionit etj. Ai është i singertë dhe i druajtur, me zemër të madhe, trim por edhe i turpshëm. Sherifi i vë zjarr ish-shtëpisë së tij vetëm e vetëm se për të është e shtrenjtë mbi çdo gjë pastërtia revolucionare dhe besnikëria ndaj idealeve të Partisë, kurse në ndjenjat që ushqen për Teutën, ai është shumë i përmbajtur, gati i turpshëm dhe i tutur ashtu sikurse deri në një fare mase është edhe ndaj Javerit që aq shumë e do. Sherifi ka botë të madhe shpirtërore dhe natyrë mendimtari, që çdo gjë në jetë e sheh seriozisht dhe mundohet t'i hyjë

thellë; atij i lënë vragë fjalët e komisarit që e krahasoim me memecin me memecllékun shekullor të Shqipërisë. Gjetje e bukur kjo për romanin, gjithmonë brenda kuadrit të thelbësore që trajtohet në të, luftës për çlirimin e radio-stacionit. Po kështu në vepër gjejmë të realizuara ndonëse tepër lakonikisht edhe personazhe të tjera. Lexuesit i mbetet në përfytyrim Mete Aliu me natyrën e tij tepër të rrëmbyer, Javeri me maturinë, gjakftohësinë dhe humorin e vazhdueshëm, Dino Sinojmeri, komandanti i njësitit, për ciltërsinë shpirtërore dhe ndjenjën e thellë të detyrës në emër të së cilës është gati edhe për vetmohim etj. Me konçizitet e stil lapidar janë vizatuar në vepër, ndonëse në pak pasazhe të saj, figurat e udhëheqësve të revolucionit tonë popullor, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Nëse folëm më sipër për tendenciozitetin në qëndrimin e shkrimitarit, ai dallohet mprehtë edhe në vizatimin e personazheve të romanit. Atë e gjejmë te figura të tillë si Adrian Guma, Mirjam Morina, deri edhe te episodikë si Nabil Kaçaj, te armiqtë e përhershëm të popullit e të revolucionit si plaka Mukades me tërë llumin njerëzor që i rri përkrah dhe e rrethon. Autorika ditur të përgjithësojë e të tipizojë me krejt bagazhin e cilësive të tyre të qena e dalluese përfaqësuesit e botës që po shembej. Kotësia e realiteti i jetës së Adrianit, që e kupton shumë vonë, prostitucioni jo vetëm fizik po edhe shpirtëror e moral i Mirjamit, egoizmi, ndjenjat çnjerëzore, laktmia për pasuri e mirëqenie të përhershme e përfaqësuesve të klasave të pasura, vaniteti i jetës së tyre, tmerri për fundin e gjithçkaje që imbante në këmbë, urrejtja e tërbuar kundër revolucionit e vegjëlisë që po i përmbyste, janë ato tipare që shkrimitari ka derdhur artistikisht, përmes shtjellimit të subjektit të veprës, te secila nga figurat e këtyre kategorive shoqërore në vepër.

Sikurse në krijimet e tjera në prozë edhe te kyroman I. Kadareja dallohet për mendim të ngjeshur dhe figuracion të pasur. Me figurën e fjalës dhe sidomos të mendimit, ai operon me shumë sukses për të na-

përçuar emocionalisht ide të fuqishme, probleme themelore të epokave me peshë në historinë tonë. Edhe te ky roman autori dëshmon pér njohje të thellë dhe zotërim të simbolit si një mjet figurativ përgjithësues dhe shumë domethënës, edhe pse në ndonjë rast është shtyrë pak si tepër në përdorimin e tij. Të rrëmbejnë në roman paralelizmat shumë të bukura e me nëntekst të fuqishëm si ai mes Tosun agait, ulokut të fshatit, dhe tankut gjerman të ngujuar në mes të sheshit të qytetit, apo partizanit memec dhe memecillëkut shumë-shekullor të Shqipërisë etj. Kadareja është mjeshtër i përshkrimeve fizike të mbushura me mendim apo të ndërtuara në funksion të zbërthimit të botës së brendshme të personazhit.

Duke gjykuar nga krejt vlerat thelbësore që zotëronë: në roman, e kryesisht nga arritjet në planin ideoriku tingëllon e fuqishme heroika e ditëve të luftës partizane, si dhe nga vlerat e dukshme të formës letrare që ka derdhur shkrimtari në materializimin artistik të brendisë ideore; të cilat i shkojnë aq pér shtat dhe janë krejtësisht origjinale, themi se ky krijim i ri i I. Kadaresë renditet ndër veprat e suksesshme të prozës sonë të këtyre viteve të fundit.

1976,

LUFTA PËR BUKËN NË FAQET E ROMANIT «PËRBALLIMI»

Periudhat historike në të cilat intensiteti i ngjarjeve është i jashtëzakonshëm, periudhat historike që nxisin dhe lypin nga shoqëria impenjim të madh, heroizma, vendosmëri dhe guxim, dhe që për këto tipare shërbejnë si bazamenti të zhvillimit të mëpasëm shoqëror, përbëjnë epokat. E tillë në historinë shumëshekullore të popullit tonë, është epoka e Partisë.

Është pikërisht kjo arsyjeja që letërsia dhe arti i vërtetë, ajo letërsi dhe ai art që mbështet buzët për t'u frymëzuar në burimet e epokave të tilla, shuan etjen e ngnjet me nektarin e veprave titanike të popujve me vullnet të çlirët, mbetet një letërsi e pamort, përherë e freskët, e gjallëruar, e shumëllojshme, frymëzuese dhe nxitëse për vepra të mëdha e të madhërishme.

Të tridhjetekatër vjetët e epokës sonë që nga dita e parë e themelimit të Partisë e deri në ditët tona, përbëjnë një vazhdë të pandërprerë fitoresh dhe heroizmash që populli ynë me në ballë Partinë ka kryer në rrugën e vet drejt socializmit e komunizmit.

Fitore që u arrit mes heroizmit e përballimit të vësh-tirësive që edhe ajo e viteve të para të pasçlirimit, kur Shqipëria e rilindur kërcënohej nga tradhtia e revisionizmit, nga uria dhe bllokada ekonomike, nga klasat e shpronësuara e të përmbylsura dhe nga bandat e shumta të agjenturave të huaja imperialisto-revisioniste.

Eshtë kjo njëra nga arsyet kryesore pse na tërheqin dhe na pëlqejnë veprat letrare që flasin për atë periudhë. Edhe pse për ato vite letërsia jonë numëron sot disa vepra, prapë çdo krijim i ri, që ngjall në përfytyrimin tonë të bukurën, madhështoren, heroiken e asaj që kanë kryer njerëzit tanë të atij brezi, përbën eveniment jo vetëm për brezin që jetoi dhe krijoi atëherë, por edhe për rininë e sotme heroike dhe revolucionare. Këto vepra janë një shkollë e gjallë njohjeje dhe fryshtimi.

Romani i ri «Përballimi» i Teodor Laços krahas dy-tri romaneve të tjera të këtij viti, që trajtojnë atë tematikë dhe pasqyrojnë ato vite, eshtë ndër veprat më të arrira ideoartistikisht, ndër veprat e shkruara me fryshtimi, me tendenciozitet klasor dhe me njohje të së vërtetës jetësore të kohës. Pikërisht për këto merita ky roman zë vend ndër romanet tona më të mira.

Temën shoqërore të mbushur me epicitetin dhe dramatikën e vetë jetës, letërsia jonë prej kohësh e ka vendosur në ballë të të gjithë tematikës së mundshme letrare. Ndaj kur vlerësojmë dhe analizojmë një vepër me dinjitet si «Përballimi», ne nuk kënaqemi vetëm dhe thjesht me faktin që shkrimtari ka zgjedhur akcilën temë, por synojmë ta thellojmë vështrimin tonë në zbulimin e meritave të autorit lidhur me mënyrën sesi ka mundur ai të gjallërojë e ta materializojë temën në vepren që ka krijuar.

Në këtë sens analize themi se te romani «Përballimi» ndër meritat kryesore eshtë edhe fakti që këtë temë të zgjedhur, autori ka ditur ta materializojë drejt duke e trajtuar të ngritur mbi kontradiktat më të mëdha të kohës, midis popullit në fuqi dhe armikut të shpronësuar nga revolucioni, klasave të feudoborgjezisë së përmbysur.

Gama e manifestimit të shumëllojshëm të kësaj kontradikte, edhe pse nuk përbën qendrën e vëmendjes krijuese të shkrimtarit, ka zënë vendin e merituar në roman. Kurse ajo shfaqje e kontradiktës ku eshtë pikëzuar tërësisht në plan të parë vëmendja e shkrimtarit, lufta e Partisë dhe e komunistëve kundër armiqve të klassës për të siguruar bukën e popullit, për të realizuar grumbullimin

e drithit, sipas ligjit të ri të grumbullimit, me qëllim që të shmangej kërcënimi tepër i afërt i urisë, që armiqtë e brendshëm synonin ta përdornin si armë për të paralizuar pushtetin e ri, për ta armiqësuar atë me masat e fshatarësisë, si dhe për të përçarë aleancën e fshatarësisë me klasën punëtore, është dhënë me forcë, vërtetësi dhe emociione të rralla që flasin për meritat e padyshimta të autorit.

Fundi i vitit 1948 dhe viti 1949 qenë kohë të vështira, kur Partisë dhe popullit iu deshën të angazhoheshin tërësishët për të përballuar situatën e rëndë që pasoi pas tradhtisë së Koçi Xoxes brenda vendit dhe tradhtisë së titistëve në gjirin e lëvizjes komuniste botërore. Kongresi I i PKSH dënoi gabimet dhe devijimet armiqësore në politikën e brendshme ekonomike. Partia rishikoi me sy i kritik rrugën e ndjekur deri atëherë dhe programoi me gjenialitet qëndrimin e ri marksist-leninist të pasuruar me përvojën konkrete të vendit. Në këto korrigjime të gabimeve dhe shkeljeve që kishin bërë me qëllim armiqtë e saj, Partia i dha shumë rëndësi ligjit apo sistemit të grumbullimit të detyrimeve bujqësore për të realizuar këto qëllime të mëdha: sigurimin e drithit të nevojshëm për bukën e popullit, sigurimin e lëndës së parë për industrinë, nxitten dhe gjallërimin e interesimit të fshatarësisë së varfér për të rritur prodhimin, dhe nibi të gjitha forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë e varfér duke u përpjekur për të tërhequr në rrugë të drejtë fshatarësinë e mesme në luftë kundër kulakut në fshat dhe borgjezisë së vogël që kishte tendenca ringjalljeje të kapitalizmit në qytet. Në shërbim të këtij synimi që edhe sistemi i ri i triskëtimit, që ua hiqte të drejtën e tregut të garantuar atyre që s'qenë në marrëdhënie pune me shtetin. Kjo politikë e re gjallëroi jetën ekonomike brenda vendit, kufizoi tregun e zi dhe matrapazllékun, forcoi aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë e varfér. Pati në atë periu-dhë lëkundje dhe frikësime, njerëz alarmantë dhe disfalistë, njerëz të gënijyer nga armiku i fshehur, kulaku dhe borgjezia e qytetit, madje pati tipa të tillë midis komunistësh dhe kuadrosh. Rol të madh në sqarimin e kësaj si-

tuate të re, luajti letra e hapur e shokut Enver drejtuar gjithë popullit që u botua në shtyp me titullin, «Mbi disa probleme në fshat» ku theksonej rëndësia dhe domosdosh-mëria e zbatimit të drejtë të vijës së Partisë në politikën e ekonomisë së brendshme.

Në këtë situatë të re që u krijua, u bë e mundur që të vihej në rrugë të mbarë puna, të ecej më lehtësish e më me siguri drejt synimeve të mëdha të kohës, ndërtimit të bazave të socializmit, zhvillimit të planifikuar të ekonomisë, që siç dihet, nisi me të parin plan, planin dyvjeçar.

Në roman ka gjetur jehonën e vet krejt kjo periudhë me atmosferën e saj revolucionare, me frymën e vetëmohimit, me frymën e luftës së paepur në radhë të parë me armikun e klasës dhe në një aspekt tjetër, me ndërgjegjen e njerëzve tanë, me forcimin e tyre pikërisht në gjirin e kësaj lufte klasore.

Linja ideore që përfaqëson vërtetësisht këtë aspekt në vepër është ajo më pozitivja, dhe q'është akoma më me vlerë te ky roman, më e realizuara, më e motivuara, veçori kjo që nuk haset kurdoherë në romanet tona. Pra fakti që romani ka mundur të realizojë me një nivel artistik të shquar pikërisht aspektin pozitiv të realitetit, pa rënë në asnjëfarë skeme, duke thyer shablonet, pra në një mënyrë të mëvetshme, është meritë kryesore e veprës.

Idea e shkrimitarit e materializuar me aspektet jetësore të kohës, që në roman janë transplantuar emocionalisht nëpërmjet episodeve dhe veprimtarisë së sekretarit të parë të Partisë së rrethit, Martin Krekës, drejtorit të grumbullimeve, Miti Vozarit, sekretarëve të Partisë dhe komunistëve Mezin Ajdini, Rifatit, Atmirit etj., përfaqësojnë të renë, forcën e saj, forcën e revolucionit që moshon duke imposhtur pengesa dhe rreziqe.

Të gjithë punën, luftën dhe përpjekjet për realizimin e vijës së Partisë, për shëmangien e rrezikut të urisë, për grumbullimin e detyrimeve të drithit etj., shkrimitari e ka mishëruar në vepër nëpërmjet skenash apo episodesh të ndërtuara me art, thjeshtësi e në mënyrë origjinale. Komunistët dhe udhëheqësit e Partisë në rreth ne i hasim

në ambientet e familjeve të tyre që, ndonëse ambiente të jetës intime personale, nuk janë larg dhe aspak jashtë interesave të punës e të luftës, që i ka thëthitur ata. (Kujtojmë episodet e Martinit në shtëpi, Mitin që eksperimenton me bukën, Atmirin që jeton në depon e grumbullimit të fshatit, Refatin po ashtu në fabrikën e miellit etj.). Edhe më tej, në skena të shumta, në kapituj të ndryshëm, në mbledhjet, në zyrat e Partisë apo në diskutimet me fshatarët, në debatet dhe fërkimet, në luftën që bëjnë komunistët në terren duke nisur me Martinin dhe deri te më i fundit, autori zbulon rrugën e luftës që zhvillonte Partia, mënyrën sesi kryhej dhe kryhet kjo luftë duke u mbështetur te populli, duke fituar përkrahjen e masave, duke u përpjekur për këtë përkrahje, për këtë unitet.

Formë pune dhe lufte për triumfin dhe mbrojtjen e vijës është edhe ajo brenda gjirit të Partisë. Në betejat për qëllimet e mëdha të Partisë dhe të popullit, dalin dhe të tremburit, shpirtvegjilit, karrieristët që s'kanë mundësi morale, forca shpirtërore ta ndjekin revolucionin. Ky fenomen, si shprehje e luftës së klasave edhe brenda gjirit të Partisë, konkretizohet në roman me Kopi Rapushin, njërin prej sekretarëve të komitetit të Partisë së rrethit, të cilin vrulli revolucionar i atyre viteve ia zbuloi dobësitë dhe e nxori jashtë radhës së parë të luftës. Është shprehje e kuqimit të thellë e të drejtë ideor të shkrimtarit fakti që ai ka mundur në mënyrë të besueshme të na e japë këtë fenomen të realizuar jo vetëm në debatin parimor në zyrat e Partisë në rreth, por edhe në mbledhjet me komunistët e bazës, qofshin këta edhe të një fshati të vogël e të largët malor. Në konfliktin bazal të romanit ky krah pozitiv fiton përherë e më shumë terren, bëhet përherë e më i fuqishëm, grumbullon forca më të shëndosha shoqërore nga masat e gjera të popullit. Me këtë fenomen tipik të atyre viteve, autori ka zërthyer drejt dialektikën e zhvilimit e të triumfit të revolucionit. Puna e Partisë, lufta këmbëngulëse e komunistëve bëri për vete masat, i afroi ato dhe i grumbulloji duke pastruar përherë e më mirë shoqërinë nga helmi mbytës i ideologjisë së klasave të përmbywsura.

Sfondi historiko-shoqëror i ngjarjeve të kohës ku ka marrë temë romani, periudha e shkurtër gati dyvjeçare që përfshijnë në shtrirjen e tyre ngjarjet që shtjellohen në subjektin e tij, janë kaq të pasura dhe të ngjeshura, janë kaq të ndërlikuara e të dhëna me densitet të jashtëzakonshëm, saqë edhe pse romani vë në epiqendër një problem të vetëm kardinal të kohës, mendojmë se e jep të plotë dhe mjaft të gjërë idenë e kohës, dhe s'ka lejuar ngushëtësi tematike.

Aspekti tjetër i brendisë ideore të romanit lidhet me paraqitjen e rezistencës, përpëlitzeve, luftës së egër, nervoze por të pashpresë të klasave që rroposi përfundimisht revolucioni ynë popullor. Kjo e vërtetë e madhe historike, që realizoi Lufta jonë Antifashiste Nacionalçlirimtare, qe sa e hidhur aq dhe e pabesueshme për të përbmbysurit, që s'mund të pajtoheshin me realitetin e ri, që s'mund ta pranonin atë, ndaj përpëliteshin ta dëmtonin, ta dobësonin, duke shpresuar gjithmonë te ndërhyrja e jashtme, shpresë kjo që pohonte dobësinë e tyre. Në ato vite shprehja më e mprehtë dhe më masive, më tipike e rezistencës së armikut të përbmbysur qe dëmtimi ekonomik i pushtetit të ri, minimi i unitetit Parti-popull, përcarja e aleancës së klasës punëtore me masën e madhe të fshatarësisë punonjëse. Në këto shfaqje tipikë të luftës së armiqve, autori është ndalur me vend dhe mendoj se i ka dhënë bukur. Kulaku, duke shfrytëzuar disa të cara dhe dobësi tonat, kishte tërhequr dhe gabuar mjaft fshatarë të varfér për t'i kundërvënë ata ndaj politikës ekonomike të Partisë. Nazifi dhe Xhezua me shokë kanë mbjellë pakë-naqësinë ndaj kërkësave për grumbullimin e detyrimeve. Parulla se misrin e prishi bryma, se gruri qe i paktë dhe se fshatarët po hanin grurin e farës, që i ndeshim shpesh në episode të ndryshme të romanit, janë pohim i kësaj veprimtarie armiqësore. Armiku, duke shfrytëzuar dobësitë e mëparshme në sistemin e grumbullimit, nxiste armiqësinë me pushtetin, me qytetin, me punëtorët, që i paraqisin vetëm si konsumatorë parazitë. Po kështu, parulla se gruri dhe drithi u dashkish për të mbajtur të huajt me bukë, synonte po në të njëjtin qëllim. Romani i ka dhënë

këto, dhe kështu ka mundur të japë esencën e luftës së egër të klasave, pavarësisht se në të nuk kemi ndonjë rast veprimi violent të armiqve, që realisht kanë vrarë edhe drejtues me përgjegjësi të pushtetit dhe të Partisë në bazë. Ky aspekt i luftës mund ta bënte më dramatik konfliktin, por edhe pa të mendoj se egërsia e luftës së klasës spikat në roman. Shprehja e kësaj lufte dhe rezistence të egër në episodet e romanit është edhe krejt linja e armikut të fshehur dhe ende të rrezikshëm pér socializmin dhe diktaturën e proletariatit në qytet, si edhe e elementëve mikroborgjezë, spekulantë e matrapazë. Tregu i zi qe jo vetëm një lëm fitimprurës pér tregtarët e vegjël që mbinin si këpurdha në ato vite të vështira, por edhe një rrezik real pér të ardhmen, një shpresë e mjet lufte i reaksionit, një burim pakënaqësish në masën e punëtorëve, që me të ardhurat e tyre s'mund t'i bënin ballë çmimeve të atij tregut. Romani ka zbuluar se, si pasojë e shthurjes e shkattërrimit armiku, nën goditjet e popullit dhe të armës së tij të fuqishme të diktaturës së proletariatit, s'ka më fuqi rezistence. Pra kur atij i priten të gjithë burimet, të gjitha krahët ai, edhe pse i tërbuar, do të tulatet derisa të mposhtet përfundimisht. Shprehje e dobësisë së tij është së fundi degjenerimi i plotë i tij. Këtë romani e jep funksionalisht e në mënyrë të qëllimshme në linjën e Kleas, të Xhezos, të Ropi Karapanos etj.

Ngjarjet e romamit zhvillohen të vendosura kryesisht në dy ambiente, që ishin dhe fushat kryesore të luftës së ashpër klasore; këto dy ambiente janë qyteti dhe fshatrat pranë ose larg tij si Borasi, Bujgëza, Vokazi etj. Autori, kuptohet qartë në vepër, është marrë kryesisht me fenomenin kardinal, me aspektet e luftës së klasave, me paraqitjen e elementëve nga klasa dhe shtresa të ndryshme, me evoluimin dhe degradimin e tyre. Duke qenë kështu, ai s'mban në epiqendër të vëmendjes së tij ambientet, por i trajton ato aq sa i nevojiten idesë dhe qëllimit të tij. Në këtë aspekt ai i ka realizuar mirë ato por mendojmë se vlera njohëse e veprës do të qe rritur sikur vështrimi i shkrimitarit të qe drejtuar më shumë në zbulimin e jetës së fshatit, të përbërjes shoqërore të tij, të luftës klasore

aty. Roman i ka dhënë më shumë rrjedhimet e kësaj iufte, e kësaj përplasjeje të kohës dhe kjo është kryesorja, prandaj vërejtja jonë synon më tepër në një plotësim që do ta gjallëronte përfytyrimin e lexuesit përfshatin e atyre viteve.

Përveç këtij trungu kryesor ideor dhe problemor, duke njojur mirë realitetin dhe si pasojë e kësaj pasurie mbresash e përshtypjesh, që e hasim edhe në shumë tregime me këtë tematikë të Teodor Laços, roman i është zgjerruar, siç është e natyrshme, edhe në pasqyrimin e shtresave të tjera shoqërore, që jetonin realisht në ato vite dhe që, nën ndikimin e zhvillimit të revolucionit, pësonin evolujm të natyrshëm. Meritë e shkrimtarit është se në këtë aspekt të veprës ka pasur ndjenjën e masës dhe të realitetit duke i lënë në plan të dytë këto fenomene më sekondare, që jo vetëm ishin jetësore, por që e plotësojnë artistikisht më mirë romanin. Ky plan që mbartet kryesisht dhe më shumë nga linja e Platon Bubuqit, nuk ka funksionin e englendisjes së lexuesit. Humori i tij jetësor, i gjallë, i këndshëm, përveç ndonjë rasti kur na duket disi i trilluar dhe i sforcuar, është dhënë jo pa qëllim. Ky humor dhe kjo linjë përfaqësojnë fshikullimin popullor, që shpërthente hovshëm në ato vite kundër klasave të përbysura, kundër sqimës dhe përbuzjes qesharake, donkishoteske që ushqen ato ndaj popullit në fuqi. Humori dhe satira e kësaj linje, që arrin kulmin me reklamën e re të Platonit përfshirë dyqanin e tij, nuk ka pse ta konsiderojmë si shprehje të qëndrimit të lumpenmëkroborgjezisë. Këta zanatçinj apo karrocierë të vegjël, që mezi nxirrin bukën e gojës, dikur ishin njerëz prej burimeve të proletariatit, që vetëm fitorja e revolucionit tonë popullor i shpëtoi nga mjerimi i plotë ku po i shtynte konkurenca kapitaliste dhe që koha e re, realiteti i ri revolucionar shoqëror i pasqirimit po i tërhoiqte drejt gjirit të klasës sonë punëtore. Nëse ata enden përfshirë disa kohë jashtë klasës, kjo s'vjen përsye ekonomike apo të pozicionit të tyre ideologjik, në rastin konkret në roman, por si pasojë e hezitimt që u shkakton tonte ndjenja e pronës e kultivuar prej vitesh e prej brezash tek ata, ashtu si edhe te fshatari i varfër që ngurron

të hyjë në jetën e re socialiste të kooperativistit. Marksizëm-leninizmi na mëson se thëllimi i revolucionit bie me vete edhe diferencimin klasor, dallimin e prerë të qëndrimit të shtresave të lëkundura shoqërore që, në momente kthesash të mëdha përcaktojnë qëndrimin e tyre o duke u bashkuar me klasën punëtore, që është forca e vetme shpëtimtare për ta, ose degjenerojnë në prehrin e borgjezisë, ndjekin rrugën dhe pasojnë fatin e saj, sikurse e po-hon romani me linjën e Lazar Karapanos e me ndonjë tjetër.

Me qëllim të përcaktuar dhe me tendencë ka vepruar shkrimitari edhe kur në zgjidhjen e konfliktit të madh të veprës ka nënvizuar rolin udhëheqës, rolin primar të klassës punëtore që, si kurdoherë edhe në ato vite, u bë mbështetja e Partisë, e rrugës dhe e politikës së saj. Grupi i punëtorëve të fabrikës së miellit «Drapër e çekan» e vencanërisht ndonjë përfaqësues i saj si Refati, e realizojnë bukur funksionin ideor që synon të japë autori. Ndoshta do të kishte bërë më mirë shkrimitari sikur t'i kishte dhënë më tepër vend këtij aspekti dhe këtij funksioni të grupit të punëtorëve, por që ai e ka dhënë të këtillë e të kësaj industrie mendoj se ka vepruar drejt për dy arsyen: Së pari, se kjo fabrikë lidhej më mirë dhe më drejtpërsëdrejti me fshatin e me problemin e drithit e të bukës, që është kryesori në vepër dhe së dyti, se ajo industri që trashëguam dhe që ishte krijuar deri atëherë s'i kalonte fabrikat dhe punishtet e vogla si fabrika e miellit ku, siç thotë shkrimitari në vepër, kanë filluar format e reja të punës e të jetës, racionalizimet, se punëtorët aty tashmë e ndiejnë veten zotër të plotfuqishëm të fatit të tyre, të fabrikave të tyre.

Krahas vlerave më të mira në planin ideotematik, romani «Përballimi» ka meritë e shënon sukses edhe në realizimin e disa karaktereve tipike, për skalitjen e të cilave janë përdorur mjeshtërisht elemente individualizuese që i kanë gjallëruar ata brenda vlerës së tyre të përgjithshme dhe tipizuese. Të entuziazmon fakti që romani ka ndër figurat e veta më të realizuara figurën e udhëheqësit të Partisë në rreth, figurën e sekretarit të parë, Martin Kre-

ka. Ky karakter i skalitur i Martin Krekës në mënyrë të natyrshme dhe jashtë pozave, është vizatuar në roman në situata dhe rrethana të ndryshme. Thjeshtësia, qetësia dhe siguria e veprimeve të tij janë kuptimplotë, domethënëse pér Partinë që ai përfaqëson. Në qytet apo fshat me një-rezit e ndershëm e të lidhur me revolucionin, ai është i përzemërt dhe i afuar si rallë ndonjë tjetër. Në familje, në jetën e tij intime, Martini, edhe pse është dhënë në situata krejt të zakonshme, rilevon ngrëtësinë dhe natyrshmërinë e sjelljes së njeriut të dashur e të dhembshur. Ai është shok i barabartë me punëtorët e fabrikës së mie-lit, gjen kënaqësi mes tyre. Ai është i zhveshur nga çdo lloj zyrtarizmi në marrëdhënie me fshatarët, të cilëve di t'u gjejë e t'u zbulojë esencën e shëndoshë, revolucionare e t'ua nxisë atë. Por po kaq, sa i gjerë dhe njerëzor me popullin, ai është dhe këmbëngulës, principal dhe intolerant me gabimet, me shkeljet e vijës së Partisë. Në raport me shokët më të afërt, me Mezinin e sidomos me Kopin zbulohet pikërisht ky principalitet i natyrshëm dhe i domos-doshëm i figurës apo tipit që ai përfaqëson. Me armikun e klasës, me përfaqësuesit e atij llumi shoqëror të flakur tej nga revolucioni, Martini është i pamëshirshëm. (Kujtojmë episodet me Klea Prokën dhe të vjehrrin e saj, Safkë Prokën, takimin e tij me Xhezon në pazarin e drithit etj). Kjo natyrshmëri në skalitjen e personazhit është ruajtur nga shkrimitari deri edhe në të folmen, në fjalorin që ai përdor. Vlerësim të karakterit të heroit ne gjejmë edhe në gojën e Mitit kur ky mendon pér Martinin: «Asnjeri s'mund ta mposhtë sedrën lehtësisht. Por kryesorja është të jesh njeri i mirë, me zemër të qëruar, kështu si ti. Të tjerat vijnë pas!» Miti Vozari, edhe pse i afërt në karakter me Martinin, mbetet origjinal dhe i realizuar, me përvijime fortmirë të dallueshme. Me detajet që ka përdorur shkrimitari në skalitjen e këtij tipi, duke nisur nga ajo mushamaja e gjatë angleze që mban Miti e deri te këmbëngulja e tij pér t'i siguruar bukën e përditshme popullit, deri te ajo prova me grurin e larë nga spërkatja e helmët, Miti mbetet i gdhëndur dhe i gjallë në përfytyrimin e lexuesit.

Detajin në funksion të plazmimit të karaktereve, shkrimtari e ka shfrytëzuar dhe e ka përdorur me sukses. Jo vetëm për personazhet kryesore por edhe për personazhet e dorës së dytë madje dhe episodikë, ai ka gjetur dhe përdorur detaje të qëlluara dhe shprehëse. Individuallizimin e karaktereve shkrimtari e ka arritur pas një rjobjeje dhe thellimi në zërthimin e tipit, pa i besuar vetëm dhe kryesisht intuitës krijuese të tij. Kështu ndonëse me pak vend, por i diferencuar dhe i gjallë është dhënë Mezini, kurse Kopi, që mbart një fenomen të rëndësishëm, që mishëron tipin e karrieristit, fjalamanit, frazeologut të pabukshëm, mendjemadhit, që përbuz dhe nënveftëson shokët, është skicuar në situata që i jepin dorë demaskimit të tij. Kur është rasti që nga fjalët të kalohet në vepra, në aksione revolucionare, aty zbulohet që ai është një njeri kallp. Për fenomenin që mbart dhe për natyrën delikate e të komplikuar të tipit që përfaqëson, ndoshta do të duhej që këtij personazhi t'i lihej më shumë vend, të motivohej më mirë. Të gjalla dhe të bucura, ndonëse me pak vend në vepër por mjaft mirë të realizuara kam mendimin se janë figura si Atmiri, djaloshi i guximshëm, i ndershëm dhe plot kurajë në luftë me armiqtë e klasës; Rifati, punëtor i dalluar dhe i papërtuar, përherë gazmor dhe entuziast etj.

Me ngrohtësi, gjallëri dhe plot ngjyra origjinale, autori ka vizatuari tipa njerëzish të thjeshtë që realiteti po i bindte për vërtetësinë dhe për drejtësinë e rrugës së jetës së re. Pllaton Bubuqi është më përfaqësuesi ndër ta. Ky tip që mbart misionin e përfaqësimit të shtresës së tij, është térësisht i realizuar, ndonëse ka ndonjë moment kur humori i tij nuk rrjedh gjithaq natyrshëm. Filozofia e tij është ajo e njeriut që edhe pse ngjarjet e mëdha i ka ndjekur në mënyrë pasive, pa dalë nga guaska e hallevë dhe e gëzimeve të vogla, prapë shpirtërisht lidhet me të renë, revolucionaren, me të cilën e afrojnë të gjitha fijet e interesave të tij, madje dhe urrejtja e përbuzja që ushqen ai përfaqësuesit e klasave të përbysura apo përkëlyshët e rinj që donin të ringjalleshin, me të cilët ai edhe tallet pa mëshirë.

Tendencioziteti klasor spikat në roman në mënyrë të dukshme edhe në karakterizimin e tipave përfaqësues të armikut të përblysur, të cilëve realiteti i ri ua kishte prerë të gjitha mundësitet pér të ngritur krye, pér t'u ringjallur, ndaj dhe ata përpëliteshin në shpresa të kota. Të ndyrë deri në fëlliqësi janë tipa të tillë si Safkë Proka dhe e reja e tij Klea, që përfaqëson llumin moral të klasës së saj. Ndërsa tipa të tjerë përgjithësues, edhe këta si kulkaku Nezir, fshatari i pasur Xhezo, apo tregtari i pasur Llazaq Karapanoja, mishërojnë lakminë e pangopur, dinakérinë, egërsinë e hijenave të cilave zjarri i revolucionit po ua priste mundësinë e majmjes nëpërmjet punëve dhe veprimeve të tyre të fëlliqura. Pér tipat dhe karakteret e shumta të romanit, pér detajet që ka përdorur autorri në skalitjen e secilit prej tyre, si vlera të këtij krijimi të ri të Teodor Laços mund të flitet edhe më gjatë, por u mundova të ndalem dhe të hedh ndonjë mendim pér ata më kryesorët, dhe pér momentet më të rëndësishme dhe kyçe të veprës.

«Përballimi» është romani i dytë i autorit, por po të krahasohet pér nga ndërtimi kompozicional me romanin e parë, të tij «Tokë e ashpër» të bie në sy përparimi i ndjeshëm i punës së shkrimitarit në harmonizimin më të përkryer të elementeve kompozicionale, pér të na dhënë një ngrehinë letrare të bukur. I konceptuar kompozitionalisht si një unitet i plotë ideoartistik, romani ruan atë formë ndërtimi të njojur dhe tradicionale tashmë pér prozën tonë të gjatë. Edhe pse pa ndonjë novitet forme, romani mbetet novator pér brendinë ideojetësore që paraqet edhe pér konfliktet e mëdha e temën e rëndësishme që trajton. Kjo vepër pohon edhë një herë me suksesin e saj, mësimin e Partisë që vlerat e veprave, novacionet e tyre, qëndrojnë në plan të parë në brendinë e tyre. Romani shtjellohet i téri në dy plane të mëdha linjash jetësore që përfaqësojnë dy qëndrime antagoniste ndaj kontradiktës së madhe të kohës. Autori ka proceduar nëpërmjet alternimit të ske nave jetësore nga më të ndryshmet në shpalosjen e subjektit të romanit, dhe në këtë mënyrë, ai ka mundur të rilevojë tipat dhe karakteret e veprës nga njëra anë, dhe

idetë e mëdha të kohës, nga ana tjetër. Retrospektiva në vepër është përdorur rrallë dhe në mënyrë shumë funksionale. Por me gjithë këto konstatime pozitive, fundi i veprés dëshmon pér një punë të nxituar dhe të pathelluar sa duhet nga ana e shkrimtarit. Sidomos pa vend na duket mbingarkesa në këtë fund, kur hasim edhe personazhe të rinj si xha Takoja etj., që vetëm sa skicohen, megjithëse duken se kanë goxha potencë të pazbërthyer. Ky fund i përspejtuar e i parealizuar ka démtuar edhe kujdesin që duhej t'i kushtonte shkrimtari së resë në fshat, që qe element jetësor i rëndësishëm në ato vite. Madje një nevojë të tillë atij ia shtron dhe vetë synimi tematik që të na japë rrugët e realizimit të së resë në fshat, rrugët e afritit të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse të kohës.

Qysh në tregimet e tij të para e deri te ky roman, Teodor Laçoja ka pohuar me krijimet e tij letrare se e ka shumë mirë të zhvilluar ndjenjën e njoħjes, të admirimit dhe të forcës paraqitëse të peisazhit. Pothuaj në çdo filim kapitulli, dhe shpesh edhe midis ngjarjeve ai ndalet pér të dhënë tablo origjinale, me detaje të pasura të natyrës, që jo vetëm të krijojnë një imazh të bukur të ambienteve ku zhvillohet ngjarja, por me lirizmin që derdh autori në to, në mënyrë intuitive të ushqejnë dashurinë pér të, pér natyrën aq të bukur dhe aq të lar me tē atdheut tonë.

Është vlerë e romanit edhe pasuria gjuhësore, frazeologjia funksionale dhe jo si qëllim në vete, si vlerë etnografiike, por e shkrirë dhe e përdorur ajo në funksionin e karakterizimit të personazheve. Në mënyrë më të spikatur ndihet kjo vlerë te personazhe si pleqtë e ndryshëm dhe në përgjithësi te fshatarët, por nuk mungon as te tipa si Platon etj. Pér individualizim gjuhësor mund të ndaleшим te shumë personazhe e në mënyrë të veçantë e qëlluar në këtë drejtim është figura e Kopi Rapushit me frazeologjinë e tij standarde.

Romani «Përballimi» zgjon në përfytyrimin tonë, në mënyrë emocionale heroikën e viteve të para të marshimit tonë drejt socializmit. Ai rrëfen dhe ngjall në imagjinatën

e lexuesve, e vecanërisht të rinisë, tablotë e fuqishme të jetës së viteve të para kur populli i lirë i udhëhequr nga Partia po hidhte hapat nismëtare drejt një jete të re, përmes një lufte të ashpër me armikun e përbysur nga revolucioni, por ende të egër, me armiqtë e jashtëm imperialisto-revizonistë që synonin ta mbysnin me gjak e uri idealin e madh që qe bërë pronë e masave. Romani flet me sinjeritet, thjeshtësi e ngrohtësi për atë epokë, ata njerëz që e përballuan me sukses edhe urinë, edhe armiqësinë dhe triumfuan mbi to. Por edhe pse për ato vite të para, jeta, rruga e triumfit tonë socialist, edhe më pas, deri në ditët tona, eci dhe po ecën përherë përmes përballimit të situatave nga më heroiket. Historia e ndërtimit të jetës së re, për ne është historia e përballimeve përherë të suksesshme të popullit tonë të udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver të çdo lloj vështirësie që na kanë imponuar e na imponojnë armiqtë e jashtëm e të brendshëm, përmes luftës së klasave dhe forcimit të diktaturës së proletariatit. Në pasqyrimin e lartë artistik të këtij realiteti qëndron dhe vlera e romanit «Përballimi» të Teodor Laços.

1975.

ROMAN PËR PRANVERËN TONË SOCIALISTE

Procesi i përmbysjes së botës së vjetër erdhi në jetën tonë si pasojë e triumfit të pandalshëm të shoqërisë së re socialiste, e cila e pohoi ekzistencën e vet, në shumë aspekte jetësore, me vitalitetin e saj të jashtëzakonshëm dhe me sulmin e pandalshëm masiv kundër çdo gjëje të vjetëruar, të huaj dhe armiqësore.

Në këtë fushë të problematikës jetësore në vitet e para të pasqirimit të atdheut, duke u kapur pazgjidhshmërisht pas fakteve dhe jetës së gjallë, e ka vendosur romanin e tij të dytë «Mars» romancieri ynë i ri Vath Koreshi. Kjo vlerë e veprës, së bashku me faktin tjetër që romani synon të shtjellojë temën e lindjes dhe të ndërtimit të shoqërisë socialiste te ne, duke na e rikrijuar epokën vërtetësisht dhe emocionalisht drejt, nëpërmjet luftës shumëplanshe që u desh bërë deri te lufta më delikate, në fußhën ideologjike, për të krijuar koncepte të reja, njeriun e ri, janë pa dyshim baza e vlerave të këtij romani të fundit të Vath Koreshit.

Jeta ka dialektikën e saj të zhvillimit dhe letërsia e vërtetë, letërsia realiste socialiste, e kryen si duhet funksionin e vet, vetëm atëherë kur shkrimtari arrin që në morinë e fenomeneve të jetës të kapë e të trajtojë ato më kryesoret, më të rëndësishmet, ato që shprehin e përfaqësojnë në mënyrë më të mprehtë luftën dhe triumfin e të resë, të revolucionares. Romani «Mars» e ka realizuar me sukses dhe në mënyrë origjinale këtë kërkësë të artit të vërtetë socialist.

Duke vendosur në qëndër të veprës dramën e jetës së një fshatari, të cilin egërsia dhe padrejtësitë e kohës e detyruan të shiste krahun, djersën e tij dhe të shndërrohenj në një punëtor gurthyes, autori jo vetëm ka vizatuar hidhërimin e së djeshmes dhe pasojat e saj të rënda në jetën e një mase njerëzish, por ka mundur që të dalë nga vuajtja e një individi të veçuar dhe ka arritur të përgjithësojë me Zikun, heroin e romanit, një fenomen kuptim-plotë e me shtrirje për atë kohë, të cilin vetëm revolucioni ynë popullor dhe triumfi i përditshëm i moralit tonë socialist mundi ta çrrënjosë dhe ta shënojë plotësisht.

Ziku është vëktimë e zakonit. Ai i nënshtrohet vullnetit të babait dhe merr për grua Dilën, nusen e vëllait të vrarë nga hasmi, e cila është mbi dhjetë vjet më e madhe se ai. Dhembla shpirtërore që Ziku ndien qysh natën e parë të martesës, brengë që e mbulon shpesh atë në jetë përgabimin e imponuar që bëri dikur, janë të përligjura dhe tërësisht të besueshme për ne. Brengë dhe trishtimi shpirtëror i heroit nuk janë në natyrën e tij, ato shpérthejnë në zemërimin e drejtë e madje ndonjëherë në tèrbimin e papërmbarjatur të Zikut, vetëm atëherë kur kjo plagë, që ka zënë dregëzë, ckëlfitet nga të tjerët, nga ata që verbaz bëhen zëdhënës të së vjetrës, përfaqësues të «nderit dhe të zakonit». I ndodhur nën bateritë e shpifjeve e të thashethemeve, Ziku lufton me besim të patundur tek e drejta, te triumfi i padyshimitë i së resë. Ky plan ngjarjesh dhe linjash i romanit, me shumë funksion ideor, është bashkë-vendosur me planin e ngjarjeve dhe të episodeve që lidhen me linjën e Maxhunit, Lemosë, Sokolit e të dhjetëra të rinjve të tjerë, të cilëve po u buzëqeshte e ardhmjë. Ziku e ka të qartë këtë perspektivë dhe është pikërisht kjo që e bën atë të jetë optimist, të ketë qëllime në jetë, është kjo që i jep kuptim dhe domethënien jetës së tij.

Për ta spikatur më mirë linjën ideore të Zikut, shkrimitari jo rastësisht por qëllimi shpëtueshëm dëshiron që të përligjurohet jetësore ka shpalosur dhe kundërvënë linjën dhe karakterin e Ademit, mbartësit të pandërgjegjshëm të errësirës patriarchalo-zakonore, te i cili dogmat e kanunit janë të rrënjosura e të mpleksura me atë ndjenjë xhelozie prej

padroni që ushqen ai ndaj Kadës, së shoqes. Nëse Ademi derdh vrerë shpifjesh për njerëz si Ziku, kjo na thotë autor, s'është vetëm dhe thjesht për hir të karakterit të tij të keq por edhe pse ai, qoftë dhe fare tërthorazi, bëhet pjesë dhe vegël e reaksionit të fshehur, e forcave të asaj së vjetre që ende nuk i kishte lëshuar pozitat e saj.

Në këtë kundërvënie antagoniste është e kuptueshme se gjithçka ndodh me Zikun, me punëtorin që shkelmon të vjetrën por që njëherazi është dhe viktimi e saj, vjen si pasojë e përplasjeve që ndodhnin në jetë, në ato vite.

Thamë më sipër që romani nuk merret thjesht dhe vetëm me dramën personale të Zikut. Ai me këtë personazh përgjithëson një fenomen shoqëror, zbulon një plagë shoqërore, trashëgim të hidhur të së kaluarës. Këtë përshtypje të gjerësisë së shtrirjes ideoproblemore të romanit e përforcon fakti tjetër që gjithë sa thamë më sipër për Zikun dhe dramën e tij shpirtërore është shkrirë brenda jetës së gjallë të kohës. Pra vepra ka frymëmarrje shumë më të gjerë sesa historia e veçuar e një individit të vëtmuar, qoftë ky edhe pozitiv si Ziku.

Autori këtë plan të dytë të subjektit të veprës e ka gërshetuar me krejt realitetin jetësor të kohës. Drama e Zikut zbërthehet brenda suazës së jetës së re, në të njëjtën rrugë në të cilën po zhvillohej revolucioni ynë për fitoren e plotë ekonomike, politike dhe shoqërore të socialistit.

Mendoj se romani shënon sukses edhe përfaktin që ky realitet i planit të gjerë shoqëror është arritur po me atë dinjitet dhe spontaneitet artistik sikurse edhe linja personale e fatit të heroit kryesor të veprës. Duke na shtyrë me anë digresionesh disa vjet më parë kur filloi puna në minierë, kur aty në malet e largëta të Veriut, në atë dimër të acartë nisi beteja e ekipit të vogël të përbërë prej një grushti punëtorësh, teknikësh dhe një inxhinieri. Shkrimtari ka mundur që jo vetëm të krijojë për ne imazhin e bukur të heroikës së kohës por edhe të zbërthejë e plazmojë tipa dhe karaktere të fuqishme, reale e përgjithsuesë.

Që në përshkrimin e asaj nate të parë që kalon ekipi, i udhëhequr nga sekretari i Partisë Martin Gjeta dhe drejtori i minierës së ardhme Gash Halili, në atë barakën e vjetër që kërciste nga pesha e dëborës, në episodin e së-mundjes së Ndoit dhe të përpjekjeve që bëjnë të gjithë e veçanërisht Martini për ta çuar në spitalin e Kukësit të sëmurin, spikasin tiparet e reja dhe të larta morale të njerëzve të punës, të klasës punëtore. Dhe jo vetëm kaq. Më tej tërë shtjella e ngjarjeve, që i jetojmë në faqet e romanit apo që i mësojmë nga goja e personazheve ku përfshihet lufta e përditshme, e vështirë, këmbëngulëse e njerëzve të punës, krejt moria e episodeve, në të cilat ze vend lufta për formimin e njeriut të ri, deri në triumfin mbi mentalitetin konservatoro-patriarkal dhe deri në zbulimin e shtresave të reja shumë të pasura në mineral, momente këto që kurorëzojnë luftën dhe punën e njerëzve në minierë, pa harruar aspekte të luftës në emër të së resë si përpjekja për arsimin e masës, lufta kundër armikut të klasës etj., e vizatojnë të pasur e me shumë individualitet, mozaikun e jetës shqiptare të atyre viteve të para të fillimit të marshimit tonë socialist.

Kjo gamë e pasur problemesh jetësore i ka shërbyer si duhet dhe është funksionale në vepër për idetë që mbart si dhe për realitetin kohor që pasqyron. Por nëse këtë mund ta pohojmë për shumicën e linjave dhe episodeve të romanit, na duket se ka edhe të atilla ku ana funksionale, për ndonjë episod, s'është e motivuar; ai, episodi, si të thuash, se justifikon vvetveten, mbetet si diçka e huaj ose, së paku, si diçka që nuk harmonizohet me tërësinë e veprës. E tillë, e pazhvilluar sa duhet si linjë, por më tepër e futur sa për t'i shërbyer qëllimeve të autorit, na duket linja e bandës së diversantëve të Dan Kaculit. Meqë autori e fut si element jetësor të kohës heroizmin e femrës shqiptare në luftën e saj për emancipimin dhe kontributin e saj të madh në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste, mendojmë se zbehtë dhe cekët është trajtuar retrospektiva e Shkurtës, madje ajo del më tepër si plotësim i linjës së Milloshit, që në vvetvete është një trup i huaj dhe krejt i panevojshëm për ngjarjet në vepër. Po këtë mbresë tepërie apo dub-

limi të panevojshëm, si shprehje e qëndrimit të së resë ndaj së vjetrës, na krijon edhe ajo pjesë ku përshkruhet takimi i Maxhunit me babanë e tij, martesë e të vëllait si dhe trishtimi shpirtëror i Maxhunit për të vëllanë. Kjo si ide dhe aspekt i kohës a nuk është ezauruar me krejt linjën qendrore të Zikut në roman? Nuancat e ndryshme midis të dy rasteve s'thonë ndonjë gjë të madhe.

Në të gjitha planet e shtjellimit të subjektit, në krejt linjat dhe episodet e veprës, autori ka mundur me mjaft shkathësi të krijojë tipa dhe karaktere që, për nga forca dhe vlera e tyre përgjithësuese, shquhen në galerinë e heronjve që ka krijuar romani ynë i derisotëm. Në këtë mendim arrijmë duke pasur parasysh në radhë të parë Zikun. Ky tip përfaqësues është skalitur si i tillë në saje të materialit jetësor që shkrimitari ka pasur në dorë dhe në saje të punës së tij hulumtuese në një radhë rastesh jetësore që ai ka grumbulluar dhe shfrytëzuar për skalitjen e Zikut si tip shoqëror i kohës. Duke na e dhënë heroin letrar në një varg episodesh, autori ka mundur të na zbërthejë shumë tipare morale të tij. Si njeri i punës Ziku i ka shokët të rrallë. Ai është i lidhur pas saj si pas më të madhit gëzim në jetë. Në heshtjen e tij gjatë punës, në përqëndrimin e madh pas saj, në ngulmimin përfundimtare një punë të pastër e të ndershme etj., ne ndiejmë atë që përbën poezinë e punës. Fill pas këtij momenti të parë dhe lidhur ngushtë me të, ne njohim dalngadalë dramën shpirtërore të personazhit, që, sikurse përmendëm më sipër, është posojë e së djeshmes së rëndë e të hidhur përfundimtare tonë. Bir fshatari të varfër që është rropatur dhe ka vuajtur vite me radhë duke u endur pas punës së rëndë përfundimtare me bukë familjen, Ziku vetëm tanë (është fjala përvitet e para pas Çlirimt) po ndien gëzimin e përtëritjes dhe të çlirimt shpirtëror. Ky fakt i madh ndihet në krejt qënien e tij. Autori jo rastësisht ka renditur e skicuar një sërë episodesh dhe detajesh që flasin bukur përfundimtare e madhe e të ngrohtë të Zikut. Ai lumturohet pas fëmijëve në shkollë, ai i gëzohet jetës së këndshme të të rinjve në minierë, ai ka një dëshirë të papërmabjtur përfundimtare ta jetuar intensivisht të sotmen e re, heroike dhe të bukur të jetës

sonë. Duke e njojur të tillë, ne e kuptojmë dhe, më tepër se sa e kuptojmë, e ndiejmë në tërë qenien tonë stuhinë e rëndë shpirtërore që duhet të përballojë ai. «Haraçi», që i paguan Ziku të kaluarës s'është vetëm i tij por i mbarë shoqërisë shqiptare të porsacliruar. Retrospektiva e shfrytëzuar për zërthimin e kësaj figure është mjaft funksionale për ta karakterizuar atë si tip shoqëror. Ajo e kaluar zbulon qartë arsyet e raporteve familjare të ftohta të Zikut, zbulon shkaqet e vërteta të atyre incidenteve që ndodhin midis tij dhe së shoqes apo djemve, duke akuzuar si fajtore të vërtetë të kaluarën e hidhur e të padrejtë të shoqërisë së dikurshme feudalo-borgjeze. Nuk është pra fajtor as Ziku as djemtë e tij as e shoqja apo Ademi, por vrelli i së djeshmes që ende synon të helmojë gëzimin e ditëve të jetës së lirë.

Ziku gjen forca të dalë mbi këtë oktapod të errësirës. Ai vërtet shpërthen në ndonjë rast (kujtojmë zënken e tij me Ademin dhe ky është një shpérthim plotësisht i justifikuar), por më shpesh ai i përbuz ata që me ose pa ndërgjegje hedhin baltë në jetën e tij.

Kështu, me krejt këtë bagazh tiparesh individuale, Ziku ka arritur të jetë një tip plotësisht i realizuar shoqëror, një karakter që tipizon dhe përgjithëson një shtresë të konsiderueshme të shoqërisë sonë në ato vite.

Vëmendja krijuese e shkrimitarit është përqëndruar mjaft te kjo linjë dhe te ky personazh. Për pasojë dhe vendi që i është lënë atij në vepër është mjaft më i gjërë se i personazheve të tjera. Por kjo s'i ka zbehur ata. Autori ka arritur që, edhe pse në një hapësirë të kursyer faqesh t'i individualizojë dhe t'u japë vlera përgjithësuesë shumë karaktereve qëjeta intensive pranë njerëzve të punës ia ka servirur atij. I tillë është, mes të tjerëve, Martin Gjeta, sekretari i Partisë. Që në momentin e parë, kur ai ndërhyjn në rrahjen dhe grindjen e Zikut me Ademin, kur ne njihemë me të, edhe më parë e më pas gjatë gjithë ngjarjeve në roman, kjo figurë, ky hero pozitiv rritet dhe bëhet përherë më i afërt e më komunikues me ne. Moment kulmor, që zërthen shpirtin e sakrificës së një komunisti të vërtetë në vepër, është ngjarja retro-

spektivë e sëmundjes së Ndoit, kur Martini zhytet në ujin e akullt të përroit në janar për të lajmëruar spitalin e Kukësit. Në gjithë këtë pasazh, në raport me punëtorët, në bisedat me mësueset Mirën, Martini kudo është komunist i vërtetë me tiparet më të larta të një luftëtarë të së resë që s'u shmanget vështirësive, por u bën ballë burrërisht dhe i kalon ato sado të ndërlikuara qofshin. Ai ruan gjakftohtësinë, mishëron qetësinë shpirtërore dhe mprehtësinë mendore si rallëkush duke përgjithësuar kështu rolin e anëtarit të Partisë, udhëheqësit të masës.

Në aspekt të kundërt, por edhe ky i individualizuar, është dhënë në roman Ademi. Njeriu që, ndonëse jo armik, bëhet mbartës i ideve armiqësore, viktimi në duart e ideologjisë së helmuar patriarkalo-konservatore. Fakti që Ademi lufton e plagoset në përpjekje me bandën diversioniste të Dan Kacilit, tregon se ai e do këtë pushtet por, duke qenë njeri me dobësi karakteri, lehtësisht bëhet mbartës dhe vegël në duart e armikut të klasës. Në veprimet dhe në cilësitë fiziko-shpirtërore të tij, ai është individualizuar mjaft dhe mbetet si tip i mëvetshëm në vepër.

Të individualizuara dhe me botë shpirtërore të pasur në roman janë realizuar një sërë figurash si Maxhuni, Lemaja, Zana që mishërojnë të renë, të ardhmen, të bukurën e jetës sonë. Maxhuni spikat me dëshirën e tij për të ecur në jetë, për ta gëzuar atë, për të shkelmuar gjithçka të vjetër. Te ai lë mbresë e madje gjurmë shqetësuese dashuria, si një ndjenjë plot lirizëm dhe optimizëm. Gëzimi për jetën e gjerë që ka përpëra e bën Maxhunin të jetë kurdoherë i prirë drejt të bukurës, të ndershmes, të pastrës dhe të luftojë për triumfin e tyre. Zana me Lemonë ndonëse të ndryshme, ruajnë si të përbashkët pasionin eëmbël si forcë gjallëruese e jetësore. Shqetësimet dhe gëzimet e dashurisë së tyre janë sa të njëjta aq dhe të ndryshme, aq dhe të bukurë. Ndërsa te e para gjemë qytetaren që aty në malësitë e largëta ka gjetur lumturinë dhe kuptimin e jetës, te e dyta kemi vajzën e njomë fshatare që jeta në gjirin e klasës punëtore e zgjoi, e shkundi, u dha drejtim ndjenjave, dëshirave dhe forcave të saj, të cilat aq egër mundohej t'i shtypte zakoni i egër dhe i mbrapshtë. Të in-

dividualizuara dhe të gjalla në roman gjemë edhe figura që janë të planit të tretë por nga pesha e ngjarjeve që mbartin ose janë edhe fare episodike si Frani, Binaku e deri dhe Neziri. Kjo forcë individualizuese e romanit flet për mundësitë e mëdha të autorit në këtë lloj të prozës sonë. Në planin e individualizimit të karaktereve, mendojmë se u duhej dhënë më shumë kujdes personazheve të tilla si Mira, Gash Halili, Milloshi etj., që kanë të dalë disi të zbehta, të paindividualizuara dhe pa forcë komunikuese me lexuesin.

I vështruar në tërësinë e vet, romani mbetet i mbërthyer në konfliktin e madh real e të përherëshëm të së resë me të vjetrën. Autori nëpërmjet planeve të shumta të veprës e ka vështruar dhe pasqyruar këtë konflikt në sfera të ndryshme të jetës. Lufta që bën Ziku, zberthimi i dramës së tij familjare dhe zgjidhja e qëlluar e saj me pajtimin e plotë të Zikut me djemtë dhe gruan, është një pjesë e konfliktit të madh. Edhe pse i vështruar në plan botëkuptimor, ky konflikt ka mprehtësinë e ndeshjes së drejtpërdrejtë me armikun e padukshëm, me konceptet, ideologjinë e njohur konservatore. Shprehje e po kësaj ndeshjeje të madhe në roman është edhe lufta, përpjekja e masës së punëtorëve për të ngritur në këmbë minierën, për të rritur atë, për t'i dhënë popullit një burim të ri të mirash materiale. Lufta për socializmin, pra, në vepër është vështruar në gjithanshmërinë e saj.

Romani, me gjithë linjat e shumta, konfliktet e vogla apo të mëdha, me gjithë pasurinë e larminë e faktave jetësore, ruan një ndërtim të thjeshtë e të rrjedhshëm. Rrëfimi i ngjarjeve të planit kryesor të subjektit të veprës, është i vijueshëm ose i alternuar sipas momenteve jetësore që shpalosen para nesh apo që na rrëfehen në formë retrospektive. Këto të fundit janë përdorur në mësën e duhur nga autorit dhe ndihmojnë në sqarimin dhe saktësimin e episodeve apo të ideve. Ndoshta do të duhej një shkrirje më e plotë e planit personal të ngjarjeve që lidhen me Zikun me planin e ngjarjeve të mëdha shoqërore të kohës. Të krijohet përshtypja se pjesa e parë e romanit merret më tepër me Zikun kurse në pjesën e dytë

jeta e madhe vërshon më shumë, më vrulltas. Bukur dhe në mënyrë funksionale është përshkruar në roman natyra, vëçanërisht në hyrjet e kapitujve, ku më se një herë shkrimitari e ka treguar veten njohës të hollë dhe përshkrues të aftë të saj. Mendoj se, me gjithë dialogun e gjetur dhe të folmen individualizuese të personazheve që hasim në roman, në këtë komponent të rëndësishëm, kryesor të veprës letrare, shkrimitari duhet të tregojë më shumë kujdes sidomos në pasurimin e fjalorit qoftë në rrëfimin e tij, qoftë në zërthimin e gjendjes shpirtërore të personazheve.

Për temën e rëndësishme që trajton, për realizimin me dinjitet artistik të ideve dhe të problemeve të mëdha të kohës, për paraqitjen e botës së gjallë, optimiste dhe të fuqishme punëtore, ku shkrimitari ka materializuar idetë e veprës së tij, mendojmë se romani «Mars» është një sukces i ri i autorit.

1975.

«ERË PRANVERORE» — ROMAN PËR JETËN E FSHATIT TONË TE SOTËM

Trajtimi i temës së jetës së fshatit tonë të kolektivizuar paraqet interesa të shumëllojshme që u vënë detyra të mëdha dhe njerëzve tanë të penës, që ata sa më shumë ta drejtojnë vështrimin e tyre nga fshati i ri për të njohur dhe pasqyruar drejt e me art fenomenet e sotme tipike të zhvillimit të realitetit jetësor, për të njohur kontradiktat e zhvillimit, për të pasqyruar vërtetësisht botën e pasur shpirtërore të fshatarit, të kooperativistit të ditëve tona.

Në këtë terren tematik, krahas traditës së shëndoshë që ka krijuar letërsia jonë e re, me vepra të shumta poetike, dramatike e në prozë, kohët e fundit janë botuar edhe disa romane ndër të cilat zë vend edhe romani «Erë pranverore» i Thoma Notit.

Ky roman, duke trajtuar jetën e fshatit të sotëm, synon të pasqyrojë transformimet e mëdha jo vetëm në ekonominë e re kooperativiste, e cila e zbuluroi si asnijëherë jetën e fshatarit, por edhe në ndërgjegjen, në zakonet, në normat morale, që futi në jetën tonë thellimi dhe revolucionarizimi i mëtejshëm i ndërgjegjes së masave. Me subjektin e vet, me fabulën që ka ndërtuar shkrimtari, romani mbart idenë se e reja në jetën socialiste të fshatit triumfon përmes luftës së shumanshme me të vjetërën dhe mbartësit e saj të ndërgjegjshëm apo të pandërgjegjshëm qofshin ata. Kjo ide në roman është materializuar nëpërmjet një subjekti të thjeshtë. Temo Mushi, një ish-partizan me merita dhe më pas ushtarak i talentuar, për arsyen shën-

detësore kthehet, pas më shumë se njëzet vjetësh, në Fikas, në fshatin e tij të lindjes, që është bërë kooperativë bashkuar. Këtu krahas sukseseve, ai vëren edhe një sërë të metash që nisin me punën e dobët të kryetarit të kooperativës Koci Madhit e me radhë deri te ndjenja mikroborgjeze e pronës private të fshatarëve të thjeshtë. Këto të meta, që janë bërë objekt shqetësimi edhe për fshatarët e tjerë, vihen në qendër të luftës për progres. Temua bëhet strumbullar i kësaj lufte e cila triumfon kundër gjithçkaje që pengonte thellimin e fitores së socializmit në fshat.

Romani mbahet i mbërthyer në konfliktet e jetës, në konfliktet e realitetit tonë të sotëm. Konflikti bazë i tij është ai që ushqehet nga vetë zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese, që për natyrën e vet tentojnë drejt shpërthimit përpara, drejt zhvillimit të vrullshëm, dhe nga ana tjetër, mënyrës së vjetër të organizimit, mënyrës burokratike e teknokratike të drejtimit që bëhet pengesë, faktor dëmtues e frenues për ecjen përpara. Kjo mospërputhje e ndonjë rasti të veçantë, që lidhet me qëndrime burokratike e formaliste subjektive të ndonjë drejtuesi të veçuar, duke qenë epigendër e shtjellës së ngjarjeve në roman, procedon gradualisht drejt zgjidhjes së logjikshme e realiste të fitores së progresit mbi regresin, mbi konservatorizmin burokratik.

Interes ngjall romani lidhur me sa më sipër për faktin se konfliktin e mbart me disa nga njerëzit tanë, që s'kanë asnjë kundërvënie ndaj sistemit, ndaj fitoreve të revolucionit, por që duke u molepsur në ndërgjegjen e tyre me ndjenjën e vetëkënaqësisë, të mendjemadhësisë, të dëshirës për pushtet, degradohen dhe bëhen mbartës të pandërgjegjshëm por të rrezikshëm të ideologjisë dhe të moralit të huaj mytës për zhvillimin tonë revolucionar.

Koci Madhi i romanit të Thoma Notit, është përfaqësues tipik i fenomenit që analizuam. I munduar nga ndjenja e vetëkënaqësisë, i paaftë që të drejtojë zhvillimin e madh e të hovshëm të kooperativës së zmadhuar, ai me stilin e tij të punës, me formalizmin, mendjemadhësinë, egoizmin e tij, pa e kuptuar jo vetëm pengon zhvillimin por

edhe e dëmton atë. Kocin, që e ndien se po i rrëshqet toka nën këmbë, e kap paniku e ç'është e natyrshme në kësi rastesh, ndjenja e frikës për pozitën. Nga ky moment shkataërimi i tij merr vrull të pandalshëm, madje ai vetë e nxit pa dashur si në episodin e mbledhjes së misrit, që rrëzikonë të kalbej në arë, në grindjen e pabazë me Temo Mushin në mbledhjen e asamblesë e në shumë momente të tjera, ku përherë ne vërejmë rrëzimin e pashmangshëm të Kocit. Edhe më thellë nënëviziohet degradimi i kësaj figure në fundin e logjikshëm ku arrin Koci nën ndikimin e njërrëzve të huaj për realitetin tonë moral e shoqëror, nën ndikimin e Pashos, dhe të Shametit, të këtyre mbeturinave të klasave dhe të moralit të përbysur nga revolucioni ynë popullor. Karakteristikë e këtij aspekti regresiv të realitetit shoqëror në konfliktin e romanit është se, sado i egër e i papërbajtur, ai përfaqësohet, ashtu si në jetën tonë, nga pakica shoqërore, që s'kanë e s'mund të kenë asnje mundësi force rezistuese kundrejt qëndrimit revolucionar, progresiv të masës së gjerë të popullit.

Antipodi i këtij qëndrimi në roman janë masa e gjerrë e kooperativistëve dhe sidomos rinia. Ndryshe nga sa mendojnë Koci me Pashon dhe Shametin, ata nuk po i lufton, nuk po i përbys Temua, nuk po i përbys ftohja e qëndrimit të Tarës apo Tomorit, por po i përbys vetë jetë me tendencën e saj për të ecur përpara, vetë populli e bijtë e thjeshtë të tij, rinia kooperativiste, që s'pajtohen me njerëz të kallëpit të Kocit, Pashos dhe Shametit.

Është meritë e romanit që në paraqitjen e këtij krahu të përfaqësimit të konfliktit kryesor, ai ka mundur t'i shpëtojë me sukses skematizimit duke na i dhënë qëndrimet dhe veprimet e tyre krejtësisht të natyrshme, plot jetë e vërtetësi. Në një radhë skenash në kanalin ujës, në episodin e mbartjes së misrit nga fusha, në mbledhjen e asamblesë dhe në një mori mikroepisodesh ku Koci takon, shkëmben fjalë, nervozohet dhe tërbohet si në bisedën me Rinën, në replikat plot ironi e sarkazëm që i drejtojnë Çemja, Gramozi, Ramoja, etj., gjithçka rrjedh natyrshëm, emocionalisht dhe me efekt dramatik. Sigurisht kjo natyrshmëri ka ndikuar në forcën komunikuese të veprës, në

atë që romani, ngjarjet e tij, nuk kalojnë lehtas dhe jashtë emocioneve të lexuesit, por përkundrazi, e shqetësojnë, e trondisin e ngazellejnë etj. Në fitoren e së resë, në këtë konflikt të madh të veprës, ka deciduar si element kryesor i jetës sonë, përkrahja e Partisë. Fryma e Partisë, vija e saj, udhëheqja e saj e urtë, e materializuar ajo në rolin e organizatës-bazë të kooperativës apo në përfaqësuesit e instancave më të larta të Partisë, të trupëzuara me figurën e Tomorit etj., janë garancia e forcës, guximit, shpirtit heroik që zoteron te masa e kooperativistëve të thjeshtë, që s'e kanë për pesë t'ia përplasin në sy vërejtjet dhe kritikat e tyre edhe një njeriu prepotent e mospërfillës ndaj zërit të masës sic është Koci, të cilit ata, njerëzit e thjeshtë, i zbulojnë krejt dobësitë, intrigat, marifetet prej ambiciozi të veshur me pushtet.

Artistikisht këto elemente jetësore janë realizuar mirë në vepër. Në monologët e heshtur të Kocit, në bisedat e tij me «miqtë» e vet si Pashoja, Shameti etj., shkrimtari ka mundur të veshë me stof artistik ngarkesën ideore që synon të realizojë në vepër. Ky efekt artistik vjen e rritet nga përplasja e mëpasme e planeve të errëta prej ambiciozi të Kocit me opinionin e shëndetshëm revolucionar të masës së udhëhequr nga Partia.

Zgjidhja e konfliktit është reale në kushtet e realitetit tonë jetësor socialist, ku tipa të tillë si Koci nuk gjejë terren të zhvillohen. Populli në fuqi, diktatura e tij proletare me format e veta të shumta, nuk mund të pajtohet, nuk mund të falë. Por Koci nuk flaket tej, si kthehet pranë njerëzve, pranë punës prodhuase që aty ai të njojë më mirë gabimet, e fajet e veta, aty ai të rilindë si njeri i pastër, i denjë për shoqërinë tonë socialiste. Koci si konceptim artistik na përqaset me figurën e njojur të Kiu Koroziut te romani «Juga e bardhë» i Jakov Xoxës. Por edhe pse jo në atë bagazh e kolorit tej masës të pasur, sic na është dhënë Kiu, Koci i Th. Notit ruan individualitetin e vet plotësisht të dallueshëm. Ky personazh na bind edhe një herë se vetëm me njojhen e plotë të jetës, me zhytjen në të, në konfliktet e saj, mund të arrihet që të pashurohet galeria e heronjve të veprave tona edhe në ato ra-

ste kur kemi të bëjmë me tipa që i kanë lindur rrrethana të njëjtë ekonomiko-shoqërore, por situata të ndryshme jetësore. Pa këtë njohje, pa këtë individualizim, kishite shumë mundësi që Koci të degjeneronte në një hije të zbehtë të Kiut.

Krahas konfliktit të madh kryesor të romanit, shohim të shtjellohet edhe një kónflikt i dytë me më pak shtrirje shoqërore, por mjaft i mprehtë e i dukshëm edhe në vetë jetën tonë, në sferën etiko-morale të saj. Linja e dashurisë së Rinës me Drinin, ku gërshetohet edhe drama e xha Meros, babait të Rinës, është shprehje jetësore dhe një-kohësish artistike e konfliktit të dytë në vepër, që zgjidhet paralelisht dhe ndonjëherë i gërshetuar me të parin.

Ka interes në këtë linjë jo vetëm qëndrimi i drejtë, i partishëm i autorit por në mënyrë të veçantë ka interes zbërthimi në këtë linjë i një figure nga më të realizuarat e romanit, siç është xha Meroja. Te ky tip autorit ka dhënë të derdhur mjeshtërisht fshatarin tonë punëdashës, që e do me shpirt tokën, që është i lidhur ngushtë me të, por që për hir të natyrës së dyfishtë të tij, të natyrës së pronarit, ka lëkundjet e veta, plotësisht të vërteta dhe të evidencuara artistikisht, për t'u bashkuar me të renë, me jetën kolektive, për t'u shkëputur plotësisht nga ndjenja e pronës. Janë të bukura në roman ato momente kur pëershkruehet dashuria e Mero Saliut për punën, për tokën, për bimët që janë gëzimi i jetës së tij. Vetëm drama familjare, revolta e Rinës që s'do të martohet me burrin që i ka zgjedhur Meroja në qytet dhe që rrëmbehet me Drinin, e largon përkohësish xha Meron nga pasioni i tij i madh për t'u ribashkuar pastaj pa rezerva me punën dhe pronën e përbashkët në kooperativë.

Në roman të bie në sy përpjekja e ndërgjegjshme dhe jo pa sukses e autorit për të krijuar një figurë të realizuar me Temo Mushin, që është heroi pozitiv i veprës. Edhe pse nuk e ndeshim në çdo kapitull të romanit, Temoja është i pranishëm me qëndrimin, urtësinë, thjeshtësinë dhe dashurinë e tij për njerëzit, për punën, për bagëtinë dhe për lulëzimin e kooperativës. Ai në shumë momente të veprës është i realizuar, por do të fitonte edhe më shumë si

figurë sikur të zhvishej deri në fund nga deklarativizmi, nga i cili vuan në një farë mase e tërë vepra, veçanërisht fillimi i saj mjافت i thatë e fragmentar, disi i mbingarkuar me digresione e të vendosura jo si duhet.

Në realizimin e karaktereve të tjera të fshatarëve të thjeshtë autor i ka pasur dorë të mbarë. Pavarësisht nga vendi që zenë në vepër, ato janë të individualizuar dhe mbeten të gjallë në përfytyrimin e lexuesit. Të tillë janë Drini me shpirtin e tij të sakrificës e me dashurinë e madhe për punën e njerëzit, Rina me notat tepër lirike e të freskëta të karakterit të saj, Gramozi me nervozizëm dhe temperamentin e rrëmbyer por me shpirt të pastër, Ramo Bardhi dhe Çeme Çobani etj., etj. Ndërsa me Pashon apo «Juridikun» shkrimtari ka stigmatizuar tipin e njeriut parazit, dembel, të njeriut që në mënyra të ndryshme tenton, për hir të interesit të ngushtë egoist, të verë shkopinj në rrota për të penguar, për të dëmtuar, por që, duke mos gjetur përkrahje, mbetet i vetmuar e i zhgënjiyer në synimet e dëshirat e tij.

Mendoj se shkrimtarit i mbetet ende për të bërë në përvetësimin e mjeshtërisë së romancierit, në zotërimin më të shkathët të ndërtimit arkitektonik të veprës. Fakti që konflikti themelor lidhur me Kocin zbërthehet shumë më parë se të përfundojë vepra, na duket se e ka dobësuar atë, dhe sado interes të paraqesë konflikti i dytë i xha Meros me të bijën, Rinën, prapë vepra s'e ka forcën dhe interesin që kishte sa kohë që autor i merret me konfliktin e madh të jetës, të realitetit. Një gërshtim më i mirë i të dy konflikteve, një ndërtim më i studjuar kompozicional, pa dyshim do t'ia kishte rritur më shumë vlerën veprës.

Edhe pse me këto mungesa, që sigurisht janë të përkohshme dhe fenomene të rritjes së vlerave krijuar të shkrimtarit, theksojmë se autor i nga vëllimi i tij i parë me tregime dhe deri te ky roman, ka shënuar një ecje të ndjeshme, e cila na garanton për sukseset e ardhme të tij edhe në gjininë e romanit.

ROMAN PËR JETËN E FAMILJES SONË TË RE

Nëse do të numëronim meritat e romanit tonë të sotëm, pa dyshim njëra, ndër më kryesoret prej tyre është gama e madhe e tematikës së tij. Pra fakti që romani ynë ka trajtuar një varg problemesh kardinale e me peshë në zhvillimin shoqëror të etapave të ndryshme historike, ka përcaktuar vlerat e tij, duke e vendosur atë si gjini në ballë të zhvillimit letrar, në mënyrë të veçantë pas Plenumin të 4-t të KQ të PPSH.

Krahas tematikës me vlerë dhe problematikë të rënë-dësishme shoqërore, që ndeshim në romane të shumta ku flitet për realitetin e sotëm shoqëror apo për të kaluarën historike të popullit, ndonëse më rrallë, hasim të trajtohet edhe problemi i familjes, i marrëdhënieve dhe raporteve të reja mbi të cilat duhet të ndërtohet ajo, e sidomos lufta me recidivët e atij patriarkalizmi që ndeshet ende sot në një pjesë të familjeve tona.

Letërsia jonë në tërësi dhe romani ynë në veçanti në një formë ose në tjetrën, herë më shumë e herë më pak, është marrë me këtë sferë të jetës. Në traditën tonë letorraine mund të përmendim romanin shumë të njojur të Haki Stërmillit «Sikur të isha djalë», si vepër që tërësisht është ngritur mbi problemin e emancipimit të gruas në familjen shqiptare të kohës së errët të sundimit zogolian. Kurse në traditën tonë të re janë të shumta romanet që merrin edhe me paraqitjen e luftës në gjirin e familjes për emancipimin e saj në dobi të shoqërisë e të revolucionarizmit të jetës së re. Këtu kemi parasysh ato vepra të kësaj gjinie, që kryesisht u kushtohen problemeve të mëdha

shoqërore, por që krahas kësaj, në mënyrë të tèrthortë, janë marrë edhe me paraqitjen e familjes, të marrëdhënieve në gjirin e saj.

Nëse kjo temë që ka shumë aspekte, është trajtuar në disa romane të viteve të fundit, te romanit «Rruja Budi 723», e veçanta, e reja dhe njëra nga meritat kryesore, është se kjo vepër është ndër të paktat që ve objektivin e vet në anën më thelbësore të fenomenit, duke e vështruar me partishmëri dhe drejt funksionin e familjes në shoqëri, rolin progresiv të saj kur bashkohet e militon në një front me mbarë forcat përparimtare të shoqërisë sonë socialiste. Kështu, ky roman i Ruzhdi Pulahës, merr në epiqendër të vështrimit të vet një familje të sotme me gjëzimet e shqetësimet e saj, dhe arrin të pasqyrojë, duke u thelluar në probleme të ndryshme, të përditshme të jetës së kësaj familjeje, ndër më të zakonshmet e familjeve tonë të sotme, përpjekjen për të ecur përpara, për të thyer të vjetrën, patriarchalen, për të dënuar të huajën, pseudomodernen në emër të idealeve të mëdha, të progresit të përgjithshëm shoqëror, pjesëtare e të cilit është çdo familje e sotme e jona.

Meritë tjetër dhe njëkohësisht vëgori e romanit është edhe se ai zhvillohet i téri mbi një varg kontradiktash joantagoniste në mes pjesëtarëve të familjes, të cilat shpesh bëhen shkak për kundërvénie konceptesh e qëndrimesh, që e rrisin dramacitetin gjatë shtjellimit të subjektit të veprës. Shpesh në vepër bëhet shkak shqetësimesh aspekti etiko-moral i marrëdhënieve shoqërore ku pjesëtarët e ndryshëm prononcohen me nuanca të ndryshme të qëndrimit të tyre. Vecanërisht për pozitën dhe rolin e fëmës në familje e në shoqëri, për të drejtat dhe dëshirat e saj, për qëndrimin e saj etiko-moral, kundërvénia është më e mprehtë. Ndryshe nga ndonjë vepër tjetër, te ky roman, dhe kjo është një vëgori e meritë tjetër e autorit, luf-tën për progres nuk e marrin mbi vete dhe nuk e përfaqësojnë kryesisht burrat por përkundrazi vetë gratë, që gjajnë forca e mundësi të plota të mbrojnë dinjitetin dhe të drejtat e tyre të ligjshme e të njohura në shoqërinë to-në të re.

Në përgjithësimin artistik të realitetit, në tipizimin e fenomeneve apo të karaktereve, romani që po studjojmë, i ka mbajtur kurdoherë drejt parasysh faktet dhe interpretimin ideoartistik të jetës që ka pasqyruar. Kjo ka rrjetdhur jo vetëm për shkak të pozicionit të shëndoshë ideoartistik të shkrimitarit por edhe për faktin tjetër shumë të rëndësishëm, që në traditën tonë të re, në traditën e letërsisë sonë të realizmit socialist, ky problem është trajtuar në forma dhe masa të ndryshme. Kështu, që në krijimet e para të shkrimitarëve tanë në gjininë e gjatë të prozës, ku më shumë dhe ku më pak ka zënë vend lufta e shoqërisë sonë për krijimin e familjes së re, të ngritur mbi normat e moralit socialist. Edhe në letërsi, ashtu sikurse në jetë kjo nuk u arrit e pasqyruar lehtësisht, por përmes luftës me forcat frenuese, patriarkalo-konservatore nga njëra anë, dhe ndikimet e huaja liberalo-borgjeze nga ana tjetër. Ndër romanet e parë që kanë trajtuar problemin e formimit e të konsolidimit të familjes socialiste është romani «Kéneta» i F. Gjatës në mënyrë të veçantë në linjën e tij Stavri, Rina, Aleksi. Kurse më vonë kjo temë u shtrirë një numër më të madh romanesh, ndër ta: «Vlaga e dheut» i F. Ndocajt, «Komisari Memo», i D. Agollit, «Zjarrret» i S. Spasses, «Kullat» i Gj. Zhejit, «Një lindje e vështrimë» i E. Kadaresë etj. Problemi, në romanet e sipërpërmendur, u vështrua kryesisht në terrenin e familjes fshatare ku patriarkalizmi zakonor i trashëguar qe më i fuqishëm dhe sidomos shfaqjet e tij qenë më të mprehta. Në këto vitet e fundit romanet e shumë prozatorëve, ndër ta edhe të rinj, këtë tematikë e vunë më në plan të parë dhe erdhën duke e pasuruar me aspekte të shumta të femonit, duke e trajtuar më me siguri dhe nivel të ngritur artistik. Të tilla janë romanet: «Mars» dhe «Dy të shtunat e Suzanës» të V. Koreshit, «Tokë e ashpër» i T. Laços, «Rusha» i Gj. Zhejit, «Dueli i madh» i A. Abdihoxhës etj.

Romani «Rruga Budi 723» duke përvijuar, thelluar dhe zgjeruar më tej atë që përvoja e deriatëhershme letrare kishte grumbulluar për romanin e kësaj teme, e ka shtrirë këndvështrimin e vet dhe është përpjekur të zbërthejë sa më shumë aspekte të sferës etiko-morale që për-

bëjnë anët e mprehta e delikate, ato anë ku përplasja e koncepteve, lufta e së resë me të vjetrën, triumfi i së resë arrihet me përpjekje, pra përmes konflikteve, ndonjëherë serioze e të vështira për t'u zgjidhur, përmes dramash të atilla shpirtërore që për t'u kaluar kërkojnë impenjim jo vetëm individual të personazheve që i provojnë ato, por edhe një angazhim serioz të forcave të tjera shoqërore. Këto forca në jetën tonë, në moralin tonë të ri proletar, janë kurdoherë të pranishme dhe të interesuara në zgjidhjen e drejtë, revolucionare të çdo konflikti e drame sado personale qoftë, në dobi të zhvillimit tërësor progresiv të shoqërisë, pra edhe të familjes e të individit si pjesë përbërëse të shoqërisë.

Në qendër të veprës së R. Pulahës është vendosur një familje e ditëve tona. Në faqet e romanit ajo jeton me shqetësimet dhe gjëzimet e kohës, me marrëdhëni e raportet e ndryshme ndërmjet pjesëtarëve të saj, me luftë konceptesh mes mbartësve të tyre, me ndikimet e fuqishme sociale të kohës sonë, me morinë e problemeve të vogla e të mëdha që jeta u vë përpara pjesëtarëve të kësaj familjeje sikurse gjithë shoqërisë.

Vangjeli me djemtë dhe vajzat e tij, ndonëse i ndajnë dekada të tëra vitesh, (si çdo baba me fëmijët e tij) mbajnë të njëjtin qëndrim, janë njësoj të interesuar për problemet e mëdha shoqërore, madje në ndonjë rast, te Vangjeli i moshuar gjemjë qëndrime më revolucionare, se sa p.sh. te djali i tij i madh Spiroja (kujtojmë skenat ku bisedohet për strehimin mbrojtës që do të ndërtohet në lagje apo për punën vullnetare në ndërtimin e banesave). Ky qëndrim pro së resë i Vangjelit theksohet ca më tepër edhe përfaktin që ai bashkohet me detyrat shoqërore pa përfillur ndjenjën e pronës private apo shqetësimet e tij familjare. Pra ai di dhe mundet të orientohet drejt në jetë në çdo moment në një radhë me famijët e tij që tashmë janë të gjithë në moshë madhore. Edhe pse kjo harmoni është dhënë realisht në vepër, shkrimitari me zotësi ka zbuluar se mes pjesëtarëve të familjes ka ndryshime konceptesh, se ata, si individë të ndryshëm, me personalitetin dhe individualitetin e tyre të theksuar, mbartin koncepte,

kanë qëndrime të diferencuara, por këto jo mbi bazën e brezave ose të moshave, por në përputhje me shkallën e formimit të tyre botëkuptimor dhe të individualitetit të tyre si karaktere. Vangjeli është njeri i ndershëm, punëtor, i kujdeshëm për fëmijët, në përgjithësi parimor në veprimet e tij si brenda dhe jashtë shtëpisë. Por edhe pse i tillë, Vangjeli nuk ka mundur të shkëputet nga shfaqje të mentalitetit shoqëror të kohës së rinisë së vet (të superruara tashmë ngajeta jonë). Ai e ka të zhvilluar në njëfarë mase të tepëruar ndjenjën e mirëqenies mikroborgjeze familjare. Kësaj ai i ka kushtuar pothuaj krejt përpjekjet e jetës së tij. Dy detaje që shkrimitari ka vendosur qysh në faqet e para të romanit, të bindin për këtë: Shtëpia e vogël private e Vangjelit mes pallateve, që sikur po i marrin frymën (është e kuptueshme simbolika) dhe kënaqësia e tij, që sikur i shpërthen nga çdo qelizë e trupit, kur djemtë vendosin antenën e televizorit, që për të përfaqëson kulmin e mundit të gjatë dhe qëllimin final të përpjekjeve të tij. Ndjaja egoiste mikroborgjeze e rehatisë personale, e zakoneve prej nëpunësi me karrierë të gjatë, që është mësuar që çdo gjë t'i shkojë mbroth, është bërë një natyrë e dytë e këtij njeriu dhe është shtrirë deri në dëshirën që të ketë të drejtë të komandojë deri edhe jetën personale të secilit prej fëmijëve të tij, sidomos të vajzave, në emër të moralit, të nderit, sepse edhe në këtë sferë jete Vangjeli ruan me xhelozipikëpamjet e tij dhe madje lufton që t'i shkojnë ato. Ky pozicion etiko-moral prej kryefamiljari dhe babai që kujton se kurdoherë ka të drejtë, bëhet objekt i ndeshjes së vazhdueshme në roman midis Vangjelit dhe fëmijëve, sidomos më të vegjelëve Edit dhe Emës, që dalngadalë e zhvendosin Vangjelin nga konceptet e gabuara, nga qëndrimet e padrejta dhe e bindin atë se jeta ka vërvshuar shumë më tej nga ç'ka ecur ai, prandaj duhet që ai jo vetëm të mos i pengojë, por t'i ndjekë ata duke u qëndruar pranë, duke i mësuar, por edhe duke mësuar prej tyre.

Në këtë plan problemor të veprës, figura më e qëlluar është pa dyshim Vangjeli. Autori te ky personazh ka trupëzuar tipare morale e shpirtërore që harmonizohen

plotësishët dhe përligjin vetë karakterin e personazhit. Edhe pse i mbetur pas nga koha, Vangjelin e duan fëmijët, e kuptojnë drejt për shqetësimet e tij dhe njëheri atyre u vjen keq që ai s'i kuption ata plotësishët. Për asnje çast në roman ne s'gjejmë antagonizmin, përkundrazi fëmijët bëjnë qështë e mundur për ta tërhequr pas vetes babanë e tyre. Nga ana tjetër, Vangjeli nuk gjen përkrahje jo vetëm në problemin e lirisë që duhet të kenë fëmijët për të zgjedhur vetë shokun e tyre, por mospërputhje ka ai me fëmijët (përveç Spiros) edhe në dëshirën mikroborgjezë për të krijuar mirëqenien e ngushtë egoiste familjare. Të gjitha këto mospërputhje reflektohen në ndeshjen e tij me fëmijët që tashmë në moshë madhore janë në gjendje të gjykojnë veprimet e prindërve të tyre dhe të ndikojnë mbi ta.

Nëse Vangjeli është i realizuar në tërësi si figurë, (themët në tërësi se ka ndonjë rast kur tërheqja e tij nga pozitat konservatore, veçanërisht në qëndrimin kritik që mban ndaj Spiros, nuk është aq e motivuar apo thyhet në pikëpamje të koherencës së karakterit) Agathia, e shoqja, ka mbetur shumë më e zbehtë, më jashtë funksioneve që duhej të kishte si nënë. Në konfliktet familjare, ajo ka vetëm funksionin e zjarrshuarses, siç i thonë shpesh edhe vetë fëmijët. Në tërësi ajo mbetet si një hije që vërtitet mes të shoqit dhe fëmijëve pa personalitetin e saj, si një grua më tepër e papërfillur. Këtë e vërteton edhe qëndrimi mëshirues i vajzave apo qëndrimi arrogant i Spiros. Ngarkesa ideoemocionale që mbart Agathia në roman mendoj se nuk është ajo më e gjetura, më tipizuesja për një nënë të ditëve tona, një nënë që ka përrreth fëmijë aq të lidhur me jetën, me ritmet e zhvillimit dhe të ecjes sonë përpara. Për kohën dhe ngjarjet që shtjellohen në roman, Agathia duhej të qe më tepër se një «alter ego» e burrit të saj.

Gjithnjë brenda kuadrit të brendisë ideore dhe problemeve që ngre vepra, të bie në sy angazhimi i saj në aspektin delikat e të rëndësishëm të trajtimit të normave morale në marrëdhëniet midis të rinjve. Një nga shkaqet e konfliktit ndërmjet Vangjelit dhe fëmijëve, që bëhet

edhe shkak i ndarjes në dy pozicione të pjesëtarëve të familjes, është dashuria midis Florës dhe Bujarit, apo më saktë, qëndrimi etiko-moral i vajzës në rrugëzgjidhjen e së ardhmes së saj. Kështu rreth këtij problemi shpërthejnë e zbulohen qëndrimet e kundërtat e karakterit të shumë prej personazheve. Vangjeli, e sidomos Spiroja, i kundërvihen dashurisë së Florës; Spiroja madje hidhet në pozita edhe më konservatore se i jati. Ai përpinqet ta zgjidhë dramën e së motrës duke e martuar kundër dëshirës së saj me Fisnikun, shokun e tij. Nga këto pozita është nisur ai edhe në krijimin e familjes së vet, kur ka zgjedhur përgrua Almën, vajzë shumë më e re se ai dhe pa personalitet. Spiroja zbulohet edhe më thellë kur autorit hap faqen tjetër të karakterit të tij si njeri i pamoralshëm, me qëllime tepër egoiste, shumë i sipërfaqshëm në jetë, pa asnjë impenjim serioz ndaj familjes e shoqërisë. Këto tipare që zbërthehen gradualisht në shumë episode të romanit janë plotësisht të motivuara dhe pohojnë mendimin e drejtë se konservatorizmi nuk është tipar që ekskluzivisht u takon vetëm të moshuarve. Personazhi mbetet tepër koherent brenda natyrës së tij dhe s'ka asgjë të pajustifikuar te ai deri në fund të veprës, ku sidoqoftë pohohet mendimi që ky tip s'ka të ardhme në shoqërinë tonë dhe do ose s'do, ai do të ecë në rrugën tonë të përbashkët, rrugë tjetër s'ka.

Të kundërt me Spiron, po për këtë problem kryesor në roman, autori ka vizatuar me shumë dashuri dhe në mënyrë të realizuar Emën, vajzën e vogël të Vangjelit. E gjallë, plot temperament, e zgjuar, me logjikë të mprehtë dhe elokuencë të pasur, plot humor e shkathësi, e gëzueshme në jetë por edhe me sensin e seriozitetit për probleme e momente të rëndësishme të jetës, Ema shquan mbi gjithë pjesëtarët e familjes së saj. Ajo revoltohet me mefshtësinë e Florës, lufton ta bindë të atin, dënon Spiron etj., sepse është e ndërgjegjshme për luftën që duhet të bëjë për të renë. Bota e saj shpirtërore është shumë e pasur, rrethi i interesave të saj në jetë është shumë i gjerë, kurajua dhe forca polemizuese e saj është si te pak nga figurat e grave me personalitet që ka krijuar proza jonë.

Në veprimet dhe qëndrimet e saj s'ka asgjë të tepërt, banale e skematike. Edhe talenti i saj letrar tingëllon i besueshëm dhe i natyrshëm. Duke qenë e krijuar kështu, mendoj se Ema është njëra ndër heroinat pozitive të realizuara të romanit tonë. Në ndryshim me të është vizatuar Alma, kukulla e bukur por vetëm kukull, që Ema mundohet dhe arrin ta shkundë nga plogështia dhe jeta boshe, ku Spiroja kishte dëshirë ta mbante përjetësisht se donte të krijonte me të shoqen vetëm një grua shtëpie, një skllave të bindur dhe të urtë pa fije personaliteti. Ndërsa Flora, që pa dyshim ka dramën më të fortë shpirtërore ndër pjesëtarët e tjerë të familjes, është brenda tipit të saj e përligjur dhe e pranueshme. Jo vetëm si karakter por edhe për fatkeqësinë e dikurshme që ka pësuar nga dashuria me Gimin, të cilën e mësojmë si retrospektivë të ngjarjeve, ajo merr shpjegim për plogështinë, natyrën e mbyllur, lëkundjet e herëpashershme qoftë kundrejt prindërve. qoftë në raport me Fisnikun apo edhe me të motrën dhe të kushërirën, Teftën. Me gjithë lëkundjet, Flora gjen forca të pohojë atë që ndien e mendon, por këtë ajo e bën pas shumë hezitimësh. Asaj i duhet një kohë e gjatë për një veprim që Ema p.sh. mund ta kryente shumë më shpejt dhe më lehtë. Po kështu është i vërtetë dhe bindës momenti kur Flora së fundi gjen forca të pohojë dashurinë e saj duke triumfuar kështu mbi konceptet, paragjykitmet, që si vargonj tentojnë të gozhdojnë fitoren e moralit tonë të pastër proletar.

Masën e problemeve dhe ngarkesën ideore romani e ka dhënë artistikisht përmes një ndërtimi original dhe të gjetur. Alternimi i monologëve të heshtur me dialogun e mprehtë e plot ngarkesë janë harmonizuar në shërbim të derdhjes së përbajtjes jetësore. Është fakt shumë pozitiv që shqetësimet familjare në roman janë realizuar nëpërmjet debateve e diskutimeve të vazhdueshme. Shqetësimi për Florën bëhet i përbashkët. Në të marrin pjesë të gjithë. Secili nga anëtarët e familjes ndeshet hapur me qëndrimin e kundërt dhe në këtë përplasje të kundërtash zbulohet gradualisht qëndrimi i drejtë, parimor e i partishëm, që bëhet i përbashkët për të gjithë pjesëtarët e familjes.

E gjithë kjo s'vjen si një fund i lumtur, i gjetur artificialisht nga autori, por si procedim normal i domosdoshëm i vetë realitetit tonë jetësor që vërvhon tejendanë veprës. Pikërisht kjo frymë e shëndoshë e kohës është baza e suksesit dhe e vlerës pozitive të romanit. Shkrimtari e ka pasur mirë parasysh këtë karakteristikë të fizionomisë së familjes sonë të sotme, ndaj dhe ka mundur ta pasqyrojë drejt realitetin jetësor në vepër.

Megjithëse merret me jetën dhe ngjarjet në gjirin e një familjeje «Ruga Budi 723» s'ka mbetur roman i një jete të vogël, i një mikrojete. Autori ka vepruar drejt që qysh në fillim të veprës na ka dhënë të kuptojmë se ai vetë e dënon vetëkënaqësinë e ngushtë të Vangjelit, mikrobotën e tij. Madje edhe personazhet pozitive të veprës, sikurse krejt tensioni emocional i ngjarjeve na shtyjnë edhe ne si lexues kundër gjithçkaje konservatore, patriarkale dhe mikroborgjeze. Ky qëndrim dhe këto ndjenja janë përfthuar përpos tij prej kundërvënies së personazheve, edhe nëpërmjet gërshtimit të herëpashershëm të ngjarjeve shoqërore me vorbullën e ngjarjeve të përditshme të familjes. Duke dalë nga guaska e ngushtë e shtëpisë së vogël të Vangjelit, shkrimtari ka pohuar artistikisht fakin që jeta jonë shoqërore me shqetësimet e preokupacionet e saj të mdha, me gjëzimet e sukseset doemos vë vulën në jetën e çdo familjeje, ndihet çdo çast edhe brenda mureve të shtëpisë së Vangjelit. Kështu jeta intensive e Emës në punë e jashtë pune, qëndrimi i ngrohtë i kolegëve të Florës në shkollë, kritika plot takt që sekretari i organizatës-bazë të Partisë i bën Vangjelit për incidentin me Bujarin, jeta e mbushur me aktivitete shoqërore në lagje etj., ndikojnë në qëndrimin e personazheve, reflektohen tek ata, shpejtojnë diferençimin e tyre dhe kjo duket më mirë se kudo në zbulimin e plotë të figurës së Spiros që mishëron anët më negative ndër pjesëtarët e tjerë të familjes.

Romani është ndërtuar e ngritur mbi një varg konfliktesh me zgjidhjen e të cilave shpaloset edhe subjekti i tij. Ato vijnë natyrshëm dhe në përgjithësi plotësojnë mirë idetë që mbart e përqon vepra. Mbështetur në to janë të

përligjura linjat e ndryshme të subjektit, shtrirja e të cilave çon në zgjidhjen e konflikteve. Por midis këtyre linjave kam mendimin se ajo më e zbehta, që qëndron disi më jashtë problemeve që shtron romani dhe që nuk kryen ndonjë funksion të veçantë, është ajo e Teftës dhe e marrëdhënieve Tefta-Landi-Vangjel. Çdo gjë që është e lidhur me këtë linjë është e njohur qysh më parë. Ajo s'i shton asgjë as karakterit të Vangjelit apo të ndonjë personazhi tjetër dhe as zbulon ndonjë aspekt të ri të vajzave dhe të grave tona që si tipa, janë të ezauruara me Emën, Florën, Almën dhe Agathinë. Nuk mund të themi aspak të njëjtën gjë edhe për linjën e Edit, për faktin që Edi është i realizuar mjaft mirë si tip, ai është shumë funksional në raport me shqetësimet e familjes, është forcë reale dhe me peshë në zhvillimin e ngjarjeve në roman, ndonëse i dhënë si lehtësish e me një pozicion të veçantë në krahasim me të tjerët. Por figura që lidhet me të, Vera, mbetet e jashtme, ornamentale për trungun kryesor të ngjarjeve. Këtu s'është fjala për vendin që ze në faqet e romanit kjo figurë, se po kaq vend ze edhe Alma që është shumë funksionale dhe ka vendin e vet në vepër, por për mungesë përligjeje sa duhet të pranisë së saj. Madje kjo linjë dashurie e dy të rinxve sikur e tepéron tendencën që duket në njëfarë mase në vepër për t'u veshur pothuaj të gjithë personazheve romane të vegjël dashurish të thëna hapur apo të nënkuptuara, siç është rasti i Emës dhe i marrëdhënieve të saj të pazbuluara plotësisht me Bashkimin. Mund të mos i ishte mëshuar kaq shumë këtij aspekti që të lë përshtypjen sikur është element zotërues në vepër, që në të vërtetë ka në pikësynim të vet probleme shumë më të rëndësishme të kohës.

Romanin e përshkon një stil i këndshëm, plot nerv, gjallëri e humor. Gjuha e tij është e pasur dhe individualizuese, ndërsa dialogu plot mendim dhe nëntekst. Këto vlera dhe në radhë të parë, pasuria ideore e veprës janë pasqyrim tregues i rritjes së pjekurisë së talentit të këtij autori.

1976.

PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË NOVELES SË VITEVE TË FUNDIT

Kur gjykojmë për zhvillimin e letërsisë së sotme, për larminë tematike dhe gjinore të saj, që nga format më të vogla dhe deri te ato më të mëdhatë, në mënyrë të domos-doshme do të ndalemi edhe në arritjet e prozës sonë, e cila, në këto vitet e fundit, pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH, mori një impuls të ri, fitoi horizonte të reja në pas-qyrimin më me art të proceseve të shumëllojta jetësore të realitetit tonë. Është dhe më pozitiv fakti që në krejt prozën e sotme dhe jo vetëm në llojin e romanit (që si-kurse u pohua edhe një herë në konkursin letrar për ndër të tridhjetë vjetorit të çlirimt të atdheut me numrin e madh të romaneve të paraqitura për konkurim, ka zënë kryet e vendit), por edhe në llojet e tjera të prozës si tregimi apo novela, kjo e fundit më pak e lëvruar, të bie në sy trajtimi relativisht i ngritur artistikisht, i pastër ideo-logjikisht dhe i pasur me vërtetësi jetësore, i realitetit të sotëm apo të djeshëm, trajtimi i partishëm dhe emocional i jetës, i problemeve të mëdha historike dhe shoqërore, orientimi i drejtë i shkrimtarëve tanë në transplantimin artistik të jetësores.

Edhe duke ndjekur, për të pasur si objektion të shkrimt tonë, disa nga novelat e botuara në shtypin letrar, gjatë këtyre dy viteve të fundit, konstatohet lehtësisht se kjo gjini është në rrugën e drejtë të suksesit. Sado që ky konstatim ka në vetvete shkallëzimin e kuptueshëm në vartësi të individualiteteve krijuese, qofshin këto firma të

reja apo talente të njoitura, mbetet tipari dallues kryesor i zhvillimit tonë të sotëm letrar.

Në çdonjërin nga përbërësit e brendisë së veprës letrare: në tematikë, në problemet që trajtohen apo edhe në idetë që mbarten brenda tregimit, novelës dhe romanit, bëjnë dukë si sukseset ashtu edhe dobësitet e krijuesve që hyjnë në kuadrin e përpjekjeve për arritje të mëtejme. Kështu, në novelat «Dasëm nëpër rrugët e luftës» të Ruzhdit Pulahës, botuar në revistën «Nëntori», nr. 10, 1974, «Ftesë nga larg» të Elena Kadares, botuar në «Nëntori», nr. 12, 1974, në novelën «Erë e fortë» të Agim Cergës, botuar në «Nëntori», nr. 12, 1974 dhe në novelën «Borë në bjeshkë» të Vito Koçit, botuar më vete këtë vit, shquhet menjëherë larmia tematike. Kjo dukuri pozitive letrare, shpreh faktin se autorët tanë po thellohen përherë e më mirë në realitetin shoqëror që marrin të trajtonë.

Shkrimtarët tanë, duke ndjekur porosinë e Partisë për të jetuar sa më pranë popullit, për t'i marrë tematikën, tipat, në vetë jetën e gjallë, kanë mundur ta pasurojnë në mënyrë të ndjeshme krijimtarinë e tyre. Në këtë drejtim me gjithë arritjet, ka gjithmonë vend për t'u thelluar. Shoku Enver në fjalimin e mbajtur në Sekretarin e KQ të Partisë më 20 dhjetor 1974 lidhur me këtë nevojë të letërsisë sonë dhe të krijuesve të saj tha:

«Që të shkruash vepra me vlerë duhet edhe kohë, pastaj duhet të lidhesh me njerëzit, me popullin, të futesh në gjirin e masave, jo vetëm sa për të gjetur subjektin e romanit ose të poezisë dhe të largohesh menjëherë nga fshati ose fabrika, duke e konsideruar të mjaftueshme lindjen e idesë. Në këtë mënyrë vepra nuk ka për të dalë e mirë dhe e goditur, prandaj shkrimtarit i kërkohet të shtrohet këmbëkryq me njerëzit...»¹⁾ Pra për krijuesit u bë edhe më e qartë, më konkrete mënyra, rruga që duhet të ndjekin për të krijuar përherë vepra të freskëta dhe të mirëpritura nga lexuesi.

Edhe në novelat që përmendëm më sipër, gjejmë lar-

1) Enver Hoxha. «Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë», 1975, fq. 14.

mi tematike. Kështu ndërsa «Dasëm nëpër rrugët e luftës» na fut në vitet e heroizmit populor të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke na përquar idenë e karakterit të revolucionit tonë populor, idenë që lufta hyri thellë në jetën, ndërgjegjen, madje dhe gjëzimet e popullit, si rruga e vetme për realizimin e të ardhmes së lumtur të tij, te «Ftesë nga larg» spikat e gërshetuar e sotmja me të djeshmen madhështore. Te kjo novelë zbulohet ideja e nevojës për të mbajtur gjallë në ditët tona fryshtë, moralin, vjetitë e shkëlqyera njerëzore revolucionare, që mbolli në zemrat e luftëtarëve Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ambiente dhe tipa të tjerë shohim në novlat «Erë e fortë» ku trajtohet tema e njohur e luftës kundër zakoneve prapanike nga një kënd vështrimi original. Kurse te «Borë në bjeshkë» jemi të futur thellësisht në realitetin e ditëve tona plot ngjyra heroike, ku epizmi gërshetohet në çdo hap me lirizmin, ku madhështorja e jetës socialiste është shkrirë me romantikën revolucionare. Fakti që edhe në një numër të kufizuar krijimesh, siç janë këto që kemi marrë në analizë, vërehet një mozaik i pasur tematik, është shprehës i larmisë edhe të novelës sonë.

Dhe jo vetëm tematika. Lidhur ngushtë me të, madje në vartësi prej saj, në këto novela, sikurse në krejt prodhimtarinë letrare të viteve të fundit, ndihen përpjekjet e autorëve për të dihënë në vepra një gamë sa më të madhe dukurish shoqërore, se në këtë mënyrë vepra mbushet me mish, pasqyron gjerësisht epokën dhe mjeriun e saj. Te novela «Dasmë nëpër rrugët e luftës» lufta kundër pushtuesve për çlirimin e vendit, pasqyrohet me realizëm të thellë. Progresi shoqëror merr me vete gjithë forcat pozitive të shoqërisë. Në këtë mënyrë pasurohet edhe problematika e novelës. Gjejmë këtu edhe urrejtjen e vjetër të fshatarëve të Humbëtirës, edhe dasmën e Beles, edhe shqetësimet e babait të saj. Lufta përipiu në gjirin e vet gjithë morinë e «tingujve» të veçuar të hallevë të njerëzve në hlinin e madh të atdheut.

Novela «Ftesë nga larg», duke synuar të rezonojë të djeshmen me realitetin e sotëm, për të vënë në dukje ndi-

kimin përtëritës moral të asaj epoke të lavdishme dhe të paharruar, që pérherë do të mbetet si shëmbëlltyrë pér brezat e sotëm dhe pér brezat e ardhshëm, arrin të shtjellojë një varg problemesh nga më të ndryshmet, që nga problemi i luftës së çdonjerit prej nesh me gjithçka të huaj, që në rrethana të caktuara, mund të shfaqet në sjelljet dhe veprimet tonë, me radhë, në problemin e marrëdhënieve intime mes të rinjve, e deri te problemet e mprehta e delikate të marrëdhënieve brenda familjes etj. Të gjitha këto harmonizohen dhe inkuadrohen në idenë themelore që, siç e përmendëm më lart, organizon krejt brendinë e novelës.

Nëse vërejtëm që novelë «Erë e fortë» bie si diçka të sajën mënyrën e kapjes së temës së luftës kundër zakoneve prapanike, në planin problematik, pra në faktin se sa kjo novelë zgjerohet dhe deri në ç'masë ngre problemet e realitetit tonë jetësor, pavarësisht se si i zgjidh ato, kemi përshtypjen se relativisht autor i s'ka mundur ta pasurojë sa duhet krijimin e vet, s'ka mundur ta shtrijë shikimin tej caqeve të kullës, ku ende, pér shumë arsy, zoteron fryma e vjetër. Kësisoj realiteti ka mbetur i mangët dhe forca e zakonit apo e moralit konservator të kullës, shëmbet në mënyrë jo dhe aq bindëse, sepse mbetet disi e pamotivuar edhe pse vetë lloji i zhanrit që ka zgjedhur shkrimtari (novela), i ka dhënë dorë të shtrihej më gjerësisht.

Krejt ndryshe novelë «Borë në bjeshkë» mund të themi se gëlon nga moria e problemeve që ka përfshirë vështrimi i autorit. Duke vendosur njerëzit e punës, sharrë-xhinjtë, në qendër të saj, është bërë e mundur, që, ku thellësisht, ku më kalimthi, të na dalin parasysh probleme të shumta të ditëve tonë. Problemi i ndërgjegjës në punë, në luftë me mbeturimat e qëndrimit mikroborgjez, lidhet natyrshëm me problemin e raportit të qëndrimit të inteligjencës ndaj klasës punëtore, me problemin e luftës pér transformime në ndërgjegjén e njerëzve të shoqërisë sonë, me problemin e jetës intime të rinisë, me problemin e luftës kundër zakoneve të shëmtuara patriarkalo-konservatore etj. Autori duke marrë spunto ngajeta, ka mundur ta shtrijë dhe ta zgjerojë kornizën e krijimit të vet pa dalë nga caqet e llojit letrar, dhe të na

transmetoje emocionalisht një kënd të realitetit të sotëm, por në mënyrë të atillë, që përgjithëson krejt tiparet e realitetit tonë shoqëror.

Në çdo krijm letrar është i rëndësishëm elementi jetësor. Letërsia jonë, si letërsi e realizmit socialist, në krijimet e saj më të mira e ka gjetur dhe zgjidhur drejt rapportin midis elementeve të realitetit që mbart e ruan dhe të trillit artistik apo të fantazisë krijuese të shkrimtarit që duhet të burojë dhe të ushqehet nga ky realitet. Ky raport është çështje thelbësore, çështje parimi. Në këtë raport duhet të zotërojë në mënyrë të theksuar jeta, realiteti shoqëror. Në novelat që po analizojmë, edhe pse në tërësi është ruajtur mirë gërshetimi i dy elementeve të mësipërme, prapë ka ndonjë moment ku edhe ndihet njëfarë zbehtësie që, sipas mendimit tonë, ka ndikuar në vlerën e krijimit. Kështu te novela «Dasma nëpër rrugët e luftës», ku e vërteta e kohës ka hyrë gjerësisht në jetën dhe fatin e Beles, vajzës fshatare, që si mijëra shoqet e saj i përjetëson heshturazi evenimentet e jetës së vet personale dhe të ngjarjeve të mëdha të atyre viteve, ku mbi gjithçka të jetës së përditshme, mbi hidhërimet dhe gjëzimet e fshatarëve, qëndron shqetësimi i madh i luftës pér çlirim, dhe ku brenda këtyre caqeve të vërtetësisë jetësore, ka lëvrirë fantazia krijuese e autorit, që ka arritur të na japë skena jete të gjallë, plot kolorit, plot individualitet, hasim edhe ndonjë episod si skenën e takimit të dasmorëve me partizanin Besho. Në këtë skënë përvçe asaj që deklaron vetë Beshoja pér vështirësitë që ka kaluar, pér arniqtë që po e ndjekin s'marrim asnjë kontakt me këtë situatë, më tej, gjatë shtjellimit të ngjarjes. Pra kemi përshtypjen se mungesa e ngjeshjes me material jetësor në këtë episod të novelës, e lë lexuesin me një mbresë të vëgëlluar, pa i dhënë mundësi të marrë kontakt me emocijet, që vërtetësisht ka provuar heroi i novelës në një situatë të atillë.

Novela «Ftesë nga larg» është ndërtuar si një alternim i së djeshimes me të sotmen. Siç është në natyrën e autores, edhe te ky krijim i saj i ri, të bie në sy impenji-

mi në zërthimin e botës së brendshme të heronjve e kryesisht të heroinës së novelës, Dezit. Alternimi kohor ka bërë që novela të vijë si një ndërthurje e harmonizuar e skenave të jetës dhe e problemeve të shoqërisë sonë sot (sigurisht në një aspekt të caktuar) me skenat epike të heroizmit të djeshëm partizan. Ato në tërësinë e tyre ruanë vërtetësi dhe janë të besueshme, rrisin në mënyrë graduale interesin e lexuesit, krijojnë atmosferë dhe motivojnë veprimet e heroinës, por në ndonjë çast, kur trilli artistik i autores ka ndërhyrë duke thyer ekuilibrin e reportit të jetësore me të trilluarën, ky motivim mungon. Kujtjmë episodin e takimit të partizanit Fazlli me infermierin dhe kallëzimin e këtij të fundit në dëm të doktorit, Andresë. Këtu mendojmë që autorja do të kishte bërë mirë të që ndalur për të gjetur motive bindëse dhe të na krijonte situata jetësore të atilla, që vetë ato të shpjegomin rrënjen e asaj intrige të fëlliçur të një njeriu shpirtvogël, e cila herë më zbehtë, herë më me forcë e ndoqi Dezin për shumë vjet në mendimet dhe shqetësimet e saj.

Në planin e luftës kundër konservatorizmit e patriarkalizmit zakonor, që si një forcë e keqe tenton të pengojë triumfin e moralit tonë të ri proletar, novela «Erë e fortë» shtjellon subjektin e vet. Kemi mendimin se autori, duke u mbajtur pas shtrimit në një mënyrë origjinale të problemit (zaikon i keq, patriarkali i shkakton dhimbje e tronditje një nënë të re, që plaku i shtëpisë, skllav i besimit në zalkonet e vjetra dhe rob i pandërgjegjshëm i predikimit të priftit të fshatit, e detyron të renë e nipi të tij të lindë në bodrum, në errësirë e vetmi për t'i shpëtuar shpirtit të keq) lë disi në plan të dytë ngjeshjen e episodeve me mishin e jetësore duke i dhënë më tepër vend fantazisë së tij kríjuese. Kështu krahas momentit plot vërtetësi dhe jetë që lidhet me të kaluarën e plakut Pal, me dramën e dikurshme që i ndodhi Maries, së shoqes, për «faj» të tij, dramë që e la atë pa fëmijë, novela ka më se një episod që s'e kanë atë forcë emocionuese. Mund të kujtjmë këtu mosmotivimin e ikjes rastësore të Dinit pikërisht atë ditë që Delira e njofton për dhimbjet që ndien në bark dhe që paralajmërojnë lindjen e aférme, apo epi-

sodin e ardhjes së Toninit, të kunatit të Palit, dhe darkën që shtrohet për të, episod që së bashku me krejt linjën e Toninit mbetet si i pafunksionistë; episodim e takimit dhe të bisedës së priftit me Palin ku, qoftë në përshtkrimin e skenës së drekës që ha prifti, në kafenë që pi ai me Palin dhe në mënyrën se si ai ndikon për të keq te fshatari plak, s'ka asgjë të re në konceptimin artistik nga ç'kemi ndeshur në krijime të tjera me këtë tematikë. Edhe zgjidhja e konflikti mes së resë dhe së vjetrës, triumfi i së parës dhe lë-kundja e madhe e Palit nga besimi i tij te zakonet e vjetra reaksionare, ndodh më tepër rastësisht nga ardhja e një mamie që paska ndodhur shoqe e ngushtë e Delirës, e cila e thyen Palin dhe gjithë të vjetrën që ai përfaqëson, dhe jo si rezultat i asaj lëkundjeje të madhe shoqërore, që erdhë gradualisht, si pasojë e bindjes së masave, e besimit të tyre tek e reja e jetës sonë socialiste.

Për njojje jetësore, për realizim të drejtë të raportit për të cilin po bisedojmë, shquhet në mënyrë të dukshme novela «Borë në bjeshkë». Në novelë ka hyrë gjerësisht jeta e sharrëxhinjve dhe e pylltarëve, problemet, shqetësimet dhe gëzimet e tyre. Fantazia krijuar e autorit është derdhur e begatë, e besueshme dihe kudo e freskët ngaqë gjallëria dhe vërtetësia e jetës shpërthen në çdo skutë të novelës. Kjo përshtypje na tingëllon kaq e vërtetë saqë linja e marrëdhënieve Bledar-Entelë, me mosarritjen e saj, ma duket si një «haraç» që shkrimtari i paguan skemës së vjetër të këtij lloji. Përpos kësaj linje, në çdo episod të novelës, në vargun e ndodhive që lidhen me njjerëzit e punës (sharrëxhinj, pylltarë etj.), në heroikën e punës së tyre, në linjën e fatit dhe të jetës së malësores Mrikë, që mbyll në vetvete, me krenarinë e saj, dhembjen për burrin e humbur, në zgjidhjen dhe shtrimin e problemit të marrëdhënieve dhe të qëndrimit të inteligjencës ndaj njjerëzve të punës, klasës punëtore në luftën e përditshme që bëjnë njjerëzit për flakjen e gjithgjake të vjetër e të huaj nga vetvetja në emër të moralit proletar, etj., ndihen vrundujt dhe shkulmat e erës së fortë që zë fill në vetë shfaqjet e jetës sonë dhe që fryn e gjallëron tejendanë novelën.

Mbisundimi i realitetit jetësor në krahasim me trillin

fantastik dhe krijues të shkrimtarit, gjen konkretizimin e vet, ndër të tjera edhe në atë element kyç të krijimit letrar, që është tipi apo karakteri në vepër. Madhështorja e heroizmit partizan dje dhe e heroizmit socialist sot qenë dhe janë vepra të njerëzve tanë të brumosur dhe të kultur nga Partia. Pra është e kuptueshme që hero i veprës *letrare duhet të bëhet pikërisht ky*, njeriu ynë i thjeshtë dhe i jashtëzakonshëm njëkohësisht. Fitoret tona u arritën dhe po arrihen jo ashtu lehtë por nëpërmjet një lufte të ashpër, nëpërmjet kapërcimit të kontradiktave të ndryshme. Të gjitha këto tipare të kohës, që zënë vend dhe pasqyrohen në vepër, duhen mbajtur mirë parasysh nga autori, në mënyrë që ato t'i japid dorë krijuesit si për individualizimin ashtu edhe për tipizimin e personazhit, tipit, karakterit në vepër.

Në linjat e shumta që shtjellohen në novelat për të cilat po bisedojmë, në morinë e ngjarjeve dhe të episodeve në secilën prej tyre, siç është e natyrshme, shpalosen fata e heronjve, mpiksen tiparet e karaktereve, marrin jetë tipa përgjithësues të njerëzve tanë. Në këtë aspekt të punës së shkrimtarit duhet të mbahet prasysh dyanshmëria e procesit krijues: tipi letrar të përgjithësojë një kategori të caktuar shoqërore, por njëkohësisht, të ruajë edhe individualitetin e karakterit që synohet të krijohet në vepër. Shkelja e çdonjërit prej këtyre elementeve bazë në krijimin e tipit letrar e dëmton rëndë atë. Proza jonë në këtë drejtim ka shembuj të shumtë realizimesh dinjitoze. Edhe novelat tona të dy viteve të fundit në përgjithësi kanë arritur të japid karaktere tipike. Kështu, novela «Dasmë nëpër rrugët e luftës» ka gdhendur me forcë e origjinalitet karaktere njerëzish të atyre viteve. Në këtë drejtim janë të realizuar si figurat qendrore të tregimit si Belja me botën e saj intime apo Nure Xhokollari, vjehrri i saj, si përgjithësim i njerëzve të fortë e të ndershëm, që kanë hijen e rëndë autoritare por edhe zemrën e madhe dhe shpirtin të ngrohtë, që janë atdhetarë të flaktë, ndonëse të pazhurmëshëm etj., ashtu edhe personazhe më të dytë bile edhe episodikë si Xhezua, krushku i parë, deri edhe Ganiu, dhëndëri. Më tepër rilevimi mendojmë duhej t'i jepte autori fi-

gurës së Beshos, që na duket se nuk ka gdhëndjen e nevojshme.

Novela «Ftesë nga larg» ka të tipizuar bukur heroinët kryesore Dezin, që është zërthyer imtësish e me shumë kolorit në rrethana e në momente të ndryshme, të jetës së saj. Një varg individualitetesh të arrira që përfaqësojnë kategoritë ndryshme shoqërore si Andrea, doktori, i shoqi i Dezit, figurë që të mbetet e skalitur edhe pse aq pak hyn në veprim të drejtëpërdrejtë dhe deri edhe figurat e individualizuarat të ish-partizanëve apo të fshatarëve si Sherifi hokatar dhe Zaçja me atë qëndrimin e hershtur e të palëvizur, me kujtimet e gjalla të luftës, që i ruan në ndërgjegjen e tij, janë suksese të novelës.

Jo kërkuesë, por domosdoshmëri e jetës sonë të sotme është që ajo të vendosë në qendër të saj njeriun e ditëve tonë, veçanërisht përfaqësuesin e klasës punëtore, heroizmin masiv, të njerëzve të sotëm të epokës së Partisë. Me këtë qëllim kryesor të vetin letërsia jonë do të zberthejë realisht e në mënyrë poliedrike tiparet e moralitetës së tona, luftën që po zhvillohet intensivisht në ditët tona, në kundërvënie me moralin e vjetër patriarkal dhe me ndikimet e huaja të shëmtuara të moralit të sotëm borgjezo-revizonist.

Novela «Erë e fortë», në këtë vështrim, ka meritë në realizimin e karakterit të Palit, që përgjithëson viktimin e mentalitetit të mykur patriarkal. Ka arritur ta individualizojë atë me brengën e tij të gjatë, me frikën bes-tute nga e papritura, nga forcat mbinjerëzore. Po kësh-tu, ndonëse me pak vend aktiv në novelë, autorit ka skicuar edhe tipa të tjerë, që kanë veçantitë e tyre dalluese si Mara e Delira, dy grante dy epokave të ndryshme, por s'ka mundur të individualizojë e të gjallërojë në atë masë që duhej Dinin, që mbetet mjaft i thatë e skematik, aspak i denjë për t'ia kundërvënë të ungjít plak, Pallit.

Eshtë, meritë e shkrimitarëve tanë që, jo rrallë, kanë arritur të vendosin në qendër të veprave të tyre njeriun e punës, fshatarin, intelektualin, gruan dhe punëtorin e ditëve tona. Por edhe pse ne gjëzohemi për të tillë realizime, mbetet shumë për të bërë. Prandaj duhen ende përm

pjekje dhe punë serioze nga ana e shkrimtarëve tanë e sidomos e prozatorëve, në mënyrë që njeriu i ri, njeriu i punës, përfaqësuesi i klasës punëtore, si edhe jeta dhe pënpjekjet e kësaj klase të zënë vend gjithmonë e më kryesor në romanet e novelat tonë. Novela «Borë në bjeshtë» shënon sukses në këtë drejtëm. Aty vërshon në çdo faqe jeta e punës, romantika e saj, heroizmi i saj, shqetësimet e saj dhe e gjithë kjo nëpërmjet karakteresh të individualizuara bukur. Secili nga personazhet punëtore të novelës është një grumbullim individualitetesh fort mirë të spikatura. Lexuesit i mbeten në mendje tipa si Vuka, Frrok Gjini, Staka, Ndrecë, Lulashi madje edhe Mirashi e Lleshi që edhe pse me mbeturina ende të pashlyera patriarchale e mikroborgjeze në ndërgjegjen e tyre, janë tipa realë të jetës sónë të sotme. E individualizuar e me botë të pasur shpirtërore në novelë është dhënë edhe figura e Sulës, shoferit hero, shoferit me zemër të pastër e me shpirtin e sakrificës, që çdo veprim dhe mendim të vetin ë ka të singertë e të besueshëm, që nuk shtiret dhe nuk ka asnje prapamendim në sjelljet e tij sado të jashtzakonshme të duken ato. Përveç këtij plani, novela i ka të realizuara karakteret edhe në plane të tjera të subjektit të saj. Të individualizuar dhe të përgjithësuar, në tërësinë e tyre, mbeten edhe intelektualët si Bledari, inxhinieri dhe Fred Mushqeta, kronisti i televizionit. Kuptohet se në këtë sukses të novelës së Vito Koçit ka ndikuar në një masë të konsiderueshme njojja e jetës, e realitetit jetësor, që e gjejmë të pasqyruar në vepër. Fakti që shkrimtari ka jetuar për një kohë të gjatë pranë heronje të tij, ka ndirë pulsin e vrullshëm të jetës së tyre, ka njojur nga afër shpirtin e tyre, e ka ndihmuar atë në realizimin e bukur artistik të krijimit të tij.

Edhe pse me ndonjë moment të paarrirë plotësisht, në përgjithësi këto krijime flasin për impulsin e madh që fitoi letërsia jonë pas Plenunit të 4-t të KQ të PPSH.

1974

TRI NOVELAT E PARA TË NJË AUTORI TË RI

Pas vëllimeve të para me tregime, prozatori Faik Ballanca botoi përmbledhjen me tri novela, ku mund të vërehen disa tipare të krijimit të tij si dhe ndonjë problem i novelistikës sonë, të lidhura këto ngushtësisht me pasuri në jetësore që ka mundur të derdhë si nëpërmjet rrëfimit realist ashtu dhe nëpërmjet forcës artistike të fjalës.

Duke qenë lloj letrar me tiparet e veta të dallueshme nga llojet e tjera të prozës, si tregimi apo romani, novelë s'duhet konsideruar si tranzicion nga tregimi te romani thjeshtë për numrin e faqeve që zë ajo, "por si një mënyrë e veçantë, madje tepër delikate për vetë arsyen se mund të ngatérrohet qoftë me njërin apo tjetrin lloj të prozës, si edhe për faktin se realisht ajo ruan disi, në një farë kuptimi, veti si të tregimit ashtu edhe të romanit. Në këtë vështrim vëllimi i Faik Ballancës pohon aftësinë e autorit për ta trajtuar me sukses ikëtë lloj letrar. Novelat e këtij vëllimi mbeten plotësisht brenda cakut të emërtimit të tyre dhe e pasurojnë këtë lloj të prozës sonë.

Të tri novelat e vëllimit janë të ngritura mbi subjekte të pasura me ngjarje dhe episode, shumica e të cilave dëshmojnë se autor i njeh mirë realitetin për të cilin na flet, kjo të bie në sy sidomos kur është fjala për novelat me temë aktuale. Dhe jo vetëm kaq. Ai ka ditur ta japë atë nëpërmjet një rikrijimi të shkathët artistik duke ngjallur te ne emocione e ndjenja që na ndihmojnë ta

shijojmë më lehtësish t veprën, duke na komunikuar njëherazi ide e mendime për ngjarjet dhe njerëzit.

Te novela «Katër orë larg shtëpisë» të tërheq shkathëtësia e narracionit të F. Ballancës për të përshikruar fshatin, ambientet e tij, e sidomos, jetën e çobanëve me thjeshtësinë, zemërbardhësinë e ciltërsinë e tyre. Nata në stan; hallet dhe dëshirat e çobanëve, bisedat e tyre dhe sidomos gazi dhe dufi i lojrale të tyre janë skema të përshikruara me nerv dhe të mbeten të paharruara në kujtesë. Me interes ridiqen te kjo novelë edhe ato personazhe ku autori ndalet e na flet për jetën e fshatit, e kryesisht për botën shpirtërore të njerëzve, për qëndrimin e tyre etiko-moral. Në këtë vështrim ai zbërthen edhe idenë që përçohet në krejt novelën, si ideja më qendrore e saj e që mishërohet në qëndrimin e njerëzve tanë ndaj të huajt që, duke pas ardhur si armiik te ne, është shndërruar në një qenie pa personalitet, sepse ai dhe forca e errët që e pruri atë, u shpartalluan pa mundur të arrinin qëllimin e tyre në saje të luftës sonë, dhe ai vetë, Bendua, personazh në tregim, mbiati vetëm një qenie që për hir të mëshirës së fshatarëve vazhdon të rrojë mes tyre dhe vetëm kaq. Bendua, i huaji që ka ardhur si armiik, mabetet përherë i huaj, ai s'mund të martohet me asnjë vajzë nga fshati, goftë edhe me ato të mbeturat si Bardha, sepse njerëzve ai kurdoherë u kujton forcën armiqësore, forcën e errët që desh të përshë jetën e tyre. Është meritë e novelës dhe e krijuesit të saj që tërë pasuria ideore dhe jetësore, ndonëse në mjaft pasazhe dhënë nëpërmjet meditimeve dhe përfytyrimeve të fëmijës, e ka kaluar caqun e asaj bote shpirtërore, për të mbetur me interes kryesisht për lexuesin e rritur të cilit i drejtohet.

Novela tjeter me temë aktuale «Shtigje me helm», e ka transplantuar konfliktin në një terren disi më të ndryshëm nga ai i novelës për të cilën folëm deri këtu, duke e vështruar kontradiktën kryesisht në luftën që bëjmë sot me ndërgjegjen e njerëzve tanë, me ndërgjegjen tonë, për të çrrënjosur atë botë plot mbeturina patriarchale e mikroborgjeze në emër të moralit të ri socialist. Novela të tërheq vëmendjen për ashpërsinë e paraqitjes së luftës së re-

së me të vjetrën si shprehje e luftës klasore që s'pajtohet me ndryshkun e trashëguar, të shprehur qoftë në konceptet patriarkale, qoftë në pilkëpamjet botëkuptimore klerikale. Jetë e fshatit, shqetësimi i përbashkët i njerëzve për të keqen që u kërcënohen, qëndrimi intolerant i forcave progresive edhe ndaj atyre që shfrytëzojnë përgjegjësitë në udhëheqjen e kooperativës dhe lidhjet gjinore për të marrë nën mbrojtje forcat konservatore regressive, janë dhënë bukur e në mënyrë të motivuar, gjë që flet përfocën njohëse të autorit si edhe përfshirësitet përshkruar të tij.

Te novela që titullohet «I fundit» është dhënë jeta e një spitali partizan, ku ndilhet shqetësimi i madh përluftët çlirimtare si dhe optimizmi dhe dëshira e njerëzve përtu riaftësuar sa më shpejt, në mënyrë që të mbushin boishllakun në radhët e luftëtarëve partizanë. Ky aspekt jetësor është gërshtuar me vizatimin plot ngjyra që i bën autori paraqitjes së të plagosurve kur ata durojnë dhimbjet e plagëve apo të mjekimit, kur evakuohen përtiu shmançgur ndjekjeve të forcave gjermano-balliste apo kur luftojnë me pushkë përtëmbuluar tërheqjen e shokëve të sëmurë rendë etj.

Ndonëse nuk po bisedojmë për romanet, që si lloje të prozës, u jepin më shumë dorë autorëve në plazmin e karaktereve, te këto novela gjemjë të realizuara disa figura që kani forcë përgjithësuese e tipizues përatë katgori shoqërore që shkrimitari ka synuar të na japë. Të tillë janë Zaharia, Baxhuli, Mihali etj. Këta tipa, negativë apo pozitivë qofshin, janë dhënë në plan realist dhe, me gjithë ndonjë mungesë që mund t'u dallojmë, mbeten në mendjen tonë. Përveç këtyre edhe një numër personazhesh të tjera, megjithëse jokryesorë e ndonjë herë episodiikë, nëpërmjet detajeve të gjetura, janë skicuar me forcë e vërtetësi e me shumë individualitet në çonjëren prej novelave të vëllimit.

Undalëm më tepër, në krye të këtyre shënimave, në problemet e brendisë ideore e të injohjes jetësore që zotëron autori, siç dëshmohet në këto novela, sepse në këtë anë na duken më të realizuara ato, por asnjëherë s'duam

të pohojmë me këtë se autori s'ka pasur «dorë të mbarë» edhe në mjeshterinë artistike, përkundrazi, edhe në këtë anë novelat dëshmojnë për merita e zotësi të tij. Por edhe pse themi kështu, nuk mund të mos vërejmë disa të metë, që i përkasim këtij vëllimi por që njëkohësisht lexuesi i ndesh edhe në ndonjë vepër tjetër të prozës sonë të sotme.

Në pikëpamje kompozicionale, kemi mendimin se novelat çalojnë dhe kjo kryesisht përsa i përket hapjes së tyre. Na duket se sado me qëllim nismëtar t'i ketë përdorur autori episodet që hapin ndonjërin nga novelat, ato episode mbeten të pafunksionta, të huaja për brendinë e novelave dhe tingëllojnë paik si shkollareske. Në këtë vështrim ato na duken të panevojshme aq sa edhe mund të mos ishim fare. Kështu te novela e dytë e vëllimit që titullohet «I fundit» fare mirë mund të fillonte kallëzimi pa qenë e nevojshme të na flitej për shoferin me shumë plagë, që është i vëllai i Mihalit, për më tepër sepse më tej, me gjithë episodet e shumta, ngjarjet nuk lidhen fare me këtë personazh. Po kështu te novela «Shtigje me helm» detaji i fillimit të saj lidhur me shqetësimin e kryetarit të kooperativës që s'mori dot patentën e motorit, s'motivohet, se më tej s'ka fare vazhdimësi lidhur me karakterizimin e këtij personazhi, bile ai detaj sikur s'harmonizohet fare me atë kryetar kooperative që më pas, nuk e gjejmë të merakoset, asnjëherë për vogëlsi të atilla, përkundrazi, më pas ai del si një kryetar që ka shqetësimë të vërteta, të rëndësishme e serioze lidhur me pasurinë e kooperativës. Gabimisht të krijohet kështu përshtypja se autori ndryshe ka dashur të na e japë atë figurë dhe ndryshe i ka dalë në shtjellimin e subjektit.

Më drejtë e më mirë është nisur novela «Katër orë larg shtëpisë» tek e cila s'e vërejmë një hyrje të atillë të tepërt e të pafunksiontë por që në krye, autori na fut në problemin që do të lëvrijë gjatë krejt novelës deri në zgjidhjen e tij duke na vendosur përballë me njërin nga personazhet, me fatin, e të cilit do të lidhet ideja e novelës, ndomëse ai s'do të jetë mbartësi kryesor i kësaj ideje. Te «Katër orë larg shtëpisë» autori, duke ndjekur një synim

të paracaktuar ideor, i vë episodet që nga i pari deri tek i fundit në funksion të atij synimi dhe kështu gradualisht e në mënyrë të natyrshme n'a e zbulon qëllimin e tij. Ne mësojmë përfatim e Bardhës, vajzës së mbetur pa burri, mësojmë përefuzimin e të jatit të saj, që s'pranon t'i japë bijën e tij sakate e të mbetur Bendos, dhe përfnjë çast, mendojmë se ky është shqetësimi kryesor që autori do të na japë me këtë novelë, po më pas, duke lexuar, ne mbetemi të zhgënjer. Autori n'a rendit tablo e skena jete të fshatit, na njeh deri në një farë mase me karakterin e Bendos nëpërmjet xha Goles e Ndonit të vogël. Në përshkrimin e jetës së çobanëve të fshatit, lart në mal te stanet, katër orë larg fshatit të Ndonit, ai na zberthen qëllimin kryesor ideor të novelës së tij, duke e ruajtur të gjallë jo vetëm kërshterinë tonë, ky s'është qëllimi i tij e i novelës, por dhe duke e zberthyer në një vështrim më të shumanëshëm realitetin jetësor përfshirë fuqizuar akoma më tepër idenë kryesore të saj.

Në arkitekturën e tyre, në ndonjëren nga novelat e vëllimit vërejmë ndërprerje të shumta e të shpeshta të shtjellimit të subjektit, nëpërmjet retrospektivash të njëpasnjëshme që, në njëfarë mënyre e vështirësojnë pa nevojë atë. Sigurisht në novelë autorit më tepër se në tregim mund t'i paraqitet nevoja përdigresionë që sqarojnë ndodhi apo karaktere, por të novelës «I fundit» kemi mendimin se ka mbingarkesë në këtë drejtim. Nis tregimi i autorit me ngjarjen e takimit me doktor Shyqyriun përfshirë vazhduar më pas me episodet që bëjnë fjalë përfjetën e një spitali partizan, ku njihemi me heroin, Mihalin, dhe ndoshta përfshirë hedhur më shumë drithë mbi karakterin e heroit, ai shpesh ndërpret ngjarjen e filluar përfshirë të na hedhur herë në kohën e luffës ilegale, herë në aksione të luftës partizane e herë në ndeshje të mprehta e demaskuese me eksponentët tradhitarë të Ballit Kombëtar dhe me bandat e tyre, pa mundur kështu të organizojë si duhet materialin jetësor gjë që përmendimin tonë e ka fragmentarizuar novelën. Një mënyrë më e gjetur e mbarështrimit të këtij materiali sigurisht do t'i kishte dhënë më shumë vlerë atij. Kjo ndoshta ka rrjedhur edhe përfshikak se autori

më pak e ka njojur materialin jetësor se sa te dy novelat e tjera të kësaj përbledhjeje. Këtë përshtypje e krijoj, më ngaqë edhe te kjo novelë ndeshim ndonjë moment që shumë për së afërmë na kujton tregime të tjera. Kujtojmë për saktësim të mendimit tonë episodin e operimit të Mihalit që i presin këmbët e gangrenizuara, për ta përgasur atë me situata të përafërtë të më se një tregimi të botuar, përvitet e Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Po kthehemë prapë te novela si lloj i prozës për të nën-vizuar nevojën që ka ajo për një konflikt të fortë, të mprehtë e të dhënë nëpërmjet përplasjes së palëve që e përfaqësojnë. Nëse ndonjë krijim letrar edhe mund të shpalosë para lexuesit një brendi pa konflikt, një novelë, mendojmë se as që duhet përfytyruar se mund të qëndrojë pa konflikt. Vlera ideoartistike e novelës varet në një masë të madhe nga fakti se sa i plotë, i fortë është konflikti më të, se sa me dinjitet e më vërtetësi janë individu-alizuar karakteret që ndeshen dhe përfaqësojnë anë të kundërta të atij konflikti. Pra ky element i dorës së parë, ndër komponentët e krijimit, përcaktom në një masë determinuese vlerat e novelës, sikurse të krejt krijimit tonë letrar, si një letërsi e realizmit socialist.

Në vëllimin e «Faik Ballancës, novela (Shtigje me helm» është ajo që ka evidentuar më me mprehtësi konfliktin, i cili është dhënë si në ndeshje konceptesh ndërmjet Zaharias, përfaqësuesit të botëkuptimit tonë të rí e revolucionar dhe Baxhulit, mbarësit të mbeturinave në ndërgjegjen e individuve, pjesëtarë të shoqërisë sonë. Te ky përfaqësues i botës së vjetër, që është realizuar mirë në pikëpamjet e tij patriarkalo-klerikale, autori ka luftuar botëkuptimin apo mbeturinat e botëkuptimit konservator e reaksionar dhe jo mbartësit e saj. Por mbyllja e novelës dhe, për pasojë, zgjidhja e konfliktit të saj, ka mbetur disi pezull. Pasi është zbuluar rrjedhim i démshém material i veprimit të Baxhulit, autori s'ka mundur të japë apo i është shmangur përplasjes me këtë përfaqësues të botës së vjetër që po s'u luftua, démon tonë jo vetëm duke molepsur jetën e njerëzve të shoqërisë sonë, por duke e démtuar atë edhe materialisht. Në këtë funksion negativ e të démshém

të Baxhulit, me të cilin mbaron novela, konflikti gati kallon në shprehës i kontradiktës antagoniste, prandaj ne s'pajtohem i mënyrën si është mbyllur ajo, duke lënë si në harresë luftëm me botën e mykur e me vetë Baxhulin, përfaqësuesin e asaj bote, që i shikaktoi aq të këqija realitetit shoqëror të marrë në vështrim te ky krijim.

Te dy novelat e tjera, «Katër orë larg shtëpisë» dhe «I fundit» kemi përshtypjen se autori shumë më pak i ka kushtuar vëmendje konfliktit, evidentimit të tij, në mënyrë që edhe novelat të fitonin më shumë vërtetësi jetësore. Te «Katër orë larg shtëpisë» konflikti është shumë i në-përtëshëm dhe duket sikur s'ekziston fare, kurse te «I fundit» konflikti antagonist midis nesh dhe armikut okupator apo tradhtarëve ballistë të tipit Isa Toska, është dhënë si tepër i copëzuar, pa arritur të jetë element organizues i novelës, i materialit jetësor të derdhur në të; për pasonjë, mendojmë se kjo mungesë ka shkakuar edhe dobësinë kryesore të saj.

Pra, duke konkluduar mendimin tonë, themi se me gjithë të metat e dobësítë që ndeshim te këtë novela të Faik Ballancës, ky vëllim dëshmon për aftësinë krijuese të këtij prozatori tashmë të njojur.

1973,

NGJARJE DHE TIPA SHOQËRORE NË NJË VËLLIM ME TREGIME

Përbledhja e re me trëgime e Dh.S. Shuteriqit, që titullohet «Një mal me këngë», ka tematikë të larne e të shumëllojshme. Ajo përfshin krijimet e viteve të fundit të këtij prozatori ndër më të njohurit dhe më me stazh në gjininë e prozës sonë të shkurtër. Për vite me radhë lexuesi ynë ka qmuar dhe vlerësuar lart krijime të tilla të Dh. S. Shuteriqit si «Zot e rob», «Xha Demi», «Dyshimet e Jonuz Ranxhës», «Fyelli i Tanës», etj., që pa dyshim përbëjnë majat e krijimtarisë së tij dhe janë suksese të letërsisë sonë. Prandaj kur marrim të shprehim ndonjë mendim për krijimet e fundit të shkrimtarit, kërkojmë, përherë me një ndjenjë të pazakontë por të ligjshme, të gjejmë ato linja, tipare brendie e forme që përbëjnë fisionominë krijuese të këtij shkrimtarit dhe që e kanë çuar atë shpeshherë në realizimet e tij më të mira.

Eshtë i vërtetë fakti që në krijimtarinë e vet letrare çdo shkrimtar nuk arrin përherë majat e tij. Por eshtë po aq e vërtetë, dhe kjo e provuar dhjetëra e qindra herë në rrugën krijuese të shumë shkrimtarëve, se në krijimet e shumta të tyre domosdo do të gjejmë realizime mbi mesataren e nivelit të tyre, krijuime që përbëjnë piketat e themelive të vlerave të vëllimeve të tyre.

Kështu ka ndodhur edhe me vëllimin «Një mal me këngë» ku vërtetë mund të mos hasim arritje kulmore të Shuteriqit, si tregimet që përmendëm më sipër, por nde-

shim një masë tregimesh të bukura me vlera si për nga brendia e tyre aishlu edhe për nga forma e zgjedhur, që i ka shërbyer për të derdhur sa më emocionalisht atë përmbytje të fuqishme jetësore.

Sikurse në shumë tregime të tjera të mëparshme të Shüteriqit, edhe te ky vëllim, diapazoni i objektivit të tij ka shtmirje të gjerë në realitetin jetësor të ditëve tonë. Shkrimtarin e ka joshur dhe rrëmbyer me forcë të rrallë madhështia e jetës sonë socialiste dhe e heroizmit të njeriut tonë të ri. Madje në esencë, atë e frysmezon vetë njeriu i ri, fizionomia shpirtërore dhe morale që ka mbjellë dhe po rrit Partia jonë e Punës te ky njeri i ri.

Skulptori që gjithë jetën e tij ia ka kushtuar artit përtë plazmuar e ngritur në pavdekësi epokën e Partisë, që gjatë dhjetëra vjetëve të krijuarit së tij ka pasur si burim frysëzimi, madhështinë e punës së lirë socialiste, ka dëshirë të pakufishme ta jetojë sa më intensivisht këtë jetë të cilës ia gjen cakun filletar në atë bocetin e fundit që bën, ku paraqitet imazhi i fëmijës që thih gjirin e nënës, pra te lindja e jetës, e njeriut të ushqyer me ide-aleet e mëdha të kohës (tregimi «Tani, të rroj»). Shoferi që sakrifikon të ritë e tij për të shpëtuar tridhjetë apo dyzet udhëtarët e autobusit nga aksidenti vdekjeprurës, e bën këtë heroizëm pa bujë edhe pse ai djalosh, Leksi, është në prag të lumturisë së vët, sepse e tillë është brumosja e tij shpirtërore, humanizmi i tij që është shprehje e humanizmit tonë socialist. Fakti artistik i tregimit është ngritur në një përgjithësim me shtrirje të gjerë për jetën tonë (tregimi «Leksi i Gogos»).

Po kështu në një varg tregimesh të tjera të vëllimit si te «Kujtime stanes», «Dispeçerja», «Te stacioni më Manas» galeria e tipave përfaqësues të kohës sonë vjen e pasurohet me figura të tillë si Haritija, ajo çobanka e bukur, e cilët, e gëzueshme e plot jetë, që aq thjeshtë flet për dashurinë e saj, apo Veroja, çobani i zgjedhur i saj, që ka atë zemër të madhe dhe atë kuptim të drejtë përmiqësinë dhe dashurinë. Fani, dispeçerja është vajza e emancipuar e ditëve tonë, që di ta zgjedhë vetë shokun e jetës, kurse Branushi, shefi i stacionit të vogël të Mana-

sit, të mbetet i skalitur si rrallë personazh tjetër, me atë butësinë e tij shpirtërorë dhe me dashurinë për njerëzit, për jetën plot gjallëri, shqetësimë e gjëzime të ditëve tonë. Të po kësaj natyre artistike janë edhe dy tregimet e tjera «Nëna e Ethemit» dhe «Nëna» te të cilat figura e nënës së luftëtarit partizan mendoj se s'ka mundur të gjallërohet sa duhet, por ka mbetur më tepër si një personazh që merr dritë ose jo në vartësi të të tjerëve. Kjo përshtypje vjen e të forcohet edhe nga fakti që në dy tregimet, njihami me nënën nëpërmjet gojës së të tjerëve dhe jo drejt përsëdrejti me të.

Edhe pse në shumicën e tregimeve të kësaj tematike i gjejmë të gërshtuara bashkë, sikurse edhe në jetë, epikën, heroikën e jetës me lirizmin, me ndjenjat e holla që harlisën e ndërthuren me trungun ideor të madhështisë epike, prapë mund të dallojmë më se një tregim ku shkrimitari ka derdhur subjekte që trajtonë kryesisht ndjenjat e dashurisë si shfaqje të gjëzimit të jetës sonë. Edhe pse të tillë, këto lloj tregimësh janë brenda lirizmit të madh të jetës. Në tregime si «Dashuri e parë», «Nga Tirana në Valbonë» e te ndonjë tjetër i përmendur më sipër si «Dispecerja» dhe «Kujtimi stansh» etj., ndjenja e dashurisë rimore, e dashurisë sonë të pastër e të vërtetë për shoqen e jetës, ndjenjat poetike plot dritë e ngjyra të dashurisë për atdheun tonë, për bukuritë e tij, siç na i ka derdhur më emocione të rralla autori, jetojnë në harmoni me optimizmin e përgjithshëm e të përhershëm të realitetit të sotëm.

Zvetënim i moral i jetës së shoqërisë në vendet revisioniste që është pothuaj krejtësisht i njëjtë me mënyrën e pështirë të jetës borgjeze, është stigmatizuar, nëpërmjet paraqitjes karikaturale të pjellave morale të atij sistemi siç është Nuzi me dy gratë e tij. Klara dhe Suzi. Tregimi edhe pse i dhënë në një mënyrë pak si jo të zakonshme për krijuesin e vet, ta krijon vërtetësisht tablonë e imoralitetit të asaj shoqërie ku mungon cdo ndjenjë e pastër, e bukur, e moralshme, ku sundon vetëm kulti i parasë, i interesit dhe i egoizmit mikroborgjez. Ajo botë, ai moral, ajo ideo-

logji e fshehur pas frazeologjisë marksiste, e sheqerosur me luksin e jashtëm, me propagandën dhe reklamën e shfrenuar, është një rrezik i mundshëm, i përhershëm për ne, ndaj duhet njojur e vërteta në vlerësimin e saj e të rrezikut që paraqet ajo. Shkrimtari bukur e ka dhënë të mishëruar me material jetësor këtë ide nëpërmjet episodit që i ndodh gjeologut të ri, Arbenit, me nepërkën e vogël, me atë si njollë të verdhëreme, te tregimi i shkurtër «Një njollë e verdhëreme».

Vend të konsiderueshëm zënë në vëllim edhe ato tregime që evokojnë periudhën e lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimitare. Episodet që ringjallin tregimet nga ajo epokë, janë sa të larmie aq dhe të gjetura, të dhëna me nerv e kolorit. Heroikja, shpirti i sakrificës, tipare të moralit të ri këto, kanë zënë vend më tregime si «Këpuçët», ku episodi i thjeshtë midis dy partizanëve në një spital partizan mbart në vetvete solidaritetin dhe humanizmin e vërtetë komunist. Shpirtim e sakrificës dhe të vetëmohimit, moralin e paepur të komunistit, shkrimtari i ka plazmuar në tregimin «Thimi Arapi», që është trupëzim përgjithësues i burrërisë, guximit të luftëtarëve të mbrujtur me idealet e Partisë.

Është me interes të nënvízojmë se ndër këto tregime, autori ka edhe të tilla ku mbizotëron zërthimi i botës shpirtërore të personazheve, formë kjo që i ka dhënë dorë të hyjë në intimitetet e heronjve, të tregimeve, për të shpjeguar psenë e qëndrimeve dhe veprimeve të tyre. Te tregimi «Një natë shtatori» zbulohet realisht e në mënyrë bindëse përkatesia shpirtërore e popullit me partizanët. Disi më të zbehtë, pa shumë material jetësor dhe pa forcën komunikuese të nevojshme na duken tregimet «Si goja, zemra» dhe «Usta Xhelali».

E djeshmja e afërt apo e largët me trashtinën e saj, me shtypjen, egërsinë dhe errësirën ku gjershtohej pagjidhshmërisht sundimi i dyfishjtë feudo-borgjez dhe i okupatorëve, ka zënë vend gati në gjithë krijimtarinë e Shuteriqit. Edhe në vëllimin që po analizojmë, ajo përbën problematikën e disa tregimeve që janë më një nivel të kënaqshëm artistik. Në krijuime të tillë si «Im atë

dhe deti», «Siva jonë» etj., ndihet dhimbja e fshatarëve të thjeshtë që luftonin me shpirt ndër dhëmbë për bukën e gojës, për kafshatën e vetme që i huaji ua rrëmbente pa çarë kokën për mjerimin e kasolleve.

Me qëndrimin e tij tendencioz, shkrimtari u jep vend në vëllim edhe aspekteve të tjera të realitetit ku spikat injoranca dhe xhahillëku i feudalëve dhe mehmurëve të kohës së satrapit Zog. Në tufën e nëpunësve të aparatit burokratik zogolian, që na parakalojnë te tregimet «Pendët e gjelit» dhe «Baltrave të Byzeqesë», zbulohet falsiteti intelektual i mehmurëve, injoranca e përgjithshme e klasave të larta të kohës, ambicia dhe lufta e tyre për kollet dhe, nga ana tjetër, qëndrimi protestues i njerëzve të popullit, shija e hollë artistike e masës dhe tendenca e natyrshme e saj për demokraci dhe përparim. Ky tipar i fundit zbërtethet në mënyrë shumë të goditur në tregimin «Një mal me këngë». Protagonisti i tregimit Sali Ymeri, që ka kurrser vite me radhë që të blejë këmborë për bagëtitë, të cilat s'janë të tijat, e bën këtë se ka shpirt artisti që s'mundi t'ia ndryshte as koha as sundimtarët as uria dhe fukarrallëku i imponuar. Kjo pikërisht është ajo më kryesorja që shkrimtari ka mundur ta realizojë me detaje të gjetura dhe që puhon optimizmin si shenjë dalluese të vitalitetit të popullit tonë.

Duke u shtyrë larg në kohë, shkrimtari disa herë ka nxjerrë subjekte të tregimeve të tij nga të bëmat e të parëve tanë. Te ky vëllim, të tilla janë tregimet «Kishin kaiuar njëqind e pesëdhjetë vjet» dhe «Buka dhe thika». I pari pëershruan vdekjen tragjike të Pjetër Budit, i dyti atë të Dhaskal Todhrit, të dy viktima të armiqve shekuillorë të Shqipërisë, viktima të atyre, që kurdoherë kanë synuar ta skillavéronin popullin tonë, të shuanin ndjenjat e tij të flakta për liri dhe kulturë, por që asnjëherë s'kanë mundur e s'do të mundin kurrë t'ia arrijnë qëllimit të tyre.

Edhe në këtë vëllim të ri tregimesh, Shuteriqi mbetet një stilist ndër më të njojurit e letërsisë sónë. Vazhdues i traditave më të mira, ai ka mundur t'i zhvillojë ato më tej nëpërmjet përpunimit të një fraze që ka individualitetin

e vet ndër gjithë krijuesit tanë. Mund të themi se te ky shkrimtar fjala, fraza janë në shërbim të plotë të mendimit dhe kurdoherë arrijnë ta japid në mënyrë të re atë. Tregimet e këtij vëllimi, me ndonjë përjashtim, (kujtojmë si ndër më të zbehtët «Një shfaqje e jashtëzakonshme») në tërësi dëshmojnë për pasuri faktesh jetësore, spikatje karakteresh, tipizmin të fuqishëm të së sotmes dhe të së dëshmes së popullit tonë si dhe për ngjyra të theksuara të asaj që është kombëtare, e jona si në brendinë e tyre ashtu edhe në formën artistike me të cilën i ka veshur shkrimtari.

Për meritat dhe vlerat e veta ideoemocionale, që dalin në pah në mënyrë më të dukshme në tregimet më të mira të përmbledhjes, pa dyshim vëllimi «Një mal me këngë» duhet konsideruar si vëllim i sukseshëm i këtij prozatori tonë të njohur.

1976.

COPEZA NGA JETA

Proza tregimtare e Naum Priftit, e njojur prej vitesh nga lexuesit tanë nëpërmjet disa vëllimeve që ka botuar ky shkrimtar, vjen e pasurohet denjësisht në këtë përbledhje të fundit titulluar «Njerëz të kësaj toke». Rritja e krijimtarisë së prozatorit tonë në gjirin e tij të prefuruar, nuk është rastësore, ajo ka ardhur si pasojë e natyrshme e punës së gjatë, të vullnetshme e me pasion në sajë të së cilës ai ka mundur ta rinojë e ta mbajë të freskët talentin e tij dhe jo vetëm kaq, por edhe ta pasurojë atë.

Kjo tufëz tregimesh të reja mbart, në secilin nga tregimet që e përbëjnë, copëza ngajeta, nga e djeshëmja apo nga e sotmja. Në to lexuesi do të gjejë trimëritë, por dhe vuajtjet e të parëve, do të ndeshë heroizmin partizan dhe zemrën e madhe të popullit, do të njohe tipa dhe karaktere njerëzish të rrallë, ndonëse të zakonshëm e të pabujshëm etj. Madje në tregimet më të mira të vëllimit gjithë kjo pasuri jetësore është e ngritur në art, është derdihur me emocione, është mbrujtur me forcën e mendimit dhe të fjalës së figurshme në atë masë saqë e ka bërë të vibrueshëm qëdo tension emocional të autorit edhe për lexuesin.

Në përgjithësi tregimet e këtij vëllimi janë të thjeshta në subjektet e tyre. Shkrimtari s'u ka kushtuar ndonjë vëmendje të veçantë as fabulave të tyre. Këto veçori dalluese për gjithë krijimtarinë e autorit nuk e kanë penguar atë të realizojë ide të mëdha, karaktere të fuqishme,

vlera ideoemocionale dhe edukative. Madje na duket se pikërisht këto vëçori janë karakteristikë e vetë autorit, e krijimeve të tij më të mira.

Naum Priftin shpesh e ka tërhequr epika e Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në këtë tematikë ai ka realizuar, si rrallë në prozën tonë, tregime të fuqishme emocionalë. Vëllimi «Njerëz të kësaj toke» vazhdon duke e pasuruar këtë aspekt tematik të tregimeve të shkrimtarit, nëpërmjet tregimesh të tillë si «Kapercimi i grykës», «Supa e ushtarëve të huaj», «Përvëlaku me hithra», «Bulina», «Muratori nga Borova» etj. Edhe pse tregime të një teme, problemet që ngrihen në secilin prej tyre, ato fragmentët jete që i gjejmë të plazmuara në çdo njërin nga ata, flasin mëvetësish për epopenë e madhe të luftës, na bëjnë të përjetojmë atmosferën heroike të asaj kohe, kohën vetë në tërë madhështinë shpirtërore të njerëzve tanë që e jetuan dhe e bënë të pavdekshme. Kësisoj, mendoj se më pranë në kuptimin e mirëfilltë të luftës që bëri populli kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, qëndron tregimi «Kapercimi i grykës» ku veçanërisht me interes është figura e partizanit Besho Kësula, por krahas këtij elementi kryesor të realizuar me sukses, tregimit i mungon motivimi për kthesën e masës së fshatarëve në anën e partizanëve kur dimë se Dan Elez Mehmeti, bajraktari, ka mundur t'i mashtrojë e t'i bindë ata, me një propagandë shumë dinake, për t'i kundërvënë me luftën e popullit për clirim. Kjo mungesë ka rrjedhur ngaqë ndoshta do të duhej t'i kushtohej më shumë vend momentit të fundit të tregimit, zgjidhjes së tij, e cila është reale por në tregim s'është mundur të përligjet sa duhet. Në më se njërin nga tregimet që trajtojnë këtë tematikë, autori ka dhënë urrejtjen për armiqtë e huaj të ngjizur bashkërisht me dhimbjen, hidhërimin e thellë për humbjen e lirisë. Diku ky realitet jetësor është transplantuar artistikisht duke u nisur nga pozitat shpirtërore të fëmijës si te tregimi «Supa e ushtarëve të huaj», ku ndërgjegjshmëria për të keqen e okupacionit materializohet në mënyra të ndryshme te fëmija, babai bujk dhe vëllai punëtor në qytet; diku tjetër si te «Bulina» ai merr trajtën

e dhembjes së fëmijëve për qenin e tyre të dashur, që ua vret oficeri nazist dhe diku, si te «Muratori nga Borova» ai merr trajtën e shkatërrimit barbar që i solli pushtimi nazist Shqipërisë qysh në ditën e parë të ardhjes së tij dhe të forcës vitale të njerëzve tanë që e përbuzën atë fuqi të errësirës, i bënë sfidë asaj sado e përbindshme dhe e blinduar në gelik të qe. Ky tregim, ndër më të bukurit e vëllimit, përpos të tjerave, përçon te lexuesi idenë tjetër të rëndësishme të kohës se qenë pikërisht këta, njerëzit si Ligor Pandoja, njerëzit e punës, që iu kundërvunë pushtuesit, përveç arsyeve të tjera edhe sepse vetë elementi bazal i jetës së tyre, puna, krijimi, u ndesh me të kundërtën e saj shkatërrimin që pruri me vete lufta nazifashiste. Me krejt subjektin dhe fabulën që ka kriuar në tregim, autori na bind që Ligori shkoi në mënyrë të ndërgjegjshme drejt rrezikut duke e përbuzur atë dhe ushtarët e vdekjes që e mbartnin pa na kriuar asnjëherë iluzionin ne lexuesve, që ky hap i Ligorit qe një kuturisje, e papeshuar, përkundrazi. Kurse për tregimin «Përvëlaku me hithra» mendoj se me gjithë fabulën origjinale, tregimi nuk sjell ndonjë vlerë ideoartistike për vëllimin se qoftë si ide apo edhe si situatë artistike është shumë e njojur për lexuesin tonë edhe nëpërmjet tregimesh të autorëve të tjerë. Do të përligjej prania e një tregimi të tillë në vëllim nëse shkrimtari idenë e dashurisë së madhe të popullit për partizanët do të mund të na e realizonte me një situatë artistike të re, të vetën. Këtë ne kemi arsyë ta kërkojmë nga tregimtarë si Naum Prifti.

Tregim i qëlluar, me vlera njoħeše dhe forcë artistike kam mendimin se është edhe tregimi «Zjarri pranë kënetës» që zë një pozicion të veçantë tematik në vëllim. Ndryshe nga sa thamë për tregimin «Përvëlaku me hithra» te ky e vërteta e hidhur e mercenarizmit të imponuar të shqiptarëve dhe e lindjes së ndjenjës atdhedashëse në masën e popullit, që edhe kjo është mjaft e trajtuar si temë te rilindasit, ka gjetur një mënyrë kapjeje dhe shtjellimi mjaft origjinal, të freskët dhe interesant qoftë si subjekt apo edhe si realizim karakteresh dhe pasqyrim realist i kohës me dhimbjet e saj të mëdha për vegjelinë.

Vëllimi ka disa tregime që synojnë dhe realizojnë karaktere dhe portrete të njerëzve tanë. Në ta spikat e zoteron në plan të parë fizionomia morale e tyre. Të tillë përfaqësues tipizojnë dhe misherojnë ato veti karakteri që janë përgjithësuesë për njeriun e punës, njeriun e ndershëm. I tillë është Ligor Pandoja i tregimit «Muratori nga Borova», i tillë është edhe Petroja në tregimin «Mermegdhendësi». Në këto lloj tregimesh ku vizatimi i karakterit është kryesorë dhe ngjarja që i materializon tiparet e karakterit vjen më në plan të dytë, se është në funksion të së parës, autori ka mundur të ngrëjë probleme të rëndësishme, të ndriçojë periudha të tëra historike me ngjarje të shumta dhe të ngjeshura, që flasin për historinë e protestës e të luftës së popullit tonë ndonëse përshkruajnë vetëm këndin e ngushtë të jetës së heroit të tregimit. Petroja i tregimit të sipërpërmendur është njëri ndër shumë e shumë të tjerë të klasës së tij. Ai të bën për vete me modestinë e rrallë, me dashurinë për punën, me mosinteresimin e plotë për fitimet nga djersa e mundi i tij aq sa mbi kurriz të tij përfiton tregtari neqez Risto Xhoja. Pasionin për punën prej artisti, prej skulptori të vërtetë, Petroja e kultivon në heshtje për një kohë të gjatë. Ai pasion ndoshta do të ishte mbetur një èndërr e parealizueshme që mund të të vdiste bashkë me mbartësin e saj, sikur të mos e ringjallte koha e zjarrtë, revolucioni ynë popullor që i dha mundësi lulëzimi edhe talentit të këtij mjeshtri popullor, të këtij artisti të vërtetë e të fuqishëm.

Ndonëse i përafërt si natyrë karakteri njerëzor, por krejt në situatë të ndryshme në krahasim me tregimin «Mermegdhendësi» është tregimi tjetër «Përpëra tij vallezonin zogjtë». Shpirti prej artisti i Servetit, protagonistit të tregimit, shpërthen në situata krejt të tjera sociale-ekonomike. Tregimi, përmes episodeve, ravijëzon tiparet artistike të fshatarit të thjeshtë, që i ka rrugët të hapura dhe mundësitë të shumta për t'u bërë artist i njohur, i dashur për popullin e vet. Por sado qe kemi të bëjmë me dy tipa disi të ngjashëm, mendoj se forca skalitëse e penës së shkrimittarit në realizimin e Petros si karakter

është shumë më e arriре se sa nё realizimin e Servetit tё tregimit qё po analizojmё.

Disa nga tregimet me problematikё dhe tematikё nga realiteti ynё socialist si ky qё pёrmendёm lidhur me figuraн e Servetit apo dhe ndonjё tjetёr si «Gjurmё tё njerezve tanё», «Komente pёr njё ngjarje tё vogёl» etj., janё nёn nivelin e tregimeve tё tjera. Nё ta ka interes tё pjesshёm lidhur me fabulen, ka ndonjё moment tё goditur pёr probleme tё luftes sё shoqёrisё sonё nё rrugёn e ecjes pёnpara, ka ndonjё karakter qё nё ndonjёfarё mase është i realizuar, por nё tёresi ato mbeten disi tё cekёta e tё zbehta ndoshta pёr faktin qё si probleme ato janё trajtuar edhe nga autorë tё tjerë tё shumtё apo ndoshta edhe ngaqё autori s'është thelluar sa duhet nё atё realitet, nё ata tipa si edhe nuk është impenjuar nё masen e nevojshme pёr krijimin e realitetit artistik tё fuqishёm si nё tregimet e tjera tё vёllimit.

Pikёrisht kёtё mungesё qё e vёrejмё te tregimet e pёrmendura mё lart, autori e ka superuar me forcё e realizёm ideoartistik nё tregimin e gjatё tё vёllimit «Mjeku i lokalitetit». Mendoj se tregimi ka zbuluar bulkur e me vёrtetёsi aspekte tё jetёs sonё, probleme tё zhvillimit socialist, tipare morale tё njerezve tё ditёve tё sotme dhe tё gjitha kёto janё dhёnё nёpёrmjet luftes pёr pastrimin dhe revolucionarizimin e ndёrgjegjes sё shoqёrisё, nёpёrmjet flakjes sё mbeturinave mikroborgjeze tё trashёgura, flakje qё realizohet pёrimes ndeshjes me mbartёsit e atyre mbeturinave. Qoftё figura qendore e tregimit, mjeku i fshatit Artan Basha, qofshin personazhet e tjera, tё gjithё janё njerez realё qё janё dhёnё nё raporte tё ndryshme marrёdhёniesh, ku spikat vёrtetёsia dhe pёrligjja e plotё. Është ndёr meritat kryesore tё tregimit ajo, qё shkrimtari i ështё shmagur çdo skeme apo shfaqjeje skematizmi duke na i dhёnё ngjarjet e njerezit nё mёnyre tё natyrshme dhe bindёse. Artani nuk është idealizuar si figurë pozitive. Nё raport me kryetarin e pushtetit nё fshat, ai është mbartёs i sё resё, luftetar trim e i guximshёm kundёr miqёsisё sё sёmurё e akraballёkut. Ai s'i trembet kritikёs apo sinjalizimeve shpifёse qё bёn Sadushи, krye-

tari, në komitetin ekzekutiv të rrëthit; ai nuk ndërron në qëndrimin e vet ndaj këtij njeriu të molepsur moralisht edhe pse i kërcënöhët armiqësia e tij. Por edhe pse i tillë, Artani në aspektin tjetër të profesionit të tij, në endrrën «për punë të madhe» në spital etj., ka ato dobësi karakteristike të tij riut që ende ska gjetur si duhet pozicionin e vet në jetë. Ngjarjet, realiteti jetësor, kontaktet me agronomin e fshatit, Eminin, njeri me shumë vullnet e pasion për profesionin e tij e forcojnë Artanin edhe në planin e aktivitetit të tij profesional si një mjek të dashur e të respektuar nga populli edhe pse ai ende është vetëm një mjek i thjeshtë i një ambulance fshati.

Vëllimi «Njerëz të kësaj toke» përpjek vlerave dhe veçorive të tjera, dëshmon edhe për trajtimin original dhe thellësisht kombëtar të problemeve jetësore që ngre apo të tipave shoqërorë përgjithësues që skalit. Në çdonjërin tregim, që flet për të kaluarën e largët apo të afërt, për të sotmen tonë socialistë, gjejmë të derdhura e të mbrujtura artistikisht copëza nga historia përherë e lavdishme e popullit tonë dhe nga realiteti i jetës sonë. Në fatin dhe luftën e shqiptarit të djeshëm, në përpjekjet e tij për pavarësi, në trishtimin e kohës që përshkruan autorin, tingëllon e kaluara e djeshme e hidhur dhe heroike. Copëzat jetësore të epopesë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në tërëlojshmërinë e aspekteve të tyre, në të cilat na i ka dhënë pena e tregimtarit, janë thellësisht të mbrujtura me vetitë, tiparet dhe karakteristikat e jetës sonë. Po kaq shqiptarë janë dhe tipat apo karakteret që ka mishëruar shkrimitari nëpër tregimet e ndryshme duke nisur që me ata fshatarët apo hallë Pepon plakë, që edhe pse e lënë mënjanë s'do t'u bëjë keq fëmijëve të saj, s'do t'i turpërojë ata. Të gjithë janë tipa njerëzorë, realë dhe sa përgjithësues aq dhe të individualizuar në botën e tyre vetjake apo shoqërore.

Pasuria jetësore, gjëresia e problemeve dhe shumë llojshmëria e tyre si dhe tematika e larme që gjejmë në tregimet e vëllimit, janë dhënë në një nivel dinjitoz artistik si në pikëpamje të stilit që dallohet për narracionin e tij të qetë, të rrjedhshëm e të figurshëm, ashtu edhe më-

nyrën origjinale të kapjes së subjekteve, të plazmimit të karaktereve dhe të zgjidhjes së konflikteve. Këto cilësi, që në tregimet më të mira të vëllimit spikasin në mënyrë të ndjeshme, përbëjnë meritat kryesore të tij, dhe e rendisin atë në një radhë me vëllimet më të mira të kohëve të fundit.

1976.

TREGIME TE MBRUJTURA ME NEKTARIN E JETES SHQIPTARE

Çdo vëllim i ri me tregime, fenomen tashmë i rëndomtë por përherë i gjëzueshëmi në jetën tonë letrare, mbart brenda kopertinës së vet disa tregues të rëndësi shëm që flasin për pjekurinë e kësaj gjinie me shumë traditë në prodën tonë të pasçlirimt.

Edhe vëllimi i fundit i Faik Ballancës, «Pritësit e rrufeve», paraqet interes jo vetëm dhe thjesht për tregimet që përfshin, sigurisht kjo anë është ndër më kryesoret, por edhe për tiparet tërësore të tregimeve që përblidhen në të, për fizionominë apo fytyrën e përgjithshme të vëllimit, për shkallën e rritjes së forcës krijuese të shkrimitarit si edhe për vendin që zë ky vëllim në krijimtarinë e autorit. Mendoj se «Pritësit e rrufeve», me tufezën e tregimeve që përban, e përligj plotësish vetveten dhe dëshmon se Faik Ballanca eci me sukses në këtë gjini, në të cilën ai dëshmoi pjekuri talenti, pasurim si në gamën e problemeve që rroku ashtu edhe në karakteret që realizoi përmes situatash jetësore dhe artistike që shpesh i vizatoi, me shumë imprehtësi dhe forcë emocionale.

Në vëllime të tillë me tregime, që udhëhiqen nga mendime të brendshme organizuese për grupe tregimesh apo për tërësinë e përbledhjes, është më e lehtë që të përftohet edhe vlera ideoartistike e tyre, madje është më e lehtë që lexuesi të mundë të kapë atë që është më thelbësorja e më me vlerë nga ajo që ka një nivel relativisht më të ulët realizimi ideoartistik.

Mendoj se si element që spikat në mënyrë të veçantë te ky vëllim i Faik Ballancës është fantazia krijuese shumë më e begatë e tij në krahasim me vëllimet e mëparshme. Trilli artistik i prozatorit ka fituar këtu cilësi e vlera që i kanë pasuruar tregimet duke rritur forcën përgjithësuesë të tyre, forcën emocionuese pa u shkëputur por duke qëndruar përherë i lidhur ngushtë me realitetin jetësor, me atë që ka qenë apo është tipike për karakterin e popullit tonë, për vlerat morale e shpirtërore të tij.

Në këtë vështrim të tërheqin vërejtjen në mënyrë të veçantë tri krijime në vëllim e pikërisht tregimet «Pritësit e rrufeve», «Dehje» dhe novela «Kënga e fundit e Marko Boçarit». U ndalëm te këto tri krijime jo se gjetë kë në vëllim s'e gjejmë këtë tipar, por se këtu ai dallohet disi më dukshëm dhe së dyti, i grupuam këto krijime bashkë edhe për afri në tematike të tyre.

Tregimet që cituam marrin shtysë nga e kaluara historike e popullit tonë dhe rrabin të venë në qendër figura heroike luftëtarësh për liri, që u flijuan në altarin e saj në emër të dashurisë për atdhe. Këto figura të ndritura heronjsh i përjetësoi folklori, gjenia e fryshtuar e popullit, në këngë të shumta, në legjenda dhe gojëdhëna që janë brilante të shpirtit poetik popullor. Kjo pasuri gojore ka fryshtuar dhe shkrimitar tonë dhe e ka shtyrë atë që në krijimet e veta, në tregimet apo novelën e cituar, t'i japë krah fryshtimit të tij, fantazisë krijuese, në atë masë saqë të na derdhë të ngritura në art momente të fuqishme të akteve sublime të heronjve, ku përshkohet mendimi i shëndoshë e i vërtetë popullor se këto figura i lindi populli nga gjiri i tij dhe ata s'u shkëputën prej tij, por rrjitën dhe u flijuan për të, ndaj dhe ai i lartësoi në pavdekësi.

Gjoleka, Hodo Nivica, Thanas Vaja apo Marko Boçari, që i ndeshim respektivisht në të tri krijimet, kanë tiparet dalluese të tyre, kanë madhështinë që u fali populli, por kanë edhe të përbashktën që i lidh e i vendos në një vijë tiparesh heroiko-legjendare, e cila buron nga fakti që shkrimitari jo vetëm ka njobur historinë, realitetin historik ku ata vepruan, por ka njobur edhe konsideratën

poetike me të cilën populli mbështollti emrat e tyre. Kjo ka bërë që në këto tregime fantazia krijuese të marrë krah dhe të mbisundojë mbi elementin real por pa e dëmtuar atë, përkundrazi duke i dhënë një bukuri të veçantë, një ngjyrë të theksuar legjendaro-romantike, e cila me gjithë sa thamë, te novela ndoshta do të qe më mirë të qe disi më e kursyer.

Edhe pse tregime të kësaj natyre, tek ata është i pranishëm, madje i theksuar më së miri, elementi real, elementi thelbësor i kohës, ai që i lartësoi këto figura bijsh të popullit, pra kontradikta antagonistë, përplasja e fuqishme e kohës me armikun pushtues. Në zërthimin e asaj kontradikte, në transplantimin artistik të saj si konflikt letrar, zërthehen vlerat e figurave të heronjve. Te «Pritësit e rrufeve» të mbetet i gjallë në përfytyrim, veç të tjerëve, edhe Rapushi, ai fshatari i thjeshtë që me tiparet e tij prej, shqiptari trim e sypatrembur u vë gjoksin e sharkun e vet të lagur gjyleve të artilerisë turke. Në mend të mbetet fakti tjetër kuptimplotë i dashurisë dhe dhembjes së Hodo Nivicës e Gjolekës për labin e panjohur që vdiq në krahët e tyre. Janë këto të bëma trimash që e mbushin me forcë, me besim Gjolekën se ky grusht burrash, ky grusht shqiptarësh është i pamort për heroizmin e fuqishëm, që i karakterizon.

Tregimi i dytë i kësaj tematike, që titullohet «Dehje», synon më tepër të zbulojë dinakérinë e halldupëve dhe intrigat e tyre në dëm të lirisë dhe të përpjekjes së shqiptarëve për shkëputje nga sundimi i huaj. Edhe pse në këtë sens vështrimi të problemit, tregimi i zbulon vettitë trimërore si edhe tiparet e tjera morale të të parëve tanë. Në to të bie në sy sidomos përbuzja e thellë ndaj intrigave të shëmtuara që kurdiste Stambolli.

Novela me shtrirjen e saj më të gjerë, ka mundur që me më shumë detaje, me më shumë episode të zbulojë po këto elemente etiko-morale, por këtë radhë të pikëzuarë te Marko Boçari, heroi i shquar i revolucionit grek, luf-tëtar sypatrembur për qirimin nga tirania turke, që provoi hidhërimin e kurbeteve të imponuara nga armiku dhe nga urejtja e tij për armikun. Kaq e thellë dhe e paanë

qe kjo ndjenjë te fatosi shqiptar, te suljoti trim, saqë ai luftoi kudo e përkrah të gjithë atyre popujve që luftuan robërinë turke, robëri që si napë e zezë, rëndonte edhe mbi kryet e popullit të tij. Novela arrin kulmin e forcës së saj në monologun e heshtur para vdekjes që shqipton nën zë Markoja, ku tingëllon e zbulohet më mirë se kudo dashuria e tij për atdheun, Sulin e tij të largët dhe për popullin, «*gjaku i të cilit është shprishur dhe rrjedh në-për Ballkan*», siç këndon heroi ndërsa shokët e mbartin në vig për të varrosur në fortifikatën «Gjergj Kastrioti» ku ai do të prehet përjetësisht.

Në vazhdë të natyrës luftarake, trimërore dhe liridashëse të popullit tonë, epoka që u dha shkëlqimin e pamort traditave më të mira të së kaluarës, që kurorëzoi me triumf gjithë ato përpjekje e heroizma qe ajo e Luftës Antifashiste Nacionallirimtarë. Tregimet që në vëllim marrin subjektin nga ato vite dhe ngjárje janë: «Pse s'qëllon kjo pushka ime» dhe «Një çast i vogël harrese». Te i pari forca e krijimit artistik është më tingëlluese, ndodhia sado e thjeshtë është më komunikuese në pikëpamje emocionale dhe gjetja artistike është më e qëlluar. Edhe pse kemi njojur edhe shumë tregime të tjera ku ndihet dëshira e të miturve për të luftuar bashkë me të rriturit për çlirimin nga okupatorët nazifashistë, prapë, te tregimi që gjemjë në këtë vëllim ka shumë origjinalitet në trajtimin e subjektit, në thjeshtësinë e paraqitjes së ndodhisë që mbart idenë e bukur të heroizmit masiv. Vdekja e djaloshit të mitur, Ahmetit, me atë shqetësimin e tij naiv se i duket sikur pushka e tij nuq qëllon ngaqë nuq ia dëgjon krismën, se shpërthimet e tjera janë shumë më të fuqishme, përbën një detaj artistik shumë të qëlluar e të gjetur nga shkrimitari.

Ndërsa tregimi «Një çast i vogël harrese» edhe pse qëndron si ide, si vërtetësi fakti jetësor dhe për tingullin e vet përherë aktual, nga që s'e ka sa duhet forcën e trillimit artistik, në masën që ky të përgjithësojë dhe pasurojë ideoemocionalisht të vërtetën jetësore, mbetet më i parerealizuar në përgjasje, me tregimin e parë të kësaj temë. Ato pak digresione përmes zberthimit psikologjik të

personazheve s'kanë mundur ta ngrejnë sa duhet vlerën artistike të këtij tregimi.

Në një radhë tregimesh, në vëllim autorit ka synuar të na vizatojë portrete njerëzish të kohës sonë. Këtë konkluzion e nxjerrim nga fakti se me gjithë që tregimet janë ndërtuar mbi konflikte jetësore herë-herë të forta e të mprehta, me gjithë episodet që radhiten e shpalosen në ta, synimi krijues i shkrimitarit është skalitja e tipareve morale, e vëtive të karakterit të njeriut tonë. Në to zbulohet e përgjithshmjë, tipikja e bashkëkohësve tamë, fisnikëria shpirtërore e shqiptarit, të cilin Partia e ngriti më lart se kurrë në vitet heroïke të Luftës dhe të ndërtimit të socialistit. Kështu, duke i vështruar radhazi këto tregime në vëllim, lexuesi lehtësisht mund të dallojë vlera shpirtërore të popullit, të mishëruara te përfaqësues të ndryshëm për periudha të ndryshme të zhvillimit tonë historiko-shoqëror.

Sulo Kandra, hero i tregimit «Qitesi me qeleshe të bardhë», është portreti i njeriut të thjeshtë që me zemrën e tij të madhe të rrëmben, të bën për vete. Ndjenja e sakrificës, e vetëmohimit është krejt e natyrshme për të. Një radhë veprimesh të tij, flasin pikërisht për atë madhështi shpirtërore krejt të heshtur e të pabujshme që është tipike për popullin tonë. Po kështu interesant është për këtë aspekt që po diskutojmë edhe xha Saliu i tregimit «Im ungj Saliu». Edhe pse si tip shoqëror i njohur ky në letërsinë tonë të sotme, prapë ka interes se autorit na e ka dhënë në situata dhe episode origjinale të gjetura. Xha Saliu nuk kursehet për të mirën dhe pasurinë e përbashkët. I heshtur ndonjëherë deri dhe enigmatik, ai jepet me pasion pas punës. Gëzimi i tij është gëzimi i gjerrë, i madh shoqëror. Asgjë s'e aftron xha Salin me ndjenjën mikroborgjeze të interesit vetjak. Madje ai me pastërtinë e tij morale arrin deri aty sa të dënojë edhe kolegun e tij për ndonjë shfaqje të ndjenjave mikroborgjeze. Autori duke na vizatuar një xha Salit të tillë, të heshtur e të thëthitur plotësisht pas punës, ka mundur që në momente të tjera ta ndriçojë atë si njeri që i do njerëzit, e do shoqërinë, gëzimet e jetës, për të cilat jepet pas punës me

mish e me shpirt. Kështu ne kemi një figurë të realizuar të një bashkëkohësi plot ndjenja të bukurë, të ushqyera nga humanizmi ynë i ri, humanizmi socialist. Megjithëkëtë vlerë, mendoj se tregimi do të qe më i arriрë artistikisht nëse do t'i qe shmangur ndonjë situate të përsëritur apo ndonjë digresioni shpjegues, që është krejt i tepërt dhe i panevojshëm.

Në situatë, periudhë e problematikë të ndryshme shoqërore është dhënë portreti i Salikos, në tregimin «Dy hapa larg vdekjes». Te ky karakter ndërthuren ndjenja e dashurisë për pasurinë e popullit me dashurinë për njeriun. Saliokoja këto ndjesi morale nuk i ka të rastit apo thjesht të lindura. Ato janë kultivuar tek ai gradualisht dhe kanë ngjyrën e kohës. Ai urren revolucionistët sovjetikë, që braktisën punën e përbashkët, dhe kjo urrejtje i jep forcë të atillë shpirtërore saqë ai të rrezikojë edhe jetën për të shuar pusin që digjef filakë.

Në ndonjë tregim, si te «Ai burrë që desh m'u bë dhëndër», autori ka vizatuar tipin e kundërt me portretet e më sipërm, tipin e armikut të klasës, që iu kundërvu të resë, revolucionares, që në ditët e para të pasçlirimit kur Republika e porsalindur po hapte rrugët e para, po vinte piketat e para të së ardhmes socialiste. Ganiu, personazhi qendror negativ i tregimit, mishëron në mënyrë të theksuar dinakérinë, hipokrizinë e falsitetin e njeriut që mbron me fanatizëm të vjetër, sado që koha punonte në dëm të saj. Ashtu siç është e natyrshme për këta tipa, ai është edhe frikacak, ndonëse këtu kam mendimin se shkrimitari s'ka arritur ta motivojë sa duhet rënien e tij në grackë. Më brenda lëkurës së vet mendoj se qëndron i ati i Ganiut, Sefë kallabaku, që me natyrën e tij prej shtaze të bën ta urresh e të ndjesh pështirosje.

Të katër këto tregime ruajnë një raport të drejtë midis elementeve jetësore që janë derdhur në to dhe trillit artistik krijues të shkrimitarit. Në përputhje me këtë raport, te këto të katërtë si dhe më të gjitha tregimet e vëllimit, del i qartë dhe në mënyrë të theksuar qëndrimi tendencios i shkrimitarit dhe synimi i tij për të rilevuar më tepër pozitiven, heroiken, atë që duhet mbajtur si shem-

bull në jetë prej secilit nga ne dhe veçanërisht prej rinisë sonë.

Me interes është në vëllim tregimi «Në rrëfim». Them kështu duke mbajtur parasysh faktim që kjo temë shumë e njojur në krijimet tona të viteve të fundit, te ky tregim ka gjetur trajtim të ri sidomos në planin e demaskimit të bashkëveprimit të forcave të errëta, priftit Dom Llesh Nika me kapidanin. Demaskimi i priftit nëpërmjet paraqitjes së figurës së tij, te ky tregim është konceptuar në mënyrë të re. Ai, prifti, është vizatuar realisht si tipi i klerikut pa personalitet, vegël në duart e bajraktarit, që është gati të lehë për atë padron e të lëpижë atë dorë që i hedh koskën. Prifti i zhveshur nga shenjtëria e tij është dhënë si njeriu më i pashpirt, i gatshëm për çdo intrigë në kurri zë varfër.

I imprehtë në konfliktin që ka të vendosur në qendër të vet është edhe tregimi «Një pëllëmbë tokë» ku nënvízohet mendimi se ndjenja e pronës jo rrallë ka arritur deri aty sa të mbjellë edhe vëllavrasjen. Por edhe pse i tillë në konflikt, tregimi vuam në pilkëpamje të forcës së mjeshtërisë artistike. Situatat e ndërtuara nga shkrimtari janë të zbehta, të pafuqishme e disi libreske, sidomos e tillë tingëllon korniza e tregimit. Në sens të kundërt mendoj se i duhet bërë vërejtja tregimit «Gjah me thëllëzë», ku problemi i situatave që përcojnë te ne vlerat ideoemocionale është i zgjidhur por që për natyrën e tij të veçantë, si tregim ku s'vihet re po ajo problematikë e madhe sociale, më duket disi i huaj për vëllimin, që në tërësi ka fizionominë e vet qartësisht të dukshme si një vëllim problemor, i mbushur me pasqyrimin e konflikteve nga më të ndryshmet të jetës sonë të sotme apo të traditës, i mbushur me botën e pasur e të shumëllojtë shpirtërore të shqiptarit të sotëm e të djeshëm.

1976.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
I. PROBLEME TË PROZËS SONË TË GJATE	3
Zhvillimi revolucionar i realitetit dhe pasqyrimi i kontradiktave të tij në prozën tonë.	5
Për të mbajtur përherë të pastër brendinë socialiste të letërsisë sonë.	16
Kombëtarja në karakteret dhe ambientet e disa romaneve të viteve të fundit.	23
Mbi problemin e tipikës në romanin tonë.	37
Qëndrimi ideoemocional i autorit dhe vendi që zë ai në disa romane.	50
Klasa punëtore dhe botëkuptimi i saj në disa romane.	59
Problemi i heroit pozitiv në disa romane me temë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.	67
Mendime mbi disa nga format më të njoitura të romanit tonë.	78
II. ANALIZË VEPRASH TË VEÇANTA NË PROZË.	85
Vitet e Rilindjes në faqet e një romani.	87
Vërtetësia jetësore dhe origjinaliteti në romanin «Shëmbja e idhujve».	100

Roman për rritjen e ndërgjegjes klasore.	110
Roman me vlerë për ditët e zjarra të historisë sonë.	116
Lufta për bukën në faqet e romanit «Përballimi».	126
Roman për pranverën tonë socialiste.	140
«Erë pranverore», roman për jetën e fshatit tonë të sotëm.	149
Roman për jetën e familjes sonë të re.....	155
Probleme të zhvillimit të novelës të viteve të fundit.	165
Tri novelat e para të një autori të ri.	175
Ngjarje dhe tipa shqërorë në një vëllim me tregime.	182
Copëza nga ijeta.	188
Tregime të mbrujtura me nektarin e jetës shqiptare.	195
.....	200
.....	205
.....	210
.....	215
.....	220
.....	225
.....	230
.....	235
.....	240
.....	245
.....	250
.....	255
.....	260
.....	265
.....	270
.....	275
.....	280
.....	285
.....	290
.....	295
.....	300
.....	305
.....	310
.....	315
.....	320
.....	325
.....	330
.....	335
.....	340
.....	345
.....	350
.....	355
.....	360
.....	365
.....	370
.....	375
.....	380
.....	385
.....	390
.....	395
.....	400
.....	405
.....	410
.....	415
.....	420
.....	425
.....	430
.....	435
.....	440
.....	445
.....	450
.....	455
.....	460
.....	465
.....	470
.....	475
.....	480
.....	485
.....	490
.....	495
.....	500
.....	505
.....	510
.....	515
.....	520
.....	525
.....	530
.....	535
.....	540
.....	545
.....	550
.....	555
.....	560
.....	565
.....	570
.....	575
.....	580
.....	585
.....	590
.....	595
.....	600
.....	605
.....	610
.....	615
.....	620
.....	625
.....	630
.....	635
.....	640
.....	645
.....	650
.....	655
.....	660
.....	665
.....	670
.....	675
.....	680
.....	685
.....	690
.....	695
.....	700
.....	705
.....	710
.....	715
.....	720
.....	725
.....	730
.....	735
.....	740
.....	745
.....	750
.....	755
.....	760
.....	765
.....	770
.....	775
.....	780
.....	785
.....	790
.....	795
.....	800
.....	805
.....	810
.....	815
.....	820
.....	825
.....	830
.....	835
.....	840
.....	845
.....	850
.....	855
.....	860
.....	865
.....	870
.....	875
.....	880
.....	885
.....	890
.....	895
.....	900
.....	905
.....	910
.....	915
.....	920
.....	925
.....	930
.....	935
.....	940
.....	945
.....	950
.....	955
.....	960
.....	965
.....	970
.....	975
.....	980
.....	985
.....	990
.....	995
.....	1000

